
Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti X (XXIV) - Nr. 33 (186) ISSN: 2305-655X

SHKENCA ISLAME | SOCIOLOGJI | PSIKOLOGJI | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

33

2021

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI I (XXIV) 2021, NR. 33 (186)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2021

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI X (XXIV), korrik - dhjetor 2021 nr. 33 (186)

Nën kujdesin e: H. Bujar Spahiu

Drejtor: Dorian Demetja

Kryeredaktor: Dr. Genti Kruja

Bordi editorial: Prof. Dr. Ferdinand Gjana, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, Universiteti Bedër
Dr. Skender Bruçaj, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
PHD. Cand. Elton Karaj, Universiteti Bedër
H. Jusuf Zimeri, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut
MA. Ramadan Shkodra, Bashkësia Islame e Kosovës

Redaktor: Andrin Rasha

Në anglisht: Msc. Xhorxhina Seferi, Universiteti Bedër

Zani i Naltë

Bordi shkencor: Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati
Prof. Asoc. Tidita Abdurrahmani, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Prof. Asoc. Dr. Majlinda Peza-Perriu, Universiteti “Al. Xhuvani”, Elbasan
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Ana Uka, Universiteti Bedër
Dr. Agron Tufa, Zvicër
Dr. Ardian Muhaj, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike
Dr. Atakan Derelioglu, SHBA
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Ilirjana Kaceli, Universiteti Bedër
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, Medreseja e Tiranës
PHD. Cand. Hysni Skura, Universiteti Bedër
MS/MA Fatos Kopliku, Washington DC, SHBA
MA. Sabri Bajgora, Instituti për Hulumtme dhe Studime Islame, Prishtinë
Msc. Agron Hoxha, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Msc. Lorela Shehu, Universiteti Florida
H. Resul Rexhepi, Prishtinë
Xhemal Balla, Tiranë

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi / Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Ejup Lila

Fotoja në kopertinë: Xhami Plakë e Ali Hajdarit, Kavajë, vitet 20’, foto AQSH

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50, Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al

Web: www.zaninalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Aspektet sociologjike në Kur'an (Xhuzi i XXV-të),
Msc. Ada Qama, Medreseja e Tiranës "H. Mahmud Dashi".....7
2. Roli i gruas në Islam dhe sfidat e ditëve të sotme (shekulli XXI),
**Msc. Valdrin Mera, Departamenti i Shkencave Islame,
Universiteti Bedër.....16**

Studime

3. Biologjia Moderne si Shprehje Kulturore,
Fatos A. Kopliku, Ann Arbor, Michigan, SHBA.....27
4. Reflektime nga të dhënat demografike për popullsinë myslimane në botë,
**Msc. Ilir Akshija, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë,
Shërbimi i Statistikës.....49**

Histori

5. Medresetë në Kosovë gjatë periudhës osmane,
Dr. Sadik Mehmeti, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.....56
6. Politika e PPSH-së kundër besimeve fetare: masat me karakter ligjor dhe
fushata propagandistike në vitin 1967,
**Msc. Xhorxhina Seferi, Departamenti i Shkencave Islame,
Universiteti Bedër.....66**

Pedagogji Islame

7. Tezat më të rëndësishme në çështjen e edukimit të fëmijëve tanë,
Prof. Ahmed Muadh el Hatib.....90

Sociologji Islame

8. Çështjet sociale të gjendura në vargjet (ajetet) e Kur'anit Fisnik,
Prof. Dr. Sadije Bushati.....113

Shkenca Komunikimi

9. Roli i gruas në edukimin e brezave, bazuar në revistat kulturore islame,
Dr. Ilirjana Kaceli, Departamenti i Drejtësisë, Universiteti Bedër.....143

Përthime

10. Kur'ani dhe sufizmi,
William C. Chittick.....156

Recencë

11. Recencë mbi librin “Hoxhë Kadri Prishtina Mendimtar Islam” me autor
z. Qemajl Morina,
Refik Gerbeshi, Prishtinë.....171

Personalitete

12. H. Hafiz Dr. Hasan Kaduku, një hafiz Kur'ani, mjeku i parë stomatolog shqiptar,
Dr. Genti Kruja, Departamenti i Shkencave Islame, Universiteti Bedër....177

Retrospektivë

13. Pse duhet te jemi fetar.....183
14. Abstracts in English.....187
15. Rregullat e shkrimit.....194



Aspektet sociologjike në Kur'an Xhuzi i XXV-të

Msc. Ada Qama
Medreseja e Tiranës “H. Mahmud Dashi”

Abstrakt

Sociologjia, si një nga shkencat më të rëndësishme humane, ka në fokus të studimeve të saj njeriun si një qenie sociale, si dhe shoqërinë në të cilën ai bën pjesë. Kështu, ajo e analizon njeriun në të gjitha episodet e ndërveprimit të tij social dhe domosdoshmërisht formon kështu një lidhje të ngushtë me të gjitha shkencat e tjera humane, si psikologjia sociale, antropologjia, filozofia, folklori, historia, teologjia, etj.

Një ndër nënlojet e sociologjisë është edhe sociologjia e fesë, e cila shqyrton ndërlidhjet që ekzistojnë midis strukturave shoqërore dhe feve të ndryshme, duke identifikuar aspektet e tyre besimore, praktikat dhe format e organizimit të besimeve fetare përmes metodave dhe disiplinave sociologjike.

Librat hyjnorë janë një burim i pashtershëm i tablove të shoqërisë së njerëzimit përgjatë periudhave të ndryshme historike, prandaj, parë nga ky këndvështrim, ato janë ndër pikat kyçe që tërheqin interesin e studimesve të sociologjisë së fesë.

Në këtë punim, në formë të shkurtuar dhe përmbledhëse, do të paraqesim disa nga aspektet sociologjike që përmbahen në xhuzin e njëzet e pestë të librit të shenjtë të fesë islame, Kur'anit.

Fjalët kyçe: sociologji e fesë, aspekt sociologjik, individ.

Hyrje

Kur'ani është një libër hyjnor i zbritur për t'u treguar njerëzve rrugëtimin më të drejtë e më të dobishëm drejt lumturisë së të dyja botëve. Nga fillimi, deri në fund, ai përmban shëmbëllimet dhe përshkrimet më të sakta rreth veçorive të qenies njerëzore dhe shoqërisë në të cilën ajo vepron. Është e pamundur të tregosh një ajet të Kur'anit që nuk i drejtohet njeriut, apo që nuk i dedikohet zgjidhjes së problemeve që e mendojnë atë nga lindja deri në vdekje. Duke qenë se ai është i gjithi një Libër *për njeriun*, atëherë në cilindo xhuz të tijin, të marrë në hulumtim, do të vëresh se si përvijohen çështje me interes të gjerë studimi për sociologët e fesë.

Megjithëse, ekziston një përshtypje e përgjithshme sipas së cilës xhuzet e para të Kur'anit, apo xhuzet që përmbajnë sure medinase, shpalosin më tepër tema sociologjike, kjo nuk do të thotë se është e vështirë të nxjerrësh në pah çështje sociologjike që u përkasin sureve të shpallura në periudhën mekase të profetësisë. Stili i thukët i Kur'anit është i tillë që mundëson reflektimin e shumë kuptimeve brenda një numri të kufizuar fjalësh.

Xhuzi i 25-të, që do të marrim në shqyrtim, fillon nga ajeti i 47-të i sures Fusilet, deri te ajeti i fundit i sures Xhathije. Suret që përfshihen

në këtë pjesë të Kur'anit janë: Fusilet, Shura, Zuhruf, Duhan dhe Xhathije.

Në punimin tonë nuk do t'i përmendim me detaje të gjitha tematikat sociologjike të xhuzit, por do të ndalemi në interpretimin e vetëm disa më të spikaturave. Do të përfshijmë kështu hapjen e disa ajeteve, që flasin mbi konstruktin social të unit, lirinë e besimit, etikën e të punuarit në bashkëpunim, menaxhimin e konflikteve, ndjekjen në mënyrë të verbër të paraardhësve, etj.

Surja Fusilet: Konstrukt social i "Vetvetes/Unit" dhe Teoritë e Atribuimit

"E nëse pas të këqijave që e goditën, Ne i japim të mira nga ana Jonë, ai me këmbëngulje do të thotë: 'Këtë e kam arritur vetë (këtë do ta kem gjithnjë), e nuk mendoj se do të bëhet kiameti, po, edhe nëse do të kthehem te Zoti im, unë tek Ai do ta kem edhe më mirë!"¹

Në Kur'an dhe në literaturën islame, dukuria e përshkruar nga ky ajet i sures Fusilet ilustron me shembuj konkretë të ndryshëm. Tregimi rreth Karunit, i cili jetonte në kohën e profetit Musa dhe zotëronte në mënyrë të përsosur dijet e Teuratit, është njëri prej tyre.

1. [https://www.Kur'an-index.com,\(16.01.2021\).](https://www.Kur'an-index.com,(16.01.2021).) Kur'an, Fussilet 41:50, përkthimi i Sherif Ahmetit.

Ndërsa përshkruhet tejet i pasur, i fuqishëm dhe i ditur, Karuni ua dedikon aftësive të veta gjithçka që posedon dhe kjo e shtyn atë në një qëndrim arrogant dhe shpërfillës ndaj bashkëkohësve të vet derisa meriton ndëshkimin hyjnor.

Ajeti i mësipërm paraqet gjithashtu një fenomen social që është lehtësisht i dallueshëm në çdo kohë dhe në çdo shoqëri. Shpeshherë njeriu priret drejt qëndrimeve individualiste dhe i ushqen vetes idenë se është i meritueshëm në mënyrë të mëvetësishme kur vjen fjala te sukseset që mund të arrijë. Sociologët dhe psikologët socialë kanë konstatuar disa aspekte interesante të çështjes dhe thonë se njeriu ka tendencën t'ia atribuojë karakteristikave të veta personale arritjet, ndërsa dështimet që pëson i lidh gjithnjë me faktorë të jashtëm, që nuk janë në dorën e tij.

Përkundrazi, kur bëhet fjalë për të tjerët, ai nuk ngurron t'i minimizojë shkaqet e jashtme ndikuese dhe të paragjykojë drejtpërsëdrejti individin që ka përballë për mangësitë e tij të mundshme, apo për humbjet e grupit.

Ç'ë do se në të vërtetë ka një sërë faktorësh, që ndikojnë në arritjet personale, apo kolektive të një individi, apo një grupi shoqëror. Shnajder e përkufizon shoqërizimin si procesin e të mësuarit se si të sillesh në mënyrë efektive në grup dhe se

si të përshtatesh me një kulturë të caktuar.² Prej këtej, bëhet e qartë se individi i përfshirë në shoqëri nuk mund të konsiderohet më gjatë si një strukturë individualiste: ai ndërvepron me njerëzit që e rrethojnë dhe ndan me ta rezultatet e përvojave të përbashkëta.

Surja Shura: Liria e mendimit, besimit dhe ndërgjegjes

“Po sikur të kishte dashur Allahu, do t'i bënte ata (njerëzit) një popull (të një feje), por Ai shtie në mëshirën e Vet atë që do (atë që me vullnetin e vet pranon rrugën e drejtë).”³

Thelbi i çështjes islame për lirinë fetare është vizioni i Kur'anit për qenien njeri. Antropologjia e Kur'anit e shikon çdo qenie njerëzore si një krijim të Zotit, të bekuar me intelekt dhe vullnet të lirë. Zoti i krijoi njerëzit **“në formën më të mirë”** (95:4) dhe duke vepruar kështu e nderoi njerëzimin dhe i dha atij favore të veçanta (17:70). Kur'ani thekson se qeniet njerëzore kanë vlerë dhe dinjitet të qenësishëm. Për më tepër, deklarohet se Zoti i dha njerëzimit

2. Yeh, C. J., & Hunter, C. D. (2004). The socialization of self: Understanding shifting and multiple selves across cultures. In R. T. Carter (Ed.), Handbook of racial-cultural psychology (Vol. 1, pp. 78-93). John Wiley: New York.

3. <https://www.Kur'an-index.com>. Kur'an, Shura 42:8.

intelektin dhe aftësinë për të dalluar midis së mirës dhe së gabuarës (17:15; 6:104).⁴

Është pikërisht liria e mendimit, e cila është pjesë e natyrshmërisë së krijimit të njeriut, që shpall të drejtën e tij për të besuar atë që i duket më e pranueshme dhe përmbushëse e nevojave të veta shpirtërore.

Disa parime mbi zgjedhjet dhe procesin e vendimmarrjes në shoqëri

1. “Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona e ju të veprave tuaja”⁵

Ky ajet mendohet se ka zbritur rreth Uelid bin Mugires dhe Shejbe bin Rabias. Ata i patën kërkuar Profetit (a.s.) që të hiqte dorë nga ftesa për në Islam dhe të kthehej në fenë e të parëve, ndërsa në këmbim i patën propozuar gjysmën e pasurisë së Uelidit dhe martesën me vajzën e Shejbes.⁶ Ndërkohë, Allahu e urdhëron Profetin që të mos u përshtatet dëshirave të tyre dhe të përqendrohet në atë çka i është urdhëruar.

Nëse do ta shihnim këtë ajet në aspektin e vet sociologjik, ia vlen të

4. <https://www.abc.net.au/religion/religious-freedom-in-islam/10419798> (23.01.2021).

5. Kur'an, Shura 42:15.

6. Çetiner Prof. Dr. Bedreddin, (2002). *Fatiha'dan Nas'a: Esbab-ı nüzul Kur'an Ayetlerinin İniş Sebepleri* (s.775). Çağrı Yayınları. İstanbul.

përmendim se sociologët dallojnë dy arsye kryesore pse njerëzit rezultojnë në sjellje konformiste, që i shtyjnë të ndryshojnë vendimet e marra. Të dyja kanë lidhje me influencën, apo presionin shoqëror që individi ndjen të ushtrohet mbi të.

Influenca sociale normative përshkruhet si dëshira e personit për ta bërë veten të pranueshëm tek të tjerët. Në këtë rast, individi synon miratimin e një grupi të caktuar, nuk do të duket qesharak përpara tyre dhe kërkon të arrijë një identitet të vetin. Ekziston dhe influenca sociale informative, e cila në ndryshim nga e para vjen pas një procesi të logjikshëm të të menduarit. Tashmë, konformizmi ndodh i motivuar nga fakte bindëse, që i parashtrihen personit: ndryshimi i sjelljes së tij premtan një përmirësim të vendimit, apo gjykimit fillestar.⁷

Përmes shembullit të Profetit islam dhe qëndrimit të tij dinjitoz karshi alternativave që i parashtroheshin për të ndryshuar objektivat e tij, njeriu i ditëve të sotme mëson mbi një etikë të vendimmarrjes. Sipas kësaj etike, zgjedhjet e gjithsecilit duhet të kenë një argument më të vlefshëm sesa tekat e një grupi të caktuar njerëzish; ato janë më të rëndësishme sesa një trend i çastit dhe nuk ndryshohen

7. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4718651> (20.01.2021).

pa qenë nevoja. Po ashtu, së bashku me planifikimin e punëve llogariten dhe përgjegjësit, që linden syresh, prandaj edhe hapat, që do të hidhen më tej duhet të jenë të mirëmenduar.

2. **“Dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta.”**⁸

Konsultimi përpara marrjes së një vendimi është një praktikë që sa vjen dhe po merr një trajtë të zyrtarizuar në shumë vende pune, në shtete të ndryshme të botës. I njohur si konsultimi etik⁹, ai konsiderohet i domosdoshëm për të mbërritur në zgjidhje efektive të problemeve dhe në produktivitet të lartë të punëve. Ky lloj konsultimi zhvillohet me njerëz të fushave të ndryshme, por të tillë, që mund të kontribuojnë përmes përvojave të tyre dhe dhënies së mendimeve. Gjithashtu, ata duhet të jenë dëgjues të mirë, ndërsa vendimi final i takon gjithnjë personit që zgjedh të këshillohet.

Këshillimi në Islam është praktikë e lavdëruar në Kur'an (ensarët janë përgëzuar për shkak të kësaj veçorie në ajetin e mësipërm) dhe metodikë e të gjitha veprimtarive të Profetit dhe shokëve të tij.

8. Kur'an, Shura 42:38.

9. Për më tepër shih: <https://www.socialworker.com/feature-articles/ethics-articles/ethics-alive-using-ethics-consultation-what-why-when-who-how>.

Rreth formave dhe kufijve të ndëshkimit, menaxhimi i konflikteve

“Ndëshkimi i së keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek All-llahu.”¹⁰

Në fenë islame, konfliktet janë parë si ngjarje të paevitueshme, përderisa janë pjesë e natyrës njerëzore, por duhet nënvizuar se vëmendja është përqendruar kurdoherë te mendimi se menaxhimi i tyre në një mënyrë të përshtatshme u jep konflikteve një *karakter pozitiv*. Falë ekzistencës së konfliktit lehtësohet gjetja e zgjidhjes së shumë problemeve, ndërsa nxitet pasurimi me ide dhe debati konstruktiv. Modeli proaktiv në menaxhimin e konflikteve është ndër modelet më të spikatura për zgjidhjen dhe stabilizimin e situatave problematike.¹¹

Sipas këtij modeli synohet mënjanimi i përplasjeve të mundshme nëpërmjet një qëndrimi proaktiv. Qasja është e tillë që konsiston në vlerësimin e detajuar të situatës, diagnostikimin e problemit, planifikimin e zgjidhjes dhe veprimin

10. Kur'an, Shura 42:40.

11. Helmy, Sh., Labib, A., & AbouKahf, A., (2014). The Impact of Islamic values on interpersonal relationship conflict management in Egyptian business organizations “an applied study”. *Procedia - Social and Behavioral Sciences* 143 1090 – 1110.

në një mënyrë të institucionalizuar.

Ekzistojnë një sërë sugjerimesh në kuadër të eliminimit të mosmarrëveshjeve në Islam. Duke anuar gjithnjë nga paqja, besimtari nxitet për sjellje të mira dhe etike si një formë parandaluese për keqkuptime dhe gërricje në shoqëri. Të treguarit i durueshëm dhe falës, këshillimi për çështjet që duhen trajtuar me kujdes, të porositurit të njëri-tjetrit veç për mirë¹², pranimi i një pale ndërmjetësuese përgjatë përplasjeve, etj.¹³, janë disa kriterë që merren në shqyrtim për kapërcimin e gjendjeve të tensionuara.

Nuk duhet lënë jashtë vëmendjes përcaktimi i caktuar, që Islami i bën shpagimit të së keqes. Në këtë pikë, rregulla të forta paralajmërojnë për moskalimin e kufijve, ndërsa është e ndalueshme të supozohet ndreqja e një dëmi nëpërmjet shkaktimit të një dëmi tjetër, qoftë ai i së njëjtës natyrë.¹⁴ Ndëshkimi i së keqes në Islam duhet parë gjithnjë nën prizmin e çuarjes në vend të së drejtës së munguar që cenon harmoninë shoqërore.

Surja Zuhruf: Pasojat negative të mosshqyrtimit të disa zakoneve, apo praktikave

“Ne i kemi gjetur të parët

12. Kur'an, sure Asr.

13. Kur'an, sure Huxhurat.

14. Shih: Mecelle: 19 (<https://www.seckin.com.tr/kitap/894775766>) (21.01.2021).

tanë në këtë fe dhe vazhdojmë gjurmëve të tyre.”¹⁵

Në shumë sure të Kur'anit përmendet se ndër arsyet kryesore, që popuj të ndryshëm kanë refuzuar t'i ndjekin profetët e dërguar nga Zoti është pretendimi se të parët e tyre u kanë lënë një rrugë nëpër të cilën të vazhdojnë. Kështu, ata refuzojnë të ndryshojnë diçka në mënyrën se si jetojnë, mendojnë dhe besojnë.

Faktikisht, është mëse e kuptueshme se një arsye e tillë është krejt e pabazë dhe bëhet pengesë për progresin vetjak të individit, po aq sa për zhvillimin e gjithë shoqërisë njerëzore. Nëse me kalimin e viteve nuk rishikohen planet e punës, mënyra e jetesës, apo funksionaliteti i ideologjive rrezikohet rënia në pasivitet e në paralizim të ideve. Njerëzit do të ktheheshin në makina automatike, që nuk gjenerojnë mendime, emocione dhe qëndrime të reja.

Krahas kësaj, duhet mbajtur parasysh se me kohën mund të lindë nevoja për korrigjimin e disa zbatimeve, që për arsye të caktuara janë vënë në jetë në të shkuarën e afërt ose të largët. Nga pikëpamja sociologjike, çdo periudhë dhe çdo shoqëri ka tiparet e veta sociale dhe strukturën e vet shoqërore, e cila ndryshon nga njëri brez në tjetrin, pasi shoqëria është pjesë e një zhvillimi të pandalshëm. Jo çdo gjë e vepruar në të shkuarën është

15. Kur'an, Zuhruf 43:22.

korrekte e vëzhguar me tejqyrën e ditëve të mëvonshme.

Si shembull, le të marrim specifikisht rastin e fshatit Mananxhari në Madagaskar. Në shekullin e XXI-të, falë një tabuje shumë shekullore, të lindurit binjakë konsiderohen ende si një mallkim dhe një fat i keq. Besëtytnia bazohet në një legjendë të transmetuar nga brezi në brez, e cila tregon se gjatë një sulmi të kryer mbi fisin në fjalë, banorët ishin larguar, por mbretëresha e tyre kishte harruar në fshat njërin nga binjakët. Ushtarët ishin kthyer ta gjenin fëmijën dhe ishin ekzekutuar që të gjithë. Që atëherë thuhet se pleqtë e fshatit i mallkuan binjakët dhe për këtë shkak nënat u ndaluan të rrisnin fëmijë të tillë. Ndërsa sot binjakët nuk janë më një mister për gjenetikën, në ishull respektohet tradita e të parëve: Ata nuk kanë vdekur dhe veç atyre u takon e drejta e ndryshimit të ligjit për binjakët(!) Kështu, banorët e zonës vazhdojnë t'i braktisin këta fëmijë në mëshirë të fatit dhe nuk reagojnë ndaj fushatave sensibilizuese.¹⁶

Realizimi i punëve në grup

“Përse të mos i ketë zbritur ky Kur’an një njeriu të madh nga dy qytete?... Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se të

16. <https://politheor.net/the-devils-duplicates-the-trouble-twins-of-madagascar> (17.01.2021)

tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin për shërbime.”¹⁷

Transmetohet se për shpalljen e ajetit 31 shkak kanë qenë fjalët e disa liderëve të Mekës dhe Taifit që pretendonin se nëse profetësia do të ishte realitet, ajo do të ishte e paracaktuar për njërin prej tyre.¹⁸ Përgjigja e dhënë nga Kur’ani për këtë logjikë hedh dritë edhe mbi pikat historike të ndryshimit shoqëror dhe moral që synon Islami: Allahu jep bekimet, që janë të vlefshme në botë si një provë; ndërsa profetësia është për ata që zgjedh për shkak të meritave të tyre superiore, dhe kjo përzgjedhje është shumë më e mirë se fisnikëria, pasuria dhe fuqia që zotërojnë paria mekase, apo thekifase.¹⁹

Në ajetin vijues, përforcohet kuptimi i ajetit të parë: Gradat, disnivelet në status social dhe ekonomik nuk shërbejnë veçse si një mënyrë për të bashkëpunuar në grup. Dikush vendoset në pozicionin e drejtuesit, kurse një tjetër në atë të nëpunësit. Mes të dyve nuk ka ndonjë dallim që nis së këndejmi, sepse primare është që të realizohen objektivat e paracaktuara dhe secili person është si një aktor dhe një komponent i pazëvendësueshëm i së tërës. Përshkallëzimi nuk është

17. Kur’an, Zuhruf 43:31-32.

18. Çetiner Prof. Dr. Bedreddin. (s.782).

19. <https://Kur'an.diyenet.gov.tr/tefsir/Zuhruf-suresi/4354/29-32-ayet-tefsiri> (22.01.2021.).

bërë që njerëzit të sillen eprorë ndaj njëri-tjetrit dhe kjo është një çështje e sqaruar mjaft mirë në ajetet kur'anore dhe në hadithet profetike.

Për këtë, në një hadith të regjistruar nga Buhariu, Profeti (a.s.) ka thënë: *“Sklevërit tuaj janë vëllezërit tuaj mbi të cilët Allahu ju ka dhënë autorizim. Pra, nëse dikush ka vëllezërit e tij nën kontrollin e tij, duhet t'i ushqejë ata me atë që ha dhe t'i veshë me atë që vesh. Ju nuk duhet t'i mbingarkoni ata me ato që nuk mund të durojnë, dhe nëse e bëni këtë, ndihmojini ata (në punën e tyre të vështirë).”*²⁰

Edhe në marrëdhëniet e sotme punëdhënës-punëmarrës të dyja palët ofrojnë secila shërbimin e vet dhe në varësi të tij marrin përfitimet e tyre.

Mbyllje

Si përfundim, xhuzi i njëzet e pestë i Kur'anit shtjellon çështje

20. Sahih al-Bukhari 2545. <https://sunnah.com/bukhari/49/29> (22.01.2021.).

sociologjike tepër të rëndësishme dhe hap dritare të reja në të kuptuarit e Islamit dhe të njeriut, si një qenie sociale, që i përket një shoqërie të cilën hera-herës e modelon dhe shumë herë të tjera modelohet prej saj. Ai ofron një dimension të veçantë të sjelljeve njerëzore, të cilat janë në kufijtë ku puqen me njëra-tjetrën sociologjia dhe psikologjia sociale.

Ndërsa na tregon historitë e popujve të shkuar dhe ditëve të para të Islamit, në të njëjtën kohë Kur'ani duketsikur na flet për ditët e sotme dhe mënyrën se si funksionon shoqëria e shekullit të XXI-të. Aktualiteti i prezantuar përmes ajeteve kur'anore gjen vend vazhdimisht në botimet, konferencat, seminarët dhe kërkimet shkencore të organizuara në emër të sociologjisë.

Një punim më i detajuar do të zbulonte të tjera këndvështrime, të tjera lidhje mes ajeteve kur'anore dhe shkencave sociale që studiohen sot prej shumëkujt.

Referenca

Çetiner Prof. Dr. Bedreddin, (2002). Fatiha'dan Nas'a: Esbab-ı nüzul Kur'an Ayetlerinin İniş Sebepleri. Çağrı Yayları. İstanbul.

Artikuj

Helmy, Sh., Labib, A., & AbouKahf, A., (2014). The Impact of Islamic values on interpersonal relationship conflict management in Egyptian business organizations "an applied study". Procedia - Social and Behavioral Sciences 143 1090 – 1110.

Yeh, C. J., & Hunter, C. D. (2004). The socialization of self: Understanding shifting and multiple selves across cultures. In R. T. Carter (Ed.), Handbook of racial-cultural psychology (Vol. 1). John Wiley: New York.

Webliografi

<https://www.abc.net.au>.
<https://www.Kur'an-index.com>.
<https://politheor.net/the-devils-duplicates-the-trouble-twins-of-madagascar>.
<https://sunnah.com>.
<https://Kur'an.diyamet.gov.tr>.
<https://www.seckin.com.tr>.
<https://www.socialworker.com/feature-articles/ethics-articles>.
<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4718651>.

Roli i gruas në Islam dhe sfidat e ditëve të sotme (shekulli XXI)

Msc. Valdrin Mera
Departamenti i Shkencave Islame
Universiteti Bedër

Abstrakt

Si bashkësia e parë sociologjike, familja është njësi më e vogël ndërtuese dhe elementi themelor i shoqërisë, dhe si e tillë, ka arritur t'i mbijetojë çdo lloj rreziku pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar gjatë historisë. Rol kryesor mbrojtës, në këtë rrugëtim të familjes, kanë feja dhe tradita si institucione që organizojnë jetën shoqërore.

Sipas të dhënave historike dhe antropologjike, gratë kanë qenë gjithmonë në qendër të "institucionit të familjes". Në këndvështrimin e fesë islame, gruaja ka një pozicion që formon familjen dhe është bartësi kryesor i strukturës aktuale shoqërore. Shumica e kapitujve rreth grave në veprat klasike Islame përqendrohen në rëndësinë vendimtare të familjes në islam dhe në rolin qendror të gruas në mbajtjen e njësisë familjare. Bazuar në funksionet e ndryshme që i obligon shoqëria, gruaja shfaqet si "nënë", si "bijë", si "motër" etj.

Zhvillimet e shumta kulturore dhe ndryshimi i rolit të gruas në shekullin 21, ka bërë të detyrueshme një qasje më globale në lidhje me çështjen e grave në universin Islam të referencës. Ky artikull përtej përsëritjes së normave, detyrave dhe të drejtave, në mënyrë literaliste hedh një vështrim në gjetjen e një mënyre për tu përballur me sfidat bashkëkohore në koherencë me mesazhin hyjnor duke qëndruar besnik ndaj parimeve dhe qëllimeve themelore.

Fjalë kyçe: Feja, familja, institucioni, gruaja në Islam

Hyrje

Në mesin e institucioneve sociale, si bazë ontologjike e një jete të shëndetshme shoqërore, familja ka rëndësinë kryesore në çdo shoqëri. Familja është bashkësia e parë sociologjike, është ambienti i parë shoqëror në të cilin njerëzit kalojnë jetën e tyre dhe ura që mundëson kalimin e individit në shoqëri dhe në jetën shoqërore.

Në shumë kërkime dhe hulumtime antropologjike vihet re se në jetesën familjare të shoqërive primitive kishte një rregull dhe një sistematikë të caktuar. Nëse është e mundur të flasim për një pikë të përbashkët, për të cilën bien dakord të gjithë sociologët dhe historianët, është se të gjitha shoqëritë kanë evoluar në aspektin e historisë së qytetërimit dhe se jeta shoqërore ka qenë gjithmonë në një përparim të pandërprerë. Besimi në evolucionin dhe përparimin e shoqërisë pranohet nga të gjithë, nga Durkheim'i te Marx'i, nga Comte te Ferguson'i.¹ Në klanin e *Durkheim*'it, të cilin ai e shikon si shoqërinë e parë dhe si familjen e parë, kishte kode të caktuara të cilat respektoheshin rregullisht nga anëtarët e klanit. Për shembull, një anëtar i një klani nuk mund të martohej me një anëtare tjetër të klanit të tij. Ata kishin

të njëjtin besim, të njëjtat bindje dhe për pasojë quheshin vëlla e motër. Në shumë shoqëri primitive, mungesa e dëlirësisë dhe nderit ishte e mbrapshtë dhe konsiderohej krim. Në favor ose jo të saj, gruaja ishte pothuajse në çdo shoqëri, faktori më i rëndësishëm i saj. Duhet theksuar se në këtë faktorizim të gruas në shoqëri, rol të rëndësishëm kishte dhe lidhja e fortë që fëmija ka me nënën e saj, në krahasim me babanë.²

Gruaja ka qenë gjithmonë në qendër të “institucionit të familjes”. Në fetë hyjnorene përgjithësi, dhe në fenë islame në veçanti, gruaja ka një pozicion që formon familjen dhe është bartësi kryesor i strukturës aktuale shoqërore. Gruaja është faktori kryesor që ndikon në familje dhe ka rolin më të rëndësishëm në kalimin e trashëgimisë kulturore dhe në përgatitjen e brezave të ardhshëm.

Në këtë punim, do të hedhim një vështrim modest mbi rolin e gruas në Islam. Duke qenë të vetëdijshëm që kemi të bëjmë me subjektin më të diskutueshëm të feve, kulturave dhe strukturave politike dhe për shkak të natyrës së këtij punimi, vështrimi ynë do të jetë i shkurtër, sepse për të shteruar një temë kaq të ndjeshme nuk do të mjaftonin as librat më voluminozë. Sidoqoftë, mënyra më e mirë për të kuptuar pikëpamjen e Islamit rreth pozitës së gruas është kthimi në burime. Një përgjigje e thelluar ndaj kësaj pyetjeje, ndoshta

1. Bulaç, 2007: 40.

2. Kurt, 2012: 321.

në një punim tjetër, kërkon kthimin në shoqëritë e hershme dhe në kulturat e tjera. Kina, India, Roma e Vjetër, bisedat e Budës me Anandën, Dhiata e Vjetër, Greqia e Lashtë dhe filozofët e saj na tregojnë shumë gjëra mbi shoqërinë patriarkale dhe mbi statusin e nënçmuar që kishte gruaja në këto shoqëri. Ndërsa studimi dhe hulumtimi i rolit dhe statusit që kishte gruaja në shoqërinë para-islame, në zonën ku zbriti shpallja dhe përreth saj, është thelbësor për të parë kontrastin dhe për të kuptuar më qartë pozicionin e gruas në periudhën e parë të shoqërisë islame.

Gruaja në shoqërinë para-Islame

Për të kuptuar mirë rolin e gruas në fenë Islame është e nevojshme të studiohet dhe të kuptohet statusi që ka pasur ajo, në periudhën e “inJORANCËS”(para-islame), veçanërisht në zonën ku zbriti shpallja. Për arsyen se shkrimi dihej dhe përdorej shumë pak, shpesh përballemi me vështirësitë e gjetjes së burimeve të besueshme. Për pasojë, ekzistojnë disa vështirësi në studimet që bëhen në lidhje me atë kohë. Veprat e poezisë dhe letërsisë, që arabët përdornin në një nivel të përparuar, na sjellin disa informacione. Sidoqoftë, duhet theksuar se burimi më i besueshëm që hedh dritë mbi atë kohë, është Kur’ani.

Në shoqërinë para-islame arabe, mbizotëronte struktura e familjes patriarkale, familja përbëhej nga burrat dhe të afërmit e tyre. Të afërmit e gruas nuk konsideroheshin si pjesë e familjes. Gruaja vlerësohej vetëm si konsumatore dhe për këtë arsye nuk gëzonte respekt. Një transmetim i Omerit (r.a.) e pasqyron qartë situatën kur thotë: “Ne nuk i vlerësonim gratë në kohën e inJORANCËS, kur Islami erdhi dhe pamë që Allahu po fliste për ta, ne pamë se ata kishin të drejta mbi ne.”³

Kur hedhim një vështrim të shkurtër në problematikën e rëndësishme që përcaktonin vendin e grave në shoqërinë arabe para-islame, ajo që bie në sy fillimisht është flijimi i vajzave. Edhe pse flijimi i fëmijëve ishte një ritual fetar që datonte nga koha e Ibrahimit (a.s.), vrasja e vajzave të fiset arabe ishte një traditë e përhapur dhe kjo ndodhte për shkak se vajza perceptohej si një barrë dhe shkak turpi për familjen.

Kjo sjellje e epokës para-islame, shihet qartë dhe kritikohet ashpër në Kur’an: **“S’ka dyshim se kanë dështuar keq ata që mbytën fëmijët e tyre nga mendjehhtësia e pa kurrfarë dije dhe ata që duke i shpifur Zotit, shpallën të ndaluar atë që Zoti u kishte dhuruar. Ata kanë**

3. Canan, 1988: 322.

humbur rrugën e drejtë dhe prej fillimit nuk ishin në udhëzim.⁴

Arabët i flijonin vajzat e tyre për një numër arsyesh. Një nga këto arsye ishte vështirësia ekonomike. Kur'ani hedh dritë mbi këtë fakt: **“Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh.”**⁵

Një arsye tjetër janë besimet fetare të arabëve. Arabët, të cilët i konsideronin engjëjt si bijat e Zotit, i varrosnin bijat e tyre për t'u bashkuar me engjëjt. Ata mendonin se perënditë e aprovonin këtë dhe se ishte një detyrë fetare.⁶ Një pjesë e studiuesve mendojnë se tradita e flijimit të vajzave të vogla nga arabët nuk ishte e përhapur në masë, dhe se aplikohet më shumë ndër arabët nomadë. Sido që të ishte gjendja e kësaj tradite makabre, kuptohet qartë se në dritën e dispozitave kur'anore, ky zakon i shoqërisë para-islame u hodh poshtë dhe u shfuqizua nga Islami.

Edhe në strukturën komunitare para-islame të arabëve, duket qartë se kishte një këndvështrim negativ ndaj gruas: gruaja ishte thjesht një konsumatore që konsumonte dhe nuk kontribuonte në jetën fisnore. Ajo mund të kapej peng në luftëra dhe si rezultat mund të shitej si

robëreshë ose si skllave. Sidomos mes arabëve nomadë, martesat shihej si një tregti. Mehrin, shumën e parave që i jepej gruas në bazë të kontratës së martesës, e merrte familja e gruas dhe si rezultat, burri mund të ndahej nga gruaja e tij në çdo kohë dhe e dërgonte përsëri në familjen e saj pa divorc. Për sa kohë që burrit ia përballonte gjendja e tij financiare, ai mund të martohej me aq gra sa donte. Në rast të vdekjes së burrit të saj, gruaja nuk mund të ishte trashëgimtare. Trashëgimia kalonte në familjen e burrit dhe gruaja kthehej në shtëpinë e babait të saj.⁷

Kishte shumë lloje martesash në shoqërinë arabe para-islame. Burri mund të martohej duke shkëmbyer motrën ose vajzën e tij me një grua tjetër për të mos dhënë para. Burri mund të martohej me njerikën e tij pasi babai i tij vdiste. E përhapur ishte dhe martesat e një burri me një grua për një kohë të pacaktuar pa pëlqimin e prindërve të saj. Dy motra mund të martohej me të njëjtin person në të njëjtën kohë. Pavarësisht se dhe në çështjen e martesës kishte ndryshime te fiset arabe, është fakt se me ardhjen e Islamit, të gjitha këto lloje martesash u shfuqizuan nga shpallja hyjnore.⁸

Islami i ndaloi të gjitha mendimet dhe sjelljet negative,

4. En'am, 6/140.

5. Isra', 17/31.

6. Demircan, 2008: 22.

7. Demircan, 2008: 46.

8. Demircan, 2008: 58.

keqkuptimet dhe tepricat e arabëve për gratë dhe i vuri ato nën kontroll. Islami e trajtoi burrin dhe gruan në pikën e të qenët njerëzorë dhe veçoi në mënyrë të barabartë për sa i përket të gjitha detyrimeve dhe shpërblimeve të tyre. Islami nuk u përpoq t'i largonte gratë nga jeta shoqërore, por përcaktoi vetëm dimensionet, parimet dhe kufijtë e marrëdhënies mes burrave dhe grave.⁹

Roli i gruas në Islam në shekullin e shpalljes

Ndërkohë që hedhim një vështrim se si referencat islame i qasen çështjes së grave, përballemi me disa pyetje: Ku qëndron gruaja në periudhën e parë në shoqërinë islame? Çfarë roli luajti gruaja në strukturimin e ri shoqëror të përqendruar rreth Profetit Muhamed? A përbën një model jete për besimtarët jeta e grave të Profetit (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të)? A mund të flasim për një rregullim shoqëror në favor të grave gjatë periudhës së Profetit (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të)? A është zona private e organizuar për gratë në traditën islame një zonë e strehuar apo një mjet përjashtimi nga shoqëria?

Roli i gruas në strukturën shoqërore të sapo marrë përsipër nga

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të), kuptohet me transmetimin e Omerit(r.a.) kur thotë: “Në periudhën e injorancës, gratë nuk i konsideronim as në statusin e njeriut. Ne e kuptuam se ato kanë të drejta mbi ne vetëm atëherë kur erdhi Islami dhe kur na urdhëroi të silleshim mirë me to.”¹⁰Gjurmët e para të ndryshimit shoqëror që filluan me Profetin së shpejti shfaqen me fjalët e vetë grave ensare ku thoshin: “*I Dërguari i Allahut ndaj nesh ishte më tolerant dhe i dhembshur se ne vetë.*”

Fillimisht, ajetet kur'anore, për shkak edhe të strukturës etimologjike e gramatikore të gjuhës arabe, përdornin vetëm shumësin mashkullor për t'iu referuar besimtarëve. Botëkuptimi i periudhës së “injorancës”, që e shtynte gruan në prapavijën e shoqërisë, i kishte përshkuar aq shumë gratë, sa që ato mendonin se nuk kishin asnjë vlerë para Allahut. Ato e ndjenë nevojën për të konfirmuar ekzistencën e tyre duke pyetur Profetin Muhamed (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të): O i Dërguari i Zotit, pse gratë nuk përmenden në mënyrë të drejtpërdrejtë në mesazhin e shpallur?¹¹

Pas këtij manifestimi të grave besimtare për të kuptuar pozicionet e tyre, ajetet filluan duke përmendur gratë dhe burrat në mënyrë të

10. Buhari, Libas, 1423: 31.

11. Tirmizi, Kitabu't-Tefsir, Nisa Suresi, 8.

9. Akyüz, 2006: 246.

dallueshme. Si në ajetin: **“Nuk ka dyshim se për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët e besimtare, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit dhe të sinqertat, durimtarët dhe durimtare, të përvuajturit dhe të përvuajturat, sadakadhënësit dhe sadakadhënëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, shumë përmendësit e Allahut e shumë përmendëset e Allahut, Allahu ka përgatitur falje (mekatesh) dhe shpërblim të madh”**¹²

Ky ishte një zhvillim thelbësor dhe tepër i rëndësishëm, sepse gratë tashmë ishin shkak i zbritjes së mesazhit dhe tani ato adresoheshin bashkë me burrat në tërë thirrjen hyjnore të Kur’anit. Ky evolucion i mesazhit është pjesë e pedagogjisë hyjnore në procesin e shpalljes që zgjati mbi 23 vjet. Statusi i grave dhe vajzave që u vranë për shkak të turpfit që mund të sillnin duhej të formohej në faza, me shpalljen e ajeteve kur’anore. Kështu u bë gjithnjë e më e qartë se mesazhi i Kur’anit dhe qëndrimi i Profetit (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) ishin të prirë për të liruar gratë nga prangat kulturore të fiseve dhe klaneve arabe si dhe nga praktikatat e kohës.¹³

Mërgimi nga Mekanë Medine gjithashtu luajti një rol të rëndësishëm në evolucionin e mendimeve midis

myslimanëve. Gratë në Medine ishin më të dukshme, më të përfshira në jetën sociale, më të zëshme dhe më të sigurta. Ato habitën edhe gruan e Profetit (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të), Aishen (r.a.), e cila ishte nga Mekka, kur tha: “Qofshin të bekuara gratë ensare (medinase), të cilat modestia nuk i pengoi për të kërkuar dituri.”¹⁴

Faza e jetës profetike të Profetit Muhamed përqendrohej në rrafshin njerëzor në vend të ndasisë gjinore. Në këtë qasje të re që e nxjerr individin në pah mes shoqërisë fisnore, gratë ishin gjithashtu bashkëbiseduese të drejtpërdrejta të të Dërguarit të Allahut. Ashtu si burrat, ata kishin të drejtë dhe liri të besonin, adhuronin, kontraktin dhe i shërbenin shoqërisë. Të gjitha shpalljet hyjnore që kumtoheshin nga Profeti (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) iu referoheshin grave dhe burrave. Fokusi i jetës shoqërore gjatë epokës së Muhamedit (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) ishte “Mesxhidi i Profetit”. Të ishte larg nga mesxhidi do të thotë të ishte larg rendit të ditës së Medinës, i cili formësohej rreth shpalljes hyjnore. Në këtë kuptim, gratë kujdeseshin për të qenë në mesxhid; madje duke kundërshtuar strukturën e mbizotëruar nga meshkujt, ato siguruan një ditë të veçantë nga Profeti Muhamed për t’iu referuar dhe për t’iu mësuar atyre shpalljen hyjnore.

12. Ahzab, 33/35.

13. Ramadan, 2017: 306.

14. Muslim, 1428: 332.

Gruaja e Profetit (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të), Aisheja (r.a.) ishte një nismëtare shumë e rëndësishme e ndryshimit të grave në shoqëri. Ajo ishte një studiuese dhe një dijetare. Sipas fjalëve të të Dërguarit të Allahut, ishte gjysma e fesë. Sahabët do të thoshin për të se: “Ne nuk kemi parë askënd që e di jurisprudencën më mirë se Aisheja (r.a.)” Pas vdekjes së Profetit Muhamed për 47 vjet me radhë Aisheja (r.a.) u kthye në “autoritetin e fetvave” dhe në udhërrëfyesen e besimtarëve.¹⁵

Si Aishja, ishin dhe Umu Seleme, Umu Uereka dhe gra të tjera që në një kohë të shkurtër u bënë pjesë e një reforme shumë të rëndësishme edukative. Nga ana tjetër, Profeti (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) inkurajonte edukimin dhe mirëqenien e vajzave dhe i këshillonte ato të merreshin me artin, tregtinë, përpunimin e lëkurës, endjen, poezinë, mësimin e shkrimleximit dhe prodhimin e ilaçeve.

Këshillimi i Profetit Muhamed me bashkëshorten e tij Umu Selemen në një situatë kritike siç ishte traktati i Hudejbijes është një tregues shumë i rëndësishëm i përparimit të rolit dhe statusit të gruas në shoqërinë Islame. Pikat e marrëveshjes së Hudejbijes ishin të rënda dhe të papranueshme për shokët e Profetit. Ata nuk kishin dëshirë të ndiqnin urdhrat e Profetit

(paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) në lidhje me kryerjen e Umres. Profeti Muhamed erdhi tek Umu Seleme dhe i tregoi për situatën e vështirë që po haste me shokët e tij. Umu Seleme i tha Profetit (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) që të shkonte pranë shokëve të Tij për të therrë kurbanin e tij pa folur me askënd. Profeti (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) bëri pikërisht atë që i tha gruaja e Tij, Umu Seleme. Sahabët, kur panë Profetin filluan të therrnin kurbanet e tyre.¹⁶ Siç shihet në këtë shembull, ishte gruaja e Tij, që e ndihmoi Profetin Muhamed në zgjidhjen e kësaj situatë. Me këtë veprim Profeti (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të), si drejtues që ishte, iu tregonte të gjithëve rëndësinë që kishte mendimi i një gruaje qoftë edhe për çështje kaq kritike.¹⁷

Duket se në shekullin e parë të Islamit, gratë besimtare, ashtu si burrat, ishin shumë të përfshira në mësimin dhe kuptimin të Kur'anit. Aishja, Hafsa, Umu Seleme, Umu Uereka ishin mes grave që e dinin Kur'anin përmendësh. Ndërkohë një numër i konsiderueshëm i grave i përkushtoheshin transmetimit të hadithit. Në këtë periudhë, kur parimet formësoheshin nga rrjedha e shpalljes hyjnore dhe rendi i ditës përcaktohej nga ajetet

16. Buhari, 1423.

17. Haylamaz, Gönül Tahtımızın Eşsiz Sultanı Efendimiz, Muhtasar 2008, 473-85.

15. Haylamaz, Mü'minlerin en Mümtaz Annesi Hazreti Aişe 2010, 337.

kur'anore, rolet sociale që gratë ndërmerrnin ishin themelore. Fakti që Mus'haf-i Sherif, i cili u mblohd gjatë periudhës së Ebu Bekrit(r.a.), pas Omerit(r.a.) i kaloi Hafsës(r.a.) në vend të Osmanit(r.a.), është një tregues i rëndësishëm i statusit që kishte arritur gruaja në atë kohë.

Sfidat e ditëve të sotme

Duhet të theksohet se statusi i gruas, e cila u ngrit në një pozitë të privilegjuar në periudhën e parë islame, me kalimin e kohës u venit dhe degradoi. Shkak për këtë, përveç interpretimeve fetare ishin dhe arsytet politike, gjeografike dhe kulturore. Megjithëse këto përcaktime nuk mund të përgjithësohen njësoj për tërë gjeografinë islame, rruga që shoqëria e parë islame hapi në favor të grave; me kalimin e kohës u ngushtua dhe kjo ngushticë deri diku e privoi gruan nga arritjet e pasura të fesë.

Gjatë periudhës së kalifatit Emevit, myslimanët zotëronin një hapësirë gjeografike që shtrihej nga Oqeani Atlantik deri në brigjet kineze dhe Afganistan, nga Azia e Vogël deri në Spanjë. Gjatë pushtimeve të shumta ata hasën kultura dhe zakone të reja nga të cilat u ndikuan. Gratë morën gjithashtu pjesën e tyre nga ky ndryshim. Me ndikimin e mirëqenies, që vinte me plaçkat e luftërave, gratë tërhiqeshin në zonat e tyre të rehatisë. Me rrjedhën serioze

të skllëvërve dhe robërshave, barra e nevojave të grave brenda dhe jashtë u transferua tek ato. Për gratë e lira, ecja në rrugë jashtë distancave të shkurtra konsiderohej turp; ata nuk ishin më të mirëpritura për të shkuar në xhami. Ndërsa ky ndryshim nuk ndikoi në pozitën e grave që i përkisnin klasës elitare, ishte fillimi i një tradite të rëndësishme për gratë e zakonshme. Në këtë periudhë të pushtetit, ku administrata ishte rregulluar sipas interesave të shtetit, dhe jo parimit të pajtueshmërisë me Kur'anin dhe Sunetin, pati një kthim në zakonet e injorancës.

Një ndër sfidat më të mëdha të botës Islame sot, është rifitimi i koherencës së mesazhit dhe gjetja e një mënyre për t'u përballur me sfidat e kohëve bashkëkohore, duke qëndruar besnik ndaj parimeve dhe qëllimeve themelore. Ballafaqimet intensive që vijnë nga Perëndimi kanë hapur debate të shumta në lidhje me çështjen e gruas myslimane, autonominë e saj, rolin e saj në familje dhe shoqëri, statusin e saj ekonomik dhe politik. Kjo në fakt është një çështje tejet delikate dhe e vështirë; janë të përfshira çështje të ndërlikuara e të ndërvarura dhe përqendrimi vetëm në një dimension të problemit shtrembëron tërë thelbin e debatit.

Bota islame është përballur me problemin e civilizimit për më shumë se tre shekuj. Për ta thënë më qartë, myslimanët në këtë periudhë kaq të

gjatë kanë diskutuar çështjen se si të marrin një qëndrim kundër civilizimit perëndimor dhe për fat të keq ata akoma nuk kanë qenë në gjendje ta zgjidhin problemin. Studiuesit, të cilët përfshijnë në studimet e tyre civilizimin perëndimor dhe pikëpamjet e perëndimorëve, janë kryesisht sipërfaqësorë në këtë drejtim. Madje, edhe në tezat e masterit dhe të doktoratës, në të cilat duhet t'i analizojnë shumë mirë çështjet, t'i shmangin vështirësitë dhe t'i ekzaminonë në një bazë shumë objektive, ata mbeten sipërfaqësorë në këtë drejtim. Studimet islame, të cilat shqyrtojnë çdo çështje në krahasim me civilizimin perëndimor, shpesh mbizotërohen nga tangjencialiteti dhe gjykimet e përgjithshme.¹⁸

Një studiues që studion rëndësinë e familjes dhe rolin e gruas në Islam, për shembull, ndërsa bën krahasime, përfshin situata të caktuara dhe subjektive në lidhje me mendimin e Perëndimit për familjen. Në fakt, ajo që kërkohet nga ai, është të jetë objektiv dhe i përpiktë. Perëndimi në vetvete është shumë kompleks dhe nuk ka një pikëpamje të vetme perëndimore, por ka shumë ide që diskutohen dhe vihen vazhdimisht në lupën e kritikës. Për këtë arsye, shkencëtarët perëndimorë nuk mund të binden kur lexojnë studime të tilla dhe ata i nënvlerësojnë këto libra. Madje

18. Yıldırım, 2012: 287.

edhe intelektualët myslimanë, që janë rritur me kulturën perëndimore, nuk i marrin seriozisht këto studime. Shumica e shkrimtarëve dhe studiuesve myslimanë duhet të rishqyrtojnë civilizimin perëndimor dhe të përcaktojnë me kujdes se si ta trajtojnë atë. Nuk ka dyshim se mënyra ideale e trajtimit të kësaj çështje ka qenë një ndër problemet më të mëdha me të cilin janë përballur myslimanët.

Në vitet e fundit, debati në perëndim, dhe sipas kësaj në vendet me shumicë myslimane, është fokusuar në aspektet më të dukshme të “statusit të gruas në Islam”. Kjo, pavarësisht se është një çështje thelbësore, ka shmangur zemrën e problemit, duke e zvogëluar atë në një debat të thjeshtuar në lidhje me “praktikat problematike”. Çështja e “grave myslimane” sot është një pjesë e debatit që karakterizon deri diku marrëdhënien e papajtueshme mes Islamit dhe Perëndimit.¹⁹

Kontrasti mes traditave patriarkale dhe modernizmit perëndimor, nxjerr në pah deri diku diskriminimet në lidhje me veshjen, poligaminë, dhunën, trashëgiminë, mungesën e edukimit, etj. Ndërkohë që edukimi në fenë Islame është detyrë: “Kërkimi i diturisë është detyrë për çdo burrë dhe grua myslimane.”, realiteti është diçka më ndryshe. Sipas raporteve të UNICEF, dy të tretat e 200 milion fëmijëve të

19. Ramadan, 2017: 302.

pashkolluar janë vajza (kjo shpesh ndodh në vendet me shumicë myslimane). Dy të tretat e pothuajse një miliard të rriturve analfabetë janë gra dhe një pjesë e madhe e tyre janë në vendet aziatike dhe afrikane me popullsi myslimane. Kjo është një pasqyrë që tradhton objektivat më të larta të etikës islame.²⁰

Përfundim

Shumë studiues myslimanë dhe myslimane, ditët e sotme po bëjnë një punë thelbësore në lidhje me përmbajtjen e burimeve të shenjta, mënyrën se si duhen lexuar dhe interpretuar ato, dhe se si ato lidhen me kulturat dhe strukturat shoqërore. Në këtë proces të vështirë dalin edhe problematika të shumta, të cilat duhen tejkualuar: Duhet të

20. Ramadan, 2017: 338.

studiohet marrëdhënia mes tekstit dhe kontekstit në mënyrë që kjo të mundësojë nxjerrjen e parimeve dhe objektivave. Tekstet nuk flasin vetë dhe mësimet janë si sinkronike ashtu dhe diakronike; lidhja me kohën është vendimtare, lidhja me kontekstin është e domosdoshme. Një lexim i fjalëpërfjalshëm nuk i qartëson dinamikat e përparimit të shoqërisë, të statusit të gruas në shoqëri dhe lidhjen e tyre të theksuar me mjediset.

Leximi i tekstit, pa marrë parasysh kronologjinë dhe kontekstin, e bën të pamundur për studiuesit të flasin për faktin se mbajtja e grave analfabete dhe ndalimi i tyre për të punuar, mungesa e autonomisë financiare dhe roli social-ekonomik i tyre, martesat e detyruara, mohimi i divorcit, lejimi i dhunës në familje janë absolutisht në kundërshtim me mesazhin e Islamit.

Bibliografi

Akyüz, Vecdi. Bütün Yönleriyle Asr-ı Saadet'te İslâm. Vol. 2. İstanbul: Beyan Yayınları, 2006.

Bulaç, Ali. Tarih, Toplum ve Gelenek. İstanbul: Yeni akademi yayınları, 2007.

Canan, İbrahim. Hadis Ansiklopedisi. Vol. 9. Ankara: Akçağ- Zaman Gazetesi, 1988.

Demircan, Adnan. Kızların Gömülerek Öldürülmesi ve Çok Kadınla Evlilik. İstanbul: Beyan Yayınları, 2008.

EL-BUHÂRÎ, Ebu Abdillâh Muhammed b. İsmail. el-Câmiu's-Sahîh. Egypt: Dar al-Ghadd al-Gadeed, 1423.

Haylamaz, Reşit. Gönül Tahtımızın Eşsiz Sultanı Efendimiz, Muhtasar. İstanbul: Muştu yayınları, 2008.

Mü'minlerin en Mümtaz Annesi Hazreti Aişe. İstanbul: Işık Yayınları, 2010.

Kurt, Abdurrahman. "Din ve Aile." In Ana Başlıklarıyla Din Sosyolojisi, 319-334. Ankara: Grafiker Yayınları, 2012.

MUSLİM, Ebu'l-Huseyn İbn Haccâc el-Kuşeyrî en-Neysâbûrî. Sahîhu Müslim. Egypt: Dar al-Ghadd al-Gadeed, 1428.

Ramadan, Tarik. Reforma Rrënjësore, Etika Islame dhe Emancipimi. Shkup: Furkan ISM, 2017.

Et-TİRMİZİ, Ebu İsa Muhammed b. İsa (v. 279/892), es-Sünen, I-IV, Çağrı Yayınları, İstanbul, 1992.

Yıldırım, Suat. Oryantalistlerin Yanılgıları. İstanbul: Işık Akademi Yayınları, 2012.

Biologjia Moderne si Shprehje Kulturore¹

Fatos A. Kopliku, M.S.
Ann Arbor, Michigan, SHBA

Abstrakt

Kjo ese gjurmon zanafillën e premisave mekanicistike dhe shkenciste, të cilat u bënë rrënja e një botëkuptimi të ri në Perëndim ku roli i Hyjnores u zbeh në atë shkallë sa gjërat e vetme “reale” u bënë forcat e papërvetshme materiale. Këto premisa i dhanë hov një kulture të re e cila u shpreh në forma të ndryshme, veçanërisht në teorinë e evolucionit të Darwin-it, e cila ishte rezultat i një procesi të gjatë të mbingopjes me filozofi materialiste, kejo e fundit pasojë e një humbjeje të shkallëzuar të kthjelltësisë metafizike në Perëndim.

Fjal kyçe: Historia e shkencës, historia e ideve, biologjia, evolucionit, shprehja kulturore

1. Kjo ese është version i zgjeruar i artikullit me të njëjtin titull botuar në gjuhën angleze: Fatos A. Kopliku, Modern Biology as a Cultural Expression, *Sacred Web*, vol. 46 (2020), f. 124-134.

Parimisht, na thuhet se tashmë e dimë se si bota funksionon, se si njeriu lindi: çdo gjë që është thelbësore dihet. Biologu anglez Richard Dawkins thotë se e shkroi librin *Orënderësi i Verbër* “me bindjen se ekzistenca jonë dikur ishte misteri më i madh, por nuk është më e tillë sepse është i është gjendur përgjigjja. Darwin-i (Darvini) dhe Wallace-i (Uallasi) e zgjidhën, megjithëse ne do të vazhdojmë ende t’i shtojmë fusnota zgjidhjes së tyre.”² Sipas fizikanëve Stephen Hawking dhe Leonard Mlodinov, edhe veli i misterit të ekzistencës së gjithësisë po shturet: “Ashtu si Darwin-i dhe Wallace-i shpjeguan se forma në dukje e mbinatyrshme e gjallesave mund të shfaqet pa ndërhyrjen e një qenieje supreme, koncepti i multiversit³ mund të shpjegojë rregullimin e ligjit fizik pa nevojën e një krijuesi bamirës, që e bëri gjithësinë për dobinë tonë.”⁴ Për autorin John Horgan ky është

2. Richard Dawkins, *The Blind Watchmaker* (New York: W. W. Norton & Company, 1986), f. xiii. Titulli i referohet argumentit të teologut e filosofit anglez William Paley (v. 1805), sipas të cilit ashtu si ora me ingranazhet nënkuptojnë orëndreqësin e saj ashtu edhe gjithësia nënkupton Krijuesin. Nga ana tjetër, Dawkins argumenton se këtë rol e luan evolucioni, “orëndreqësi i verbër”.

3. *Universi* nënkupton një (uni) gjithësi, kurse *multiversi* nënkupton shumë (multi).

4. Stephen Hawking, Leonard Mlodinov, *The Grand Design* (New York: Bantam, 2010), f. 123-124.

Fundi i Shkencës dhe njëkohësisht titulli i librit të tij, ku shprehet se në të ardhmen nuk do të ketë ndonjë rishqyrtim rrënjësor sepse versioni ynë shkencor i realitetit “në shumë pikëpamje është i vërtetë” edhe pse ka ende të panjohura.⁵ Nga ana tjetër, ka shkencëtarë si biologu tjetër anglez Rupert Sheldrake, që argumentojnë se ideja që tanimë shkenca i ka përgjigjet e pyetjeve kryesore është “mashtrimi më i madh shkencor”. E rrënjësor në një filozofi materialiste, që u formësua në shekullin e XIX, kjo ide është përgjegjëse për frenimin e vetë shkencës, thotë ai.⁶

Duke marrë argumentin e shkencëtarit Sheldrake si pikënisje, në këtë ese do të gjurmojmë burimin dhe formësimin e botëkuptimit të sotëm të shkencës, përfshirë atë të biologjisë moderne. Si u ndikua biologjia dhe botëkuptimi i saj nga zhvillimet përgjatë historisë dhe pse kjo ndodhi në Perëndim e jo në vende të tjera? Për t’u përgjigjur këtyre pyetjeve duhet të kthehemi

5. John Horgan, *The End of Science: Facing the Limits of Knowledge in the Twilights of the Scientific Age*, 2nd ed. (New York: Basic, 2015), f. xiii.

6. Shih Rupert Sheldrake, *The Science Delusion: Freeing the Spirit of Inquiry* (London: Coronet, 2012). Shtojmë se Sheldrake nuk është zë i vetëm, përkundrazi. Shih për shembull përmbledhjen me ese nga shkencëtarë dhe mendimtarë të ndryshëm *Science and the Myth of Progress*, ed. Mehrdad Zarandi (IN: World Wisdom, 2003).

prapa në Greqinë e Lashtë, para mëse 25 shekujsh.

Shkaqe e Pasoja...

Ashtu si edhe tradita të tjera të hershme e të sotme edhe ajo e Greqisë së Lashtë kishte një qasje simbolike ndaj natyrës, duke e parë atë si një teofani – shpalosje e Cilësive Hyjnore. Natyrisht, në të njëjtën kohë kjo qasje ishte edhe një urë ndihmëse në soditjen e realiteteve shpirtërore.⁷ Për shembull, në dialogun e Platonit me Timeus-in (27-30) thuhet se “pa dyshim kjo botë është shëmbëllturyrë e diçkaje... le ta themi qartë se gjithësia i ngjan më shumë se çdo gjëje Gjësë së Gjallë, pjesë e të Cilës është çdo gjë, si në vete edhe në lloj. Ajo Gjë e Gjallë përfshin në vetvete çdo gjë të mundshme...”⁸

Soditja e natyrës shihej si diçka thelbësore për shndërrimin e shpirtit sepse, siç thotë Plotini (v. 270 e.s), figura më e rëndësishme e mendimit neoplatonist⁹, ajo e mundëson atë

7. Për një studim të hollësishëm të qasjes ndaj natyrës në tradita të ndryshme fetare shih Seyyed Hossain Nasr, *Religion and the Order of Nature* (New York: Oxford University Press, 1996).

8. *Plato: Complete Works*, ed. intro. & notes John M. Cooper, assoc. ed. D. S. Hutschinson (Hackett, 1997).

9. Me shumë gjasë, Plotini dhe të tjerë si ai do ta shihnin veten si Platonistë ose vijues të filozofisë së Platonit dhe jo si ‘neoplatonistë’, një term ky i sajuar nga akademikët evropianë të shekullit të XIX. Parimet dhe mësimet e Neoplatonizmit

të “bëhet i tëri një vegim”, i cili më pas “zgjon një tjetër vegim: ashtu si një aftësi, që kur i mësohet një fëmije dhe pastaj përkryhet, zgjon tek ai një aftësi tjetër...”¹⁰ Simbolet janë çelësa për këtë shndërrim dhe mënyra më e frytshme e të mësuarit është nëpërmjet tyre. Mendimtari dhe filozofi neoplatonist Iamblikus (v. 325 e.s) shprehet kështu:

Sipas Pitagorës, mënyra më e duhur e mësimdhënies është nëpërmjet simboleve. Kjo është forma më e hershme e diturisë së lëvruar prej pothuajse gjithë grekëve. Por, nga ana e egjiptianëve ajo çmohej jashtëzakonisht dhe ishte përvetësuar prej tyre në mënyrën më të larmishme. Kështu, nëse dikush zbërthen mirë domethëniet dhe konceptet e mistershme të simboleve Pitagoriane, mban qëndrimin e duhur dhe jeton të vërtetën, që ato mbartin, duke i çliruar nga forma e tyre enigmatike, atëherë bëhet e qartë pse Pitagora i kushtonte vëmendje të madhe kësaj diturie.¹¹

Duhet të shtojmë diçka në lidhje me botëkuptimin egjiptian, sepse vetë Pitagora studioi mbi njëzet

u panë si në harmoni me botëkuptimin abrahamik dhe u integruan në ligjërimin filozofik e teologjik të traditës së krishterë, judaiste dhe islame.

10. Plotinus, *Enneads* III, 8,5, trans. & intro. A. H. Armstrong (London, 1953). Plotini ishte një grek që jetoi në Egjiptin romak rreth gjashtë shekuj pas Platonit.

11. *Iamblicus' Life of Pythagoras*, trans. Thomas Taylor (London: J. M. Watkins, 1818), f. 55.

vjet në tempujt e Egjiptit të Lashtë, veçanërisht në Iunu, ose Heliopolis, siç e quanin grekët.¹²

Në kuptimin faraonik, një qenie natyrore nuk është tjetër porse mishërimi i një Ideje, simbol i së cilës ajo është. Zogu që fluturon ka një natyrë ajrore; nëpërmjet zakoneve të tij (jeta, të ushqyerit, metoda e gjahut, lidhjet dhe armiçësitë, karakteri, mënyra e përvetësimit, etj.) ai bëhet trupëzimi i një funksioni, i një teatri të zanafillës së përbotshme, dhe së fundi i një Ideje. Kështu çdo gjë natyrore është trupëzimi i një parimi; është simbol i atij parimi.¹³

Edhe pse Iamblikus-i flet kryesisht për simbole gjeometrike dhe numerike, përshkrimi është po aq i vlefshëm edhe për simbolet në natyrë. Fundja vetë fjala *kozmos* në greqisht do të thotë njëherësh *rend* dhe *stoli*. Për nga kuptimi *kozmos* nuk ishte fjalë neutrale, por e mbarsur me “dinjitetin më të lartë religjioz”, siç shprehet studiuesi Hans Jonas.¹⁴ Kurse për Platonin kozmosi ishte

12. Më vonë Pitagora do të kthehej në koloninë greke të Krotonit në Kalabrinë e sotme të Italisë së Jugut dhe do të themelonte një vëllazëri mistike me rregulla të qarta morale, praktika askete dhe të përqendruar në studimin e doktrinave fetare dhe filozofike.

13. R. A. Schwaller de Lubicz, *The Temple in Man: Sacred Architecture and the Perfect Man*, trans. Robert and Deborah Lawlor (New York: Inner Traditions International, 1977), f. 31. ‘Faraonik’ këtu do të thotë ‘egjiptian’.

14. Hans Jonas, *The Gnostic Religion*, 3rd ed. (Boston: Beacon Press, 2001[1958]), f. 241.

“në të vërtetë një krijesë me shpirt e intelekt”.¹⁵ Meqë njeriu edhe kozmosi janë në shëmbëllturyrë të Hyjnores që i krijoi, duke lexuar kozmosin njeriu lexon dhe kupton veten. Për këtë arsye qasja diturore ndaj simboleve të natyrës shihej si një çelës shndërrues dhe çlirues, ose shpëtues, nëse përdorim termin e traditave Abrahamike.

Sidoqoftë, kjo qasje e të lexuarit dhe e të kuptuarit të natyrës dalëngadalë kishte filluar të harrohej, madje edhe më përpara kohës së Platonit (v. 347 p.e.s). Për shembull, për mendimtarë si Anaksimenes-i i Miletit (v. 526 p.e.s) natyra dhe dukuritë e saj ishin thjeshtuar në “rrallim e trashim”, ku ndryshimi i vetëm cilësor ishte sasia.¹⁶ Zbehja e të kuptuarit simbolik, ngatërrimi i gishtit tregues drejtuar nga hëna me vetë hënën, u pasua nga naturalizmi dhe idhujtaria. Në Greqinë dhe më vonë, Romën e Lashtë adhurimi i objekteve në natyrë, përfshirë trupat qiellorë, u bë shumë i përhapur, dukuri kjo që njihet edhe si *kozmolatri*, adhurim i kozmosit.

Nuk është rastësi që kur erdhi në Mesdheun greko-romak, pikërisht për shkak të rrezikut të shkarjes drejt natyralizmit e kozmolatrisë, Krishterimi e vuri theksin te dashuria si mjet shpëtimi, jo te

15. *Timen*, 30b, 34a.

16. Shih Francis M. Cornford, *From Religion to Philosophy: A Study on the Origins of Western Speculation* (London, 1912), ff. 144-159.

leximi simbolik i natyrës.¹⁷ Si pasojë, “në formulimet më të përhapura teologjike të veta, Krishterimi... vendosi kufij të padepërtueshëm mes mbinatyrores dhe natyrores, duke përfunduar me një qasje të varfëruar të natyrës”, thotë Seyyed Hossain Nasr, profesor i studimeve fetare në Universitetin George Washington.¹⁸ Nasr tërheq vëmendjen se pa e kuptuar këtë, “nuk do ta kuptojmë kurrë pse Krishterimi... në historinë e mëvonshme të tij do t’ia dorëzonte botën natyrore një botëvështrimi tërësisht jofetar.”¹⁹ Ndonëse jo i rëndësishëm parësore, leximi i kozmosit si *vestigia Dei* (*gjurmë të Zotit*), do të vazhdonte të ishte i pranishëm në Krishterim. Për shembull, kardinali, filozofi dhe teologu gjerman, Nikola i Kuzës (v. 1464) shkruante:

Të gjithë filozofët e teologët tanë më të mëdhenj pohojnë njëzëri se bota e dukshme është një pasqyrim i saktë i asaj të padukshme dhe nga njohja e krijesave mund të arrijmë të një njohje e Zotit... Arsyeja kryesore për përdorimin e simboleve në studimin e gjërave shpirtërore është ngaqë e dimë me të vërtetë se çdo gjë ka lidhje me njëra tjetrën...²⁰

17. Duhet të thuhet se qasja ndaj natyrës e popujve gjermanikë dhe nordikë ishte në thelb simbolike, pra krejt ndryshe nga kozmolatria e botës greko-romake.

18. Seyyed Hossain Nasr, *Knowledge and the Sacred* (New York: State University of New York Press, 1989), f. 30.

19. Nasr, *Religion... op. cit.*, f. 21.

20. Nicholas of Cusa, *De Docta Ignorantia*, I,

Në veçanti, gildat mesjetare evropiane patën integruar me kohë traditën Pitagoriane dhe Hermetike të interpretimit ezoterik të natyrës në botëkuptimin e krishterë.²¹ Kuptohet që kishte edhe një qasje utilitare e praktike ndaj natyrës sepse njerëzit e përdornin atë për shumë nevoja të tyre. Sidoqoftë, natyra shihej si një libër për tu lexuar, si një ikonë për t’u soditur, ajo ishte një organizëm me shpirt të vetin, Shpirtin e Botës (*anima mundi*).²² Kjo ishte mënyra se si e shihte Perëndimi natyrën.

Për shembull, William Gilbert (v. 1603), i njohur edhe si babai i studimit të elektricitetit dhe magnetizmit, thotë: “Ne e gjykojmë të gjithë universin të gjallë dhe të gjitha sferat, yjet, bashkë me tokën fisnike të udhëzuara qëmoti nga shpirtrat e tyre të emëruar, të cilët kanë motivet e tyre të vetë-ruajtjes.”²³

xi në *Of Learned Ignorance*, tr. Fr. Germain Heron (London: Routledge & Kegan Paul, 1954).

21. Në mënyrë të ngjashme, edhe në Islam natyra shihet si një libër plot me *ajet-e*, shenja, gjurmë që duhet të lexohen. Vërejmë se vargjet e Kur’anit quhen po ashtu *ajet-e*. Në tradita të tjera si ato të indianëve të Amerikës, natyra nuk shihet vetëm si simbol, por edhe si vatër e shpalosjes e Cilësive Hyjnore. Shih kreun ‘Cosmos as Theophany’ në Nasr, *Knowledge and the Sacred*.

22. Fjala *spirit* dhe *soul* në anglisht, ose *spiritus* dhe *anima* në latinisht, *pneuma* dhe *psyche* në greqisht nuk janë identike, kurse në shqip fjala *shpirt* mund të përdoret për të dyja. Në këtë rast ajo përkon me *anima*-n, veten, egon.

23. Cit. nga Brooke, *Science and Religion*, ff.

Për Leonardo Da Vinci-in (d. 1519) vetë toka ka një “shpirt vegetativ, trupi i saj është dheu, dhe kockat e saj janë shkëmbinjtë... gjaku i saj janë liqenet me ujë... frymëmarrja dhe pulsi i saj janë batica e zbatica e detit.” Këto ishin mendime të mbajtura nga disa prej mendjeve me të ndritura në Perëndim, jo bestytni popullore.

Sidoqoftë, dalëngadalë drejt fundit të Mesjetës dhe në veçanti gjatë Rilindjes, kuptimi simbolik i natyrës filloi të mjegullohej, duke humbur kështu kthjelltësinë e vet metafizike. Ashtu siç kishte bërë Anaksimeni para gati dy mijë vitesh, tani natyra prapë filloi të shihej e trajtohej thjesht si mori faktesh sasiore. Tashmë ajo nuk ishte më e mbrujtur me kuptim, sekularizimi i saj kishte filluar. Zhvendosja e botëkuptimit nuk ndodhi menjëherë, por për të ndodhur ndodhi.²⁴ Për Galileon gjuha

e universit është “e shkruar në gjuhë matematikore dhe simbolet e saj janë trekëndëshat, rrathët dhe figurat e tjera gjeometrike, pa ndihmën e të cilave është e pamundur t’i kuptohet qoftë edhe një fjalë.”²⁵ Ndërsa për astronomin Johannes Kepler (v. 1630) makineria Qiellore duhet parë “jo si një organizëm hyjnor, por si një sahat me kurdisje...”²⁶ Në fizikën e Newton-it (Njuton) Zoti u shndërrua në *Mekanikun e Madh*, që në të vërtetë e ndërtoi botën si një sahat gjigand, duke mos lënë kështu asnjë hapësirë për *anima mundi*-n, shpirtin e botës. Falë Descartes-it (Dekart) kafshët ishin zhveshur me kohë nga shpirti. Edhe pse fjala ‘animal’ (kafshë) nënkupton se ato kanë shpirt (*anima* në latinisht), Descartes-i i pa ato thjesht si *automata* (makineri) dhe si të tilla ato s’mund të kishin shpirt.²⁷

Me përjashtimin e *vetes (anima)* nga ekzistenca, hierarkia klasike e trefishtë e *trupit, vetes* dhe *shpirtit* u zvogëluar në dy. Kjo ndarje e trefishtë njihet në greqisht si *hyle, psike* dhe *pneuma*; në latinisht si *corpus, anima* dhe *spiritus*; në arabisht si *schism, nefis* dhe *ruh*; në anglisht si *body,*

161-162. Për një panoramë të botëvështrimit tradicional të krishterë të natyrës shih Nasr, *Religion and Order of Nature*, f. 56-59.

24. Ky ndryshim u shoqërua në të njëjtën kohë me një zbehje të rëndësisë, me raste edhe shkatërrim, të bashkësive si ato të *Fedeli D’Amore* (të cilës i përkiste edhe Dante Aligheri), *Tempullarëve* ose *Rozikercianëve...* Bashkësi të tilla ishin çerdhet e mësimëve mistike të Krishterimit, në të cilat roli simbolik i natyrës kishte një rëndësi të veçantë. Në njëfarë mënyre ato përkojnë me vëllazëritë e sufjve në Islam, të cilët, ndryshe nga bashkësitë e lartpërmendura të krishtera, ishin e mbetën gjithmonë shumë me peshë e ndikim në jetën intelektuale e shpirtërore myslimane.

25. Cituar nga Edwin A. Burttt, *The Metaphysical Foundations of Modern Science*, rev. ed (New York: Dover Publications, 2003[1925]), f. 62.

26. Cit. nga Brooke, *op. cit.*, f. 63.

27. Shih *The Philosophical Writings of Descartes*, trans. John Cottingham, Robert Stoothoff, Dugald Murdoch (New York: Cambridge University Press, 1985), f. 140-142.

soul dhe *spirit*. *Vetja* është realiteti i ndërmjetëm mes trupit (*corpus*) dhe shpirtit (*spiritus*), dhe është sinonim i egos ose psikës.²⁸ Heqja e *vetes* ishte në të vërtetë heqja e nyjës, që lidh trupin me shpirtin, duke e bërë përjashtimin ë këtij të fundit thjesht çështje kohe. Me ngritjen e një botëkuptimi, që e shihte gjithësinë, si një makineri stërmadhe, natyrën sipas modeleve matematikore e gjeometrike dhe që thjeshtoi kafshët në *automata*, i erdh radha njeriut, që të përjetonte një trajtim të ngjashëm.²⁹ Nëse natyra ishte një makinë e ndërlikuar stërmadhe, pse u dashka që njerëzit të bëjnë përjashtim? Biologjia amerikane Lynn Margulis e vajton faktin që Descartes-i mohoi se vullneti për të jetuar dhe t'u rritur që rrezaton prej të gjithë gjallesave, njerëzore, apo jonjerëzore, dëshmohet nga vetë prania e tyre. Ai shpërfilli ekzistencën e ndjeshmërisë jonjerëzore. Trashëgimia e tij e mohimit ka çuar në supozime në nënkuptuara mekanistike. Pothuajse

28. Megjithatë, si në gjuhë të tjera edhe në shqip *vetja*, egoja, psika mund të quhet 'shpirt', çka me të drejtë mund të jetë pak çorientuese. Sidoqoftë, në rastet ku përdorëm fjalën 'shpirt', kemi vendosur në kllapa nëse bëhet fjalë për shpirtin si *anima* apo si *spiritus*. Për më shumë hollësi shih 'Spiritus, Anima, Corpus' në René Guénon, *The Great Triad*, tr. Peter Kingsley (Cambridge, UK: Quinta Essentia, 1991 [1946]).

29. Shih psh., Nasr, *Religion... op. cit.*, kreu 3; Brooke, *op. cit.*, ff. 189-195.

të gjithë kolegët tanë shkencore ende kërkojnë "mekanizma" për të "shpjeguar" gjënë e gjallë, dhe presin që ligjet (natyrore) të përputhen me analizën matematikore...³⁰

Më shumë se katër shekuj përpara, një kritik bashkëkohës i Descartes-it shkruante se "nëse dikush mohon shpirtin bimor (vegjetativ) dhe shqisor në kafshë, atëherë ai u hap derën ateistëve, të cilët do t'ia mveshin veprimet e shpirtit racional një shkaku të të njëjtut lloj dhe do të na japin një shpirt material në vend të shpirtit (*anima*) tonë shpirtëror (*spiritus*)."³¹ Këto fjalë dolën profetike: sot ka disa mendimtarë e shkencëtarë që edhe njerëzit i përshkruajnë pak a shumë si produkt i gjeneve, ndërveprimet mes proteinave ose mekanizmave të tyre. Ne jemi thjesht "makineri mbijetese - robotë të programuar verbërisht për të ruajtur molekula egoiste të njohura si gjene", shprehet një biolog.³²

Sipas këtij botëkuptimi, universi punonte si sahat, kurse Zotit iu dha vetëm roli i kurdisësit të tij. Pas vënies se kozmosit ne lëvizje Ai u tërhoq diku, ndoshta në ndonjë divan hyjnor për të ndjekur telenovela mitologjike. Nganjëherë Ai ngrihej

30. Lynn Margulis, Dorion Sagan, *Slanted Truths: Essays on Gaia, Symbiosis and Evolution* (New York: Springer-Verlag, 1997), f. 182.

31. Cit. nga Brooke, *op. cit.*, p. 191.

32. Richard Dawkins, *The Selfish Gene*, 2nd ed. (Oxford: Oxford University Press, 1989 [1976]), f.i.

dhe ndërhynte në punët e botës, por në këtë kozmos mekanik Ai filloi të ishte i pavend. “Natyra e filozofisë mekanistike mund të tingëllojë *teiste*, por zhvillimi i saj ishte në rrezik të luhatej në anën e kundërt”, vëren historiani i shkencës John H. Brooke. Me gjithë besimin dhe devotshmërinë e tyre, shkencëtarë si Robert Boyle (v. 1691) dashje pa dashje filluan të përdorin “terma që jepnin përshtypjen se i Plotfuqishmi kishte krijuar botën e pastaj ishte larguar”, pikëpamje kjo e njohur si *deizëm*.³³ Një nga rrjedhojat e kësaj qasjeje ishte vënia në dyshim, madje edhe mohimi i fesë: pse u dashka që njeriu të interesohet për fenë nëse Zoti është tërhequr në ndonjë qoshe? Nuk vonoi shumë dhe njeriu mund të shfaqësohej nëse mendonte se një Zot i larguar nuk ishte fort ndryshe nga një që nuk ekziston.

Rreth së ashtuquajturës *Epokë e Iluminizmit* Zoti ishte tërhequr ose fshehur, kurse natyra ishte zbrazur nga simbolet dhe mbushur me fakte, parakusht ky që i hapi rrugën shfrytëzimit të saj të pashembullt. Kjo periudhë lindi dhe lulëzoi në Evropë gjatë shekujve XVII-XVIII, veçanërisht në Francë dhe Angli.

33. Brooke, *op. cit.*, ff. 190, 193. *Teizmi* përshkruhet si besimi në Zot ose zota dhe pranon realitetin e shpalljes, kurse *deizmi* pranon Zotin si krijues por nuk e njeh Atë si Punues dhe Mbajtës së gjithësisë, dhe as nuk pranon shpalljen si burim të dijes. *Deizmi* mori hov në Evropë veçanërisht gjatë Epokës së Iluminizmit.

Disa nga figurat më të rëndësishme të kësaj lëvizjeje filozofike dhe kulturore ishin René Descartes, Denis Diderot, John Locke, Adam Smith... Ndërkohë duhet të thuhet se ka një paradoks në këtë mes: edhe pse ka përjashtime të rëndësishme, shumica e figurave të kësaj lëvizjeje të quajtura *Iluminizëm* nuk e njohin përndritjen (*illuminatio*) e intelektit nga Hiri Hyjnor, por njohin si kriter të vetëm të njohjes arsyen (*ratio*), e cila nga vetë emri nënkupton se është fragmentare.³⁴ Sipas doktrineve tradicionale të feve Abrahamike, por jo vetëm, intelekti (*intellectus*) është dhunti dhe shkëndijë hyjnore te njeriu, që kur zgjohet plotësisht e çliron dhe e shpëton atë. Reduktimi i intelektit në arsye dhe kufizimi i tij në finokëri e zgjuarsi është një nga simptomat më domethënëse të desakralizimit të dijes dhe rrafshimit të synimit vertikal të njeriut, drejtuar kah Zoti, në synime horizontale nga të cilat spikat pushteti mbi natyrën dhe të tjerët.

Gjatë kësaj periudhe vetë kuptimi i fjalës *shkencë* pësoi ndryshim, shkruan Brooke, sepse “nëse dija shkencore përftohet nga të menduarit mbi idetë që dolën përfundimisht nga përvoja shqisore, afërmendsh ishte tunduese të dilje në përfundimin se asnjë formë tjetër njohurie nuk ishte e mundur.”³⁵ Me

34. Fjalët ‘arsye’ dhe ‘ndarje’ kanë si rrënjë fjalë ‘arë’, e cila përkon me *ratio*.

35. Brooke, *op. cit.*, ff. 208-209. Shih edhe

përkufizim, dija e vetme e besueshme u bë ajo e lëndës, e gjërave, e mënyrës si ato funksionojnë. Përkufizimi që Francis Bacon-i (v. 1626) i bëri dijes ishte: *dija është pushtet* - me pasë dije mbi diçka do të thotë me pasë pushtet mbi të. Kjo u bë kredoja e Perëndimit dhe kështu dija pushoi së qenuri mjet i përndritjes dhe çlirimit. Vargu biblik “E Vërteta do t’ju bëjë të lirë” nuk ishte më i vërtetë.³⁶

Meqë një zhvendosje e tillë e konceptit të dijes dhe të kuptuarit të natyrës nuk ndodhi në botën Sinike, Hindu, Islame apo të Krishterë Ortodokse, por vetëm në Perëndim, pikërisht këtu veprimtaria njerëzore ndërroi kahun e përparësive, duke u drejtuar nga bota e veprimit në kurriz të asaj të kuptimit, u josh moria e fakteve në natyrë, duke harruar ligjëratën e simboleve të saj. Njeriu evropian filloi t’ia kushtonte energjinë e vet botës materiale, duke e lënë pas dore atë shpirtërore. Shkencat e fakteve e aplikimi i tyre - zbulimet, mekanizimi, industrializimi - morën hov, duke arritur majat në shekullin e XIX. Gjatë sundimit kolonial, nënshtrimi i shumë kombeve anembanë globit ia forcoi Perëndimit bindjen në epërsinë e botëvështrimit të ri, që kishte përqaftuar.

Në parim, ky botëvështrim nuk e pranonte Alegorinë e Shpellës të

“Science and Religion in the Enlightenment”, po aty.

36. Gjoni, 8:32.

Platonit, në të cilën Bota e Ideve e ndriçuar nga Dielli pasqyrohet në atë të shqisave në formë hijesh në thellësinë e shpellës – ç’është e vërteta Alegoria është në përputhje me çdo botëvështrim premodern.³⁷ Platonistët do të thonin se në botëvështrimin e ri perëndimor, ku përparësia ishte te veprimi dhe jo përsiatja, vëmendja ishte përqendruar thujtë e tëra në lëvizjen e lojës e hijeve në shpellë. Me shumë gjasë, ata do ta shihnin këtë rrjedhë ngjarjesh si të natyrshme, njëfarë kompensimi material për zbehjen e kthjelltësisë simbolike e metafizike të botës. Siç vëren Plotini:

Kur aftësia e përsiatjes u dobësohet... njerëzit e kthejnë veprimin në surrogat të zbehtë të përsiatjes dhe arsyetimit. Të qenit të dobët shpirtërisht i bën ata të paaftë të rrokin mjaftueshëm pamjen (*theoria*), duke mbetur kështu të paplotë. Por ata prapë kanë mall për të (pamjen, *theoria*) dhe kështu nxitojnë e hidhen në veprim për të kuptuar pamjen që s’mund ta rrokin me intelektin e tyre... Kush është ai që kur është i aftë të soditë atë çka është me të vërtetë reale, shkon me qëllim pas hijes së saj? Dallimi mes

37. Në thelb, botëvështrimi i Platonit është në harmoni me ato të qytetërimeve premoderne, të cilat pa përjashtim ishin themeluar dhe ndërtuar rreth një Ideje Shpirtërore. Shih Huston Smith, *Forgotten Truth: The Common Vision of the World's Religions* (Harper San Francisco, 1992 [1976]).

veprimet dhe përsiatjes dëshmohet edhe nga disa fëmijë që kur nuk janë të aftë për studime mësojnë zanat e punë krahu.”³⁸

Shkenca si një shprehje kulturore

Kur vjen puna për të zgjidhur një çështje, një mister, asnjë detektiv nuk do ta kishte luksin e shpërfilljes së një skenari të mundshëm. Charles Darwin-i bëri pikërisht këtë në lidhje me lindjen e vetë jetës, burimit të çdo misteri. Meqë ai ishte bindur se me shumë gjasë nuk kishte Zot dhe se bota materiale ishte i vetmi realitet - këto janë premiset mbi të cilat varet përfundimi - atëherë jeta *dubët* të ishte zhvilluar ashtu siç e përshkruante teoria e tij. Tjetër mundësi nuk mund të kishte. Nuk ishte çështje vëzhgimi asnjans që çoi në një përfundim, por e një interpretimi të natyrës duke marrë si pikënisje një botëvështrim të caktuar. Darwin-i e përshkruan kështu dobësimin dhe më vonë humbjen e besimit në parimet fetare:

Rreth viteve 1836-39, fillova të shoh se Dhiatës së Vjetër s'mund t'i besohej më shumë sesa teksteve të shenjta të Hinduve... Më vonë, duke menduar se dëshmia më e qartë është kusht për ta bërë një njeri me mend të besojë në mrekullitë mbi të cilat mbahet Krishterimi, se sa më shumë

38. Plotinus, *Enneads*, III, 8.4.

dimë mbi ligjet e pandryshueshme të natyrës aq më të pabesueshme bëhen mrekullitë, se njerëzit në atë kohë ishin injorantë dhe naivë në një shkallë të paimagjinueshme prej nesh... dalëngadalë besimi në Krishterimin si shpallje hyjnore mu sos. Mbi mua rëndonte disi fakti që shumë fé të rreme janë përhapur si vetëtimë mbi shumë vise nëpër botë. Por isha tepër i vendosur të mos e braktisja besimin tim; jam i sigurtë për këtë sepse e kujtoj mirë sa herë sajoja në imagjinatën time letërshekëmbime mes Romakësh me emër dhe dorëshkrime, që zbuloheshin në Pompei e gjetkë, të cilat vërtetonin në mënyrë të prerë çdo gjë që ishte shkuar në Ungjijtë. Por e pata gjithnjë e më të vështirë... të sajoja dëshmi që do të mjaftonte të më bindte. Kështu ngadalë ngadalë mosbesimi më pushtoi tërësisht dhe përfundimisht; aq ngadalë sa nuk ndjeva shqetësim.³⁹

Ky mohim i besimit, bashkë me idetë e ekonomistit politik Robert Malthus, u bë platforma mbi të cilën ai ndërtoi teorinë e tij. Shkuar një brez para Darwin-it, *Një Ese mbi Parimin e Popullsisë* e Malthus-it ishte aq e njohur në ato kohë sa shpesh quhej për shkurt *Popullsia (Population)*. Ai argumenton se popullsitë njerëzore do të konkurojnë (ose luftojnë) patjetër sepse rritja e popullsisë gjithmonë

39. *The Life and Letters of Charles Darwin*, ed. Francis Darwin (London, 1887), f. 308-309.

e tejkalon atë çka ata prodhojnë. Sipas tij, vetëm “e liga”, në veçanti lufta, mjerimi dhe zija e bukës, ose përkorja si “vetëpërmbajtje morale” mund t’i vënë frë konkurrencës.⁴⁰ Në autobiografinë e tij Darwin-i shkruan për ndikimin e Malthus-it:

Në tetor të vitit 1838... qëlloi që po lexoja për qejf *Popullsinë* e Malthusit dhe duke qenë i gatshëm, falë vëzhgimit të kahershëm të sjelljes së kafshëve e bimëve, të vlerësoja luftën për ekzistencë që zhvillohet kudo, menjëherë mu bë e qartë se në rrethana të tilla variacionet e favorshme do të prireshin drejt ruajtjes, ndërsa ato të jofavorshmet drejt zhdukjes. Pasojë e kësaj do të ishte formimi i specieve të reja. Më në fund, tani kisha një teori me të cilën të punoja...⁴¹

Por Darwin-i nuk ishte një rrufe në qiell të pastër. Ai jetonte në një shoqëri të Evropës Perëndimore që në krahasim me paraardhësit, kishte bërë një zhvendosje drastike në botëvështrimin e saj: Zoti ishte tërhequr (ose s’ekzistonte), në rastin më të mirë Bota e Ideve dhe Arketipeve e Platonit ishte kthyer në një kuriozitet filozofik, natyra shihej si diçka që ishte në thelb mekanike. Në një shoqëri të tillë shfaqja e

teorive, që e shihnin njeriun thjesht si tejjgatje e rendit fizik ishte një rrjedhë logjike - qoftë si aksident biologjik (Darwin-i) ose si produkt i forcave të papërvetshme ekonomike e politike (Marksit). Për më tepër, ai jetonte në një Angli Viktoriane, ku industrializimi, ekonomia e tregut, konkurrenca, kolonializmi dhe progresi merreshin si të qenë. Qëllimi i njeriut ishte lufta për ekzistencë dhe teoria e Darwin-it ia mvesh këtë qëllim natyrës. “Çdo grup nxori nga një moral prej tij”, do të shkruante dramaturgu dhe kritiku i njohur irlandez George Bernard Shaw.

Yjet duhet të kenë qenë në vijë të drejtë sepse... ai pati fatin t’i bënte qejfin të gjitha palëve. Në mirëseardhjen e Darwin-it nuk u radhitën me ngazëllim vetëm humanitarët. Ushtarakët ishin po aq entuziastë sa humanitarët, socialistët po aq sa kapitalistët. Në veçanti, socialistëve u dha zemër theksi i Darwin-it mbi ndikimin e mjedisit. Ndoshta mburoja më e fortë morale e kapitalizmit është bindja në efektshmërinë e ndershmërisë personale... Ndaj socialistit nuk kishte kundërpërgjigje më të gjetur sesa t’i thojë të reformojë veten para se të përpiquej të reformojë shoqërinë... Nëse qëlloje i kamur, ku kishte më mirë se të mendoje se pasurinë e kishë falë epërsisë së karakterit tënd!

Përparësia dhe theksi mbi konkurrencën si vlerë përgatiti

40. Shih Thomas Robert Malthus, *An Essay on the Principle of Population* (1798). Malthus ishte gjithashtu klerik i shuguruar i Kishës Anglikane.

41. *The Autobiography of Charles Darwin*, ed. Nora Barlow (London, 1958), f. 120.

terrenin për ardhjen e teorisë së Darwin-it, e cila u prit me një entuziazëm dhe organizim të pashembullt. Shaw vazhdon:

Me sa dimë, asnjëherë në histori nuk ka pasur një lëvizje politike të organizuar, aq të vendosur dhe të mbështetur financiarisht, për të bindur njerëzimin se gjithë përparimi, mirëqenia, shpëtimi individual dhe shoqëror varet nga një konflikt pa frë për ushqim dhe para, nga shtypja dhe asgjësimi i të dobëtit nga i forti, në Treg të Lirë, Kontratë të Lirë, Konkurrencë të Lirë, Liri të Natyrshme, *Laissez faire*,⁴²; me një fjalë, dorë e lirë për të 'hequr qafe tjetrin' pa asnjë përgjegjësi e pasojë.⁴³

Biologët Richard Levins dhe Richard Lewontin e pranojnë se teoria e evolucionit të Darwin-it ishte një produkt tipik i revolucionit intelektual borgjez. E para, ishte një teori materialiste, që mohoi idealet Platonike dhe i zëvendësoi ato me forca reale mes objekteve realë. E dyta, ishte një teori ndryshimi në kundërshtim me atë qëndrueshmërisë, si vazhdimësi e zotimit të shekullit të XIX për ndryshim.⁴⁴

Nuk mund të ketë ide që

42. Term në frëngjisht që do të thotë "pa ndërhyrje, pa rregullim" nga ana e shtetit.

43. George Bernard Shaw, *Back to Methuselah: A Metabiological Pentateuch* (The Project Gutenberg eBook, [1921]), hyrje, f. 22.

44. Richard Levins, Richard Lewontin, *The Dialectical Biologist* (Aakar Books, 2009 [Harvard University Press, 1985]), f. 3.

kundërshtohet më fort nga shkencëtarët sesa ajo që shkenca e një shoqërie mund të ndikohet nga kultura e saj, përfshirë këtu edhe politikën. Në lidhje me komente të bëra nga disa shkencëtarë për librin e tij *Stephen Jay Gould dhe Politika e Evolucionit*, profesori i shkencave politike David F. Prindle shkruan: "... është e qartë se shumë shkencëtarë profesionistë e përceptojnë çdo orvatje për të marrë parasysh nuancat politike të ideve shkencore, si një sulm mbi vetë idenë e së vërtetës shkencore."⁴⁵ Ndryshe nga shumë kolegë të tij, vetë Gould (v. 2002), një nga shkencëtarët më të njohur amerikanë në shekullin e XX, thekson se jo vetëm që politika ndikon shkencëtarët (e si rrjedhojë edhe teoritë e tyre), por tërheq vëmendjen se ata janë "qenie njerëzore të rrënjësuar në kulturë."⁴⁶

Gazetarët William Broad dhe Nicholas Wade duket se janë në një mendje me të:

Shkencëtarët nuk udhëhiqen vetëm nga logjika dhe objektiviteti, por edhe nga... retorika, propaganda dhe paragykimet vetjake. Shkencëtarët nuk varen vetëm nga mendimi racional dhe nuk kanë monopol mbi të. Shkenca nuk duhet

45. David F. Prindle, *Stephen Jay Gould and the Politics of Evolution* (New York: Prometheus, 2009), f. 11.

46. Stephen Jay Gould, *Time's Arrow, Time's Cycle: Myth and Metaphor in the Discovery of Geological Time* (Cambridge, MA: Harvard University Press, 1987), f. 6-7.

gjykuar si mbrojtësja e arsytimit në shoqëri, por thjesht si një formë kryesore e shprehjes së saj kulturore.⁴⁷

Parë nga ky kënd, Darwin-i nuk bën përjashtim. Ideja e tij e seleksionimit natyror nuk buroi nga vëzhgimet që ai bëri gjatë udhëtimit me anijen ‘Beagle’, por “në thelb” ishte zbatimi i idesë së “ekonomisë së Adam Smith-it në natyrë”, vëren Gould.⁴⁸ Adam Smith ishte një ekonomist skocez i shekullit të XVIII, i njohur veçanërisht për veprën e tij *Pasuria e Kombeve* (*The Wealth of Nations*), e cila gjykohet si themeli i ekonomisë moderne. Bazuar në shënimet dhe autobiografinë e Darwin-it, fizikani dhe historiani i shkencës, Silvan S. Schweber ka studiuar gjerësisht dhe ka lënë dëshmi të hollësishme mbi rolin qendror të ekonomisë politike të Adam Smith-it dhe rrethit të tij në formulimin e teorisë së evolucionit nga Darwin-i.⁴⁹ Për shembull, në një nga citatat më të njohura të Smith-it shkruhet:

47. William Broad, Nicholas Wade, *Betrayers of the Truth: Fraud and Deceit in the Halls of Science* (New York: Simon and Schuster, 1982), f. 9.

48. Stephen Jay Gould, *The Structure of Evolutionary Theory* (Cambridge, MA: Harvard University Press, 2002), f. 122.

49. Shih Silvan S. Schweber, The Origin of the “Origin” Revisited, *Journal of the History of Biology*, vol. 10, no. 2, (1977), ff. 229-316; Darwin and the Political Economists: Divergence of Character, *Journal of the History of Biology*, vol. 13, no. 2, (1980), f. 195-289.

Çdo individ synon sigurinë e vet... ai nuk synon interesin publik dhe e as nuk di sa po e mbështet atë. Duke e kanalizuar zellin në mënyrë që t’i japë përfitimin më të madh, ai kujdeset vetëm për interesin e vet dhe këtu, si edhe në shumë raste të tjera ai udhëhiqet nga një dorë e padukshme që e shtyn drejt një qëllimi që ai s’e kishte ndërmend... Duke ndjekur interesin e vet, shpesh ai promovon interesin e shoqërisë më mirë se vërtet të synonte ta promovonte atë.⁵⁰

Me një fjalë, ndonëse të gjithë ndjekin interesat vetjake, përfundimisht *dora e padukshme* i udhëheq ato në dobi të interesit publik. Ekonomisti skocez J. R. McCulloch, redaktori i *Pasurisë së Kombeve*, duke perifrashuar Smith-in shton:

Çdo individ përpiket vazhdimisht të gjejë mënyrat më dobiprurëse në shfrytëzimin e kapitalit dhe punës së tij. Është e vërtetë, që ai ka fitimin e vet si synim, jo atë të shoqërisë. Por, duke qenë se shoqëria nuk është më shumë se një grumbull individësh, është e qartë se duke rendur pa ndalim pas pasurimit të vet secili po ndjek busullën e veprimit që jep përfitimin më të madh publik.⁵¹

E sajuar nga Smith, “dora e padukshme” (invisible hand) është bërë një nga frazat më të njohura në

50. Adam Smith, *The Wealth of Nations*, Libri IV, kreu 2.

51. J. R. McCulloch, *Principles of Political Economy*, ed. 2 (1830), f. 149.

gjuhën angleze. Është e vështirë të mos vërehet ngjashmëria e aplikimi i ekonomisë së Smith-it në natyrë, siç u shpreh më lart Gould. Nëse *dora e padukshme* bën që përfundimisht të gjithë interesat vetjake të synojnë drejt të mirës publike, atëherë Darwini e merr këtë argument ekonomik dhe ia mvësh natyrës. Mund ta perifrazojmë kështu:

Megjithë luftën e ashpër për ekzistencë mes specieve (interesi vetjak), evolucioni nëpërmjet seleksionit natyror (dora e padukshme) përfundimisht synon drejt harmonisë (interesi publik).

Por, duhet të kujtojmë se përveç Darwin-it kishte edhe të tjerë që kishin zhvilluar ide të ngjashme me të tija, si Jean-Baptiste Lamarck, Robert Chambers, dhe në veçanti Alfred Wallace.⁵² Është e natyrshme që njerëz me ide të tilla shfaqen pothuajse në të njëjtën kohë në Perëndim dhe jo në Indi ose Japoni. Në mos Darwin-i, dikush tjetër do të kishte dalë për ta mbështetur e përkrahur botëvështrimin e ri materialist dhe mekanicistik të Evropës Perëndimore të shekullit të XIX me një teori të re të natyrës.

‘Sipas Kujt?’

– Shpata e Demokleut

Nëse dikush do të thoshte se “e vërteta është se të gjithë janë gënjeshhtarë”, atëherë do ta shihnim

52. Shih Charles Darwin, *Autobiography*, ed. Nora Barlow (1958), f. 120-121.

atë me qesëndi – ky pohim duhet t’i përfshijë edhe ata. Kësisoj, nëse na thonë se njerëzit janë të rrënjësuar në kulturë, ose të kushtëzuar nga gjenet, a nuk duhet të pyesim “sipas kujt?” Kush është ky njeri që mund të thotë një të vërtetë të tillë pa u ndikuar vetë nga gjenet ose kultura? ‘*Sipas kujt?*’ rri si shpatë e Demokleut mbi deklaratatë të tilla përgjithësuese. Duhet ta kemi parasysh se kjo çështje nuk i përket vetëm biologjisë. Për fat të keq, në lidhje me njeriun dhe natyrën ka deklarata nga autorë akademikë ose jo-akademikë që bëjnë të njëjtin gabim.

Psh., dëgjojmë ose lexojmë se jeta s’ka kuptim, se universi lindi nga përplasja aksidentale e thërrmijave atomike, se toka e njeriu s’janë hiçgjë në krahasim me hapësirën e kozmosit e të ngjashme si këto. Nëse jeta s’ka kuptim atëherë edhe vetë fjalia që e pohon këtë s’duhet të ketë kuptim, nëse bota e jeta lindi në mënyrë aksidentale, si mund të mos jetë aksidental një pohim i tillë, nëse toka e njeriu janë të humbur në këtë humnerë të pafund të universit pse u dashka ta marrim seriozisht një pohim nga një qenie e humbur në një trup qiellor të humbur në një cep të gjithësisë? *Kush* flet në këtë rast, që duhet ta marrim seriozisht? *Kush* është subjekti njohës, vetja jonë, që flet e gjykon atë çka e rrethon, objektin që njihet? Sokrati tek *Faedo* (230a) e thekson këtë problem themelor: “Fillimisht duhet të njoh veten, siç

thotë edhe mbishkrimi i Delfit. Do të ishte qesharake të bëhesha kurioz për diçka që nuk ka lidhje me mua, ndërsa jam ende i paditur në lidhje me veten time.” Përgjatë pjesës me të madhe të historisë, kjo është *pyetja* që i ka interesuar më shumë njerëzve. Sidoqoftë, kjo pyetje shpesh anashkalohet, nuk adresohet, ose edhe quhet edhe si shumë filozofike, që nënkuptohet si e parëndësishme, ose thjesht çështje fjalësh. Kjo është një çështje që kërkon trajtim më vete por që patjetër duhet përmendur sepse, e para është themelore dhe e dyta harrohet ose shmanget në mënyrë sistematike.

Lakmi dhe Konflikt Interesi

Kjo lloj shmangieje është një simptomë shumë shqetësuese, tërheq vëmendjen John R. Saul në librin e tij *Kopilat e Volterit: Diktatura e Arsyës në Perëndim*, sepse “dëshmia e padiskutueshme që një shoqëri është nën kontroll, ose në rënie, është kur gjuha ka pushuar së qeni mjet komunikimi dhe është bërë një mburojë për ata që e zotërojnë atë.”⁵³ Si për ironi, shton ai, fajtorët kryesorë janë ata që duhet të ishin të përkushtuar për rritjen e komunikimit – profesorët...” Arsyet mund të jenë të ndryshme, por shpesh akademikët shmangin pyetje

53. John Ralston Saul, *Voltaire's Bastards: The Dictatorship of Reason in the West* (New York: First Vintage, 1993), f. 9.

themelore, që u drejtohen teorive të pranuarra gjerësisht ose japin përgjigje të mjegullta duke ruajtur kështu *status quo*-në:

Ata e dinë me saktësi se si pyetjet nga një joekspert do të trajtohen nga një ekspert... metoda e zakonshme kur përballen me pyetje nga jashtë është shpërfillja dhe në vend të përgjigjes e shkurajojnë, madje edhe e trembin pyetësin, duke nënkuptuar se ai është i keqinformuar, i pasaktë, i cekët dhe tepër i emocionuar; kjo e fundit përmendet gjithmonë. Nëse pyetësi ka ndonjë farë autoriteti, eksperti mund të ndihet i detyruar të përgjigjet më me kujdes. Për shembull, ai mund të ndajë një sasi minimale informacioni në dialekt terminologjik dhe kërkon ndjesë për ndërlikimin, duke nënkuptuar se pyetësi nuk është i aftë të kuptojë më shumë. Dhe nëse pyetësit duhet t'i jepet përgjigje, por pa qenë nevoja të respektohet, – për shembull, një gazetar ose politikan – eksperti mund të lëshojë një lumë të dhënash të pakuptueshme, duke e shuar kështu diskutimin ndërsa shtiret se gjoja po merr pjesë në të. Edhe në qoftë se dikush mundet të kuptojë paqartësitë e temës, ai do të detyrohet të argumentojë kundër ekspertit në një kontekst aq të ndërlikuar saqë publiku, të cilit ai supozohet t'i komunikojë qartë, do ta humbasë interesin shpejt. Me një fjalë, duke e tërhequr pyetësin ngulmues në fushën e vet, eksperti e

bën atë të paaftë.⁵⁴

Meqë institucionet shkencore janë të themeluara dhe të drejtuara nga njerëzit dhe jo gjëra abstrakte, ato pasqyrojnë qëndrimet e tyre kur supozimet e teoritë u vihen në pyetje. Kuptohet, bashkë me to vihen në pyetje edhe autoriteti, prestigji dhe patjetër mbështetja financiare.

Ideja e akademive shkencore siç i kuptojmë sot mund të gjurmohet te vepra utopike *Atlantida e Re* e Francis Bacon-it, botuar në vitin 1626, ku ai imagjionon një kler shkencor që do të krijonte një organizatë, e cila do të trajtohej me respektin e nderimin më të madh.⁵⁵ Mund të thuhet me siguri se parashikimet e tij u realizuan pa shumë vonesë. Që në vitin 1660 u themelua *Shoqëria Mbretërore (Royal Society)*, akademia e shkencave të Britanisë së Madhe, e cila u pasua nga ngritja e institucioneve të ngjashme nëpër Evropë. Patricia Fara, historiane e shkencës në Universitetin e Cambridge-it, e përshkruan kështu rritjen e autoritetit shkencor në Evropën Perëndimore, veçanërisht gjatë shekullit të XIX:

Të etur për prestigj, shkencëtarët donin të zotëronin autoritetin për të deklaruar hapur se kishin të drejtë në mënyrë të pakundërshtueshme, se dija që prodhohet në laboratorët e tyre ishte e saktë në mënyrë të pamohueshme. Specializime të reja

po sajoheshin, por jo të gjitha u panë si të denja për t'u quajtur shkencë. Kjo e fundit po ndahej në disiplina – veçse kjo ndarje nënkuptonte jo vetëm larmi në lëndë mësimore, por njëkohësisht edhe kontroll. Si rojet, që patrollojnë kufijtë shtetërorë, shkencëtarët vendosën se cilat tema duhet të ishin brenda fushës së gjerë nën mbikqyrjen e tyre, e cilat duhet të ndaloheshin.⁵⁶

Gjendja e tashme në shkencat biologjike ngjason shumë me atë të shkencës në shekullin e XIX në Evropë, me sa tregon biologja Margulis:

Universitetet dhe shoqatat profesionale të sotme e ruajnë dijen e tyre. Programi mësimor universitar i biologjisë, shtëpitë botuese të librave shkollorë, komitetet shqyrtuese të Fondacionit Kombëtar të Shkencës (National Science Foundation), Provimet Pasuniversitare (Graduate Record Examinations) dhe shoqatat e ndryshme të mikrobiologjisë, evolucionit dhe zoologjisë, hartojnë territoret që njihen dhe ato që mund të njihen. Ata bëjnë dallimin mes dijes së nevojshme dhe asaj të ndaluar, duke ndëshkuar me takt shkelësit me anë të refuzimit ose harresës; ata shpërblejnë liturgjistët besnikë, duke u akorduar diploma e shpërndarë fonde dhe bursa... Çdo përpjekje për të dalë përtej kufirit

54. Po aty, f. 476-477.

55. *New Atlantis*, 1626. Vepra u botua pas vdekjes së Bacon-it.

56. Patricia Fara, *Science: A Four Thousand Year History* (Oxford: Oxford University Press, 2009), f. 194.

të lejuar, menjëherë sulmohet nga kritikë e ashpër, megjithëse shumë më shpesh luftohet me shpërfillje dhe injorim.⁵⁷

Ky shkallëzim i konfliktit të interesit në shkencë është diçka mjaft serioze. Sipas filozofit të shkencës Thomas Kuhn, ka diçka edhe më të thellë në këtë mes. Është në natyrën e “shkencës normale” – ajo e pranuar gjerësisht nga institucionet shkencore, që të kundërshtojë thirrjet për ndryshim dhe të mbrojë dogmën e saj:

Asnjë nga qëllimet e shkencës normale nuk kërkon të zbulojë fenomene të reja: ç’është e vërteta, çfarë nuk përputhet (me teoritë në fjalë) nuk merret aspak parasysh. Gjithashtu, shkencëtarët zakonisht nuk kërkojnë të formojnë teori të reja dhe shpesh janë intolerantë ndaj atyre të formuluar nga të tjerët. Përkundrazi, kërkimi shkencor normal udhëhiqet drejt shprehjes së fenomeneve dhe teorive që tashmë ofron paradigma.⁵⁸

Arsyet ose ndërthurjet e tyre për gjendjen e sotme në shumë fusha shkencore, bashkë me ngulmimin, që shkencëtarët dhe shkencë e tyre janë “objektivë” dhe të imunizuar nga çdo ndikim shoqëror ose

57. Margulis & Sagan, *op. cit.*, f. 265-266.

58. Thomas Kuhn, *The Structure of Scientific Revolutions*, 2nd ed. (IL: The University of Chicago Press, 1970[1962]), f. 24. Paradigma është botëkuptimi themelor i teorisë ose teorive shkencore në një ose shumë fusha shkencore.

interes, mbajnë në këmbë njëfarë hutimi dhe çoroditje në publik dhe pengojnë një dialog kuptimplotë me të.

Dikush mund të kundërshtojë duke treguar progresin teknologjik si dëshmi e saktësisë së teorive moderne shkencore. Mirëpo, ky është argument i mangët. Fakti që ndërtojmë aeroplanë, ose bomba atomike, nuk do të thotë se teoritë moderne janë doemos përshkrime të sakta të natyrës së realitetit. Në linjë me kredon Bacon-iane (*Baconian Creed*), qëllimi i shkencës moderne nuk është dija mbi natyrën e gjërave, përfshirë ajo mbi veten tonë, por përfundimisht është teknologjia, sepse me të vjen ose rritet pushteti. Si rrjedhojë, ka kohë që dija është bërë shërbëtore e pushtetit dhe kuptohet, etjes e lakmisë për të. Margulis (v. 2011), një nga shkencëtarët më të njohura amerikane, marrëse e shumë çmimeve, përfshirë *Medaljen Presidenciale për Shkencën*, shprehet kështu:

E ashtuquajtura shkencë e aplikuar (applied science) – që nga mrekullitë e mjekësisë molekulare, deri te shpërthimet e bombave me hidrogjen – është thjesht pjesë e së njëjtit petk llafollogjik, që thuret për të maskuar lakminë: lakmi akademike, lakmi shkencëtarësh, lakmi korporatash, lakmi qeveritare. Shkencë justifikohet, paqartësia gëlon, përshkrimet mjegullohen,

kërdia bëhet e plotë. Hipokrit për nga natyra, antropocentrizmi i papandehur shumëzohet me vetveten, duke reduktuar punën kërkimore në vetë-justifikim banal. Përveç kësaj ka edhe viktima, gjithmonë viktima, të dobëtit e të pashpresët – shkrimtarët e propagandës së shkencës, studentët që mësojnë përmendsh, teknikienët part-time, minjtë e kavjet e laboratorit, dhe të gjithë të çvlerësuarit e tjerë.⁵⁹

Gazetarja Suzan Mazur ka tërhequr vëmendjen në lidhje me konflikte serioze interesi edhe në biologjinë evolucionare. Sipas saj kjo disiplinë:

... ka të bëjë me shtirje, shitje, bërje bisht të pyetjeve dhe ngacmim të vazhdueshëm, po aq sa ka të bëjë me teori të mirëfilltë shkencore. Ajo është një ligjëratë shoqërore që përfshin hipoteza marramendëse për nga ndërlikimi, ku shkencëtarët, përfitues së fondeve më të mëdha se çdo intelektual, marrin pushtet politikanësh... Në një kohë kur ka nevojë për largpamësi shkencore, kërkimi shkencor është marrë peng nga një industri lakmie, ndërsa librat e evolucionit reklamohen si vaj gjarpri në karnival.⁶⁰

Përparësia dhe shqetësimi kryesor i shkencës dhe

shkencëtarëve, që përshkruajnë Fara, Margulis ose Mazur nuk është e vërteta, por pushteti. Do të ishte një qëndrim tejet optimist nëse do të shpresonim që teoritë e një shkence të tillë të kenë përparësi të tjera.⁶¹

Përfundime

Në një botë pa një Zot, në një botë të padepërtueshme prej ndonjë domethënieje më të lartë se asaj të rezervës natyrore, gjallesat mund të jenë vetëm produkt i forcave aksidentale dhe të verbëra. Ndërsa me përcaktimin e dijës si pushtet, kërkimi i saj është kufizuar në rritjen e pasurisë dhe teknologjisë, dy levat e rëndësishme të pushtetit. Materia dhe pushteti janë dy shtyllat mbi të cilat qëndron botëkuptimi modern, diçka që dëshmohet nga fakti se qytetërimi modern është në thelb tekno-industrial – vetëm një qytetërim i tillë mund ta shohë natyrën, si

61. Argumenti se arritjet teknologjike janë dëshmi e vërtetësisë së teorive dëgjohet vetëm në rastin e shkencës moderne. Për shembull, egjiptianët e lashtë ose aztekët nuk njihnin dhe as nuk patën nevojë të njihnin teorinë e gravitetit për të ndërtuar piramidat e tyre, dhe as Ibn Sina nuk e ndjeu mungesën e teorisë së evolucionit për të shkruar *Kanonin e Mjekësisë (el-Kanun fi el-Tibb)*, për shekuj me radhë libri burimor i mjekësisë në tre kontinente. Ndërsa i njohim, madje edhe admirojmë arritjet e qytetërimeve ose shkencëtarëve të hershëm, çuditërisht nuk ngurrojmë të gjujkojmë si naive dhe të pasakta teoritë e tyre mbi botën.

59. Margulis & Sagan, *op. cit.*, f. 20.

60. Suzan Mazur, *The Altenberg 16: An Exposé of the Evolution Industry* (Berkeley, CA: Noth Atlantic Books, 2010), f. v.

lëndë të parë dhe pushtetin si qëllim në vetvete.⁶² Shkenca moderne, si produkt i këtij botëkuptimi, natyrisht është në linjë me dhe e mbështet atë botëkuptim. Teoria e evolucionit – ose më saktë interpretimi neo-Darwinist i saj,⁶³ sidomos në SHBA dhe vendet e tjera anglishtfolëse - mbizotëron në shkencat biologjike, sepse ajo është “në përputhje të plotë me mitet kryesore të qytetërimit tonë dominues... dhe teknologjik”, thotë Margulis.⁶⁴

Dikush mund të pyesë: po zhvillimet në biologji dhe faktet

62. “Qytetërimi modern industrial është zhvilluar brenda një sistemi mitesh, që i shkojnë për shtat. Shtysa e qytetërimit modern industrial ka qenë leverdia materiale vetjake, e cila pranohet si legjitime, madje e lëvdueshme, me arsyen se veset private prodhojnë përfitime publike. Tani është kuptuar me kohë se një shoqëri, që mbështetet në këtë parim, me kalimin e kohës do të vetëshkatërrohet. Me gjithë vuajtjen dhe padrejtësinë që sjell, ajo mund të vazhdojë (të mbajë këtë parim) për sa kohë është e mundur të hiqet sikur forcat shkatërruese që njerëzit krijojnë janë të kufizuara, se bota është rezervë e pafund pasurish, dhe se bota është një kosh i pafund plehrash.” Noam Chomsky në një leksion mbi librin e tij *Manufacturing Consent*; cit. nga *Manufacturing Consent: Noam Chomsky and the Media*, dirs. Mark Achbar, Peter Wintonick (Zeitgeist Video, 1992) Documentary.

63. E njohur edhe si “teoria sintetike” ose “sinteza moderne”, Neo-Darwinizmi është versioni mbizotërues i evolucionit në tekste shkollore. Sipas Neo-Darwinizmit evolucioni drejtohet nga seleksionimi natyror nëpërmjet ndryshimeve gjenetike, ose siç njihen ndryshe, mutacioneve.

64. Margulis & Sagan, *op. cit.*, f. 277.

për evolucionin? Kjo është një temë që shpresojmë ta shtjellojmë më gjerë në të ardhmen, por mund të themi se ka shumë kohë në fushën e biologjisë ka kundërshtim. Filozofi i shkencës Michael Ruse nga Universiteti i Florida-s pohon se “një numër në rritje shkencëtarësh... argumentojnë se teoria Darwiniane e evolucionit nuk është aspak teori e mirëfilltë shkencore... Shumë nga kritikët kanë kredencialet më të larta intelektuale.”⁶⁵ Por, megjithatë ndryshimi ka qenë i ngadaltë sepse, “nëse... kërkesat për një qëndrim rigoroz shkencor mbi çështjen në fjalë ranë në veshë të shurdhër, kjo erdhi sepse teoria e evolucionit ka “meritën” e madhe të përputhet plotësisht me besimin në progresin njerëzor, i cili ka

65. ‘Darwin’s Theory: An Exercise in Science,’ *New Scientist*, vol. 1295, no. 90 (1981): 828-830. Më poshtë janë disa tituj nga shkencëtarë që kritikojnë qasjen Darwiniane, si Michael Denton, *Evolution: A Theory in Crisis* (Chevy Chase: Adler & Adler, 1985), ndjekur nga *Evolution: Still a Theory in Crisis* (Seattle: Discovery Institute, 2016); Rupert Sheldrake, *A New Science of Life: The Hypothesis of Formal Causation* (CA: Tarcher, 1981); Denis Noble, *The Music of Life: Biology Beyond Genes* (Oxford: Oxford University Press, 2006); Douglas Dewar, *The Transformist Illusion* (Murfreesboro, TN: Dehoff Pub., 1957); Michael Behe, *Darwin’s Black Box: The Biochemical Challenge to Evolution*, 2nd ed. (New York: Free Press, 2006[1996]); William A. Dembski, *The Design Interference: Eliminating Chance Through Small Probabilities* (New York: Cambridge University Press, 1998).

qenë rryma kryesore e mendimit Perëndimor për më shumë se një shekull,” shprehet autori anglez Martin Lings.⁶⁶ Qëllimi i këtij progresi është “pothuajse pa përjashtim teknologjia, pushteti, pasuria... dhe çdo kulturë lëshon hijen e vet, hije që është përshtetja e natyrës së saj”, shkruan William Irwin Thompson, një nga mendimtarët më të spikatur amerikanë të shekullit të kaluar.⁶⁷

Atëherë, *quo vadis?* Nëse teoritë tona janë të rrënjësura nga ana kulturore siç thotë Gould dhe Lewontin, ose janë hije të vetes sonë siç shprehet W. I. Thompson, për sa kohë që mbajmë të njëjtat përparësi nuk do të ketë ndonjë ndryshim të madh. Kur njeriu nuk ndryshon qëndrimin e vet, as trajta e hijes së tij nuk do të ndryshojë. Përparësitë dhe parimet sipas të cilave jetojmë e veprojmë, botëkuptimi që kemi ose që na mësohet, këto nuk janë gjëra të parëndësishme. Inteligjenca, bukuria, prejardhja e një gruaje në sytë e një pimpi⁶⁸ kanë vlerë *vetëm* në lidhje me të ardhurat që ato sjellin. Ai mund ta mbështesë këtë me fakte duke thënë se mosha,

inteligjenca, talenti muzikor i një gruaje kanë rëndësi sepse klienti duhet të paguajë më shumë dhe kaq! Nga ana tjetër, ajo çfarë një Dante sheh te një Beatrice ose një Ibn ‘Arabi tek një Nizama është një trupëzim i Urtësisë (*Sofia*) që udhëzon e çliron shpirtin.⁶⁹ Meqë botëkuptimi i tyre është rrënjësisht i ndryshëm, ajo çfarë ata shohin në një grua është krejtësisht tjetër nga ajo çfarë sheh një pimp. Pikëpamja e këtij të fundit është e pasaktë dhe për t’u përbuzur – ndërgjegjja jonë duhet të na e thotë kaq e gjë! Mirëpo, ky nuk është një ushtrim në sajimin e analogjive provokuese, por një shembull që thekson se mënyra se si e shohim botën flet njëherësh për ne, po aq sa për vetë botën. A mundet një pimp ta shohë një grua me sy tjetër? Mundet, por vetëm me kusht që të reshtë së qeni një pimp, d.m.th. duhet të ndryshojë veten, vlerat dhe botëkuptimin e vet. Po ne, si mund ta studiojmë natyrën dhe veten tonë me sy të tjerë? Jam i sigurtë se lexuesit mund ta plotësojnë vetë fjalinë...

66. Martin Lings, ‘Book Review: *The Transformist Illusion* by Douglas Dewar’ in *Studies in Comparative Religion*, vol. 4, no. 1 (1970).

67. Cit. nga from Margulis & Sagan, *op. cit.*, f. 276-277.

68. Tutor.

69. Beatricja ishte frymëzimi për *Komedinë Hyjnore* të Dantes dhe vasha Nizama për veprën *Zëdhënësi i Dëshirave* (*Terxhuman el-Ashmaq*) të Ibn ‘Arabiut. Shih Ralph Austin, ‘Lady Nizam – An Image of Love and Knowledge,’ *Journal of the Muhyiddin Ibn ‘Arabi Society*, vol. 8 (1988): 35-48.

Bibliografia

- Bacon, F. (1626). *New Atlantis*.
- Barlow, N. (Ed.). (1958). *The Autobiography of Charles Darwin*. London.
- Brooke, J. H. (1991). *Science and Religion: Some Historical Perspectives*. Cambridge University Press.
- Burt, E. A. (2003[1925]). *The Metaphysical Foundations of Modern Science*. New York: Dover.
- Cornford, F. M. (1912). *From Religion to Philosophy: A Study on the Origins of Western Speculation*. London.
- Cusa, N. o. (1954). *De Docta Ignorantia - Of Learned Ignorance*. trans. G. Heron. London: Routledge & Kegan Paul.
- Darwin, F. (Ed.). (1887). *The Life and Letters of Charles Darwin*. London.
- Dawkins, R. (1986). *The Blind Watchmaker*. New York: W.W.Norton&Company.
- Dawkins, R. (1989[1976]). *The Selfish Gene*. Oxford: Oxford University Press.
- Fara, P. (2009). *Science: A Four Thousand Year History*. Oxford: Oxford University Press.
- Gould, S. J. (2002). *The Structure of Evolutionary Theory*. Cambridge, MA: Harvard University Press.
- Horgan, J. (2015). *The End of Science: Facing the Limits of Knowledge in the Twilights of the Scientific Age*. New York: Basic.
- Iamblichus' Life of Pythagoras* (1818). trans. & not. T. Taylor. London: J. M. Watkins.
- John Cottingham, R. S. (Ed.). (1985). *The Philosophical Writings of Descartes*. New York: Cambridge University Press.
- Jonas, H. (2001[1958]). *The Gnostic Religion*. Boston: Beacon Press.
- Kuhn, T. (1970[1962]). *The Structure of Scientific Revolutions*. The University of Chicago Press.
- Lubics, R. A. (1977). *The Temple in Man: Sacred Architecture and Perfect Man*. (R. & Lawlor, Ed.) New York: Inner Traditions International.
- Malthus, T. R. (1798). *An Essay on the Principle of Population*.
- Margulis, L. (1991). *Slanted Truths: Essays on Gaia, Symbiosis, and Evolution*. New York: Springer Verlag.
- Mazur, S. (2010). *The Altenberg 16: An Exposé of the Evolution Industry*. Berkeley, CA: North Atlantic Books.
- McCulloch, J. R. (1830). *Principles of Political Economy*.
- Nasr, S. H. (1989). *Knowledge and the Sacred*. New York: State University of New York Press.

- Nasr, S. H. (1996). *Religion and the Order of Nature*. New York: Oxford University Press.
- Plato. (1977). *Complete Works*. (D. S. John M. Cooper, Ed.) Hackett.
- Plotinus. (1953). *Enneads*. trans. & not. A. H. Armstrong. London.
- Prindle, D. F. (2009). *Stephen Jay Gould and the Politics of Evolution*. New York: Prometheus.
- Richard Levins, R. L. (2009[1985]). *The Dialectical Biologist*. Aakar Books.
- Saul, J. R. (1993). *Voltaire's Bastards: The Dictatorship of the Reason in the West*. New York: First Vintage.
- Schweber, S. S. (1977). The Origin of the "Origin" Revisited. *Journal of the History of Biology*, 10(2).
- Schweber, S. S. (1980). Darwin and the Political Economists: Divergence of Character. *Journal of the History of Biology*, 13(2).
- Shaw, G. B. (1921). *Back to Methuselah: A Metabiological Pentateuch*. Project Gutenberg eBook.
- Sheldrake, R. (2012). *The Science Delusion: Freeing the Spirit of Inquiry*. London: Coronet.
- Smith, A. (1776). *Wealth of Nations*.
- Smith, H. (1992). *Forgotten Truths: The Common Vision of World's Religions*. New York: HarperCollins.
- Stephen Hawking, L. M. (2010). *The Grand Design*. New York: Bantam.

Reflektime nga të dhënat demografike për popullsinë myslimane në botë

Illir Akshija, M.D., M.Sc.

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë,
Shërbimi i Statistikës

Abstrakt

Të dhënat demografike janë thelbësore për shoqëritë islame. Origjina e censeve në Islam e ka filluesën në vitin e parë të Kalendarit Hixhri me urdhëresën e Profetit a.s. Numri i njerëzve që popullojnë aktualisht tokën është i krahësueshëm me numrin e supozuar të të gjithë myslimanëve që ndonjëherë kanë jetuar në tokë përbën një fakt së paku interesant. Duke mos u futur në interpretime shpirtërore, që është kompetencë e tjetërkujt, mund të arrijmë në disa përfundime të bazuara në “të dhëna gjysmë-shekencore” në përafrim të këtij numri. Llogaritjet tregojnë se nga 107 miliard njerëz që kanë jetuar mbi tokë, 7,269,215,000 (6.8%) kanë lindur myslimanë. Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave të paraqitura në mënyrë grafike tregojnë proporcionin e numrit të myslimanëve, që kanë jetuar deri në atë moment në kohë, me numrin e popullatës njerëzore të gjallë në atë kohë, që tregojnë disa pika thyerje me interes. Të gjitha të dhënat dhe konkluzionet duhen konsideruar me kujdes për arsye të burimeve të pasigurta të informacionit.

Hyrje

Një nga suret e Kur’anit, i dha Profetit a.s. dhe komunitetit të tij lajmin e mirë të një fitoreje të madhe siç ishte çlirimi i Mekës dhe lajmin e përqafimit të Islamit nga njerëzit ‘turma-turma’.

*Me emrin e Allahut, t
Gjith m shirshmit, M shir plotit!*

1. Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (ngadhënjimi),
2. dhe t’i shohësh njerëzit, që po hyjnë turma-turma në fenë e Allahut,
3. ti, atëherë, lartësoje Zotin tënd duke falënderuar dhe

kërko nga Ai falje. Ai vërtet e pranon shumë pendimin, është Mëshirues i madh.¹

Një pyetje me vlerë praktike do të ishte rreth numrit të popullatës myslimane, që aktualisht jeton në tokë, dhe të tjera të dhëna demografike. Një pyetje tjetër mund të bëhej rreth “numrit të të gjithë myslimanëve që kanë jetuar ndonjëherë në tokë” ose “në çfarë proporcioni janë këta numra me njerëzit e tjerë që nuk i përkasin Islamit”. Ndërsa kërkesat rreth demografisë janë të pranishme që nga koha e Pofetit a.s., i cili urdhëroi edhe zhvillimin e një censi në vitin e parë të kalendarit islam, pyetjet e tjera mbeten interesante por me një vlerë “gjysmë-shkencore”.²

Këto të dhëna nuk kanë ndonjë vlerë në lidhje me komunitetet e tjera fetare për aq kohë sa vlerat më të larta njerëzore garantojnë bashkë-ekzistencën dhe tolerancën, ndërkohë që ato mund të jenë të rëndësishme në lidhje me aspekte praktike, si planifikimi dhe parashikimi i burimeve njerëzore.

Metoda dhe materiali

Ideja a kësaj llogaritjeje vjen si

1. Kur'an; 110. Kuptimet e tij në gjuhën shqipe. Mbështetur në përkthimin e Sherif ef. Ahmetit.

2. The Noble Life Of The Prophet By Dr. Ali Muhammad As Sallaabee P. 882.

rezultat i llogaritjeve të ngjashme në lidhje me popullatën njerëzore në tokë duke shkuar pas deri në vitin 50,000 (CE), megjithëse këto janë të bazuara në të dhëna të pasigurta që lidhen me kohën e vërtetë të ekzistimit të njeriut në tokë, numrin e lindjeve dhe vdekjeve, si dhe të tjera të dhëna të gabuara.

Të dhënat që lidhen me numrin e myslimanëve janë marrë nga burime demografike shkencore, ndërsa të dhënat si “lindje për 1.000” janë adoptuar nga një studim që vlerëson të gjithë popullatën njerëzore, jo vetëm myslimanët. Metoda e llogaritjeve është bazuar në metodën e ofruar për të gjithë popullatën njerëzore, me përjashtim të rastit kur të dhënat rreth popullatës për vitet që shërbejnë si pikë referimi në kemi përdorur mesataren e limitit të poshtëm dhe të sipërm të klasës për popullatën.

Paraqitjet grafike për çdo gjetje në tabelë janë treguar në formë diagramesh.

Rezultate

Rezultatet janë fokusuar në dy elemente kryesore për tu llogaritur, numrin e supozuar të të gjithë myslimanëve, që ndonjëherë kanë jetuar në tokë, dhe proporcionin e tyre ndaj njerëzve të tjerë që jetojnë.

Tabela. 1 Numri i përgjithshëm i myslimanëve që kanë jetuar ndonjëherë në tokë

Year	Popullata*	Lindje për 1,000**	Lindje që nga data e mëparshme***	Kumulative****
600	0			
800	11,000,000	80		
1000	23,000,000	80	176,000,000	187,000,000
1100	32,000,000	80	220,000,000	407,000,000
1200	44,000,000	60	304,000,000	711,000,000
1300	52,000,000	60	288,000,000	999,000,000
1400	56,000,000	60	324,000,000	1,323,000,000
1500	71,000,000	60	381,000,000	1,704,000,000
1600	98,000,000	60	507,000,000	2,211,000,000
1700	114,000,000	50	636,000,000	2,847,000,000
1800	162,000,000	50	690,000,000	3,537,000,000
1850	215,000,000	40	471,250,000	4,008,250,000
1900	282,000,000	40	497,000,000	4,505,250,000
1950	478,000,000	38	760,000,000	5,265,250,000
1975	852,000,000	35	631,750,000	5,897,000,000
2000	1,290,000,000	31	937,125,000	6,834,125,000
2010	1,588,000,000	23	446,090,000	7,280,215,000
Totali			7,269,215,000	

* Ghazi bin Muhammad, Kalin I, Kamali M. War and peace in Islam. Cambridge, U.K.: Islamic Texts Society; 2013. 210-211.

** Science L. The Dead Outnumber the Living (Infographic) [Internet]. Live Science. 2018 [cited 6 February 2018]. Available from: <https://www.livescience.com/18336-human-population-dead-living-infographic.html>

*** Lindje që nga data paraardhëse, tregon numrin e lindjeve bazuar në ‘numrin e lindjeve për 1,000’ dhe mesatares së popullatës së vitit përkatës dhe vitit paraardhës, e llogaritur për diferencën e viteve.

**** Kumulative, mbledh numrat e lindjeve të të gjithë klasave të mëparshme me klasën ku jemi.

Figura. 1 Numri i të gjithë myslimanëve që kanë jetuar ndonjëherë në tokë krahasuar me numrin e njerëzve të të gjithë njerëzve të tjerë.



	Numri	%
Popullata e botës 2011	6,215,000,000	
Nr. i njerëzve që kanë jetuar ndonjëherë në tokë	107,000,000,000	
Myslimanë që kanë jetuar ndonjëherë në tokë	7,269,215,000	6.8
Të tjerë	99,730,785,000	93.2

Tabela. 2 Krahasimi ndërmjet numrit të të gjithë njerëzve të gjallë në një moment të caktuar kohor dhe numrit të supozuar të myslimanëve, që kanë jetuar ndonjëherë deri në atë moment në kohë.


Viti	Të tjerë gjallë*	Myslimanë që kanë jetuar ndonjëherë në tokë **
1200	406,000,000	711,000,000
1650***	402,000,000	2,211,000,000
1750	681,000,000	2,847,000,000
1850	1,050,000,000	4,008,250,000
1900	1,656,000,000	4,505,250,000
1950	2,038,000,000	5,265,250,000
1995	4,470,000,000	6,834,125,000
2011	4,627,000,000	7,280,215,000

* Numri i supozuar i të gjithë njerëzve që kanë jetuar në atë moment në kohë përveç myslimanëve.

** Numri i njerëzve të etiketuar si të lindur myslimanë (umeti i profetit Muhamed a.s.). Të tjerë njerëz konsiderohen si myslimanë nga Kur’ani por janë lënë jashtë kësaj llogaritje. **“Ibrahimi nuk ka qenë, as jehudi, as i krishterë, por ai ishte larg besimeve të kota, ishte mysliman dhe nuk ishte prej idhujtarëve.”**

*** Qelizat e ngjyrosura tregojnë se shifrat e popullatës myslimane janë marrë nga një burim informacioni që i referohet (**Tabela 1**) vlerës së vitit më të afërt të disponueshëm.

Figura. 2 Krahasim ndërmjet numrit të njerëzve të tjerë, në momentin kohor, me numrin e supozuar të të gjithë myslimanëve deri në atë moment



Diskutimi

Ndërsa popullsia e tokës po troket 7.9 miliard (2021) këto llogaritje tregojnë disa vlerësime rreth popullatës myslimane, që ndonjëherë ka jetuar në tokë. Numri 7,269,215,000, vlerësim i vitit 2010, është një vlerësim i numrit të përgjithshëm të myslimanëve, që ndonjëherë kanë jetuar në tokë (bëhet fjalë për umetin e Muhamedit a.s.). Grafiku (Figura 1) tregon proporcionin e popullatës myslimane që ndonjëherë ka jetuar në tokë (rrethi i vogël me figurën e Qabes) ndaj numrit total të njerëzve që kanë jetuar në tokë (rrethi i madh me figurën e hartës së botës). Sipas këtyre llogaritjeve 6.8% e

të gjithë njerëzve, që kanë jetuar në tokë, janë myslimanë. Të tjerë myslimanë kanë jetuar në tokë por këto të dhëna tregojnë vetëm umetin e Muhamedit a.s. Një nga faktet më interesante ishte krahasimi i numrit të të gjithë myslimanëve, që kanë jetuar në një moment të caktuar në kohë, me numrin e të gjithë njerëzve që kishin jetuar deri në atë moment në kohë. Paraqitjet grafike tregojnë disa pika thyerje në kohë, që mund të shërbejnë për të orientuar kërkimet në mënyrën e zgjerimit të Islamit, për shembull, mund të analizohet nëse rritja ka ardhur si rezultat i konvertimit apo nga numri i rritur i lindjeve dhe rënia e vdekshmërisë, veçanërisht vdekshmëria infantile.

Konkluzione

Në këtë botë dhe tjetrën numrat kanë rëndësi. Rezultatet e prezantuara mund të konsiderohet si “*gjysmë-shkencore*”, ashtu edhe siç shkruan vetë autori i punimit origjinal, të cilit i jemi referuar. Në fund kemi llogaritur, me kusht që numri i njerëzve të jetë kriteri i mbartjes së dijes, kusht teorik dhe jo i vlefshëm, por i përdorur vetëm për arsye demonstrimi, që ne në vitin 2010 duhet të kishim;

144 persona si Imam Abu Hanifa (699 - 767 CE / 80 - 148 AH),

144 persona si Imam Malik ibn Anas (733 - 795 CE / 114 - 178 AH),

144 persona si Imam Al-Shafî'i (767 - 820 CE / 149 - 204 AH),

144 persona si Imam Ahmad ibn Hanbal (780 - 855 CE / 163 - 240 AH),

144 persona si Muhammad al-Bukhari (810 - 870 CE / 194 - 256 AH),

144 persona si Muslim ibn al-Hajjaj (815 - 875 CE / 199 - 261 AH),

69 persona si Al-Qushayri (986 - 1072 CE / 375 - 464 AH),

50 persona si Imam Al-Ghazali (1058 - 1111 CE / 448 - 504 AH),

36 persona si Ibn Arabi (1165 - 1240 CE / 560 - 638 AH),

36 persona si Jalal ad-Din Muhammad Rumî (1207 - 1273 CE / 603 - 671 AH),

31 persona si Ibn Qayyim al-Jawziyya (1292 - 1350 CE / 691 - 751 AH).

Ebu Hurejra r.a. tregon: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s. se ka thënë: “*Nga pasuesit e mi do të hyjnë në Xhenet (pa u marrë në llogari) një grup prej shtatëdhjetë mijë vetësh, fytyrat e të cilëve do të shkëlqejnë si hëna në një natë me hënë të plotë*”. Kur dëgjoji këtë ‘Ukashe bin Mihsan El-Esedij u ngrit, duke ngritur çarçafin që e mbulonte, dhe tha: O i Dërguari i Allahut! Lutju Allahut që Ai të më bëjë prej tyre. Profeti a.s. tha: “*O Allah, bëje atë njërin prej tyre*.” Një burrë tjetër nga Ensarët u ngrit dhe tha: O i Dërguari i Allahut! Lutu Allahut që Ai të më bëjë prej tyre. Profeti a.s. i tha, “*Ta kaloi Ukashe*.”³

Referimi i rezultateve të këtij studimi duhet bërë në mënyrë shumë të kujdesshme për arsye se të dhënat mund të mbartin gabime që vijnë nga burimet e informacionit ku janë marrë, si kur flitet për numrin e lindjeve, vlerësimin e numrit të popullatës, etj. Supozimet që lidhen me rritjen konstante të popullatës mund ta nënvleftësojnë atë në periudhat e hershme, ndërsa një datë më e hershme e shfaqjes së njerëzve në tokë do ta rriste numrin.⁴

3. Bukhârî M Khan M. The translation of the meanings of Sahîh Al-Bukhârî. Volume 8. Riyadh, Saudi Arabia: Dar-us-Salam,; 1997. 294

4. Haub C. How many people have ever lived on earth? Population Today. 1995 Feb 1; 23(2):4-5.

Referenca

Ahmeti Sh., KURANI I MADHËRISHËM, Kuptimet e tij në gjuhën shqipe. 2nd ed. Lies Stiftung; 2015.

The Noble Life Of The Prophet By Dr. Ali Muhammad As Sallaabee.

Ghazi bin Muhammad, Kalin I, Kamali M. War and peace in Islam. Cambridge, U.K.: Islamic Texts Society; 2013.

Science L. The Dead Outnumber the Living (Infographic) [Internet]. Live Science. 2018 [cited 6 February 2018]. Available from: <https://www.livescience.com/18336-human-population-dead-living-infographic.html>

Bukhâri M Khan M. The translation of the meanings of Sahîh Al-Bukhâri. Volume 8. Riyadh, Saudi Arabia: Dar-us-Salam,; 1997.

Haub C. How many people have ever lived on earth? Population Today. 1995 Feb 1; 23(2).

Footnotes

1. Ghazi bin Muhammad, Kalin I, Kamali M. War and peace in Islam. Cambridge, U.K.: Islamic Texts Society; 2013. 210-211.

2. Science L. The Dead Outnumber the Living (Infographic) [Internet]. Live Science. 2018 [cited 6 February 2018]. Available from: <https://www.livescience.com/18336-human-population-dead-living-infographic.html>

Medresetë në Kosovë gjatë periudhës osmane

Dr. Sadik Mehmeti

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë

Hyrje

Me depërtimin e osmanëve në Kosovë dhe me vendosjen e administrimit të tyre (shek. XIV - XV), dhe pas pranimit të Islamit nga pjesa më e madhe e popullatës së saj, ata, siç është e ditur, kanë sjellë në këto anë të njëjtat parimet të cilat i kishin përvetësuar nga arabët dhe persët¹. Në mesin e këtyre, bëjnë pjesë edhe shkollat fetare myslimane - *mejtepet dhe medresetë* -, të cilat, pas xhamive, i hasim shumë herët në Kosovë.

1. Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane*, në: Historia e Shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman, vëll. II, AIITC, Tiranë, 2009, f. 366.

Në të vërtetë, fillet e para të veprimtarisë arsimore-edukative islame në trojet tona datojnë qysh nga periudha më e hershme e krijimit të bërthamave të para të komunitetit shqiptar të islamizuar. Kjo veprimtari në fillimet e saj është zhvilluar *në xhami*, ose *pranë xhamisë*. Pikërisht për këtë arsye edhe historia e veprimtarisë së arsimimit islam ndërlidhet me historinë e ngritjes së xhamive të para në këto troje, që ka filluar në vitet e para të vendosjes së pushtetit osman.

Historikisht xhamia ka luajtur rol shumë më të gjerë dhe më kompleks se sa roli i saj si faltore apo si vend ku kryhej rituali i faljes (namazit). Ajo ka qenë institucioni themelor islam, me të cilën kanë qenë të lidhura ngushtë

jeta fetare, arsimore-edukative, kulturore, politike dhe shoqërore e myslimanëve qysh në fillimet e saj.

Më vonë, afër xhamive u ndërtuan godina për arsimin fillor, të quajtura *mejtepe*, numri i të cilave u rrit aq shumë, saqë në çdo fshat kishte të tilla, madje në shumë raste kishte edhe më tepër se një².

Pas mejtepeve, si institucione klasike të arsimit osman, *medresetë*, që prej themelimit të perandorisë e deri në fund të saj, kanë ofruar arsimimin dhe përgatitjen e një lloji dhe niveli të caktuar të dijetarëve, i cili përputhej me nevojat e shtetit dhe të shoqërisë në çështjet fetare, juridike dhe shkencore. Meqenëse ato financoheshin nga vakëfet, medresetë nuk lidheshin financiarisht me shtetin. Por pavarësisht kësaj, zyrtarët që u diplomuan nëpër medrese (kadilerët, myftilerët, myderrizët, imamët, etj.), kishin ndikim mbi popullatën si përfaqësues, nga njëra anë të rregullave zyrtare të shtetit, dhe nga ana tjetër të ideologjisë së tij. Për këtë arsye shteti i kushtoi rëndësi të madhe medreseve, të cilat kishin strukturën e tyre hierarkike³. Shteti gjithashtu nuk hezitonte të ndërhynte në punët e brendshme të këtyre institucioneve. Megjithatë,

2. Ziya Kazıcı, *Islam medeniyeti ve müesseseleri tarihi*, M. Ü. İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları, Nu: 191, İstanbul, 2011, f. 325-326.

3. Ziya Kazıcı, *Islam medeniyeti...*, po aty, f. 441.

qëllimi themelor i medreseve, ose arsimimit të medreseve, ishte të nxirrte “besimtarë të përgatitur” dhe myslimanë të cilët do të mund të mbronin fenë islame kundër sfidave intelektuale nga jashtë bashkësisë⁴.

Medresetë e para

Në bazë të vakëfnameve dhe burimeve të tjera të publikuara deri sot, mund të konstatohet se medresetë e para në trojet shqiptare janë ngritur në fillim të shek. XV. Medreseja më e vjetër e ngritur në këto troje është *medreseja e Is'hak Bent në Shkup* e hapur para vitit 1411⁵. Kurse Medreseja më e vjetër në Kosovë është ajo e themeluar në Vushtrri brenda viteve -1444-1455 nga Gazi Aliu beu, pastaj para vitit 1516 në Pejë nga Mehmet Beu, pastaj e Gazi Mehmet Pashës në Prizren e vitit 1537, Medreseja e Besharet Begut në Prishtinë, e ngritur nga Besharet Begu qysh para vitit 1566, etj.⁶ Pas këtyre u hapën edhe në qytete të tjera, saqë në shek. XVIII, sipas të dhënave që na ofron

4. Po aty, f. 442.

5. Hasan Kaleši, *Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku*, Prishtinë, 1972, f. 90; Dr. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, IA, Prishtinë, 2017, f. 231.

6. Dr. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare...*, po aty, f. 232; I njëjti, *Kontribute albanologjike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, f. 222 e tutje.

udhëpërshkruesi i njohur Evlija Çelebiu, në trojet shqiptare numri i tyre ishte shtuar, aq sa kishte qytete me më shumë se një medrese⁷. Në shek. XIX dhe në fillimi të shek. XX në Kosovë ekzistonin 16 medrese: katër në Prizren, dy në Prishtinë, dy në Gjakovë, dy në Pejë, dy në Vushtrri, një në Mitrovicë, një në Gjilan, një në Opojë dhe një në Dobërçan, në të cilat ndiqnin mësimet një numër i madh i nxënësve nga treva të ndryshme, madje edhe jashtë Kosovës. Të gjitha medresetë nuk kanë qenë të të njëjtit nivel⁸. Disa prej tyre për shkak të lëndëve që mësoheshin aty dhe autoritetit që gëzonin myderrizët e tyre, krahasoheshin me medresetë e larta të rangut të fakultetit “Fatih” të Stambollit, si medreseja “Mehmet Pasha” në Prizren, “Medreseja e Madhe” në Gjakovë (e ndërtuar në vitin 1707), etj.

7. Më gjerësisht, shih: Evlija Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë*, përkthyer nga Sali Vuçiterni, “Horizont”, Tiranë, 2000; Evlija Çelebiu, *Në Shqipëri dhe në viset fqinje: Kosovë, Mali i Zi, Ohër, përgatitur nga Robert Elsie*, përkthyer nga Abdurrahim Myftiu, SHB. “55”, Tiranë, 2008.

8. Medresetë në Perandorinë Osmane rradhiteshin sipas niveleve akademike të cilat përcaktoheshin sipas pagës ditore të myderrizit, si 20 akçe, 30, 35, 40, 45 dhe 50 akçe. Medresetë e Kosovës i kanë takuar rangut të medreseve 20 akçe. Shih: Cahid Baltaci, *Osmanli Medreseleri (XV-XVI Yüzyıllarda)*, vëll. 1-2, M.Ü. İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları, nu. 198, Stamboll, 2005.

Lëndët mësimore

Studentët në medrese regjistroheshin pas përfundimit të shkollës fillore (mejtëpit), ose në periudha të më vonshme, edhe shkollën e mesme të ulët (mektebi rushdije). Kohëzgjatja e mësimit në medrese ka qenë 12-16 vjet. Pas kryerjes së medresesë, studentëve - të cilët quheshin *softe* ose *talebe*⁹ - u lëshohej ixhazetnameja/diploma për kryerjen e studimeve dhe studentit i jepej licenca që të mësonte edhe të tjerët. Kishte disa lloje të ixhazetnameve, duke filluar nga ato të përgjithshme (‘amme), e deri tek ato të veçanta për një fushë apo fusha të caktuara (hassa), siç është hifzi, kiraeti, hadithi, tefsiri, akaidi, e drejta islame, kaligrafia, tesavufi, medicina, matematika, zanatet e veçanta, etj.¹⁰

Në këto medrese, jepnin mësim myderrizët, të cilët kanë qenë njerëz shumë të arsimuar, shumica e të cilëve të shkolluar në qendrat e ndryshme të arsimit dhe kulturës islame. Disa kanë qenë specialistë vetëm për një lëndë, ndërsa të tjerët për shumë lëndë.¹¹

9. Fjala “*softa*” është me prejardhje nga persishtja “*subte*”, që d.m.th. “*i djegur, i dashburnar pas dijes*”, kurse fjala “*talebe*” është njëjësi i “*tul-lab*”, që rrjedh nga arabishtja, që d.m.th. “*kërkuës i dijes*”. Ziya Kazıcı, *Islam medeniyeti...*, po aty, f. 383.

10. Haso Popara, *Idžazetname u rukopisima Gazi Husrev-begove biblioteke*, në: “Anali Gazi Husrev-begove biblioteke, knjg. XXV-XXVI, Sarajevë, 2007, f. 5.

11. Hasan Kaleshi, *Prizren kao kulturni*

Në medresetë e Kosovës, janë mësuar të njëjtat lëndë si në medresetë e tjera të këtij niveli në Perandorinë Osmane. Edhe pse nga burimet e kohës nuk mund të jepet në mënyrë të qartë dhe të hollësishme programi mësimor i medreseve, megjithatë, duke parë biografitë e mësuesve dhe të dijetarëve (ulemasë, myderrizëve), diplomat e tyre, vakëfnametë, etj., mund të krijojmë një ide të përgjithshme se çfarë mësohej në medrese.

Në medresetë e kohës mësoheshin këto lëndë me disiplinat e tyre: Komentimi i Kuranit (*tefsir*), shkencë për Traditën (*ilm el-hadith*), doktrina/apologjëtika (*akaid*), e drejta e Sheriatit (*fikh*) dhe burimet e së drejtës së Sheriatit (*usul el-fikh*), e drejta e trashëgimisë sipas Sheriatit (*faraid*), gramatika dhe sintaksa e gjuhës arabe (*sarf, nahu*), etj. Nxënësit për disa vite mësonin gramatikën dhe sintaksën e gjuhës arabe. Mësimi zhvillohej duke lexuar, duke sqaruar tekstet dhe duke mësuar përmendsh rregullat e morfologjisë dhe sintaksës, e përveç gramatikës dhe sintaksës, mësoheshin edhe leksikografia (*ilm el-luga*), retorika (*ilm el-belaga*) dhe metrika (*ilm el-'arud*).¹²

Ndonjëherë kishte ndryshime në renditjen dhe numrin e këtyre studimeve dhe lëndëve. Në

centar za vreme turskog perioda, Gjurmime Albanologjike, I/1, 1962, Prishtinë, f. 94.

12. Hasan Kaleši, *Najstariji vakufski...*, po aty, f. 23.

medresenë “Mehmet Pasha” në Prizren, në bazë të dokumenteve arkivore të kësaj shkolle¹³, dihet se mësoheshin 20 lëndë me disiplinat e tyre: 1. *Kur’ani Kerim*, 2. *Texbnid*, 3. *E drejta e Sheriatit* (‘Ilmi fikh), 4. *Burimet e së drejtës së Sheriatit* (‘Ilmi Usuli fikh), 5. *Dogmatikë/apologjëtikë* (‘Ilmi Kelam), 6. *Shkencat natyrore-fizikë* (Hikmeti Tabi’ijje), 7. *Teologji* (Hikmeti ilahije), 8. *Logjikë* (‘Ilmi mantik), 9. *Komentim i Kur’anit* (‘Ilmi tefsir), 10. *Shkenca e Traditës* (‘Ilmi hadith), 11. *E drejta trashëgimore* (‘Ilmi feraid), 12. *Matematikë* (Hisab), 13. *Histori e peygamberëve* (Tarih-i enbija), 15. *Metafora* (‘Ilmi bejan), 16. *Retorikë* (‘Ilmi bedi’), 17. *Kaligrafia* (Husn-i hatt), 18. *Bukursbkerim* (Imla), 19. *Gramatikë* (‘Ilmi sarf), 20. *Sintaksë* (‘Ilmi nahv)

Gjuha arabe, sipas praktikës së shumëgjuhësisë në Perandorinë Osmane, ka qenë gjuhë e shkencës, persishtja gjuhë e poezisë, kurse turqishtja gjuhë e administratës dhe e dijeve laike. Kjo traditë në Perandorinë Osmane, si bartëse e kulturës dhe qytetërimit islam, ka zgjatur gjithnjë deri në shek. XIX, dhe, si rrjedhojë, shkencë islame bazohej në njohjen e gjuhës arabe, jo vetëm për të njohur dhe

13. Arkivi i Kosovës, *Fondi i dokumenteve osmane*, i pa rregulluar, dokumenti/shehadetnameje e Fahri ef. Iljazit nga Gjakova. Shih edhe shehadetnamenë e Mehmet Salihut nga Bresana e Opojës, një kopje e së cilës gjendet në duart tona.

studiuar Kur'anin e Hadithin, por për të njohur edhe shkencat e tjera, si metrikën, retorikën, stilistikën, gramatikën, poetikën dhe disa disiplina të tjera, të cilat studioheshin dhe komentoheshin në gjuhën arabe në tërë Botën Islame¹⁴.

Tekstet shkollore

Në bazë të ixhazetnameve që kemi marrë në shqyrtim dhe burimeve të tjera¹⁵, si tekste në medresetë tona, me ndonjë ndryshim, janë përdorur:

- “*Texhvid*”- ka të bëjë me studimin e artikulimit dhe të vetive të shkronjave arabe, në mënyrë që të mësohet të kënduarit e drejtë dhe të bukur të Kur’anit. Tek ne, më së

14. Fehim Nametak, *Književnost bosnaskobercegovačkih Muslimana na turskom jeziku do XVII stoljeća*, Godišnjak institut za jezik i književnost, Sarajevë, 1982, f. XI/119, Cituar sipas: Jusuf Ramić, *Izučavanje arapskog jezika kod nas*, në: “Zbornik Radova”, nr. 2, Sarajevë, 1987, f. 237.

15. Cahid Baltaci, *Osmanli Medreseleri...*, vëll. 1, po aty, f. 87-90; Murat Akgündüz, *Osmanli medreseleri –IXI Asir*, 2 baski, Beyan, Stamboll, 2012, f. 156; Omer Nakičević, *Arapsko-islamske znanosti i glavne škole od XV do XVII vijeka (Sarajevo, Mostar, Prusac)*, Starješinstva IZ, Sarajevo, 1999, f. 87-107; Kasim Dobrača, *Katalog arapski, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevo, 1963 dhe svezak drugi, Srajevo 1979; Zejnil Fajić, *Katalog arapskih, turskih, perzijskih i bosanskih rukopisa*, vëll. III, London/Sarajevo, 2000; Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2008. etj.

shumti, është përdorur “*Karabash Texhvidi*”, të cilin e ka shkruar ‘*Abdurrahman Karabashi*’ por edhe texhvide të tjerë.

- “*Munijja*” (“*Munjetu ‘l-Musal-li*”) e Saduddin Muhammed bin el-Kashgarit.

- “*Halebija*” (“*Sherhu ‘l-Munijja*”) – koment i veprës së më sipërme, nga autori Ibrahim bin Muhammed bin Ibrahim el-Halebi. Autori ka dy komentime: Ai i shkurti me titullin “*Gunjetu ‘l-Mutemli fi sberbi Munjetu ‘l-Musal-li*”, që njihet me emrin e popullarizuar “*Halebi sagir*” (Halebi i vogël), për t’u dalluar nga komentimi tjetër i gjerë me emrin e popullarizuar “*Halebi kebir*” (Halebi i madh), që të dy këto vepra shumë të njohura ndër ulematë tanë.

- “*Durrijekta*”, e autorit Imam zade Ahmed Es’ad el-Konavi.

- “*Kuduri*” (“*Mubtesaru ‘l-Kuduri*”)- I shkruar nga njëri prej përfaqësuesve më të njohur të shkollës juridike hanefi, Ebu ‘l-Husein Ahmed b. Muhammed el-Kuduri el-Bagdadi “*Mubtesaru ‘l-Kuduri*”.

- “*Multeka ‘l-ebhur*” - Është një nga shkrimet themelore të fikhut hanefi, e shkruar në mënyrë të thukët dhe koncize, me stil të lehtë, andaj dhe ka qenë shumë i popullarizuar dhe është përdorur gjatë si doracak dhe si libër mësimi i fikhut nëpër medrese. Veprën e ka shkruar Ibrahim b. Muhammed el-Halebi.

- "*Mevkufati*" – Komentim dhe përkthim në gjuhën turke i veprës së më sipërme "*Multeka*". E ka shkruar Muhammed efendi Mevkufati. Përveç titullit të lartshënuar, ky komentim, në burime të ndryshme, njihet edhe me emra të tjerë, me pak ndryshime, si "*Terxbeme-i Multeka 'l-ebbur*", "*Sherb Multeka 'l-ebbur*", "*Sherb-i Kitab Multeka el-ebbur*", "*Terxbeme-i Multeka 'l-ebbur me'a sherbi bit-turkijjeti li 'l-Mevkufati*".

- "*Bergivi Sherbi*" ("*Kadi zade*") - Është koment i veprës së Birgeviut "*Risale-i Birgevi*" dhe ka të bëjë me elementet e besimit islam. E ka shkruar Ahmed Mehmed Emin Islamboli Kadi Zade.

- "*T'alimu 'l-Mute'al-lim*", - vepër mbi sjelljen fetare-morale dhe me edukatën e nxënësit. E ka shkruar Burhanuddin ez-Zarnuxhi.

- "*Pendi 'Attar*" - Emri i plotë dhe i drejtë i saj është "*Pend-name*", e poetit mistik pers Feriduddin 'Attari.

- "*Gülistan*" - vepër që përmban rrëfenja moralizuese në vargje në gjuhën perse. Autor është i mirënjohuri Ebu 'Abdullah Muslihuddin Sa'adi esh-Shirazi.

- "*Emsile*"- përmban shembuj për foljet në gjuhën arabe (me përkthim në gjuhën turke) nga një autor anonim.

- "*Bina*" - shpjegon foljet në gjuhën arabe. Si autori i mundur i kësaj vepre merret Abdullah ed-Dinkuz.

- "*Maksud*" ("*el-Maksud fi*

't-tasrif") - Vepër nga morfologjia e gjuhës arabe. Rreth autorit të saj ka disa mendime. Rëndom përmendet Imami 'Azam Ebu Hanife Nu'man Thabit el-Kufi.

- "*Izz'i*" - "*Tasrifu 'l-Izz'i*" - trajton të njëjtën temë sikurse "*Maksud*" në gjuhën arabe. Autor i saj është Abduluehhab Izuddin ez-Zenxhani.

- "*Merabu 'l-eruab*" - gramatikë e morfologji arabe, e autorit Ahmed b. 'Ali b. Mes'ud.

- "*MerabSherbi*" - Ështëkomentim i veprës së sipërpërmendur. Ka disa komentime me këtë emër.

- "*Auamil*" - Vepër e shkurtër mbi sintaksën e gjuhës arabe, njihet edhe me emrat "*el-'Auamilu 'l-mije 'l-xhedide*" dhe "*el-'Auamilu fi n-nabui*". E ka shkruar Muhammed b. Pir 'Ali el-Birgevi.

- "*Iz'har*" - është vepër e shkurtër mbi sintaksën arabe, e përdorur shumë në medresetë e kohës. Autor i veprës është Pir Ali efendi el-Birgevi.

- "*Kafija*" ("*el-Kafije fi 'n-nabu*") Është vepër nga gramatika arabe e shkruar nga Xhemaleddin Ebu 'Amr Osman b. Ebi Beker b. el-Haxhibi.

- "*Mulla Xhami*" - është gramatikë e gjerë e gjuhës arabe dhe zhvillohet në gjuhën arabe. Njihet sipas emrit të autorit Mevlana 'Abdurrahman b. Ahmed el-Xhami. Titulli i saktë i kësaj vepre është "*el-Fenaid ed-Dijaije*".

- "*Isaguxhi*" ("*Isagoxhi*") - Vepër nga logjika, në gjuhën arabe e autorit

Etheruddin Mufeddal b. Omer el-Ebheri.

- *“Fenari”* - Edhe ky është një koment i veprës *“Isaguxhi”* të Etheruddin el-Ebheriut, të cilin e ka bërë Shemsuddin Muhammed b. Hamza el-Fenari. Njihet me emrat *“el-Fenaidu l-Fenarije”* ose *“Sherb el-Isaguxhi lil-Fenari”*.

- *“El-Kamusu l-mubir”* - është fjalor i gjuhës arabe të cilin e ka shkruar Muhammed Mexhduddin Firuz’abadi. Në gjuhën turke e ka përkthyer Sejid Ahmed ‘Asim efendiu. Tek ne më shumë është përdorur përkthimi në gjuhën turke se origjinali.

- *“Sherbu l-Akaidi n-Nesefije”* - është doracak për apologjetikën islame. Është komentim i bërë veprës *“Akaid en-Nesefi”* të autorit Nexhmuddin Ebu Hafsa Omer b. Muhammed en-Nesefi. Komentimi është i Saduddin Mes’ud bin Omer Taftazanit.

- *“Sherbu l-Hidajeti l-Hikme”* - Është komentimi i bërë veprës *“Hidajetu l-hikme”* të autorit Etheruddin el-Ebheri. Autor i komentit është Kadi Mir Husein el-Mibidi.

- *“Sherbu l-Aka’idu l-Adudijje li Deuani”* - Vepër në gjuhën arabe nga dogmatika, e autorit ‘Aduddin ‘Abdurrahman b. Ahmed el-Ixhi. Kurse komentimin e ka shkruar Muhammed Xhelaluddin Deuani.

- *“Mutau-nel”* - *“Sherb telbisu l-Miftah”* - është doracak mbi

stilistikën në gjuhën arabe e autorit Saduddin Mes’ud b. Omer Taftazani.

- *“Durru l-Muhtar”* (*“ed-Durru l-Muhtar fi sberbi Tenuiri l-ebzar”*) - është vepër nga jurisprudenca islame dhe e drejta e Sheriatit në gjuhën arabe, e autorit Muhammed Haskefi el-Hanefi. Në të vërtetë është koment i veprës *“Tenuiru l-ebzar”* të Dimeshkiut.

- *“Ued’ijje”* - *“err-Rrisaletu l-Adudijje fi l-ued’i”* - është shpjegim i shkurtër për etimologjinë e fjalës në gjuhën arabe (*uad*), të cilën e ka shkruar ‘Aduddin ‘Abdurrahman b. Ahmed el-Ixhi. Është e njohur me emrin *“Risale fi l-Ued’i”* dhe sipas autorit *“Risale el-Adudijje”*.

- *“Veledijje”* - është libër mbi debatin për fillestarët. Autor i veprës është Muhammed Saçakli Zade. Njihet edhe me emrin *“Risale mine l-Edeb li Saçkali Zade”* dhe me emrin *“Err-Rrisale-i l-veledijje”*.

- *“Sherbi shemsijje”* - Vepër mbi logjikën. Emri i plotë është *“Tabriru l-kaua’idi l-mantikijje fi sberbi err-Rrisaleti sh-shemsijje”* e autorit Kutbuddin Muhammed er-Rrazi et-Tahtani.

- *“Enuaru t-Tenzil ue Esraru t-Te’uil”* - është koment i Kur’anit (tefsir) i autorit Omer bin Muhammed bin ‘Ali Ebul-Hajr Nasiruddin el-Bejdau.

- *“El-Keshshaf”* (*“Hakaiku’t-tenzil”*) - komentim i Kur’anit nga Ebu l-Kasim Mahmud bin Omer ez-Zamahsheri.

- *“Sabihu ‘l-Buhari”* - autor: Muhammed bin Isma‘il bin Ibrahim el-Buhari. Ka përjetuar disa komente, më të njohurit dhe që janë mësuar në medresetë tona janë: *“Umdetu ‘l-Kari fi sherb Sabihu ‘l-Buhari”*, nga Bedruddin bin Muhammed, i njohur me emrin ‘Ajni al-Hanefi dhe komenti *“Fet’bu ‘l-Bari fi Sherb Sabihu ‘l-Buhari* i autorit Ibn Haxher el-Askalani.

- *“Shemali sherif”* - Është përmbledhje e haditheve që bëjnë fjalë për personalitetin dhe jetën e pejgamberit Muhammed a.s. e autorit Hafidh Ebi ‘Isa Muhammed et-Tirmidhi.

- *“Miratu ‘l-Usul fi sherb Mirkatu ‘l-Usul”* - Këtë vepër dhe komentimin e saj nga lëmi i filozofisë së të drejtës së Sheriatit e ka shkruar më 1470-1471, dijetari i njohur, i treti “shehu ‘l-islam” me radhë i Perandorisë Osmane, Mulla Muhammed bin Feramerz bin Ali, i njohur si Mulla Husrev (vd. 885/1480).

- *“Dela’ilu ‘l-hajrat fi sheuariki ‘l-enuar”* - e Ebu Abdullah Muhammed b. Suleyman el-Xhezuli.

- *“Ilmi Feraiz”* - vepër e shkurtër mbi ndarjen e trashëgimisë mes trashëgimtarëve, e autorit Siraxhuddin Muhammed b. Aburrashid es-Sixhavendi.

- *“Muhtesaru ‘l-Me’ani sherif”* - e ka shkruar Saduddin Mesud bin Omer Taftazani”.

- *“Kaside-i Burde”*. Titulli i plotë i kësaj kasideje është *“El-Keuekibu*

‘d-Durrije fi med’bi Hajri ‘l-berrije”, e autorit Sherefuddin Abu ‘Abdullah Muhammad b. Sa’id al-Busiri.

- *“Et-Tarikatu ‘l-Muhammedije ue es-Siretu ‘l-Ahmedije”* e autorit Muhammad Pir ‘Ali el-Bergivi.

- *“Mesabihu ‘s-sunne”* - është nga fusha e hadithit e autorit Husein b. Mes’ud el-Begau esh-Shafi’.

- *“Tenkibu ‘l-usul ue teuzihu’t-tenkih”* - është nga jurisprudenca islame, e autorit Burhan esh-Sheria Mahmud b. Sadri esh-Sheria el-Eu-uel Ahmed b. Ubejdullah el-Mahbub el-Hanefi.

- *“El-Hidaje”* - nga fusha e jurisprudencës islame e autorit Burhanuddin b. Ebi Beker el-Merginani.

- *“Muhtesaru ‘l-Uikaje”* - është vepër për jurisprudencën islame (fikh), e autorit Sadr esh-Sheria eth-Thani.

- *“Sherbu ‘l-Menar”* - komentim i veprës *“Menaru ‘l-Enuar”* e autorit Ebu ‘l-Berekat Hafidhud-din en-Nesefi.

- *“El-Mugni”* - (*“el-Mugni fi usuli ‘l-fikh”*) – vepër e njohur e drejtimit juridik hanefi, të cilin e ka shkruar Xhelaluddin Omer el-Habbaz el-Huxhandi.

- *“Kenzu ‘d-dekaik”* - e Hafidhud-din Ebu el-Berekat Abdullah b. Ahmed b Mahmud en-Nesefi.

- *“El-Kasidetu ‘n-Nunijje”* - poezi mbi besimin, e autorit Mevlana Hidr-bej b. Xhelaluddin.

- *“Esh-shifa bi t’arifi bukuki*

‘*L-Mustafa*’ - përmbledhje e thënieve nga profeti Muhamed a.s. dhe detyrat e myslimanit për të respektuar atë. E ka shkruar Ebu ‘l-Fadl ‘Ijad b. Musa el-Jahsubi es-Sebti.

- ‘*Kasidetu Bedu ‘l-Emal*’- kaside nga apologjetika islame, e autorit Siraxhuddin Ebu Muhammed ‘Ali Osman el-Fergani.

Ekzemplarë të këtyre veprave, gjenden në bibliotekat e institucioneve që, në kuadër të fondeve dhe koleksioneve të tyre, ruajnë edhe vepra e dorëshkrime në gjuhët orientale, por edhe ndër posedues privatë dhe individë me kulturë dhe vetëdije historike mbi vlerat fetare islame dhe tradicionale¹⁶.

Arkitektura

Medresetë në Kosovë ishin të tipit të medreseve të vogla në formë të shkronjës “L”, rëndom në oborrin e xhamisë, ose si komplekse të veçanta. Nga ana arkitektonike, janë ndërtuar sipas shembullit të arkitekturës osmane, por me një lloj transformimi, nën ndikimin e traditës vendase të ndërtimit. Nuk kanë qenë të mbuluara me

16. Ndër bibliotekat e institucioneve që ruajnë këso pasurish janë: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Prishtinës, Biblioteka e Arkivit të Kosovës, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren, Biblioteka e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, etj., pastaj nëpër teqe, xhami dhe trashëgimtarë të ulemasë më të hershme shqiptare.

kupola, nuk kanë pasur pretendime monumentale dhe u përgjigjeshin tërësisht mundësive të donatorëve, andaj arkitektura e tyre njëjtësohet me arkitekturën ndërtuese tradicionale. Si rezultat i kësaj, hasen edhe elemente të arkitekturës së thjeshtë ndërtuese, siç janë çardakët-divanhanet dhe lokalet për pritjen e mysafirëve, të cilat nuk paraqiten si pjesë përbërëse e medreseve të vendeve të tjera¹⁷.

Të gjitha medresetë në Kosovë janë ndërtuar në sajë të vakëfeve dhe të nismave individuale të banorëve vendas, si përshpirtërore të tyre. Për mirëmbajtjen e tyre janë lënë objekte ekonomike, si dyqane, mullinj, ara, male, etj., ose të holla të gatshme, në mënyrë që të siguroheshin të ardhurat e sigurta dhe të rregullta, për personelin mësimor dhe për mirëmbajtjen e medreseve. Nxënësit e kishin të siguruar banimin, diku edhe ushqimin, e diku merrnin edhe bursa.

Roli kombëtar i medreseve

Mbështetur në plan-programet mësimore të këtyre medreseve, si dhe në nivelin mjaft të lartë profesional dhe intelektual të myderrizëve të tyre, gjë që pasqyrohet në veprat e

17. Madžida Bećirbegović, *Prosjetnji objekti islamske arkitekture na Kosovu*, në: “Starine Kosova”, nr. VI-VII, Prishtinë, 1972-1973:81-96.

tyre të mbetura në dorëshkrim, mund të arrihet në përfundimin se këto medrese kanë formuar një shtresë intelektuale fetare e akademike të admirueshme. Në këto medrese janë shkruar, kopjuar, komentuar e krijuar vepra të shumta, nga fusha e disiplinave të ndryshme fetare, shkencore, e letrare, përfshirë edhe letërsinë shqipe alamiado, e cila ka prodhuar efekte shumë pozitive në zhvillimin kulturor të masave popullore shqiptare edhe jashtë objekteve të medresesë.

Në këto institucione arsimore zuri fill dhe u intensifikua përpjekja për futjen e gjuhës shqipe në shërbime të fesë islame në xhami dhe jashtë saj, përkatësisht thellimi i punës në drejtim të shqiptarizimit sa më të plotë të xhamisë dhe institucioneve të tjera islame¹⁸. Në këtë drejtim dallohen Tahir ef. Gjakova, Sheh Mala nga Rahoveci, Selim ef. Drejta nga Vushtrria, Mehmet Sezai nga Prishtina, Ymer Shemsiu e Vejsel Xhelaludin Guta nga Ferizaj, Hysen ef. Statovci nga Prishtina, Mehmet Salihu nga Opoja e shumë të tjerë, të cilët janë autorë të njohur veprash fetare, didaktike dhe atdhetare, disa prej të cilave të shkruara në gjuhën shqipe me alfabet arab, në radhë të parë për nevojën të nxënësve dhe të

studentëve, e pastaj edhe të masës së gjerë të komunitetit mysliman.

Shumë nga myderrizët dhe nxënësit e medreseve kanë marrë pjesë dhe kanë luajtur rol konstruktiv në të gjitha lëvizjet politike shqiptare, si në *Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*, në Lidhjen e Pejës “*Besa Besë*”, kryengritjet e ndryshme, etj. Veprimtarët politikë më të dalluar nga radhët e myderrizëve janë haxhi Ymer Prizreni, Halim ef. Gjergjizi, Haxhi Zeka, Ali ef. Mici, Hasan ef. Shllaku, Ismail ef. Yveysi, Hafiz Ymer Guta, Haxhi Rrystem Shporta, e shumë e shumë të tjerë, të cilët aktivitetin tyre politik e paguan me internime e burgosje. Më vonë u dalluan sheh Mehmet Sezai, hfz. Abdullah Hizri, Asim ef. Luzha, Mulla Idriz Gjilani, Haki ef. Sermaxhaj dhe një plejadë e tërë e myderrizëve.

Si përfundim

Me një fjalë, medresetë në Kosovë ishin një pjesë e pandarë e jetës publike, të cilat qëndronin mbi baza intelektuale dhe që rrënjët i kishin te feja. Nga ana strukturore ato ishin pjesë e sistemit të vakëfeve, ndërsa nga ana financiare ishin të pavarura dhe i zhvillonin aktivitetet nën mbikëqyrjen e shtetit. Ato vazhduan të funksionojnë kështu për një periudhë disa qindra vjeçare.

18. Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare Shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, IA, Prishtinë, 1989, f. 384.

Politika e PPSH-së kundër besimeve fetare: masat me karakter ligjor dhe fushata propagandistike në vitin 1967

Msc. Xhorxhina Seferi
Departamenti i Shkencave Islame
Universiteti Bedër

Abstrakt

Menjëherë pas çlirimit nga pushtuesi fashist, në Shqipëri u vendos regjimi komunist, i cili bazohej në diktaturën e proletariatit dhe në luftën e klasave. Qeveria e drejtuar nga Enver Hoxha në vitet e para të pasçlirimit u paraqit si qeveri me vizion, e cila kishte hartuar projekte për zhvillimin arsimor, kulturor, ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në fillimet e tij shteti komunist nuk u afirmua në publik si shtet ateist, por si shtet laik. Megjithatë kjo nuk do ta pengonte shtetin që të fillonte luftën për zhdukjen e feve si ideologji kundërshtarë. E zhvilluar në një shoqëri të mbyllur dhe me nivel të ulët kulturor, propaganda komuniste arriti të denigrojë klerikët dhe të cenojë integritetin e shërbesave fetare. Në vitin 1967 u zhvillua haptazi, në mënyrë intensive e të programuar, propaganda kundër besimeve fetare, e cila tregoi nevojën e regjimit për uniformitet politik e social. Në këtë studim rreth politikave të PPSH-së kundër besimeve fetare, jemi ndalur te vendosja e regjimit komunist në Shqipëri, marrëdhënia e tij me komunitetet fetare, masat e para kundër besimeve fetare, metodat e përdorura në luftën kundër fesë, fushata propagandistike dhe mjetet kryesore të propagandës, te qëndrimi i klerit e deri te ndalimi i veprimtarisë fetare në vend.

Fjalë kyçe: *Besime fetare, PPSH, Propagandë, Masa ligjore, Ndalimi i fesë, Ateizëm, Komunizëm, Regjim, Komunitete fetare, Shqipëri.*

I. Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri dhe marrëdhënia e tij me komunitetet fetare

1.1. Etapa fillestare e regjimit komunist

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare mbylli një etapë të rëndësishme historike, gjatë së cilës u arrit të çlirohej vendi nga okupatorët nazifashistë dhe të rivendosej pavarësia e atdheut. Me përfundimin e luftës pritej edhe një zhvillim demokratik i vendit. Mirëpo lufta pati një veçori që do të ndikonte në zhvillimet pas saj. Organizatat nacionaliste, Balli Kombëtar dhe Legaliteti, për shkak të qëndrimit të mbajtur gjatë luftës dhe të largimit jashtë vendit të krerëve të tyre, nuk do të ishin faktorë në zhvillimet pas lufte. Në pushtet kishin ardhur forcat që bënë luftën, të cilat qenë bashkuar në Frontin Nacionalçlirimtar, ku Partia Komuniste kishte një peshë të rëndësishme.¹

Pas çlirimit nga pushtuesi fashist vendi ka përjetuar një gjendje krize tejet të vështirë. Shqipëria ishte, në çdo aspekt, vendi më i prapambetur në Evropë. Industria kishte pësuar dëme të mëdha, infrastruktura thuajse ishte shkatërruar e gjitha, klasa punëtore ishte e paktë në numër dhe shumica e popullsisë

1. Historia e Popullit Shqiptar, vëll. IV, Tiranë: Botimet Toena, 2009, f. 161.

ishte analfabete. Populli kishte nevojë për strehë, veshmbathje, bukë dhe rreziku i sëmundjeve ishte shumë i lartë. Sipas historiografisë shqiptare mund të përmenden dy shkaqe kryesore të kësaj gjendjeje krize: Prapambetja e trashëguar nga e kaluara dhe dëmet e mëdha në ekonomi e në njerëz që shkaktoi lufta. Në nivelin ekonomik dhe social, që paraqiste vendi në atë kohë, por edhe sipas doktrinës së Marksit, nuk parashikohej vendosja e regjimit komunist në një vend me nivel kaq të ulët zhvillimi.

Marksit, i cili është themelues i komunizmit shkencor, deklaronte se idetë e tij do të ishin të suksesshme nëse do të viheshin në jetë në vendet e zhvilluara kapitaliste. Pra, për një vend si Shqipëria nuk mendohej vendosja e rendit komunist, por Partia Komuniste për shkak të disa zhvillimeve politike, që ndodhen gjatë luftës, arriti të vinte e vetme në pushtet. “Duke filluar veprimin e tij me 1941, me një grumbull ndjekësish të tij dhe me një grusht këshilltarësh jugosllavë, Enver Hoxha kishte vënë duart mbi pushtetin më 1944, duke vënë në jetë mësimet e Stalinit.”²

Me 18 mars 1946 Kuvendi Popullor ngarkoi liderin e Partisë Komuniste, Enver Hoxha, që të formonte qeverinë e parë pas lufte. Me 24 mars Kuvendi miratoi programin

2. Franko Benanti, *Lufta ime më e gjatë në Shqipëri 1943-1948*, Tiranë: Naimi, 2012, f. 193.

dhe Kabinetin qeverisës me përbërjen e mëposhtme: Enver Hoxha kryeministër, ministër i Mbrojtjes Kombëtare dhe ministër i Jashtëm; Koçi Xoxe zëvendës kryeministër dhe ministër i Brendshëm; Haxhi Lleshi e Tuk Jakova, ministra pa portofol; Manol Konomi, ministër i Drejtësisë; Nako Spiru, ministër i Ekonomisë dhe kryetar i Komisionit të Planit, Spiro Koleka, ministër i Punëve Botore; Ramadan Çitaku, ministër i Financave; Sejfulla Maleshova, ministër i Arsimit; Medar Shylla, ministër i Shëndetësisë.³

Karakteristikë e regjimit ishte lufta e ashpër e zhvilluar brenda radhëve të udhëheqjes së lartë të PPSH, me eliminimet dhe dënimet maksimale të kundërshtarëve, sipas modeleve dhe metodave staliniste të kohës. Lufta brenda llojit ishte mjaft e ashpër dhe ajo ka sunduar sidomos pas vitit 1947 e në vazhdim, deri në rënien e regjimit komunist në Shqipëri.⁴ Ligjet ekzistonin, por ato nuk zbatoheshin njëlloj për të gjithë qytetarët e Republikës. Për rrjedhojë kalohej në veprime arbitrare nga njerëzit e pushtetit. Dënimet arbitrare filluan të shtrihen ndaj kujtdo që shfaqte pakënaqësi, ose kundërshtonte hapur një vendim partie.⁵

3. Historia e Popullit Shqiptar, vep. e cit., f. 176.

4. Hamit Kaba, *Lufta për pushtet në udhëheqjen e PKSh 44-60*, Studime historike, nr. 1-2, Tiranë: 2009, f. 292.

5. Peço Kagjini, *Konferenca e Tiranës e Prillit 1956*, Tiranë: 1999, f. 18.

1.2. Masat për rimëkëmbjen e vendit

Menjëherë pas lufte, Partia Komuniste e Shqipërisë përcakttoi si detyrë prioritare ndërtimin e një sistemi politik, që do t'i përshtatej natyrës dhe qëllimeve të saj. Në këtë kuadër, rëndësi të veçantë kishte organizimi i shtetit, që do të përdorej si mjet për kryerjen e reformave që duhet të çonin në normalizimin e shpejtë të jetës dhe në zhvillimin ekonomik, por edhe për të shtypur klasat kundërshtarë dhe rezistencën e tyre. Ndërtimi ekonomik dhe shtypja e klasave kundërshtarë përbënin qëllimin kryesor të PKSH dhe përmbajtjen e funksioneve të shtetit që po ndërtohej. Në rrethana të tilla, shteti demokratik, që doli nga lufta, dalëngadalë do të merrte tiparet e një diktature të majtë të tipit Stalinist.⁶

Meqenëse vendi ndodhej në kushte shumë të vështira ekonomiko-shoqërore, shteti fillimisht i dha përparësi problemeve më emergjente siç ishin: Rindërtimi i infrastrukturës së dëmtuar, sigurimi i nevojave të domosdoshme për jetesë dhe ndërmarrja e reformave që do të shpejtonin normalizimin e jetës në vend.

6. Historia e Popullit Shqiptar, vep. e cit., f. 169.

1.2.1. Reforma agrare

Ndër reformat e marra nga qeveria ishte edhe reforma agrare. “Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, me 29 gusht 1945, miratoi dhe shpalli ligjin mbi reformën agrare.”⁷ Në bazë të ligjit shpronësoheshin çifligjet e shtetit, pronat bujqësore të konfiskuara, çifligjet dhe pronat e mëdha private si dhe ato të enteve fetare. Sipas ligjit pronarëve u mohojë çdo e drejtë mbi pronën përveç së drejtës për ta përdorur atë.

Në pamje të parë shpronësimi nuk dukej si një veper antifetare, por si domosdoshmëri për zbatimin e ligjit, i cili nuk i shpronësonte të gjitha tokat në pronësi të komuniteteve fetare, por i linte atyre 20 ha tokë.⁸ Në të vërtetë regjimi komunist e shfrytëzoi këtë reformë për të dobësuar komunitetet fetare. Xhamitë, manastiret, teqetë dhe objektet e tjera të komuniteteve fetare siguronin të ardhura nga tokat që zotëronin dhe këto të ardhura përdorëshin nga komunitetet përkatëse. Me miratimin e ligjit për Reformën Agrare komunitetet fetare pësuan një goditje të rëndë.

Dekretligji nr. 253, i 27 majit 1946, që bën disa ndryshime të Ligjit e Shtojcë-Ligjeve të Reformës Agrare, e ul sipërfaqen e pronave të komuniteteve fetare sipas të

cilit: “Teqevet, manastirevet dhe komuniteteve fetare të Prefekturave, u lihen gjer në 10 ha tokë. Dhe, në rastet kur në sipërfaqet që përfitojnë pronarët nga ky dekretligj përfshihen edhe pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, sipërfaqja e tokës që jepet zbritet në proporcion me vleftën e kulturave”.⁹

Kjo reformë dhe një sërë masash të tjera në fushën fiskale të shtetëzimeve, e kufizuan shumë bazën ekonomike të fesë. Procesi i kooperimit të mjeteve të punës së prodhimit në bujqësi, sidomos tatimfitimi mbi ndërtesat, që filloi në vitin 1955 me efekte prapavepruese, ishin një goditje tjetër që iu dha më vonë pozitës ekonomike të institucioneve e udhëheqjes fetare.¹⁰

1.2.2. Reforma arsimore

Pas çlirimit, shteti tregoi një angazhim të veçantë në fushën e arsimit, kjo për arsye se u përball me shumë probleme, ndër të cilat ishte edhe analfabetizmi. Një arsye tjetër pse shteti u angazhua për përmirësimin e arsimit ishte ajo e edukimit me ideologjinë komuniste të brezit të ri.

Këshilli i Ministrave hartoi platformën mbi reformën arsimore dhe me 17 gusht 1946 Kuvendi

9. Gazeta Zyrtare, nr. 50, Tiranë, 4 qershor 1946, f. 5.

10. Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë: 2011, f. 433.

7. Po aty, f. 185.

8. Po aty.

Popullor miratoi ligjin mbi Reformën Arsimore. Në ligj përcaktohej sistemi arsimor me gjithë strukturën dhe hallkat e tij. Ai përbëhej nga arsimi parashkollor, arsimi i përgjithshëm, ai profesional dhe arsimi për të rritur. Arsimi i përgjithshëm do të ishte 11-vjeçar. Hallkat e tij ishin: Arsimi fillor katërvjeçar, arsimi unik shtatëvjeçar dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm katërvjeçar.¹¹

1.2.3. Lëvizja për “emancipimin” e gruas

Një tjetër lëvizje që u ndërмор nga partia komuniste ishte edhe lëvizja për emancipimin e gruas. Në themel të kësaj lëvizjeje qëndronin motivet politike e ideologjike. Shtysë për krijimin e kësaj lëvizjeje u bënë normat e vjetra të kanunit që vepronin me forcë në disa zona të vendit dhe e mbanin gruan të shtypur e të diskriminuar. Zakonet e vjetra bënë që ajo të ishte inferiore në raport me burrin. Kjo pozitë shfaqej në çdo fushë, por ishte akoma më e dukshme në familje, ku ajo ishte e shtypur dhe trajtohej si skllave. Duke marrë shtysë nga realiteti PPSH-ja organizoi një lëvizje shoqërore në të gjithë vendin. Kjo lëvizje pati qëllim eliminim e normave të kanunit, të praktikave dhe zakoneve të vjetra patriarkale që e diskriminonin gruan dhe që pengonin përfshirjen e saj në

11. Historia e Popullit Shqiptar, vep. e cit., f. 219.

jetën shoqërore, politike e kulturore.

Kjo lëvizje filloi të kishte sukses dhe nëpërmjet saj u arrit sensibilizimi i opinionit shoqëror. Pothuajse të gjitha shtresat e shoqërisë filluan të dënojnë mentalitetet dhe zakonet që kishin sjellë diskriminimin e gruas. Lëvizja u përqendrua në luftën kundër mentaliteteve e zakoneve të vjetra dhe në krijimin e kushteve për emancipimin e saj në fusha të ndryshme të jetës.

Aktivë të partisë nëpër rrethe të ndryshme të vendit e përkrahën këtë lëvizje dhe filluan të shprehen se: “Do të ngremë në vende me përgjegjësi gratë që nga skuadër komandante gjer në kryetarë kooperative”, “Do të prishim fejesat e lidhura në moshë të mitur dhe do të bëjmë luftë të pandërprerë kundër rasteve të tilla”, “Do të ndryshojmë veshjen e grave brenda 6 mujorit të parë të këtij viti dhe do të marrim masa për ndryshimin e marrëdhënieve në familje, sidomos ato ndërmjet burrave dhe grave”.¹²

Një jehonë të veçantë pati protesta e pionierëve të shkollës 8-vjeçare të Progonatit në Kukës, që prishën publikisht fejesat e bëra nga prindërit e tyre në moshë të vogël dhe deklaruan se: “Nuk do të ngrohemi, në qoftë se drutë do ti

12. AQSH, F. 14, v. 1967, D. 417, fl. 14, Letra e telegrame përshëndetje e angazhime drejtuar shokut Enver Hoxha, nga aktivë partie, ku është shqyrtuar problemi për emancipimin e gruas, 3.3.1967.

bijen në krahë nënat tona dhe nuk do të pijmë ujë në qoftë se do ta sjellin ato në krahë”.¹³

Për drejtuesin e PPSH-së filluan të vinin letra nga mbledhje të aktivitetit të grave nga konferenca të bashkimit të grave të Shqipërisë nga rrethe të ndryshme të vendit. Ato fillimisht shprehnin mirënjohje për të, më pas tregonin shqetësimet e tyre dhe premtonin se do të jepnin kontributin e tyre në ndërtimin e shoqërisë socialiste dhe do të luftonin derisa të arrinin rolin e merituar në familje dhe në shoqëri.

Aktivi i grave të rrethit të Dibrës në një letër shprehej: “Ne si gra do të përpiqemi me punë konkrete që të sigurojmë rritjen e personalitetit tonë dhe barazi të plotë në shoqëri dhe në familje. Do të ngremë zërin kundër kujtdo që merr nëpërkëmbë të drejtat tona, do të kërkojmë ndihmën e të gjithë komunistëve dhe të organizatës së partisë të katundit për t’i çue deri në fund porosinë tuaja që të djegim me zjarr e t’u këputim kokën të gjithë atyre që marrin nëpërkëmbë këto të drejta.”¹⁴

Në kuvendet dhe mbledhjet që u zhvilluan, u dënuan praktikat dhe zakonet e vjetra që lejonin

13. Po aty, fl. 3.

14. AQSH, F. 14, v. 1967, D. 422, fl. 2, Letra e telegrame drejtuar KQ të Partisë dhe shokut Enver Hoxha, nga konferenca, plenumet dhe aktivët e organizatës së gruas në rrethe, me anën e të cilave premtojnë se do t’i kryejnë me nder detyrat e kryera nga partia, Dibër, 7.4.1967.

keqtrajtimin e gruas dhe nëpërmjet kësaj lëvizje filloi të ndryshojë pozita e gruas, si në familje ashtu edhe në shoqëri. “Për t’i siguruar grave kushte lehtësonjëse u hapën 15 menca në lagje. 500 gra u ngritën në përgjegjësi që nga kongresi i 5-të i Partisë dhe në vazhdim”.¹⁵ PPSH-ja gjithashtu kërkonte nga organizatat e partisë, ato të masave dhe organet e pushtetit që: “Të mos lejojnë asnjë lëshim në këtë çështje dhe për këtë qëllim të forcojnë punën edukative e politike duke krijuar kudo një atmosferë mbyhtëse ndaj këtyre zakoneve që poshtërojnë gruan.”¹⁶ Ishte kjo lëvizje që bëri të mundur “emancipimin” e gruas dhe që i dha shtysë aktivizimit të saj në jetën shoqërore e kulturore të vendit. Sipas PPSH-së zhvillimi i gruas ndikoi drejtpërdrejt në forcimin e familjes dhe në zhvillimet ekonomike e politike të vendit.

1.3 Marrëdhënia e regjimit të ri komunist me komunitetet fetare

Në Shqipëri, megjithëse shumica e popullsisë ishte myslimane, në të jetonin edhe të krishterë. Fillimisht shteti komunist nuk u afirmua në mënyrë të hapur si shtet ateist, por

15. AQSH, F. 14, v. 1967, D. 6, fl. 10, Raport mbajtur në konferencën e 16 të partisë të Tiranës për dhënie llogari dhe zgjedhjet me rastin e bashkimit të qytetit me rrethin, në të cilin flitet për tema të ndryshme, 8.5.1967.

16. Po aty.

si shtet laik. Rrjedhimisht edhe metodat e luftës kundër fesë ishin jo të drejtpërdrejta. Shteti nuk ndërhyri në përcaktimin e pozitës juridike të komuniteteve fetare, por politikave fetare iu dha mundësia të mbështeteshin në legjislacionin zogist. Statuti themeltar i vitit 1946 dhe Kushtetuta e 1950 sanksiononin lirinë e besimit dhe ndarjen e shtetit nga feja.

Për të arritur qëllimin e tij regjimi veprroi me dinakëri, duke mos ndërmarrë masa në mënyrë të hapur kundër besimeve fetare. Shqiptarët e shihnin besimin të ndërthurur ngushtë me vlerat e zakonet familjare dhe shoqërore. Në këto kushte, regjimi komunist vendosi t'i dobësonte në mënyrë graduale institucionet fetare. Ai fillimisht vendosi t'ia nënshtrohte këto institucione shtetit, t'i përdorte për aq kohë sa ato përkrahnin programin e qeverisë dhe në fund t'i zhdukte. Këtij plani të PPSH-së iu deshën 23 vite që të realizohej plotësisht.

Gjatë Luftës Çlirimtare regjimi i ardhshëm komunist i kishte zbatuar dhe ruajtur me kujdes planet e tij. Në Kongresin e Përmetit, të mbajtur në maj 1944 për formimin e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe për hedhjen e bazave të pushtetit socialist, Enver Hoxha nderoi në mënyrë të veçantë “klerin” që ndodhej në radhët e delegatëve,

partizanëve dhe patriotëve.¹⁷ Më vonë edhe kushtetuta i jepte garanci për të drejtat civile dhe për ushtrimin e lirë të fesë.

Pavarësisht asaj që kishte prezantuar deri tani, regjimi i ri komunist filloi t'i dobësonte institucionet fetare gjatë viteve 1944-1946, duke e përjashtuar nga ligji edukimin fetar dhe duke mbyllur shkollat e mbetura private fetare. Gjithashtu u ndaluan botimet fetare dhe të rinjtë nxiteshin për të mos marrë pjesë në veprimtaritë fetare. Në vitet e para të ndërtimit të shtetit, komunistët nuk caktuan ndonjë dokument ligjor autentik në lidhje me pozitën juridike të fesë në shoqëri. Me këtë veprim u la të kuptohej se shteti i qëndronte besnik standardeve të njohura në marrëdhëniet e fesë me shtetet demokratike. Por, kur erdhi koha e përshtatshme ato e zbatuan me përpikëri njëri nga pikat e programit të tyre që ishte lufta kundër fesë.

1.4. Dekretligji për komunitetet fetare i vitit 1949

Ligjin Zogist për komunitetet fetare shteti komunist e konsideroi të mirëqenë dhe me disa ndryshime të vogla e mbajti në fuqi deri në fund të vitit 1949. Pas kësaj kohe, me pretekstin se në Shqipëri ishin krijuar

17. Edwin Jacques, *Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Tiranë: Kartë e Pendë, 1998, f. 491.

realitete të reja politike, ekonomike e sociale, të lindura nga Lufta ANÇ, ai e abrogoi atë dhe hartoi një kuadër të ri më të plotë ligjor për fenë.¹⁸

Me 26.11.1949 doli dekretligji nr. 743 “Mbi komunitetet fetare”, miratuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë.¹⁹ Dekretligji i Komuniteteve fetare i vitit 1949, i përbërë nga 37 nene dhe formuluar në përputhje me kushtetutën, sanksiononte ndërhyrjen e shtetit në çështjet e brendshme të komuniteteve fetare. Ky dekretligj në përputhje me nenin 16 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë, në nenin nr. 1 parashikonte se të gjithë shtetasve u garantohej liria e ndërgjegjes dhe besimit. Në nenin nr. 2 deklarohet se besimet dhe komunitetet fetare ishin të ndara nga shteti, ndërkohë që në nenin nr. 6 thuhet se komunitetet fetare ishin të lira të organizoheshin dhe të ushtronin shërbimet fetare në bazë të dogmave dhe statuteve të tyre, nëse këto nuk binin në kundërshtim me ligjet e shtetit, me rendin publik dhe zakonet e mira. Sipas nenit nr. 9 çdo komunitet fetar duhet të kishte një Kryesi, që do të ishte përgjegjëse përpara shtetit dhe lidhjet ndërmjet qeverisë dhe komuniteteve fetare do të bëheshin përmes kryesisë së Këshillit të Ministrisë.

Përmes këtij dekretligji shteti

18. Sh. Hysi, *Muslimanizmi në Shqipëri në periudhën 1945-1950*, vep. e cit., f. 58.

19. A. Qazimi, vep. e cit., f. 21.

vinte nën kontroll zgjedhjen e drejtuesve të komuniteteve fetare duke i dhënë kështu qeverisë të drejtë absolute të vendoste për drejtuesit e këtyre komuniteteve. Në nenin nr. 13 thuhet se kryetarët e komuniteteve fetare dhe të sekteve fetare pasi të zgjidheshin ose të emëroheshin duhet të aprovoheshin nga Kryesia e Këshillit të Ministrisë. “Gjithashtu shteti me propozim të Kryesisë së Këshillit të Ministrisë mund të pezullonte nga shërbimi ose të pushonte kryetarët e komuniteteve fetare dhe të gjithë funksionarët e tjerë që ishin në shërbim të tyre, nëse nuk respektonin kriteret e përcaktuara në dekretligj.”²⁰ Përveç këtyre, dekretligji përcaktonte për kryetarët e komuniteteve fetare, si dhe për të gjithë funksionarët e tjerë fetarë që fillonin detyrën pa qenë aprovuar zgjedhja e tyre nga shteti, që të dënoheshin me privim të lirisë deri në 3 vjet.²¹

Komuniteteve fetare i kërkohej të edukonin besimtarët me dashurinë ndaj partisë dhe pushtetit. Kjo tregohet qartë në këtë nen: “Komunitetet fetare me aktivitetin e tyre duhet të zhvillojnë tek besimtarët ndjenjën e besnikërisë ndaj pushtetit të popullit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë si dhe përforcojnë bashkimin kombëtar.”²²

20. Dekretligji nr. 743 “Mbi komunitetet fetare”, neni 18.

21. Po aty, neni 34.

22. Po aty, neni 12.

Në nenin nr. 4 theksohej se ishte i ndaluar çdo provokim dhe urrejtje fetare ndërsa, në nenin nr. 3 ndalohej përdorimi i kishës dhe i fesë për qëllime politike edhe formimi i organizatave politike me baza fetare.

Dekretligji izolonte veprimtarinë fetare brenda vendit, sepse sipas tij lidhjet me komunitetet homologe jashtë vendit cenonin sovranitetin e shtetit. Kjo tregohet në nenin nr. 25 ku thuhej se komunitetet fetare mund të kishin lidhje me komunitete fetare, institute, organizata dhe persona zyrtarë, që kishin qendrën ose banimin jashtë shtetit, vetëm me autorizimin e mëparshëm të Këshillit të Ministrisë dhe me anë të ministrisë së Jashtme.

Komunitetet fetare ose degët e tyre (urdhra, shoqata, misione fetare, etj.), që kishin qendrën e tyre jashtë shtetit, nuk mund të hapnin në Republikën Popullore të Shqipërisë degë të tyre (urdhra, misione, institute mirëbërësie, etj.), dhe ato që ekzistonin duhet të mbylleshin brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij Dekretligji.²³

Të gjitha komunitetet fetare duhet të vinin në dijeni Kryesinë e Këshillit të Ministrisë për letrat pastorale, qarkoret me karakter të përgjithshëm dhe çdo botim publik që botohej prej tyre. Këshilli i Ministrave mund të ndalonte shpalljen, shtypjen dhe shpërndarjen e letrave, qarkoreve dhe botimeve

23. Po aty, neni 26.

të mësipërme në qoftë se ishin në kundërshtim me ligjet e shtetit.²⁴ Meqenëse buxhetet e komuniteteve fetare aprovoreshin nga Këshilli i Ministrave, shteti e kontrollonte drejtpërdrejt edhe veprimtarinë e tyre financiare.²⁵ Komunitetet fetare nuk mund të shkëmbenin ndihma materiale dhe dhurata me vendet e huaja, veçse me autorizimin e Këshillit të Ministrave.²⁶

Dekretligji ndalonte komunitetet fetare të hapnin spitale, jetimore dhe institute të tjera analoge. Për më tepër, institucionet e lartpërmendura që mund të ekzistonin deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Dekretligji, shtetëzoheshin bashkë me pasuritë e tyre të luajtshme dhe të paluajtshme pa u shpërblyer dhe kalonin nën administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë, ose të Drejtorisë për Kujdesin Social.²⁷ Pasurive të zhdukura të komuniteteve fetare, ose pasurive që u hiqej njohja i kalonin shtetit.²⁸ Çdo bashkësi fetare duhej të rishikonte statutin e vet, duke e përshtatur atë me nenet e dekretligjit dhe brenda tre muajve duhej ta paraqiste në Këshillin e Ministrave për miratim.

Pas analizimit të këtij dekretligji dalim në përfundimin se ai hapi rrugë për zhvillimin e propagandës

24. Po aty, neni 15.

25. Po aty, neni 16.

26. Po aty, neni 27.

27. Po aty, neni 24.

28. Po aty, neni 29.

antifetare, krijoi terren të përshtatshëm për të rritur varësinë e fesë ndaj shtetit dhe krijoi kushte për instrumentalizimin e institucioneve fetare.

II. Masat me karakter administrativ, kulturor dhe propagandistik të regjimit komunist kundër fesë

2.1. Masat e para të regjimit kundër fesë

Meqenëse fillimisht shteti komunist nuk u prezantua si shtet ateist, por si shtet laik, dhe format e luftës kundër fesë nuk ishin të drejtpërdrejta. Në luftën kundër fesë u përdorën metoda nga më të ndryshmet dhe u morën masa sipas kushteve në të cilat ndodhej vendi. “Në këtë luftë vendin qendror e zunë mjetet politike, e në radhë të parë, akuzat për bashkëpunim me armikun.”²⁹

Për t’i vënë fre ndikimit fetar, kleri jo vetëm që u kufizua nëpër xhami e kisha, por edhe në ato mjedise shteti ndërhynte shpesh. Në përpjekje për të shtypur kritikën që mund të vinin nga klerikët, shteti komunist në fillim vuri censurë mbi shtypin fetar, pastaj e ndaloi fare me pretendimin se “nuk ka letër”. Edhe për të botuar kalendarin e thjeshtë që botonte çdo vit Komuniteti Mysliman, i cili tregonte kohën kur

29. A. Qazimi, vep. e cit., f. 11.

duhet të fillonin e të mbaronin 5 lutjet e ditës, kur fillonte muaji i ramazanit, kur binin festat fetare etj., duhet të merrej leje nga qeveria.³⁰

Me 2 mars 1946, në Drejtorinë e Shtypit dhe Propagandës pranë Ministrisë së Shtypit, Propagandës e Kulturës Popullore, u krijua një komision, i cili ngarkohej për t’u dhënë leje qarkullimi librave të botuar deri në atë kohë në Shqipëri si edhe atyre të importuara nga jashtë.³¹ Pas dy vitesh, me 2 mars 1948, Gjykata e Rrethit të Tiranës, ndaloi qarkullimin e mbi 155 titujve, të cilët, sipas Gjykatës, kishin përmbajtje ideologjike të dëmshme për popullin dhe ishin kundra frymës së re Demokratike. Sipas tyre, qarkullimi i atyre botimeve nuk i sillte dobi popullit, por përkundrazi nxiste urrejtje dhe përçarje.³²

Propaganda që zhvilloi shteti komunist jo vetëm që arriti të denigrojë klerikët, por cenoi edhe zhvillimin e shërbesave fetare. Gjithashtu bëri të mundur edhe nisjen e procesit të ngritjes së Enver Hoxhës në simbol. Ai ishte një udhëheqës që vinte nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe përqendrimi në duart e tij i postit të kryetarit të partisë, të kryeministrit,

30. Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*, vep e cit., f. 435.

31. AQSH, Ministria e Shtypit, Propagandës e Kulturës Popullore, v. 1946, D. 97, fl. 1.

32. Gazeta Zyrtare, nr. 29, Tiranë, 10 prill 1948, fl. 8.

të komandantit të përgjithshëm të ushtrisë, të kryetarit të Frontit Demokratik, të ministrit të jashtëm, bënte që kultit i personit të tij në praktikë të ishte e pakontestueshëm.

Procesi i nënshtrimit të organizmave fetare ndaj shtetit ka një datë të përpiktë, 26 qershorin e vitit 1951, kur Kisha Katolike pranoi statutin e saj të ri, komunitetet e tjera fetare u nënshtruan edhe më shpejt. Kështu, besnikëria e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u siguroa qysh me 25 gusht të vitit 1949, kur Sinodi i Shenjtë shfuqizoi Imzot Kristofor Krisin dhe në vend të tij zgjodhi “Kryepeshkopin e kuq” Paisi Vodica. Kongresi i III i KOASH-it, që miratoi statutin e ri (shkurt 1950), ishte vetëm një akt formal dhe tribunë për trumbetimin e këtij nënshtrimi pa kushte. Dy muaj më vonë u miratuan edhe statutet e Komunitetit Mysliman dhe atij Bektashian.³³ Nënshtrimi i komuniteteve fetare nuk ishte një proces i lehtë për arsye se u shoqërua nga një përndjekje e anëtarëve të lartë të klerit.

2.2. Lufta kundër fesë, paragjyqimeve e zakoneve fetare

Meqenëse në shumë rrethe të vendit ishte intensifikuar lufta kundër fesë, paragjyqimeve e zakoneve fetare, sekretari i parë i PPSH-së, Enver Hoxha, e pa të nevojshme të

33. A. Qazimi, vep. e cit., f. 24.

jepte disa orientime në mënyrë që kjo luftë të bëhej pa gabime dhe të kishte sukses. Fillimisht ai theksonte se feja ishte opiumi i popullit, për këtë arsye duhej punë intensive që kjo të kuptohej nga çdo njeri.

Sigurisht, feja ka të bëjë me botëkuptimet, me ndërgjegjen, vepron me koncepte të cilat me shekuj klerikët jo vetëm i kanë kthyer në dogma filozofike, por për t'i rrënjësuar këto dogma në ndërgjegjen e njerëzve, i kanë shoqëruar ato edhe me disiplina konkrete, me organizime të veçanta e i kanë lidhur me ngjarjet e jetës së njeriut. Feja çdo gjë është munduar ta lidhë me ndodhitë e jetës së njeriut dhe ka bërë që ky (njeriu) çdo mendim, çdo veprim të tij ta lidhë me fenë, me besimin idealist, mistik etj. Luftën tonë kundër fesë ne duhet ta drejtojmë si kundër vetë dogmave fetare, pikëpamjeve filozofike idealiste e mistike të saj, ashtu edhe kundër disiplinave fetare, që kanë hyrë deri në zakonet e përditshme të atyre që besojnë, bile edhe të atyre që nuk besojnë, por që ndonjëherë i zbatojnë pa ditur, pa treguar kujdes, shpesh nga forca e zakonit.³⁴

Kishat dhe xhamitë ishin vendet ku klerikët grumbullonin besimtarët për të mbajtur gjallë besimin. Prishja e kishave, xhamive, teqeve

34. AQSH, F. 14, v. 1967, D. 190, fl. 2, Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rretheve mbi luftën kundër fesë, paragjyqimeve e zakoneve fetare, 27 shkurt 1967.

dhe manastireve ishte e vështirë, sepse shteti në këtë mënyrë dilte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me atë pjesë të popullit që besonte. Edhe pse disa prej tyre ishin prishur me iniciativën e masës pa ngjallur asnjë reaksion, disa të tjera ishin kthyer në depo ose kishin mbetur pa hoxhë ose prift dhe praktikisht nuk funksiononin. Ai bënte gjithashtu thirrje që institucioneve fetare duhej t'u hiqej e gjithë toka, ndonjë rrënjë ulla ose të ardhura të tjera që mund të kishin akoma. Mungesa e rezistencës, sidomos në fshat, ndaj këtyre veprimeve shihej si rezultat i punës ateiste që bënte partia, por edhe i mungesës së hoxhallarëve, priftërinjve dhe librave fetarë.

Lufta kundër fesë, duhet bërë me këmbëngulje, sidomos kundër zakoneve, traditave, mënyrës së jetesës, interpretimit të fenomeneve, sepse nëpërmjet kësaj rruge klerikët kishin mundur, për shekuj me radhë, të futin helmin e fesë dhe këtë helm ta përzierin me ngjarjet e përditshme të jetës së njeriut. Në jetën e njeriut, që nga lindja e tij deri në vdekje, kanë depërtuar ritet fetare, pagëzimi, vënia e kurores, synetllëku etj., si krimbi brenda mollës së kuqe. Duke i analizuar e duke i njohur mirë këto, lufta kundër fesë do të bëhet e studiuar e sistematike, ideologjike, politike e organizative, pa pushim e pa pushim. Për të luftuar konceptet fetare ne duhet të përgatitim leksione teorike të bazuara në marksizëm-

leninizmin, të thjeshta, reale, t'ua përshtatim vendit, njerëzve, zakoneve dhe nivelit tonë intelektual. Të mos kopjojmë gjëra që nuk i përshtaten realitetit tonë. Të mos hyjmë në gjëra dhe në mendime që nuk janë të nevojshme për gjendjen tonë.³⁵

Gjatë historisë së popullit shqiptar ka pasur klerikë patriotë, që edhe pa e mohuar besimin e tyre, kanë qenë të lidhur me popullin dhe me idenë e çlirimit kombëtar, por në asnjë kohë feja si fe nuk ka qenë një faktor përparimtar, bile nuk ka dhënë as ndihmën më të vogël në çlirimin kombëtar. Pra, sipas drejtuesit të PPSH-së ky ishte një argument tjetër me baza historike që lufta kundër fesë duhej zhvilluar në mënyrë intensive.

2.3. Fushata propagandistike

KQ i PPSH-së, si rrugë për zhdukjen e praktikave fetare, shihte luftën që duhej zhvilluar me frymën patriotike dhe revolucionare. Për shembull, çështjet e praktikave fetare myslimane, sipas PPSH-së, gjatë 14 shekujve ruanin karakterin e unitetit arab, të dominimit arab me anën e fesë. "Disiplina e fesë myslimane kërkon që çdo mysliman, i çdo kombësie që të jetë, duhet të falet në gjuhën arabe, Kur'anin ta mësojë dhe ta këndojë vetëm në arabisht. Myslimanët falen kudo

35. Po aty, fl. 6.

njëlloj, numri i të falurave çdo ditë është njëloj, marrja avdes është njëloj. Gjithashtu njëloj janë deri në përcaktimin e datave të tyre agjërimit, festat e bajrameve, matemi etj.”³⁶ Sipas regjimit këto praktika duheshin thyer në mënyrë që t’i tregohej të gjithë atyre që besonin sa absurde ishte të ruaje dhe të zbatoje zakone të tilla, që nuk kishin asnjë lidhje me jetën. Partia kishte si qëllim të shpjegonte origjinën dhe qëllimin e tyre, të vërtetonte se si nën petkun e perëndisë, fshihej ligji i otomanëve, i pushtuesve turq dhe i shërbëtorëve të tyre.

Sipas Enver Hoxhës, asgjë nuk i lidhte shqiptarët me fenë dhe praktikatat e saj, për arsye se ligjet e fesë i shihte si ligje të të huajve dhe pushtuesve, por që ishin të veshura me petkun e fesë e të sheriatit. Bindja ndaj këtyre ligjeve e zakoneve, nënkuptonte të ishte i lidhur shpirtërisht me të huajt dhe nuk ishte e mundur që të mendoje dhe të vepronte drejt politikisht, kurse nga ana tjetër të mendoje shtrembër ideologjikisht.

Sipas propagandës ateiste të regjimit komunist, feja ishte frenuese për zhvillimin e vendit dhe duhej zhdukur përfundimisht, sepse deformonte realitetin dhe e fuste njeriun në errësirë. Klerikët, me përjashtim të katolikëve, cilësoheshin si injorantë, sepse nuk ishin të pasur me libra fetare dhe fetë që predikonin

36. Po aty, fl. 4.

i mbështesnin më shumë në ruajtjen e disiplinave fetare. Shteti jo vetëm që e kishte ndaluar mundësinë për botimin e librave, por kishte mbyllur edhe të gjitha shkollat fetare duke zhdukur mundësinë e përgatitjes së kuadrit të ri klerik. Myslimanët kishin vetëm disa sure të Kur’anit që i transmetonin gojarisht, Ortodoksët kishin avantazhin që ungjillin e kishin në shqip, ndërsa katolikët, sidomos klerikët e tyre, ishin më të pasur me libra dhe atje ku gjenin mundësi vazhdonin ta zhvillonin fenë katolike si filozofi.

Sipas regjimit komunist, besimet e kota fetare nuk gjendeshin vetëm te klerikët, të cilët i propagandonin dhe i ruanin të gjalla, por besimet fetare ekzistonin edhe në popull. “Prandaj, pa e ngadalësuar për asnjë çast propagandën kundër fesë, të kemi kurdoherë parasysh se kemi të bëjmë me popullin. Veprimet e pamatura, të ekzaltuara duhet të evitohen, çdo veprimi i duhet përgatitur me kujdes terreni politik.”³⁷

Feja në propagandën ateiste të regjimit komunist shihej si reaksionare, shtypëse, idealiste, qoftë në zhvillimin e dogmave e në përmbajtjen e tyre, qoftë në liturgjinë e ngarkuar, qoftë në praktikatat dhe në disiplinatat fetare. Një armë historike kundër fesë dhe klerikëve ishte edhe fakti se feja myslimane shihej si ideologji e pushtuesve turq, feja ortodokse si ideologji e shovinistëve grekë dhe

37. Po aty, fleta 8.

feja katolike, me qendër Vatikanin, si ideologji e pushtuesve italianë.

Drejtuesit e regjimit komunist e dinin mjaft mirë se të zaptoje xhamitë dhe kishat me një urdhër ishte punë e lehtë, por më e vështirë ishte përgatitja e besimtarëve shpirtërisht dhe ideologjikisht për të kuptuar kotësinë e ekzistencës së këtyre institucioneve, zhdukja e fesë nga zakonet e jetës dhe heqja dorë me bindje nga praktikat e saj. Nëse veprohej në këtë formë, për ta nuk do të kishte rëndësi xhamia apo kisha, prifti apo hoxha. Shumë kisha dhe xhami po braktiseshin dhe po rrënoheshin dhe meremetimi i tyre ishte i panevojshëm, sepse sipas qeverisë kishte ndërtime më të dobishme për të bërë.

Partia ishte e vendosur për të mos lejuar përdorimin e masave administrative për zhdukjen e institucioneve fetare, të zakoneve dhe të besimeve. Për zgjidhjen e këtyre problemeve ato shihnin vetëm një rrugë: Punë politike, ideologjike dhe bindje. Vazhdimisht përsërisnin se zakonet prapanike dhe besimet fetare nuk zhdukeshin menjëherë, por me një punë të gjerë e të vazhdueshme, duke përdorur forma të përshtatshme për çdo familje dhe individ veç e veç. Enver Hoxha shprehej: “Mos lejoni, shokë, që njerëz të ekzaltuar të prekin ndjenjat e popullit. Në asnjë mënyrë nuk duhet të acarohemi me popullin për majën e një minareje, e cila

në rast se nuk rrëzohet sot, do të rrëzohet mot, kur populli të bindet për kotësinë e besimeve fetare.”³⁸

2.4. Mjetet kryesore të propagandës

Qëndrimi ndaj fesë për komunistët ishte çështje parimore. Çdo komunist duhej të ishte ateist, sepse botëkuptimi fetar ishte i papajtueshëm me botëkuptimin marksist-leninist, i cili përbënte edhe bazën ideologjike të PPSH-së. Regjimi komunist ka përdorur disa mjete për realizimin e propagandës antifetare ndër të cilat mund të përmenden: Shtypi, radioja, institucionet kulturore, shkolla, etj. Këto mjete ndihmuan në zhvillimin e propagandës dhe ushqyen lëvizjen e masave.

2.4.1. Shtypi

Në mënyrë që të çrrënjoseshin me sukses besimet fetare, PPSH-ja urdhëronte që shtypit t'i kushtohej një vëmendje dhe kujdes akoma më i veçantë. “Shtypi qëndror e lokal duhet të vazhdonte të trajtonte luftën kundër fesë pasi ai ishte nga mjetet kryesore për zhvillimin e propagandës. Në mënyrë të veçantë duhet t'i kushtonte më shumë vëmendje përgjithësimit të

38. Enver Hoxha, Vepra 35, Në luftën kundër besimeve fetare ka vetëm një rrugë, 7 prill 1967, f. 226.

eksperiencave pozitive, të përkrahte iniciativat e reja të masave dhe të propagandonte afirmimin e normave dhe zakoneve të reja. Çështjet e ndryshme që shtypi ngrinte për luftën kundër fesë duhet të bëheshin objekt bisede për masat. Kjo metodë pune konsiderohej një mjet i rëndësishëm për përhapjen e ideve materialiste dhe luftimin e ideve idealiste mistike.”³⁹

Megjithëse literatura antifetare ishte në qarkullim, PPSH-ja kërkonte që të zgjeroheshin tematikat dhe t'irrazhet e librave dhe botimeve të ndryshme me karakter shkencor popullor, të librave artistike me tema antifetare dhe botimeve ku shpjegohej shkrirja e fesë me zakonet e jetës së përditshme.⁴⁰ Tematikat më të rëndësishme në faqet e shtypit komunist me përmbajtje të propagandës ateiste rezultojnë: Feja si opium për popullin, feja si ideologji antishkencore, reaksionare, antipatriotike, edukimi ateist dhe letërsia ateiste, arti dhe letërsia ateiste në luftën kundër fesë, etj.⁴¹ Rol të rëndësishëm në zhvillimin e propagandës luante edhe radio. Nga radio Tirana kërkoheshin përmirësimi i përmbajtjes ideo-politike dhe ateiste-shkencore i emisioneve që kishin të bënin me kulturën e jetës.⁴²

39. AQSH, F. 14, v. 1967, D. 190, fl. 34, Raport informativ mbi rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa të mëtejshme për thellimin e saj, 7.7.1967.

40. Po aty.

41. Sokol, Paja, *Roli i mediave në propagandën ateiste në periudhën totalitare*, Tiranë: 2018, f. 72.

42. AQSH, Po aty.

2.4.2. Shkolla

Një rol të madh në formimin e botëkuptimit shkencor materialist ka luajtur edhe shkolla. Sipas PPSH-së, pavarësisht rezultateve pozitive të arritura, kishte akoma shumë për t'u bërë në këtë drejtim. “Studentët që përfundonin shkollën kishin akoma boshllëqe edhe ata që përfundonin fakultetet pedagogjike e kishin të vështirë të bënim me nxënësit dhe masën propagandë të argumentuar e bindëse antifetare. Për këtë arsye nga Ministria e Arsimit Kulturës kërkoheshin udhëzime për përmirësimin e gjendjes. Edhe nga komitetet e partisë kërkoheshin që me arsimtarët e disa lëndëve të bëhej një punë më e mirë nëpërmjet seminareve dhe formave të tjera në mënyrë që të ishin më të përgatitur për të bërë propagandë bindëse antifetare.”⁴³

2.4.3. Institutet e kulturës

Nga institutet e folklorit, historisë, gjuhësisë, etj., kërkoheshin të bënin studime me karakter shkencor dhe të shpjegonin rolin reaksionar të fesë në të gjitha fushat.

Nga teatrot, estradat, grupet amatore e profesioniste të shtëpive të kulturës në rrethe, kërkoheshin që, herë pas here, t'i jepnin më shumë vend demaskimit të riteve e zakoneve fetare dhe në mënyrë të

43. Po aty.

veçantë propagandimit e afirmimit të normave e zakoneve të reja socialiste.

Kinostudioja “Shqipëria e Re”, duke trajtuar problemet e lidhura me luftimin e zakoneve prapanike dhe fetare, në të njëjtën kohë, duhej të propagandonte dhe të përhapte zakonet dhe normat e reja socialiste.

Ministria e Arsim Kulturës dhe institucionet që vareshin prej saj duhet të shihnin mundësitë për ngritjen e ekspozitave me fotografi e materiale që demaskonin fenë.

Gjithashtu inteligjencës i kërkohej përfshirja në mënyrë aktive për të bërë studime mbi problemet e ndryshme të fesë nëpër rrethe, pleksjen e saj me traditat e zakonet e popullit dhe grumbullimin e fakteve konkrete që të përdroreshin për demaskimin e fesë. Me ta herë pas here duhet të organizoheshin ekipe e brigada kulturele për të shkuar në fshatra dhe t’i diskutonin këto probleme.⁴⁴

2.5. Metodat e përdorura në luftën kundër fesë

Lufta kundër fesë ishte luftë që u zhvillua në gjirin e popullit dhe të partisë dhe kërkonte që t’i kushtohej kujdes i veçantë metodave që do të përdroreshin në zhdukjen e fesë.

44. AQSH, F. 14, v. 1967, D. 190, fl. 35, Raport Informativ mbi rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa të mëtejshme për thellimin e saj, 7.7.1967.

Në letrën e drejtuesit të PPSH-së porositej që puna me njerëzit e çdo besimi “...të jetë një përpjekje bindjeje e vazhdueshme dhe me durim të madh, të cilën mos e lejojmë të kthehet në ofenduese. Me këta njerëz partia duhet të sillet, si të thuash, si doktori i mirë që bën të gjitha përpjekjet për të shëruar të sëmurin...”,⁴⁵ “Besimet e kota fetare nuk do t’i gjejmë vetëm tek klerikët. Këta janë ata njerëz profesionistë që i propagandojnë, që i ruajnë të gjalla, që bëjnë spekulime dhe mashtrime të poshtra, por ato egzistojnë edhe në popull. Prandaj, pa e ngadalësuar për asnjë çast propagandën kundër fesë, të kemi kurdoherë parasysh se kemi të bëjmë me popullin. Veprimet e pamatura, egzaltuese, duhet të evitohen. Çdo veprimi i duhet përgatitur me kujdes terreni politik.”⁴⁶ Edhe në Kongresin e V-të të PPSH-së të mbajtur në nëntor të vitit 1966, kupola e lartë partiake shqiptare deklaroi edhe një herë këmbënguljen e saj për të vazhduar objektivat e përcaktuara qysh më parë në fushën ekonomike dhe atë shoqërore.⁴⁷

45. AQSH, F. 14, v. 1967, D. 190, fl. 8, Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rretheve mbi luftën kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare, 27 shkurt 1967.

46. AQSH, Po aty, fleta 9.

47. Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: Kristalina - KH, 2007, f. 296-297.

2.5.1. Metoda e bindjes së masave

Organizatat e partisë, që pas ardhjes në pushtet, zhvilluan punë intensive edukative me popullin. Meqenëse mbyllja e institucioneve fetare u bë brenda një kohe të shkurtër e të shpejtë, pati edhe raste ku u veprua më shumë në mënyrë administrative se sa duke përdorur metodat bindëse. Partia theksonte se: “Para se gjithash duhet luftuar kundra kuptimit të ngushtë të problemit, shikimit të cekët të çështjeve, konceptit të gabuar se feja është kisha, xhamija, prifti, hoxha, ikona etj. dhe po u zhduken këto u zhduk edhe feja si botëkuptim.”⁴⁸

Një pjesë e klerit dhe e besimtarëve në dukje u përpoqën të përshtaten me gjendjen e krijuar nga regjimi komunist, por sërish ruanin përmbajtjen e vjetër. Një pjesë e klerikëve predikonin se nuk ishte e domosdoshme të shkoje në kishë e xhami, por njeriu mund të falej edhe në shtëpinë e tij. Sipas partisë kishte tentativa të shumta konformizmi nga kleri dhe besimtarët për të vendosur barazi mes normave të moralit komunist dhe predikimeve fetare. Qëllim të ruajtjes së fesë kishin edhe shprehjet të cilat përsëriteshin nga besimtarët: “Ne po të mbajmë

ramazan dhe të bëjmë bajram nuk e dëmtojmë gjë partinë, neve do të festojmë festat kombëtare dhe ato fetare”, “Ai që është për fenë është edhe për Atdhenë” ose pyetjet që janë bërë: “A nuk është e mundur që të kemi në të djathtën partinë dhe në të majtën fenë?”, “A nuk e lejon kushtetuta lirinë e besimit?”⁴⁹ Nga situata e krijuar partia arrinte në përfundimin se nëse dobësohej lufta kundër fesë, besimet fetare nuk do të zhdukeshin. Për këtë arsye, propaganda ateiste shkencore ishte e gjithanshme dhe mjaft intensive.

2.5.2. Metoda e punës së diferencuar sipas shtresave të popullit

Rinia: Në aksionin ideologjik rinia luajti një rol të rëndësishëm, meqenëse ishte pjesa më e pastër dhe e zhveshur nga besimet fetare. Ajo luajti një rol mjaft të rëndësishëm në vënien në jetë të vendimeve të kongresit të 5-të të partisë. Në të gjithë rrethet e vendit të rinjtë zhvilluan një luftë të gjerë fillimisht mes njëri-tjetrit nëpërmjet kritikës dhe autokritikës nën parullën: “Të ndreqim shtëpinë tonë dhe krahas kësaj të ndihmojmë edhe të tjerët.”⁵⁰ Nëpërmjet fletë rrufeve në bazë klase, reparti, shkolle dhe ndërmarrjeje kritikoheshin nxënësit besimtarë dhe feja në të gjitha drejtimet. Komitetet

48. AQSH. F. 14, v. 1967, D. 190, fl. 28, Raport informativ mbi rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa të mëtejshme për thellimin e saj, 7.7.1967.

49. Po aty, fleta 29.

50. Po aty, fleta 30.

e partisë dërgonin të rinj të qendrave të punës dhe të shkollave në fshatra. U kombinua që të rinjtë që punonin nga një muaj në kooperativat e zonave malore, të merreshin edhe me propagandën ateiste shkencore.

Nga aksioni që zhvilloinin të rinjtë dilte në pah rëndësia e porosisë së vazhdueshme të Enver Hoxhës, që duhej pasur besim në forcën e rinisë dhe se rinia duhet të mobilizohet mirë. Sipas tij, me rininë duhet të arrihej të luftoheshin besimet dhe zakonet fetare si dhe të parandalohesh trashëgimia e tyre në brezat e ardhshëm.

Gruaja: Gruaja ishte nga shtresa e popullsisë që ruante më shumë besimet fetare. Ajo kishte qenë e shtypur, por në luftën ideologjike që zhvilloi partia merrte pjesë gjerësisht në mbledhjet e popullit dhe ndihmoi në demaskimin e fesë, duke përdorur fakte nga jeta e saj. Puna për emancipimin e gruas kishte një rëndësi mjaft të madhe për partinë, sepse emancipimi i saj do të ndikonte pozitivisht edhe për zhdukjen e zakoneve fetare nga ndërgjegjja e saj. Sipas partisë feja ka qenë armike e gruas, sepse ka ndikuar në mohimin e të drejtave dhe në përçmimin e saj.

Të moshuarit: Kjo shtresë e popullsisë, si patriotë të vendit, e ka përkrahur lëvizjen kundër fesë madje është bërë edhe mbështetje e saj. Organizatat dhe komitetet e partisë kanë zhvilluar mbledhje dhe kuvende të veçanta, në të cilat kanë

marrë mendimet e të moshuarve dhe kanë bërë punë sqaruese me ta. Por, të moshuarit ishin edhe mjaft fanatikë. Shumë prej tyre ngrinin shqetësime dhe pyetje në lidhje me punën që i prishte feja partisë. Partia bënte thirrje që: “Nën drejtimin e saj organizata e frontit demokratik duhet të marrë si aksion me rëndësi punën e veçantë me të moshuarit, duke trajtuar problemin me kujdes të madh pa rënë në konflikte, por pa bërë edhe lëshime që na dëmtojnë.”⁵¹

2.5.3. Metoda e punës së diferencuar sipas krahinave, fshatrave, lagjeve, familjeve

Në çdo rreth të Shqipërisë kanë ekzistuar disa fe por, mes tyre kishte ndryshime për arsye se në një rreth një fe kishte gjetur më shumë përkrahës sesa në një tjetër. Në një pjesë të krahinave të veriut si: Shkodër, Lezhë dhe Mirditë, historikisht feja katolike ka pasur influencë të madhe. Kjo duket edhe nga numri i kishave që kanë ekzistuar në këto zona. “Në Shkodër numri i kishave arrinte në 67, në Lezhë dhe Mirditë nga 24. Në disa krahina të jugut si: Sarandë, Gjirokastër, një pjesë e Korçës, Kolonjës, Vlorës, Fierit, Beratit, Lushnjës, Durrësit etj. feja orthodhokse ka patur një

51. AQSH. F. 14, v. 1967, D. 190, fl. 31, Raport Informativ mbi rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa të mëtejshme për thellimin e saj, 7.7.1967.

influcencë më të madhe. Në Korçë ka patur 132 kisha të mëdha e të vogla, në Gjirokastrë 86, në Sarandë 21, në Kolonjë 90, në Vlorë 31, në Fier dhe Lushnje nga 40 etj.⁵² Ndërsa feja myslimane ka qenë më e përhapur në zonat e Elbasanit, Gramshit, Librazhdit, Dibrës, Kukësit, Tiranës, Burrelit, etj. “Kështu në Dibër kishte 122 xhami, në Burrel 70, Librazhd 50 etj. Në Tepelenë, Përmet, Skrapar, Krujë e rrethin e B. Currit influcencë më të madhe kanë patur dërvishët (shehlerët) si sekt i fesë myslimane.”⁵³

Ndryshimet e përhapjes së një feje më shumë se sa një tjetre në rrethe të ndryshme të vendit ishin tregues se në secilin rreth duhej punë e diferencuar ateiste-shkencore. Partia porosiste organizatat dhe komitetet e saj që të tregonin kujdes të veçantë ndaj minoritetit. “Në rrethin e Sarandës nga popullata minoritare që përbënte 41.3 % të popullsisë së rrethit, rreth 2500 frymë prej vitit 1932-1943 kishin marrë edukatë sistematike fetare në shkollë duke filluar nga klasa e dytë fillore. Vetëm në rrethin e Sarandës kishte 70 quadro që kishin mbaruar shkollën në Greqi dhe 38 prej tyre edhe me vendosjen e regjimit komunist punonin në sektorin e arsimit.”⁵⁴ Partia theksonte dhe porosiste që me ata që kishin marrë edukatë fetare dhe sidomos me të

gjithë ata që kishin dhënë edukatë fetare duhej një punë e veçantë për t'i larguar nga feja dhe për t'i përgatitur për edukimin e një brezi të ri ateist.

2.5.4. Metoda e zbatimit të vijës së masave

Regjimi komunist porosiste që: “Diskutimi i gjërë në popull e ballafaqimi i mendimeve, koncepteve materialiste me ato fetare duhej përdorur gjerësisht dhe rëndësi e veçantë i duhej dhënë aktivizimit të organizatave të masave”.⁵⁵ Nga eksperiencia e deriatëhershme i duhej dhënë rëndësi aktivizimit të organizatave të masave, sepse ato kishin luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e opinionit të masave për aksionet ideologjike. Çdo organizatë, sipas profilit të saj, duke ndërmarrë aksione konkrete, duhej të thellonte luftën kundër besimeve fetare.

2.6. Karakteristikat e luftës kundër fesë

Lufta kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare në vendin tonë është zhvilluar në kuadrin e thellimit të revolucionit ideologjik. Ajo ishte një luftë e thellë klasore, mes dy ideologjive, që zhvillohej për të çrrënjësuar botëkuptimin fetar, me qëllim që ta zëvendësonte më pas atë me

55. Po aty.

52. Po aty, 32.

53. Po aty.

54. Po aty, fleta 33.

botëkuptimin materialist marksist-leninist.

Kjo luftë që po zhvillohej në të gjithë vendin dallohej nga këto karakteristika kryesore:

a. Zhvillohej në një front të gjerë në qytet e në fshat, në të gjithë shtresat e popullit.

b. Dallohej nga aksione goditëse direkte, jo vetëm kundër fesë si botëkuptim reaksionar, por edhe kundër bazave që kishin ruajtur dhe ushqyer fenë.

c. Nga pjesëmarrja e gjerë e masave të popullit në këto aksione, nga diskutimi popullor mbi kotësinë dhe dëmin e besimeve fetare.⁵⁶

Revolucioni intensiv ideologjik, që po zhvillohej, ishte rezultat i punës 23 vjeçare të partisë komuniste. Që në fillimet e saj partia edukoi anëtarët e saj dhe masat me frymën e ateizmit. Ndërsa pas çlirimit të vendit mori disa masa të rëndësishme, ndër të cilat mund të përmendim: Ndarjen e fesë nga shteti dhe nga shkolla, kufizimin e vazhdueshëm të institucioneve fetare, kufizimin e mundësive për përgatitjen e kuadrit fetar, ndalimin e botimit të literaturës fetare, etj. Të gjitha këto luajtën një rol të rëndësishëm në luftën kundër fesë. Partia, si kryesore për arritjet e deriatëhershme shihte edhe punën e saj për të përhapur arsimin,

56. AQSH, F. 14, v. 1967, D. 190, fl. 14, Raport Informativ mbi rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa të mëtejshme për thellimin e saj, 7.7.1967.

kulturën dhe njohuritë shkencore në të gjitha fushat, në mënyrë që të zhdukej injoranca. Regjimi komunist, duke parë rezultatet pozitive të masave që kishte marrë kundër besimeve e zakoneve fetare, arrinte në përfundimin që KQ dhe partia e kishin studiuar mirë gjendjen shpirtërore të masave dhe parullën e luftës e kishin hedhur në momentin e duhur. Edhe letra e 27 shkurtit, që Enver Hoxha kishte dërguar, kishte luajtur një rol ndihmues, sepse ai kishte dhënë orientime të rëndësishme për zhvillimin me sukses të luftës kundër fesë, paragjykimeve dhe zakoneve prapanike.

2.7. Numri i faltoreve dhe i klerikëve të Komunitetit Mysliman sipas qarqeve në 1965

Komuniteti Mysliman⁵⁷

Qarku	Faltore	Klerikë
Tiranë	127	140
Durrës	76	80
Shkodër	118	144
Kukës	90	94
Peshkopi	165	125
Elbasan	150	176
Korçë	163	168
Berat	61	70
Gjirokastër	37	42
Vlorë	65	70
Total	1052	1109

57. AQSH, F. 490, v. 9.7.1965, D. 1007.

Tarikatet nën varësinë e Komunitetit Mysliman⁵⁸

Tarikatet	Faltore	Klerikë
Halveti	90	68
Rufai	35	27
Kadiri	33	20
Sadi	8	6
Tixhani	7	5
Total	173	126

Në Shqipëri, ashtu siç duket edhe nga të dhënat, vetëm Komuniteti Mysliman bashkë me tarikatet, që ishin nën varësinë e tij, posedonte 1225 faltore dhe 1235 klerikë që shërbenin në këto faltore. Komuniteti bektashian posedonte 76 faltore dhe 150 klerikë,⁵⁹ ndërsa pjesa tjetër rreth 944 faltore i përkisnin komunitetit katolik. Gjatë viteve 1945-1966 këto objekte kulturi u shkatërruan ose u morën në dorëzim nga shteti. Në fillimin e vitit 1967 në Shqipëri ishin funksionale vetëm 7 xhami dhe një numër i vogël kishash, ndërsa pak muaj më vonë, në po këtë vit, ndodhi shkatërrimi i plotë i objekteve fetare dhe persekutimi i hoxhallarëve, priftërinjve dhe baballarëve.

2.8. Xhamitë e prishura ose të tjetërsuara

Xhamitë që kanë funksionuar, por që janë prishur ose janë

58. Po aty.

59. Po aty.

tjetërsuar nga organizatat e masave për t'i kthyer në shtëpi kulturore, depo etj. janë klasifikuar si vijon sipas rretheve dhe qyteteve:⁶⁰

Shkodër (qytet):

1. Xhamia “Ura Maxhar”: lagja Partizani, të qytetit të Shkodrës ishte përvetësuar nga këshilli i lagjes, duke i marrë edhe inventarin fizik e duke e kthyer në çerdhe. Xhamia në fjalë frekuentohej nga besimtarët e lagjes dhe kishte imam të rregullt. Ky veprim ishte bërë më 7.V.1966.

2. Xhamia e Garucit: lagja “Kongresi i Përmetit”. Për këtë xhami, kryesia e Frontit të kësaj lagjeje me shkresën e saj nr. s’ka, datë 5.6.1966 njoftoi Myftininë e Shkodrës se populli i lagjes në mbledhjen e tij kishte vendosur marrjen e xhamisë për ta përdorur për terren sportiv për fëmijët. Xhamia funksiononte në rregull, me imam të cilin e paguanin besimtarët e lagjes. Flitej se në qytetin e Shkodrës do të përvetësoheshin Xhamia e Kirasit (për çerdhe) dhe e Dudasit (për shkollë).

Shkodër (rreth):

1. Xhamia e katundit Vrakë: Këshilli Popullor kërkonte ta kthente faltoren në çerdhe, duke u përpjekur që të pengonte kryerjen e veprimeve

60. AQSH, F. 490, v. 1966, D. 470, fl. 2, Informacion të sektorit të komunitetit fetar, mbi kufizimin e veprimtarisë së besimeve dhe ankesat e komiteteve fetare.

fetare (8.9.1965).

2. Xhamia e Shtoit: Këshilli Popullor kishte vënë dorë në xhaminë e këtij katundi, duke e transformuar xhaminë në çerdhe dhe duke i marrë imamet çelësat. Ky veprim ka ndodhur në Shtator 1965. Edhe disa të tjera u kthyen në depo gjatë vitit 1964-1965.

3. Xhamia e katundit Kuç: E okupuar para dy vjetësh nga kooperativa bujqësore për depo. Xhamia në fjalë nuk funksiononte rregullisht.

Elbasan (rreth):

1. Xhamia e katundit Xibrakë, lokaliteti Belsh, është shembur nga rinia më 14.5.1966. Kjo xhami funksiononte dhe kishte imam të rregullt.

2. Xhamia e katundit Muriqan, lokaliteti Cërrik, më 15.5.1966 është prishur nga organizata e rinisë. Xhamia funksiononte dhe kishte imam të dekretuar nga Komuniteti Mysliman.

3. Xhamia e katundit Tërbaç, lokaliteti Kërrabë, ishte kthyer nga rinia në qendër kulture, duke i marrë çelësat imamet. Xhamia funksiononte me imam të rregullt. Xhamia është marrë nga rinia dhe është kyçur më 13.5.1966. Populli i katundit Tërbaç është treguar i gatshëm për të bërë me punë vullnetare shtëpi kulture tjetër.

4. Xhamia e katundit Lleshan, lokaliteti Gjinaj u prish nga Këshilli popullor dhe rinia më 29.6.1965.

5. Xhamia e katundit Shtepanj, lokaliteti Cërrik, u prish minarja 497 vjeçare nga Këshilli popullor dhe faltorja u kthye në shtëpi banimi për arsimitarët.

6. Xhamia e katundit Shënavlash, lokaliteti Cërrik, u prish nga kryetari i kooperativës. Minarja e saj dhe faltorja u kthyen në dyqan bukësh. Ky veprim është bërë në vitin 1965.

7. Xhamia e katundit Selvijas (10.X.1965), u prish nga kryetari i këshillit popullor dhe sekretari i organizatës së rinisë së fshatit.

8. Xhamia katundit Shalës, lokaliteti Belsh, është prishur në korrik të 1965 nga lokaliteti përkatës. Po kështu edhe xhamia e katundit Rrasë është kthyer në dyqan buke.

9. Xhamia e katundit Kajan, lokaliteti Kajan, është prishur nga kooperativa dhe lokaliteti (Korrik 1965).

10. Xhamia e katundit Dëshiran, lokaliteti Kajan dhe xhamia e katundit Dragot-Dumre, u prish nga lokaliteti dhe kooperativa.

11. Xhamia e Katundit Gostimë, lokaliteti Cërrik.

12. Xhamia e katundit Mollas, lokaliteti Molla.

13. Xhamia e katundit Dragot-Sulovë.

14. Dhe Xhamia e Darëzës janë shembur nga organet e pushtetit lokal vitin e kaluar.

Të gjitha xhamitë e sipërpërmendura kanë funksionuar.

Korçë (rreth):

1. Xhamia e katundit Bozhigrad, lokaliteti Bilisht, u prish më dt. 18.4. 1965, nga kryetari i kooperativës bujqësore.

2. Xhamia e katundit Menkulas, lokaliteti Bilisht, u shemb nga organet e pushtetit të atij fshati vitin e kaluar.

Tiranë (rreth):

Xhamia e lokalitetit Ndroq u prish nga kooperativa bujqësore, e cila mori edhe materialin pa marrëveshje nga Komuniteti Mysliman. Ky veprim është bërë në Qershor 1966. Xhamia para se të prishej ka qenë depo.

Bibliografia

Burime të arkivave

AQSH, F. 890, v. 1945, D. 1.

AQSH, Fondi i Ministrisë, v. 1946, D. 97.

AQSH, D. 470, v. 1966.

AQSH, F. 14, v. 1967, D. 6.

AQSH, F. 14, v. 1967, D. 37.

AQSH, F. 14, v. 1967, D. 53.

AQSH, F. 14, v. 1967, D. 189.

AQSH, F. 14, v. 1967, D. 190.

AQSH, F. 14, v. 1967, D. 417.

AQSH, F. 14, v. 1967, D. 422.

AQSH, F. 490, v. 1966, D. 470.

AQSH, F. 490, v. 1965, D. 1007.

AQSH, Nr. 420 protokolli, v. 1967.

Dekretligji Nr. 743, Mbi komunitetet fetare, 26.11.1949.

Gazeta

Gazeta Zyrtare, nr. 50, Tiranë, 4 qershor 1946.

Gazeta Zyrtare, nr. 29, Tiranë, 10 prill 1948.

Zëri i Popullit, 8 shkurt 1967.

Literatura

- Basha, M Ali. *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë: 2011.
- Benanti, Franko, *Lufta ime me e gjatë në Shqipëri 1943-1948*, Tiranë: Naimi, 2012.
- Beqja, Hamit, *Lufta për shkollën ateiste shqiptare*, Tiranë: ShBLSh, 1984.
- Moroco, Roberto dela Roka, *Kombësia dhe Feja në Shqipëri 1920-1924*, Tiranë: 1994.
- Moroco, Roberto dela Roka, *Kombi dhe Feja në Shqipëri (1920-1944)*, Tiranë: Elena Gjika.
- Dervishi, Kastriot, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912–2005*, Tiranë: “55”, 2006.
- Duka, Valentina, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: Kristalina - KH, 2007.
- Foucault, Michel, *Disiplinë dhe ndëshkrim: Lindja e burgut*, Tiranë: Odeon, 2010.
- Historia e Popullit Shqiptar, vëll. IV, Tiranë: Toena, 2009.
- Hoxha, Enver, *Veptra 35, Në luftën kundër besimeve fetare ka vetëm një rrugë*, 7 Prill 1967.
- Hoxha, R. Artan, “Marrëdhëniet midis Regjimit Komunist dhe Kishës Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë në vitet 1945–1967”, Tiranë: 2014.
- Hysi, Shyqyri. *Histori e Komuniteteve Fetare Shqiptare*, Tiranë: Mësonjëtorja, 2006.
- Hysi, Shyqyri. *Muslimanizmi në Shqipëri në periudhën 1945-1950*, Tiranë: Mësonjëtorja, 2006.
- Jacques, Edwin, *Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Tiranë: Kartë e Pendë, 1998.
- Kagjini, Peço, *Konferenca e Tiranës e Prillit 1956*, Tiranë: 1999.
- Llarja Haxhia, Nertila, *Kisha Katolike dhe Shteti Komunist në Shqipëri (1944-1990)*, Shkodër: Botimet Fishta.
- Paja, Sokol, “Roli i mediave në propagandën ateiste në periudhën totalitare”, Tiranë: 2018.
- Pllumi, Zef, *Rrno vetëm për me tregue*, Botimi II, Tiranë: “Hylli i Dritës”, 1997.
- Pllumi, Zef, *Rrno vetëm për me tregue*, Botimi II, Tiranë: “55”, 2006.
- Qazimi, Azem, *Komunitetet fetare në Shqipërinë komuniste*, Tiranë.
- Qendra e studimeve albanologjike, *Studime historike 1-2*, Tiranë: 2009.

Tezat më të rëndësishme në çështjen e edukimit të fëmijëve tanë

Prof. Ahmed Muadh el Hatib

Falënderimi i takon Allahut, xh.sh., i Cili ka thënë:

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: ‘Unë do të krijoj një njeri prej balte. 72. Kur t’i jap trajtë dhe t’i fryj prej shpirtit Tim, përlujni në sexhde atij!’”¹

Edukimi i njeriut është vërtet i çuditshëm. Ekzistojnë forma dhe mënyra të ndryshme të edukimit të njeriut. Secili individ, në vetvete, është një botë. Sa më shumë ligje që e përcjellin, ndihet intimiteti më i madh dhe pasuria e brendësisë së tij. Edukimi i fëmijëve, posaçërisht, është një mjedis i frytshëm e i pranueshëm dhe sa më tepër që mundohet edukatori, aq më tepër tregohet arti njerëzor në të dhe

1. Sad, 38:71-72.

bëhet pishtar i udhëzimit, rilindjes dhe urtësisë.

Për këtë shkak është shumë vështirë që në disa fletë të përshkruhet ajo botë e pakuptueshme, shumëdimensionale dhe vetëripërtëritëse, por ky është një plotësim i vogël, qëllimi i të cilit është që të zbulohet ndonjë perde dhe të ndriçohet kjo temë për shkak të detyrës, këshillimit dhe përkujtimit të ndërsjellë.

Nga temat më madhore në edukimin e fëmijëve tanë është puna në vazhdimësi në përcaktimin dhe rrrumbullakimin e pesë gjërave:

1. “Kush jam unë?” - Përcaktimi i identitetit.

2. “Kujt i përngjaj?” - Përcaktimi i përkatësisë.

3. “Kë pasoj?” - Përcaktimi i shembullit tënd dhe autoritetit.

4. “Si të sillem?” - Përcaktimi i qëllimit të përkohshëm.

5. “Çfarë vlen ajo që unë bëj?” - Përcaktimi i qëllimit përfundimtar.

Duhet punuar në këto pika që nga fillimi i njohurisë, d.m.th. që nga fëmijëria e hershme. Nëse këto pika do të jenë mjaftueshëm të qarta, ndoshta për shkak të rrumbullakësimit jo të qartë të tyre që në fillim, atëherë duhet të bëjmë vlerësimin e brendshëm të gjërave për të vlerësuar (pa) qartësinë e tyre, sepse humbja e këtyre pikave ndonjëherë është shkak i zbrazëtirave permanente në edukimin e fëmijëve tanë dhe nëse dikush nuk zotëron diçka nuk mund t'i japë tjetrit.

Nuk mund ta paramendojmë se sa e rëndësishme është të dimë përgjigjet e sakta të këtyre pesë pikave që përmendëm.

Për shkak të lëvizjes normale të këtyre gjërave do të vonohemi në dhënien e këtyre përgjigjeve, por te problemi i parë do të ndiejnë se sa e rëndësishme është kjo përgjigje, në të kundërtën, do të na përcjellin mëdyshjet dhe një hutim të rëndë.

Këto pika që do shtjellojmë, njeriut do t'i japin baraspeshë, qetësi, besim të thellë e të drejtë, sikur do të parandalojnë largim psikik, i cili udhëheq drejt ndërtimit të formave jo të drejta të sjelljes njerëzore ose nga vlerat normale edukative.

1. “Kush jam unë?” (Përcaktimi i identitetit)

Lidhja e parë të cilën njeriu ose fëmija ka, pasqyron identitetin e tyre, iu siguron baraspeshën në hapat e tyre të komunikimit me të tjerët, në mënyrë të mirë ose të keqe, duke falur ose urryer, hapur ose mbyllur ne vetvete, kuptueshëm me naivitet, me trimëri apo me frikë. Në këtë kontekst imam El-Gazaliu ka thënë: “Dije se fëmija është amanet i prindërve të tij, ndërsa zemra e tij është një margaritar i papërpunuar, i cili pranon të gjitha llojet e përpunimit. Nëse mësohet në mirësi, ashtu do të mplaket dhe prindërit e tij dhe edukatori i tij nga kjo do të kenë sevap, por nëse mësohet në të keq, ashtu do të plaket, kështu bëhet mëkat në qafën e kujdestarëve të tij që duhej ta ruanin, edukonin, ta mësonin për sjelljen e bukur dhe ta ruanin nga shoqëria e keqe”.

Ky themel ose pozitivitet i lindur do i japë fëmijës baraspeshën përgjatë jetës së tij.

Ky fakt e ka bazën në hadithin ku Pejgamberi a.s. ka thënë: “Secili fëmijë lind në natyrshmërinë e shëndetshme, kurse prindërit e tij e bëjnë të krishterë, hebre ose adhurues zjarri”. (Buhariu)

Kur’ani Fisnik e përcakton qartë identitetin e myslimanit kur Allahu i Madhërishtëm thotë:

“Thuaj: ‘Me të vërtetë, Zoti im më ka udhëzuar në rrugë të

drejtë, në fenë e vërtetë, fenë e pastër të Ibrahimit besimplotë, i cili nuk ka qenë adhurues i idhujve'. Thuaj: 'Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.'"²

Problemet më të mëdha që paraqiten mes prindërve dhe fëmijëve rrjedhin nga mos ekzistenca e identitetit të vërtetë.

Mund të vërejmë se ndonjëherë prindërit, në ditët e para të jetës familjare, kur janë larg nga feja, t'i japin fëmijëve të tyre identitet negativ. Nëse këta prindër kthehen në fe, kur këta fëmijë arrijnë periudhën e pubertetit, do të hasin në pengesa tejet të mëdha që fëmijët e tyre të ecin hapave të tyre.

Shkaku qëndron në atë se identiteti, i cili sapo është mbjellë tek ata, ka qenë negativ që në fillim, andaj ata nuk mund të lëvizin, përveçse me bindje të thellë ose përvojat individuale, të cilat nuk mund të jenë aspak më të cekëta nga përvoja e prindërve të tyre.

Identiteti, me të cilin e edukojmë fëmijën tonë, lë gjurmë tejet të fuqishme në personalitetin e tij. Kur'ani na tregon për faraonin, i cili kur kuptoi se do të lindte një fëmijë, i cili do të ketë identitet të kundërt nga ai që dëshironte, bëri të pamundurën për ta shkatërruar atë identitet, duke vrarë të gjithë të porsalindurit.

2. En'am, 6:161-162.

Për t'i dhënë fëmijës sonë një identitet të qartë, prej nesh kërkohet:

- nderimi i/respekti i veçantë ndaj shkencës së vërtetë
- ndërtimi i zemrës së pastër
- dhënia e shembullit të bukur nga vetvetja
- sigurimi i mjedisit, i cili do të ndihmojë që të kristalizohen gjërat.

Shkenca e vërtetë:

Shkenca e vërtetë kërkohet prej nesh përpjekje të pandërprera. Njohuria jonë e disa gjërave nuk kërkohet që edhe fëmijët tanë ta zotërojnë këtë njohuri dhe, gjithashtu, atë që ne e kemi grumbulluar gjatë një periudhë të gjatë, mundemi që për një kohë të shkurtër ta përcjellim tek ata, kur njohim mënyrën e drejtë të mësimit.

Problemi paraqitet, kur mendojmë se disa imtësi, të cilat atyre ua japim në mënyrë të paplanifikuar, të japin rezultatin e kërkuar, duke llogaritur se në këtë mënyrë nga ata të ndërtojmë njeriun, i cili posedon njohuri të veçantë.

Kur'ani Fisnik na jep leksione të veçanta dhe porosi rreth çështjes së përkufizimit të shkencës së mirëfilltë dhe moralit të saj. Nga shembujt e qartë është edhe tregimi i Musait a.s. me Hidrin në kaptinën El-Kehf, shkaku e të cilit e shënon hadithi, ku Musai a.s. është pyetur se cili është më i ditur, për të cilën është përgjigjur se është ai, duke mos ia përshkruar diturinë e tij Allahut xh.sh.

Ndërtimi i zemrës së pastër

Ndërtimi i zemrës së pastër do të thotë edukim, që nuk që nuk ngjason me çdo lloj edukimi, sepse përkufizimi i tyre shpesh përzihet. Imam El-Bejdauiu, Allahu e mëshiroftë, e përkufizon edukimin si “arritje e shkallëzuar e pikës më të lartë të një gjëje”.

Mund të vërejmë shumë paraqitje fetare, të cilat inkurajojnë në punë të vazhdueshme, që është e domosdoshme për edukim të sjelljes. Ndër këto numërohet edhe thënia e Muhamedit a.s., kur thotë: “Puna më e dashur tek Allahu xh.sh. është ajo e vazhdueshmja, edhe nëse ajo është modeste në madhësinë e saj (e paktë)”. (Muslimi)

Dhënia e shembullit të bukur nga vetvetja

Duhet vazhdimisht të ruajmë praktikën e mësimin në fe, vështrimin permanent dhe ushtrimin e vazhdueshëm në të. Sa më shumë kushte të nevojshme të jenë prezentë gjatë edukimit të personit, aq më e madhe është mundësia e suksesit.

Në një familje, e cila kishte mbjellë besim në zemrat e fëmijëve të saj në fushën shkencore dhe praktike, qëllimi i dëshiruar e arriti thellësinë më të madhe, kur këtu kishte një shembull të bukur, të cilin do t’jua tregojmë juve:

“Në qetësinë e natës fëmija u

ngrit nga krevati i tij, dhe u drejtua vjedhurazi deri te krevati i babait, duke dëshiruar ta pushtojë me duart e tij dhe të flejë në përqaftimin e tij. Por, vogëlushi u habit kur e pa krevatin e babait të tij të zbrazët, andaj u drejtua për në shtëpi duke e kërkuar nëpër dhoma. Në dhomën më të largët dëgjoi zërin e babait të tij, i cili lexonte Kur’an me zë të dhembshëm, të cilin vogëlushi më parë nuk e kishte njohur. Pa u diktuar (vërejtur) u afrua afër babait të tij dhe nga qëndrimi i tij e kuptoi se ishte duke u falur. Sytë e vogëlushit tonë u ndalën duke regjistruar në memorien e tij imazhin të cilin nuk do ta harronte kurrë dhe që do të linte ndikim të madh tek ai pas një periudhe të gjatë. I pa dy vija lotësh që lëshoheshin përgjatë fytyrës së babait, i cili ishte i preokupuar me lexim duke qarë, pa e vërejtur prezencën e të birit. Duke u përvjedhur, vogëlushi e braktisi dhomën dhe u drejtua për në krevatin e tij. Në trurin e tij u skalit diçka që kuptimin e thellë do ta zbulonte pas një kohe të gjatë.

E mira kurrë nuk shkatërrohet. Vogëlushi ynë u rrit. Duke u rritur filloi të ndiejë ëmbëlsinë e imanit dhe bindjen ndaj Allahut xh.sh.

Edhe pse ishte i shoqëruar me dobësi, të cilat gjenden te secili njeri, vesa e Kur’anit, në thellësitë e shpirtit të tij, e freskonte thatësisirën e zemrës së tij sa herë që i afrohej mëkateve. Skena e babait të tij me sy

të përloitur, në thellësinë e asaj nate, u ngulit në memorien e tij, vala e zhurmshme e imanit ia largonte nga rruga e tij të gjitha pengesa dhe të gjitha gjërat të cilat e luhatin.

Sigurimi i mjedisit, i cili do të ndihmojë që gjërat të kristalizohen

Përsa i përket sigurimit të klimës së dëshiruar, këtu nuk do të jetë gjithmonë ashtu siç dëshirojmë ne. Gjatë sundimit komunist, në vendet islame, metodat e egra staliniste nuk patën sukses të çrrënjoshin Islamin nga zemrat e myslimanëve.

Kur'ani, besimi dhe rregullat islame u mësuan në bodrume të ngushta e të errëta, në shpella të braktisura dhe male. Islami qëndroi edhe pse i rrethuar me injorancë, përndjekje dhe dobësi, nëpër të cilat kaloi; që nga ato vende përsëri u ngrit duke u përhapur edhe më tepër.

Na duhet të besojmë fuqishëm se, çfarëdo lloji qofshin rrethanat, ligjet, të cilat Allahu xh.sh. i vendosi në këtë botë, mund të na hapin dyert e punës dhe ndërtimit dhe do të na japin hapësira të gjëra për veprim. Ne duhet të mësojmë mirë si t'i vëmë ato në praktikë dhe si t'i drejtojmë.

Para nesh duhet të vendosim kuptimin e Kur'anit dhe udhëzimin e Pejgamberit a.s. si dy shenja të përhershme ndaj të cilave gjithnjë duhet të shpejtojmë:

“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë..”³

**2. Kujt i përngjaj?
(Përcaktimi i përkatësisë)**

Harmonia e brendshme, apo vetë pranimi, është një çështje e rrezikshme në ndërtimin e shpirtit njerëzor. Njeriu nuk pushon së menduari rreth krijimit të tij të brendshëm dhe pranimit të jashtëm të kësaj dukurie. Nëse gjatë kësaj ndërtohen bindje të thella të brendshme, ato i japin bartësit të saj, stabilitetin e duhur për rritje të drejtë. Ndërsa personat të cilët gjatë jetës së tyre sillen mes mendimeve të ndryshme, në shumicën e rasteve, harmoninë e brendshme e kanë të çrregulluar. Nëse ky person nuk arrin deri te rezultati i kërkuar, kjo mund të kthehet në një formë të hipokondrisë⁴. Disa ide bashkëkohore paraqesin shembuj të ashpër të çrregullimit shpirtëror njerëzor nën perden e emrave të zëshëm, frytet e të cilit janë një formë e shturjes shpirtërore të individit në dredhën e pashpresës së përhershme dhe reaksioneve, të cilat ndajnë çdo gjë prezente dhe askujt nuk i japin asnjë dobi pozitive.

3. Zelzele, 99:7-8.

4. Hipokondri: Çrregullim narcisist të personalitetit.

Gjërat bëhen edhe më të rrezikshme kur kjo shthurje shpirtërore bëhet rrymë e jo shembuj të vetmuar dhe të kufizuar. Kjo temë lidhet me masën sipas së cilës njeriu shkon sipas çështjes së përcaktimit të vetvetes dhe marrëdhënies ndaj të tjerëve. Kur'ani Fisnik na tregon qartë në peshoren kryesore për përcaktimin e të gjitha veprave të brendshme dhe të jashtme, kur na drejtohet:

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.”⁵

Vetë pranimit në rrugën e devotshmërisë e pasuron jetën, kështu që në të ka mirësi për secilin, ndërsa parimet që fokusojnë superfuqinë e individit, ose shoqërisë, ose interesin apo egoizmin, çojnë drejt shkatërrimit individual dhe të përbashkët.

Imam Gazaliu na tregon për ndodhinë e këndshme, që i ndodhi Sehl bin Abdullahut me dajën e tij, Muhamed b. Siuarin, se si daja tek ai ndërtoi harmoninë e brendshme. Ai tregon se si atëherë ishte tre vjeçar dhe e shihte dajën se si falej natën, pas së cilës daja i kishte thënë: A nuk po e përmend Krijuesin tënd? Unë e pyeta: Po si ta përmend Atë? Ai

5. Huxhurat, 49:13.

më tej kërkoi nga unë që ta përmend disa herë me zemër: Allahu është me mua, Allahu më vëzhgon, Allahu më shikon!

Pasi e përsërita disa net me radhë, ai më tha ta shtoj të përmendurin. Pastaj, Sehl ka thënë: Bëra atë që më tha dhe në zemrën time ndjeva ëmbëlsinë e saj dhe daja pas një vitit më tha: “Mbaje mend këtë që të mësova dhe kështu vazhdo deri në fund të jetës sate!” Dhe kështu kam vazhduar për disa vite me radhë dhe gjeta ëmbëlsinë e gjithë kësaj në qenien time, pas së cilës daja më tha: O Sehl, me atë që është Allahu, atë që e vëzhgon dhe e shikon Ai, a mund të gabojë ndaj Tij? Ruaju nga mëkati!”

Pas kësaj Sehl u rrit, e mësoi përmendësh Kur'anin kur ishte gjashtë apo shtatë vjeçar dhe u bë njëri prej agjëruesve më të shpeshtë dhe i devotshëm dhe shumë herë e kalonte tërë natën me ibadet (adhurim).

Shumica e prirjeve negative dhe armiqësore të fëmijët paraqiten në ditët e para të fëmijërisë, si rezultat i përvojës së rëndë të fëmijët e keqtrajtuar. Te këta fëmijë mbillen tendenca katastrofike, sepse në këtë mënyrë ata mësojnë se te njerëzit ka të mira dhe të këqija, të cilat më vonë psikika e tyre nuk do t'i kuptojë. Ky fakt është tejet i madh për kuptimin fëmijëror në vitet e hershme të fëmijërisë së tyre, për çka këto prirje për ata janë trishtuese, duke krijuar

tek ata pesimizëm dhe vrage, të cilat kurrë nuk shërohen.

Ashpërsia është e mirë dhe gjë e patjetërsueshme në fushën e edukimit, ndërsa nuk është aspak e arsyeshme për fëmijët. Mes formave negative të edukimit bën pjesë edhe cungimi i dhunshëm i fëmijërisë së fëmijëve. Ndër gabimet, që shpesh përdoren, është frikësimi i fëmijëve se Allahu do e ndëshkojë me zjarr! Më e drejtë është që fëmija të inkurajohet me atë se Allahu atë e do, ndërsa duhet larguar nga gënjeshtria nëpërmes inkurajimit dhe adaptimit në drejtësi dhe mbjelljen e madhështisë së dashurisë së Allahut ndaj personave të sinqertë. Kjo duhet të përsëritet derisa vetëdija e tij të bëhet e aftë të dallojë të mirën nga e keqja, në bazë të vështrimit fetar në këto fenomene dhe të kuptojë pasojat e tyre në këtë botë dhe në botën tjetër.

Ndër faktorët e rrezikshëm, që e udhëzojnë njeriun në harmoninë e tij të brendshme, bëjnë pjesë dimensionet shpirtërore, që janë të mbjella tek ai, dhe mënyra e mbjelljes së tyre. Hadithi në të cilin Pejgamberi a.s. ka thënë: “*Jam dërguar të plotësuar moralin e bukur*.”⁶, na tregon pozitën e moralit të bukur në jetë. Lavdërimi i Allahut të Madhërishëm për të Dërguarin e Tij, kur thotë: **“Vërtetë, ti je në shkallë të lartë të moralit!”**, tregon qartë se të dërguarit kanë pjesëmarrjen më të

6. Ahmedî, Hakimi dhe Bejhekiu.

madhe të moralit të lartë.

Ekzistojnë grupe të caktuara, të cilat thërresin në mënyrë transparente në moral, por ato janë hipokrite dhe oportuniste, të cilave u intereson vetëm interesi personal, si hajduti, i cili ka humbur gjahun e tij dhe fillon të qajë besimin dhe vazhdimin në sinqeritetin në jetë.

Ekzistojnë grupe të tjera, që nuk kanë lidhje të drejtë me moralin dhe as që thërresin, përveç në rastet kur gjërat arrijnë deri te “kufijtë e kuq”, që në vetvete bartin shkatërrim të qartë. Këta janë sikurse disa bashkësi, të cilat lejojnë të gjitha format e shturjeve, duke menduar se ky është veprim natyral, i cili nuk shkakton probleme.⁷ Kur këto probleme fillojnë të ndodhin pandërprerë, vetëm atëherë këto bashkësi fillojnë, me turp, të ngrenë zërin e tyre mbi patjetërsueshmërinë që të kushtohet vëmendja në disa çështje dhe që të mos kalohet kufiri në shfrytëzimin e disa gjërave, të cilat japin rezultate shkatërruese!

Ekziston grupi i tretë i njerëzve, të cilëve u intereson etika lokale vetëm në kornizat ligjore, kështu që nuk ka asgjë të keqe që mjeku të pijë alkool në kafene, përderisa të nderohen rregullat spitalore, të cilat preferojnë që alkooli të konsumohet vetëm jashtë ambienteve të spitalit dhe jo gjatë orarit të punës, ndërsa

7. BBC-ja përmend shënimin se në vitin 2001 në botë nga SIDA kanë vdekur 25 milion njerëz dhe të sëmurë nga e njëjta sëmundje ka afro 40 milion.

askush nuk duhet të ketë lidhje me jetën e tij private. Esenca negative e këtij akti dalëngadalë kalb tërë bashkësinë.

Edukimi islam dallon tërësisht nga të gjitha grupet e përmendura. Struktura etike e bashkësisë, në themelet e saj, është e baraspeshuar dhe strukturë harmonike, në të cilën nuk ka kundërthënie ose kontradikta, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e së cilës e mbajnë të gjithë anëtarët e kësaj bashkësie.

Kjo strukturë etike mund të pranojë ndonjë lëshim të vogël individual të kufizuar e të parashikuar, por gjithmonë mendon se realizimi i interesit të vërtetë për bashkësinë dhe mënjanimi i të gjitha pengesave, është detyrim farz, që nuk mund të lihet. Për këtë arsye, struktura jonë etike është tejet e ashpër ndaj personave që dëshirojnë të zbatimin dhe ta shkatërrojnë.

Hadithi mbi anijen na tregon kuptimin e gjerë të strukturës së etikës islame, në të cilin Pejgamberi a.s. thotë: *“Shembulli i atij që kujdeset për kufijtë e Allahut dhe ai i cili i kalon, është sikurse njerëzit që udhëtojnë me anije, ku disa kanë zënë vendin lart, e disa në pjesën e ulët të anijes. Sikur këta poshtë të dëshironin të pinin ujë, duhej të kalonin pranë atyre në pjesën e lartë të anijes dhe thanë: “Do ishte mirë që ne të shponim anijen që të mos i pengojmë ata lart.” Nëse do i lejonin ta bëjnë atë që kishin për qëllim, do të vdisnin të gjithë, ndërsa nëse i pengojnë në*

*këtë qëllim, do të shpëtonin të gjithë”*⁸

Për shkak të këtyre gjërave, Omer b. Abdulazizi r.a., duke urdhëruar që dënimi të kryhet mbi personin, i cili ishte prezent gjatë konsumimit të alkoolit, shtoi: Së pari atë dënoni, sepse në sulm të faktorëve të dobësimit duhet pasur vëmendje.

Etika shoqërore është parim, të cilin të gjithë duhet ta bartim, por përderisa ekziston një hendek mes parimeve tona morale dhe sjelljes praktike, do të mbesin shumë zbrazëtira.

Ekziston edhe një gjë e rëndësishme, e kjo është domosdoshmëria e arsimimit dhe udhëzimi në fushën e kuptimit të çështjeve dhe kur nuk mund të ndodhë përjashtim në ligj. Në të kundërtën, fëmijët do të rriten me teorinë ideale, e cila do të rrënohet gjatë çdo akti praktik, ose do të mbytet në valën e prishjes, gjatë së cilës nuk do të ndalet te kufiri i caktuar.

Ekziston një gjë tejet e rrezikshme për të cilën duhet të kemi mjaft kujdes. Etika e një myslimani në disa fusha të rëndësishme jetësore, si vazhdimësia në fushën e hulumtimit dhe leximit, duket e zbehur në krahasim me kërkimin e parimeve islame dhe në krahasim me popujt e tjerë, të cilët ishin në vendin e fundit, por pastaj përparuan mjaftueshëm në këto fusha. Simboli i përkryerjes,

8. Buhariu.

rreth të cilit flasim vazhdimisht, dhe i cili thotë: “Allahu dëshiron, kur dikush prej jush bën një punë të caktuar, ta plotësojë atë.”, pothuajse nuk është fare prezent te ne. Koha e vlefshme, me të cilën Allahu xh.sh. betohet në kaptinën El-Asr, nuk është në nivel të kërkuar, qoftë në çështjen e respektimit të saj, shfrytëzimit, ruajtjes dhe kryerjes së të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Zbrazëti të tmerrshme kanë goditur umetin në këtë fushë, ndërsa gjurmët e tyre janë për çdo ditë e më të mëdha, nëse vetëdija për ekzistencën ose pranimin e cilitdo problemi, hapi i parë drejt zgjidhjes së tij, atëherë nuk ka dyshim se nevojitet mund shumë më i madh nga ai që bëjmë.

Nëse përsosmëria e punëve në nivelet më të vogla ende zvarritet, çfarë mund të pritet në nivelet më të larta? Nuk ka dyshim se mbledhja e etikës së përsosmërisë së punës nuk është gjë e thjeshtë, por ky është një hap i domosdoshëm, i cili kërkon durim të madh. Kjo çështje nuk është e kufizuar, ngase jemi sëmurë me përsosmëri të dobët të punëve në nivelin individual, të bashkësive, madje edhe në nivel shtetesh e popujsh.

Nëse humbja e ndjenjave, zhdukja e besimit dhe largimi nga përgjegjësitë, te cilido popull qoftë, shprehje e thellë e cilësisë së individit, të cilit do i nevojiteshin t’i jepnin forcën, kjo nuk do të thotë se këtu mungon përgjegjësia

individuale, e cila, shumë mirë, e arrin marrëdhënien mes ngecjes së përbashkët dhe lëshimit individual.

Te ne është e detyrueshme që të mbjellim strukturën e thellë etike, ndikimi i së cilës, me gjithë pengesat ekzistuese, do të jetë më i madh se fushata shkatërruese.

Kjo është, pikërisht, esenca e punës së ripërtëritësve të misionarëve, tek të cilët ende ka pjesë të mira, e cila zhvillohet e përhapet dhe që pandërprerë do ta shkatërrojë të keqen.

Nga gjërat që shkatërrojnë esencën e strukturës etike dhe japin shenja të moskuptimit të lidhjes ndërmjet prapambetjes së përbashkët dhe gjurmëve të mundit individual në rrugën e pengimit të përparimit të kësaj prapambetje, janë veprimet e individit, i cili kur fëmija diç e thënë vihet në vendin e mbrojtësve të tij, duke refuzuar çdo vërejtje të mundshme, duke u arsyetuar që këtë vepër të keqe e ka bërë fëmija i fqinjtit ose motra e mjerë, e cila nuk është prezentë.

Këta, me këtë veprim, në thellësinë e këtij fëmije mbjellin besimin se tërë shpëtimi qëndron në gënjeshtëri, duke i mësuar egoizmin, ndërsa akuzohet i pafajshmi për të shpëtuar fajtori i vërtetë! Ata, në këtë mënyrë, derdhin mbi të marrëzi dhe jo besnikëri, sepse ai atëherë sheh se akuza është drejtuar te dikush tjetër, derisa ai ka mbetur i qetë dhe i rehatuar.

Duhet të vërejmë se nuk duhet të mbështetemi në çdo gjë, që më parë nuk është provuar.

Mbështetja në bonton, i cili nuk është provuar, është sikurse ndërtesa së cilës shtyllat e drurit i ka pushtuar dhe i ka krimbur krimbi. Veprat e mira janë pjesë e pandashme e besimit, ndërsa ushqimi teorik, pa prezencën e praktikës, mund të shkatërrojë të gjitha parimet.

Etika jona duhet të jetë praktike dhe e mbjellë thellë në jetën tonë. Marrëdhënia jonë ndaj kësaj etike duhet të jetë sikurse marrëdhëniet ndaj vetë parimeve, të cilat i vërejmë, për shkak të realizimeve për të cilat përpiqemi dhe në rrugën e të cilave vdesim. Kjo etikë nuk duhet të jetë simbol i zbehtë, të cilën do e fshijnë ditët dhe ndodhitë.

3. Kë do të pasoj? (Përcaktimi i autoritetit)

Në jetë, autoriteti është gjithmonë i nevojshëm, domethënë ana ndaj së cilës përcaktojmë shikimet, mendimet, sjelljet, vlerat, veprimet tona, në bazë të të cilave organizojmë jetën tonë.

Gjithashtu, patjetër duhet të kemi shembuj për sjelljet tona, të cilat do t'i pasojmë dhe rreth së cilit sillen shembujt tonë më të mëdhenj.

Në këta shembuj përcaktohen qëllimet që synojmë. Në tërë botën nuk ekziston askush, i cili mund të jetojë pa autoritet dhe gabon kushdo

që mendon se është i pavarur në këtë çështje. Ka pasur shumë që janë munduar të ikin nga autoriteti, të cilit i takojnë, që në një formë tjetër të bien nën ndikimin e autoriteteve të tjera.

Ekzistimi i pashmangshëm i autoritetit është i madh, sepse mosekzistimi i tij e bën individin ose grupin të jetojë në vakum, e në këtë rast mund ta mbizotërojë njeriun duke luajtur me të, duke marrë parasysh se rrugët e shtrembëruara janë të shumta dhe të ndryshme.

Për tërë këto arsye patjetër është ekzistimi i parimeve, duhet patjetër që të ekzistojnë parimet, sipas të cilave duhet peshuar, sepse Allahu xh.sh. thotë: **“E sikur të përputhej e vërteta me dëshirat e tyre, do të shkatërroheshin qiejt e toka dhe çdo gjë që gjendet në to. E megjithatë që Ne atyre u sollëm (me këtë Kur’an) famën e tyre, ata u zmbropsën ndaj përkujtimit të vet.”**⁹

Kur’ani shumë qartë e ka saktësuar autoritetin si metodë e besimtarit: **“Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni.”**¹⁰

Në hutime të mëdha bëjnë pjesë pohimi i individëve që nuk i takojnë askujt, që gjithsesi nuk është e drejtë. Në këtë jetë nuk ekziston askush që

9. Mu’minun, 23:71.

10. En’am, 6:153.

nuk i përket një grupi. Nëse do të paramendojmë se ekziston individi, i cili nuk i takon asnjë feje, parimi ose ideologjie, a do të thotë kjo se ai nuk i takon askujt? Kurrsesi! Ai i takon një shkollë së cilës i takojnë individë të ngjashëm me të. Të gjithë ata, përafërsisht, kanë kuptime të përbashkëta dhe fillojnë nga vetë kuptimet ekzistuese, të cilat janë prezentë tek të gjithë ata. Kur një perëndimor ka shkruar veprën “Të papërcaktuarit”, e gjitha ka ngjarë në një pa përcaktim të shprehur në lojën gjuhësore, sepse askush nuk mund të jetë i papërcaktuar. Ky përcaktim te njeriu rrezaton format e sjelljes, e të menduarit, e të kuptuarit dhe qëllimet drejt të cilave ai anon.

Kështu në familje, hapi i parë nga shembulli i sjelljeve të drejta vjen nëpërmes prindërve. Kur’ani Fisnik, në mënyrë të drejtpërdrejtë, saktëson temën e shembullit ose modelit, i cili duhet pasuar, kur Allahu i Madhërishtëm thotë:

“Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun.”¹¹

Shkaku i krizave ideore, të cilat paraqiten tek individët, janë paqartësia e termit “model”. Frika nga mbyllur hendekun dhe e ka përdorur vulën për t’i vulosur

11. Ahzab, 33:21.

letrat e tij dërguar sundimtarëve. Në të kundërtën, me këtë mund të gjejmë se turpi gjatë praktikimit, ose turpi nga bartja e Islamit, është një prej shkaqeve të humbjes së modelit. Fokusimi i disa kulturave bashkëkohore nuk ka tejkaluar, madje edhe disa mendimtarë të singertë në çështjet e mendimeve devijuan në të kuptuarit e Islamit.

Prej shembujve më të çuditshëm është fakti, të cilin e përmend një autor, i cili me ngulm mundohet që të rrënojë çdo gjë të qëndrueshme në Islam dhe të bëj hutimin e përhershëm, që transplantimi i organeve njerëzore, siç janë: zemra, veshkat ose retina, ende është e papranueshme, dhe se myslimanët akoma për këto duhet t’u drejtohen dijetarëve për të “marrë” nga ata fetva. Është e mjerueshme që një shkrimtar i tillë nuk di për fetvanë e dijetarit dhe mjekut Ebu Jusra ej-Abidinit (1981-1889), myftiut të dikurshëm të Sirisë, sipas së cilës është lejuar transfuzioni i gjakut dhe retinës.

Humbja e autoritetit është shumë e rrezikshme, ndërsa humbja e një pjese të tij mund të shkaktojë humbje totale, me ç’rast e tërë feja dhe të gjithë myslimanët bien në pozitë të pa lakmueshme. Për këtë arsye, çështja e sjelljes shembullore është gjë shumë e rëndësishme në kornizën e kuptimit gjithëpërfshirës, e jo fjalëpërfjalshëm, siç është rasti aktual me disa individë.

Nga pjesët përbërëse të ekzistimit të autoritetit është aktivizimi i serishëm dhe shpjegimi i pandërprerë i tij. Dobësia në këtë fushë ka dhënë rezultate tragjike, nga të cilat, si shembull, përmendim Ugandën. Uganda është shtet, banorët e të cilit janë të lidhur me Islam prej afro dy shekujsh. Përparimi i Islamit në drejtim të jugut të shtetit u ndal për shkak të autoritetit të kufizuar individual të ngarkuar me pranga medhhebike, pas së cilit u ndal përparimi i Islamit drejt jugut.

Rast i ngjashëm para këtij ishte me përparimin e Islamit në Rusi dhe në veriperëndim po për këtë shkak. (Këtë shënim e përmend Tomas Arnoldi në veprën e tij “Thirrja në Islam”). Disa myslimanë nuk kanë ditur të ballafaqohen me këtë problem. Çmimi i interesit, në rastin e përmendur, ka rrjedhur nga autoritetet që nuk kanë pasur aftësi të shohin më larg se hunda e tyre!

Rezultatet e humbjes së autoritetit brenda shtëpisë, është mjaft i qartë dhe tragjik, sepse zënkat e prindërve nuk shuhen. Në këtë rast mëdyshjet dhe shqetësimet e preokupojnë psikën e fëmijës, sepse nuk ekziston autoriteti i shëndoshë, i cili drejton dhe ndjek sjelljet e fëmijës, andaj edhe vetë prindërit, në këtë rast, nuk kanë autoritet kah i cili do të anojnë, gjë që sjell më shumë parregullsi, devijime, bërtitje dhe hidhërim.

Është e çuditshme që një

arsimim i fuqishëm i individit të mësuar dhe të kulturuar, humbet për shkak të injorancës dhe tendencave, sepse nuk ka autoritet të shëndoshë. Njoh një njeri tejet të arsimuar dhe me autoritet, gruaja e të cilit lindi vajzë, e për pasojë tendenca e tij e mungesës së edukatës doli në pah, ngase, pas këtij rasti, e braktisi nënën e mjerë nga fakti se i lindi një fëmijë femër e jo mashkull. Ekzistojnë drejtime që flasin për Kur’anin dhe Sunetin dhe domosdoshmërinë e pasimit të tyre, por nëse një gjë e caktuar është e lidhur me gra, atëherë bregu i besnikërisë së Kur’anit dhe Sunetit bëhet gjithnjë më e pakët, valët e të cilit thyhen në shkëmbinj të autoritetit të paqëndrueshëm individual, të cilët dominojnë në psikën e tij, e jo autoriteteve kulmore në krahët e të cilit duhet jetuar: **“Andaj, ti përmbaju asaj që po të shpallet, e s’ka dyshim se ti je në rrugë të drejtë.”**¹²

Gjithnjë duhet theksuar se ekzistenca e modelit të mirë, i cilitdo autoriteti qoftë, dhuron ndikimin e tij faktik të thellë dhe praktik, me të me sukses, fuqishëm, mund të notohet drejt projektit të fuqizimit të popullit dhe ripërtëritjes së rolit të tij.

Për këtë është e domosdoshme prezenca e modelit të mirë, tek i cili autoriteti paraqet shpirtin me të cilin lëviz, e jo parimet e thata filozofike, të cilat lehtë hasen në libra, ose bredhin pa mend mes rreshtave të

12. Zuhruf, 43:43.

fletëve letrare.

Është e domosdoshme të jetojmë dhe edukojmë veten dhe fëmijët tanë në prehrin e qartë, specifik, dhe të gjallë të autoritetit të drejtë, nga i cili thithim fuqinë, tek i cili anojmë dhe tek i cili thërrasim, për fuqizimin e të cilit punojmë dhe në prehrin e të cilit jetojmë e vdesim.

4. Si të sillem? (Përcaktimi i qëllimit të stadi)

Ndërtimi i vetëdijes së pjekur, në përgjithësi çfarë duhet bërë?

Kur njeriu i zgjedh vetes modelin që do të pasojë, ndodhin situata tek të cilat i duhet largpamësi në vlerësimin se a i përgjigjen modelit që ka zgjedhur për vete! Sa më mirë ta kuptojë ai modelin ose shembullin, aq më të drejta do të jenë veprimet e tij. Nëse e vështrojmë thënien e Sufjan eth-Theuriut, e cila thotë: “Dituria e vërtetë, sipas mendimit tonë, është lehtësia nga dijetari i njohur, sepse secili di të vështirësojë.”, do të shohim se ai vendos një rregull të madh të baraspeshës, të cilën imam El-Muzeniu, njëri prej pasuesve të imam Shafut, e ka qartësuar në formë praktike në fushën e shkencës, për të cilin Amr b. Osman thotë: “Nuk kam parë asnjë asket në mundin e tij, qëndrueshmërinë dhe respektin e diturisë e dijetarëve si imam Muzeniu. Ai ndaj vetes ishte më i ashpër sa i përket shkeljeve të vogla, ndërsa popullit të thjeshtë i

kërkonte rregullën më të lehtë. Ai thoshte: ‘Unë jam vetëm një pjesë e mirësisë, të cilin e ka pasur imam Shafiu.’”

Rregulli jo i përkufizuar “Çfarë duhet bërë?”, mund të ketë rezultate të rrezikshme. Ndodh që për njeriun, që shpall të vërtetën, të thuhet se është i ngutshëm, për atë që vepron me urtësi është qyqar, për atë që mundohet t’i udhëzojë njerëzit është hipokrit, ndërsa për atë që shërbehet me hipokrizi shoqërore është i gjindshëm. Në hadithin e saktë përmendet se do të vijë një periudhë, kur për njeriun do të thuhet: “*Vërtetë është i mençur...vërtetë është i bukur...vërtetë është i aftë...ndërsa në zemër nuk do të ketë asnjë thërrime të imanit*”.¹³

Në hadithin, të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi, i Dërguari i Allahut ka thënë: “*Prej shenjave të ditës së Kiametit është humbja e diturisë dhe përhapja e injorancës*”. Nga ky hadith imam Esh-Sha’biu e ka kuptuar se nuk do të ndodhë dita e Kiametit përderisa shkenca do të jetë në vend të paditurisë, ndërsa padituria në vend të shkencës, dhe ka kuptuar mënyrën e ndërtimit të vetëdijes së brendshme, e cila di se si të sillet drejt në kornizën e rrugës së drejtë, të cilën Kur’ani Fisnik na e ka sqaruar në ajetin vijues:

“E ata, të cilët luftuan për hir Tonin, Ne, me siguri do t’i orientojmë rrugës për tek Ne, e nuk ka dyshim se Allahu është në

13. Buhariu.

krahun e besimtarëve”¹⁴

Pra nënkupton se kjo, e gjitha, kërkon punë, vazhdimësi dhe mund të pandërprerë.

Gjendja më e keqe me të cilën e vërteta mund të sprovohet, janë bartësit e dobët që e duan të vërtetën, por nuk e njohin sa duhet, sikurse e urrejnë gënjeshtren, të cilën e njohin dobët. Të gjithë e dimë se njerëzit janë armiq të asaj që nuk e njohin.

Ekziston rreziku që në pasimin e rrugës së vërtetë të punohet me vite për të kuptuar vetëm disa çaste, që kjo të vidhet ose të jetojë në amulli, nga e cila zgjohet me goditje të dhembshme, gjatë së cilës humbet çdo formë e mirësisë ose e maturisë.

Sakrificat e jetës (shehadet) në fushën e mbrojtjes së të vërtetës është detyrim, edhe pse ndonjëherë, njëra prej formave të këtyre sakrificave, mund të jetë vetëm një fjalë. Kjo sakrificë ripërtërin shpresën në fitore të asaj që njerëzve u shërben dhe ngjall ndjenja shumë të mëdha, të cilat, pasuesit e së gënjeshtres, mundohen me ngulm ta zhvlerësojnë dhe shkatërrojnë, duke e njollosur me gjuhët e tyre të padenja.

Këta njerëz nuk kanë aspak vazhdimësi në të vërtetën ose në përpjekje për të arritur fitoren e saj, sepse ekzistojnë rryma, të cilat, në këtë jetë, më së tepërmi u intereson që njerëzit të merakosen për etikën e përhëndetjeve të mëngjesit, ushqimit, dhurimit të trëndafilave,

14. Ankebut, 29:69.

dhe që nga ata fshihet etika e ruajtjes së të gjitha bashkësive, duke thyer secilën fortësi të bartësve të flamurit të krimbur dhe të ndarjes, pas së cilës të gjithë do të bien në kolaps. Madje edhe format minimale etike, ndikimi i të cilave njihet fare lehtë, i është ekspozuar faktorëve të ndryshëm të shkatërrimit. Nëse është kështu, atëherë, çfarë ndodh me elementet themelore?

Pas kësaj, nuk është aspak e çuditshme që nga ana jonë nuk ka asnjë zhurmë në fushën e kundërvënies ndaj armatimit të çmendur ose organizatave tregtare botërore. Gjithashtu, nuk mund të gjejmë asnjë mysliman, i cili thërret në fushatën e protestës me qëllim ruajtjen e natyrës.

Ndjenja e bashkësisë paraqitet vetëm në raste të caktuara, të cilat ne nuk i zgjedhim, por na imponohen, edhe pse përjetimi me të tjerët është një prej shenjave të mira në shpirtin njerëzor dhe kuptimi i drejtë i interesit të përgjithshëm. Madje një njeri tha: O i Dërguari i Allahut unë kam *mëshirë ndaj deles kur e ther!* Atëherë Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nëse ke *mëshirë ndaj saj, Allahu do të ketë mëshirë ndaj teje.*”¹⁵

Edhe më e rëndë është rasti kur fëmijët tanë, të cilët nuk kemi ditur t’i edukojmë me ndenjen e xhematit, rriten me ndenjen e gabuar të xhematit, dëgjojnë britmën e imamatit nga minberi ose klithjet e folësit,

15. Ahmedi.

duke menduar se dëgjimi i hutbes së “zjarrtë”, është një formë e punës aktive të xhematit. Për këtë kërkohet që njerëzve t’u kthehen të drejtat, që të ndalen burgosjet tiranike dhe vrasjet e njerëzve të pafajshëm, që të ndalet ai grup apo individ që synon të sundojë në mënyrë despotike umetin, që të mënjanohet secili faktor që orienton drejt të gjitha formave të korrupsionit dhe mashtrimit, që të ndalet vjedhja dhe uzurpimi i pasurisë individuale e shoqërore, që të mbillet etika praktike ... të gjitha këto janë gjëra të cilat përbëjnë bërthamën e asaj që dëshiron Islami të vendosë e të mbrojë. Çdo formë tjetër e shkeljes së këtyre kufijve është të hutosh popullin dhe luajtje me fenë.

Një perëndimor, i cili e pranoi Islamin, më tha: “Ka shumë grupe të cilat kundërshtuan, protestuan dhe shumë të rinj nga vende të ndryshme erdhën që të qëndrojnë kundër konferencës së organizatës botërore dhe idesë së globalizimit të botës. Disa prej tyre iu ekspozuan rrahjes, burgosjes, ose u gjakosën, por myslimanët nuk bënë asnjë lëvizje as në lindje as në perëndim, madje as edhe me një telegram përkrahjeje! Si është e mundur që ende nuk është e qartë për myslimanët se kundërshtimi i armatimit, provat nukleare, ndërprerja e ndotjes së ambientit dhe ruajtja e natyrës, lufta kundër përhapjes së narkotikëve, etj., janë forma të farzit civilizues

(detyrë fetare) dhe bosht themelor, gjithëpërfshirës i globalitetit të Islamit.

Të gjithë besojmë se ndihma e Allahut është me xhemat dhe moskuptimi i patjetërsueshëm i bashkësisë sjellë te rezultatet më të këqija. Kjo bindje do të zhduket nëse nuk ekziston lëvizja e vazhdueshme drejt fokusimit të këtij fakti në jetën tonë. Është e pamundur që një popull të përparojë nëse individualizmi vrasës nuk “lëviz” nga gjoksi i ithtarëve të tij, siç është rasti me studimin e tij nga dëshira për mirësi për secilin nga esenca e degëve të imanit, sepse *“askush nuk beson përderisa nuk i dëshiron vëllait të tij atë që dëshiron për vetë”* dhe se *“njeriu duke ecur rrugës pa një ferrë, të cilën e largoi nga rruga, pas së cilës Allahu e lavdëroi dhe ia fali mëkatet.”* Në transmetimin tjetër të këtij hadithi përmendet se ai njeri asnjëherë nuk kishte bërë vepër të mirë! Çdo ditë na vërteton se pas mosekzistimit të edukatës, i cili fokuson xhematit, qëndrojnë pasojat më të rënda.

Matja e frymës së xhematit nuk është aq e rëndësishme në kohët e bollëkut dhe gjendjes së stabilizuar, sa është e shprehur qartë në periudhat e krizave. Fëmijët tanë duhen nxitur drejt sferave larta në fushën e kuptimit të frymës së xhematit për të arritur te kufiri i caktuar i përfshirjes së brengave të umetit me ushtrimet praktike të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe kontaktit me të

tjerët, sado që pikat që na bashkojnë janë të kufizuara.

Në botën e tregtisë për shembull, firma të mëdha që bashkohen në grupe të mëdha ekonomike, në tregun botëror, kanë gjithnjë e më shumë ndikim, prodhime dhe mundësi. Në disa shtete shpesh ndodh që kur vdes babai, i cili ka qenë pronar i një firme të madhe, fëmijët e tij e ndajnë pasurinë e tij, duke themeluar secili prej tyre nga një firmë të veçantë, çfarë paraqet paaftësinë e qartë për të gjetur një strategji të përbashkët e të gjerë, sepse fryma e ekipit të këta persona ende nuk është e fuqishme.

Gjithashtu, është e thjeshtë që në shumë xhami të shihni sa i shprehur është egoizmi gjatë renditjes në safe, veçanërisht gjatë kohës së namazit të xhumasë, sepse shumica rezervojnë për vete hapësirë për të cilën mendojnë që të kenë rehati gjatë sexhdes, ndërsa vetëm një pjesë e vogël vëzhgon pas vetes për të lëvizur përpara për t'u lëshuar vend vëllezërve të tyre, të cilët nuk kanë vend të bien në sexhde, përveç se në këpucë ose në skajet e rrugës.

Puna në ekip (xhemat) është fushë e gjerë, e cila te ne është prezentë vetëm në disa forma, por jemi në fillim të rrugës për te niveli i dëshiruar i civilizimit Islam, për çka duhet të arrijmë drejt plotësisimit të saj me përpjekje të vazhdueshme! Duhet të kemi dëshirë, e cila nuk njih lodhje, dhe parim në bazë të të cilit duhen edukuar fëmijët tanë

dhe i cili thotë: “Individi punon për bashkësinë, ndërsa bashkësia për individin, ndërsa të gjithë së bashku punojmë për Islam!”

5. Çfarë vlere ka ajo që veproj? (Qëllimi i largët)

Ndonjëherë gjërat, duke i vështruar me ngutësi, duken si të pavlefshme, pas së cilës fillon të humbasë besimi në idenë që bart dhe këtë nëpër përllogaritje të ndryshme. Thënia e Pejgamberit a.s., të cilën e transmeton imam Ahmedi, na urdhëron që: “*Nëse fillon Dita e Kiametit dhe ndonjëri prej jush ka në dorë një fidan, nëse mundet le ta mbjellë para se të vdesë.*” Këtë fidan të vockël asnjë njeri nuk do ta shohë rritjen e tij, frutat ose të shërbehet me fladin e tij. Edhe pse situata në atë moment do të jetë e rëndë, përkundër saj, vepra e mirë ka vlerën e saj të madhe në Islam, arsye për të cilën duhen bërë punë të mira pa marrë parasysh rrethanat ekzistuese. Kur një njeri i thjeshtë u mundua që t'i thotë imam Ahmedit që të shmanget nga qëndrimet e tij, ai u përgjigj: “Nëse ti mendon kështu, atëherë mund të pushosh!”

E vërteta duhet të lartësohet dhe të përmendet, pa marrë parasysh rezultatin, ndërsa gënjeshtra duhet të ndalet dhe të zbulohet, sado që të kushtojë. Pas kësaj, arrijmë te peshimi i urtësisë dhe zgjedhja e demit më të vogël, nga aspekti fetar e jo demit i

bazuar në interesat personale, sepse vëmendja nuk duhet të përqendrohet në çështjet, të cilat, personat përplot lakmi, i mendojnë të dëmshme dhe të kobshme.

Interesat materiale te njerëzit e thjeshtë përfshijnë pjesën më të madhe të jetës së tyre, për shkak se shumica prej tyre ngurrojnë të veprojnë drejt, madje edhe atëherë kur kanë mundësi. Kur'ani Fisnik na urdhëron që të vazhdojmë në bërjen e veprave të mira deri në fund të jetës: **“Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë ty e vërteta (vdekja).”**¹⁶

Hadithin, të cilin e transmeton Hudhejfe r.a., shpjegon detyrimin e bartjes së të vërtetës në të gjitha rrethanat, sepse sahabët e tjerë e pyetën Pejgamberin a.s. për të mirën, ndërsa Hudhejfe e pyeti për të keqen, duke u frikësuar që të mos e përfshijë. Hudhejfe e pyeti: “O i Dërguari i Allahut, ne kemi qenë në injorancë (xhahilijet) dhe në të keqe, por Allahu na dhuroi këtë mirësi, por pas kësaj mirësie a do të ketë përkeqësim?” Resullahu tha: “Po!”. Unë i thashë: “Por a thua pas kësaj të keqe a do të ketë përsëri mirësi?” Ai a.s. tha: “Po, dhe në këtë do të ketë ndryshime.” I thashë: “Çfarë janë këto ndryshime?” Tha: “Janë njerëz që do të udhëzojnë në atë që unë nuk kam udhëzuar dhe do t'i njohësh dhe do t'u kundërvihesh.” I thashë: “Po, pas kësaj mirësie a do të ketë përkeqësim?” Ai a.s. tha: “Po. Njerëz që do të thërrasin për në dyert e 16. Hixhr, 15:99.

Xhebenemit dhe kush u përgjigjet do ta bedhin në të.” I thashë: “O i Dërguari i Allahut, na përshkruajë këta njerëz.” Tha: “Ata janë nga populli jonë dhe flasin gjubën tonë.” I thashë: “Por çfarë më urdhëron që të bëj nëse ndodh kjo?” Tha: “Mbahu xhematit mysliman dhe imamit të tyre.” E pyeta: “Nëse nuk do të kenë as imam as xhemat?” Tha: “Atëherë ndabu nga të gjitha grupet qoftë edhe nën rrënjën e druve, derisa të të vijë vdekja, e ti je në atë gjendje.”¹⁷

Islami, ithtarët e tij të sinqertë, i ka përgatitur që të paraqiten realisht ndaj rrethanave: **“A menduan njerëzit të thonë: ‘Ne kemi besuar, e të mos vihen në provë?’”**¹⁸

Islami ua dha dimensionet thelbësore:

*“Dëgjoni dhe binduni, qoftë edhe nëse ju udhëbeq robi abisinas me pamje të çuditshme.”*¹⁹

Ai, në të gjitha rrethanat jep shembull praktik, të cilin secili mund ta kuptojë:

*“Pejgamberi a.s. ka marrë abdes me një grusht ujë (mudda), ndërsa është larë me sa'a (katër mudda).”*²⁰

E gjithë kjo është e lidhur me qëllimin më të lartë e kjo është arritja e premtimit të Allahut dhe kënaqësisë. Ky është shkak që besimtari vazhdimisht ndan e ofron dhe se bashkësia islame jeton nën ombrellën e ndihmës së ndërsjellë

17. Buhariu.

18. Ankebut, 29:2.

19. Buhariu.

20. Buhariu.

edhe pse i rrethojnë shumë faktorë të dobësisë dhe prapambetjes, ndërsa bashkësitë e tjera ndajnë vetëm kur kanë tepriçë. Kjo është për shkak se besimtari sa do që të ndajë (japë), ai ka një llogari rrjedhëse nga e cila tërheq pasuri e kjo është llogaria e ahiretit! Sikurse se dr. Bekkar ka dëshirë të theksojë, në njërën prej veprave të tij, se për çdo harxhim është e nevojshme llogaria rrjedhëse në të cilën mbështetet dhe sa më e madhe të jetë ajo, aq më e madhe është mundësia e harxhimit.

Për shkak të qëllimeve të larta, duhet të ekzistojnë gjëra të cilat duhet të jenë në çdo grimcë të trupit tonë. Marrim, për shembull, dashurinë për bukurinë e jetës. Është e qartë se shumica e çregullimeve ndodhin te personat që nuk kanë dhuratën e ndjenjës për bukurinë. Bukuria nuk është vetëm bukuria e fytyrës, por kulmi i harmonisë, përputhshmërisë, baraspeshës, shkëlqimit, sakrificës dhe shpirtit të lindur, i cili përparon e paraqet çdo kënd të kësaj jete të bukur me nivel të lartë të përsosmërisë. Ndjenja për bukurinë te disa myslimanë është e pavërejtur, çka është jo e drejtë, sepse besimi është kulmi i bukurisë, ndërsa kufri (mosbesimi) është kulmi i së keqes. Për këtë arsye, përshpejtimi i ndjenjës për bukurinë është diçka themelore, sepse “sado që njerëzit flasin për esencën e bukurisë”, - siç e thekson këtë Abdulkerim Bekkar, - “ajo mbetet njëra prej peshoreve

më të rëndësishme të civilizimit.” Shfrytëzimi i komponentit të bukurisë, në ndërtimin e besimit, është gati i pavërejtur, përveçse në rastet e caktuara, me gjithë rëndësinë e saj gjithëpërfshirëse.

Arti amorale nuk mund të mënjanohet me britma nga minberët e drurit, por me anën e artit të pastër, i cili ngjall lindjen, e cila me kundërsulm mënjanon amoralitetin nga arti. Populli të cilin e udhëheqin tiranët, e ka humbur dhuntinë e bukurisë, pas së cilës prapambetja dhe primitivizmi mbetet virtyti i çdo gjëje që ekziston.

Mirëpo, përkundër këtyre tiranëve ekziston e tërë ushtria e ideve të bukura, të cilat kurdo që sulmohen, bëhet gjithnjë e më e qartë se tiranët me vete bartin mendime amorale dhe ide me të cilat dëshirojnë të prishin tërë popullin e mirë, dhe pikërisht për këtë arsye, tiranët asnjëherë nuk do të kenë sukses në qëllimet e tyre, sado që të zgjasë pushteti i tyre.

Shembulli i gjallë më i mirë i thënies së Pejgamberit a.s.: “Allahu është i bukur dhe e do të bukurën.”, të cilin e kemi të prekshëm e të qartë, është biografia e Muhamedit a.s. dhe ligji i Zotit, të cilin e zgjodhi për rob të Tij.

Gjatë dhjetë viteve, të cilat Enes b. Maliku r.a. i kaloi duke i shërbyer Pejgamberit a.s., nuk dëgjoji asnjë fjalë pakënaqësie, dhe për këtë shkak mirësia e Pejgamberit a.s. e robëroi.

Kur ndodhi eklipsi i Diellit, populli e pa bukurinë e monoteizmit, kur Pejgamberi a.s. i mësoi se Dielli dhe Hëna janë dy shenja të Zotit, të cilat nuk errësohen për shkak të lindjes apo vdekjes së dikujt.

Kur erdhi robëresha nga periferia e Medinës dhe e luti Pejgamberin a.s. për një shërbim, atëherë populli e pa bukurinë e modestisë së tij.

Kur qau një fëmijë, e ëma e të cilit falej me xhemat pas Pejgamberit a.s., ai e përshpejtoi namazin, pas së cilit e mësoi bashkësinë me bukurinë e mëshirës ndaj popullit, mes të cilëve kishte pleq dhe të pafuqishëm.

Kur erdhi një i ri, i cili kërkoi t'i lejohej imoraliteti, Pejgamberi a.s. e dëgjoi, pastaj i vendosi dorën në gjoksin e tij, pas së cilës iu largua e keqja nga zemra e tij, duke treguar në këtë mënyrë bukurinë e edukatës.

Kështu pasqyrohen shenjat e bukurisë së edukatës, pas së cilës burojnë forma të mira, të ndryshme dhe të panumërta, në mënyrë që të zgjohet e tërë bota për të parë kurorëzimin e bukurisë së civilizimit profetik.

Tregohet se imam Ibn Tejmijje ka thënë: “Në dynja ka xhenet dhe kush nuk hyn në këtë, nuk do të hyjë as në Xhenetin e ahiretit.” dhe besoj se më këtë ka treguar se pirja e bukurisë së imanit dhe ndjenja e ëmbëlsisë së saj në dynja, është e vetmja rrugë drejt lumturisë së pakufizuar, atje ku janë kënaqësitë e përhershme.

Mendoj se nuk ekziston

gabim më të madh se prishja e natyrshmërisë së fëmijëve tanë me atë që i gjymtojmë dhe i vendosim në një këllëf të caktuar, varësisht prej botëkuptimeve tona dhe bëjmë atë që ne dëshirojmë e jo atë që Krijuesi ynë dëshiron. Me këtë ne e shkatërrojmë lidhjen me fëmijët tanë me bukurinë madhështore dhe tek ata vrasim përgatitjen e madhe të lindur të tyre, që të harmonizohen me krijesat e stërbukura, të cilat pa fund i rrethojnë.

Të dorëzohemi në kaptinën e Kur'anit Fisnik Nahl-Bletët dhe të përjetojmë pak kuptimet e saj për të arritur të shohim sa i madh është perimetri i besimit në të cilin do ta gjejmë veten. Por, për të ndodhur kjo duhet të dëgjojmë atë përreth nesh, ku mund të dëgjojmë zërat e shumtë:

“Nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bën tesbih) duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre...”²¹

Nuk mund të njohim fshehtësitë e botës mahnitëse nëse nuk dëgjojmë thellësisht tonet e saj, e këto nuk mund t'i dëgjojmë nëse nuk mësojmë të dëgjojmë, ndërsa dëgjimi mësohet ashtu siç mësohet të folurit.

Vendosja e miqësisë me natyrën, të cilën e krijoi Allahu, është çelësi i gjërave sa i përket baraspeshës njerëzore dhe zgjerimit të horizonteve të tij. Ashtu si rasti i

21. Isra', 17:44.

njeriut që mëson një gjuhë të huaj i hapen dyert e gjëra të diturisë, është edhe rasti me kuptimin e gjuhës së të folurit të botës së heshtur përreth nesh. Për aq kohë sa jemi të preokupuar me veten tonë, nuk do të lejojmë shpirtrat tanë të notojnë në detin e monoteizmit dhe thirrjes së Zotit dhe nga respekti i thellë e nga nderimi i përulemi Krijuesit të Lartësuar.

Në esencë, natyrshmëria e lindur njerëzore refuzon mosbesimin dhe humbjen dhe ky rregull është vështirë të prishet, arsye për të cilën duhet vazhdimisht të kemi kujdes që të qëndrojmë në krahët e besimit të vërtetë.

Këtë natyrshmëri njerëzore të lindur e ngufatin filozofitë e humbura njerëzore, madje edhe edukata nuk u ka shpëtuar nga njollat e humbura, sepse edukata është zhdukur në shumë fusha. Atë e kanë vrarë begatitë e dynjasë dhe fshehtësitë e shkretëtirës, të cilën fëmijët tanë nuk e kanë shijuar, sepse shumica prej nesh nuk e ka shijuar. Ajo tokë nga e cila jemi krijuar, nuk e pluhuros më ballin e shumicës së njerëzve gjatë të folurit, sepse disa balle janë mësuar të falen në diçka më të butë se mëndafshi. Nuk na magjeps më ulja e heshtur mes drurëve, të cilët e lartësojnë Zotin. Automjetet, të cilat ne nuk i prodhojmë dhe ndërtesat e rrokaqiejt na kanë robëruar. Nuk ka më zë bilbili, lëvizje milingonash, zhurmë të erërave, frymë të agimit,

pozita e yjeve të gjerë, kufijtë e të cilëve nuk janë të njohur për ne, zhurma e valëve të detit, kaltërsia e qiellit, ushtrimit dhe sixhadetë e gjelbra... Shumica e këtyre gjërave nuk janë më të dashura për ne, miqësore e shoqërore. Së pari kjo jetë e kësaj bote na vodhi e më pas na rrethuan epshtet e pasurisë së dynjasë.

Kemi humbur ëmbëlsinë e dëshirës për të bërë sexhde në mbulesën e gjelbër, andaj na ndodhi shumica e përtacisë dhe dobësisë. Për këtë zemrat dhe shqisat tona hetojnë, madje edhe diçka më pak nga universi i gjerë, në të cilin ne paraqesim një prej pjesëve më të imëta. Nëse bota e dukshme, me gjithë bukurinë dhe paraqitjen e saj, ka mbetur e fshehur dhe e paparë nga ne, atëherë nuk ka dyshim se besimi në të padukshmen është edhe më i dobët e më i fshehur.

Nga shenjat e bukurisë në jetë është njohja e ndërsjellë. Duhet të dimë a është themel i marrëdhënieve njerëzore armiqësia ose njohja dhe komunikimi i bukur? Unë jam tërësisht i bindur se themeli i marrëdhënieve njerëzore është njohja e ndërsjellë dhe ndërtimi i urave të ndërsjella:

“O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni në mes vete...”²²

22. Huxhurat, 49:13.

Ideja e vetë mbylljes, largimit dhe vetë përkushtimit nuk është zgjidhje e drejtë. Duhet të dimë se besimi jonë në drejtësinë e përgjithshme, të asaj që pasojmë, nuk do të thotë se hapat tanë, që përshpejtojnë drejt realizimit të tyre, gjithashtu janë të drejtë!

Në këtë mënyrë mund të llogaritim bindjen tonë në madhësinë e Islamit në fushën e ndërtimit të familjes dhe marrëdhënieve mes burrit dhe gruas, që përbëjnë themelin e jetës njerëzore.

Ejani të bëhemi të hapur dhe të themi se këto marrëdhënie mes tyre i turbulluan mjaft kuptimet e gabuara në shumë fusha jetësore. Shumica, që në gruan shohin robëreshën për të shërbyer, ose kukullën për të luajtur e argëtuar, e kanë nënvlerësuar krenarinë e gruas. Nga anekdotat në historinë islame është rasti i vajzës të cilën i ati e martoi pa pëlqimin e saj. Ajo erdhi te Pejgamberi a.s. dhe e informoi se çfarë i ndodhi, duke shtuar: “Babai im më martoi me djalin e xhaxhait tim për ta ngritur nderin e tij! Pas kësaj Pejgamberi a.s. e thirri babain e saj dhe i dha të drejtë vajzës, për çfarë ajo u përgjigj: “O i *Dërguari* i Allahut! Unë e pranoj veprimin e babait, por dëshiroja që t’u tregoj grave tjera se ato kanë të drejtë zgjidhjeje.”²³

Kjo grua ka treguar se, ideja e tutorimit, është gjithnjë e më e fuqishme në të gjitha fushat e

papranueshme dhe se askush nuk ka të drejtë të udhëheqë me të tjerët, përveçse me lejen fetare dhe brenda kornizës fetare.

Mjerisht, gjithnjë e më shumë, në mesin e myslimanëve, është e pranishme ideja e kuptimit tutorik, ndërsa ideja e kuptimit të afërsisë është gjithnjë e më shumë e braktisur, ndërsa ndryshimi është i madh mes këtyre dy kuptimeve në nivelin familjar ose shtetëror. Kur Omeri r.a. tha:

- “O njerëz! Dëgjoni dhe binduni!”, Selmani r.a. u ngrit dhe i tha:

- “O Omer, ti nuk meriton të të dëgjojmë dhe as të të bindemi!”

- “E përse o Selman?”, - bërtiti Omeri.

- “Për arsye se kur erdhën pelerinat nga Jemeni të gjithëve u ke dhënë nga një, por meqë je i gjatë e shoh se ti ke veshur dy pelerina?, - tha Selmani.

Omeri r.a. bërtiti:

- “O Abdullah!”, por nuk u përgjigj askush. Pastaj përsëri bërtiti: “O Abdullah i biri i Omerit!”, pas së cilës u ngrit i biri i tij dhe tha:

- “Të përgjigjem o Kalif i besimdrejtëve!”

Omeri iu drejtua:

- “Kjo pelerinë e dytë që e mbaj, kujt i përket?”

- “Është e imja dhe unë ta dhurova ty”, - u përgjigj Abdullahu.

Pas kësaj Selmani tha:

- “Tani mund të urdhërosh, e ne do të dëgjojmë dhe bindemi!”.

23. Transmeton Ebu Davudi dhe Ibn Maxheh.

Dimensioni më i shprehur i kësaj ndodhie është se Selmani nuk kërkoi falje nga Omeri, pasi e pa se nuk kishte të drejtë, sepse Umeti ka të drejtë të pyesë, por nuk duhet kërkuar falje për të drejtën që i është dhënë njeriut.

Nga format më të rrezikshme të prapambetjes së tërë njerëzimit, është mosnjohja e begatave që Allahu iu ka dhënë, pas së cilave kërkojnë të drejtat e tyre prej tiranëve dhe individët i japin njëri-tjetrit një formë të hyjnizimi, e cila i takon vetëm Allahut.

Nga gjërat që e shkatërrojnë jetën dhe njohjen reciproke, për të cilën jemi krijuar, është ideja e tutorit, të cilën Islami nuk e ka pranuar dhe nuk e ka imponuar. Duhet me këmbëngulje të përforcojmë botëkuptimet fetare, të cilat janë ende larg nga mjediset tona edukative.

Me shkencë të mirëfilltë arrijmë vetëplotësimin e patjetërsueshëm dhe dobësinë e pabarazisë së ndërsjellë. Shpirtrat tanë gjurmojnë për përkujdesje e jo për tutorizëm, për nder e jo për despotizëm, sepse Kur'ani Fisnik thotë:

“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë) e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”²⁴

24. Nahl, 16:97.

Përfundim

Vazhdimësia në të vërtetën dhe gjurmimi i saj janë të domosdoshme për baraspeshën dhe stabilitetin njerëzor. Në të kundërtën, lumturia nuk mund të arrihet pa arritjen e kënaqësisë së Allahut xh.sh. në rrugën e arritjes së jetës së bukur në dynja dhe ahiret.

Tezat për të cilat folëm, janë të domosdoshme për shkak të edukimit të shëndoshë të shpirtit njerëzor. Ne duhet të dimë identitetin tonë, bindjen dhe përkatësinë, duhet të njohim modelet dhe autoritetet tona dhe hapat tanë të parë dhe qëllimet e largëta.

Secila nga këto pika ka vlerat dhe shpjegimet dhe para se t’i mbjellim te fëmijët tanë duhet të kthehemi në fillim të fëmijërisë sonë për të zbuluar anët tona negative, sepse në fëmijërinë e hershme fshihen shkaqet e shumë të metave dhe sëmundjeve psikike.

Bota e ëmbël dhe e virgjër fëmijërore është e rrethuar me dredhi nga të cilat nuk mund të shpëtojmë nëse nuk dimë të notojmë me mjeshtri.

Nuk mund ta përmirësojmë askënd, madje as edhe fëmijët tanë që i duam, nëse nuk arrijmë t’i kuptojmë të metat në veten tonë, nëse nuk kuptojmë metodën dhe së bashku nuk bashkëpunojmë në mirësi, sepse ai që nuk zotëron diçka nuk mund t’ia ofrojë atë tjetrit.

“Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj (me të ardhur të peygamberëve) dhe lutni Atë duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën). S’ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë atyre të mirëve.”²⁵

Çdo gjë që kemi përmendur është vetëm një përshkrim sipërfaqësor, i cili mund të lexohet për disa minuta, por nga ne kërkohet më shumë kohë për ta bërë veprues në jetën praktike. Nëse ende nuk jemi të bindur në

25. Araf, 7:56.

domosdoshmërinë e tërë kësaj, atëherë duhet përsëri ta lexojmë disa herë.

“Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit.”²⁶

Në fund, falënderimi qoftë për Allahun, Zotin e botëve.

Përktheu dhe përshtati nga boshnjakishtja:

Prim. Dr. Sc. med. Ali F. Iljazi

26. Furkan, 25:74.

Çështjet sociale të gjendura në, ajetet e Kur'anit Fisnik

Prof. Dr. Sadije Bushati

Hyrje

Dijetarët myslimanë shpeshherë e vlerësojnë Kur'anin Madhështor, për parimet themelore me anë të të cilave rregullohet jeta e njeriut, sepse ai rregullon të gjithë shoqërinë, madje në të gjitha kohërat.

Kur'ani Madhështor përbëhet nga 114 sure, të cilat kanë një numër të caktuar ajetesh. Numri i këtyre të fundit varion nga 3 deri në 286 ajete. Aty trajtohen jo vetëm çështjet sociale, por edhe ato juridike,

shkencore, me një fjalë, është rregullues i të gjitha problemeve të një shoqërie, natyrisht nëse njihen e zbatohen rregullat e tij dhe me bindje të plotë. “Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është mëse e vërtetë...”¹

“Kur'ani është burimi i gjithë dijeve në Islam, qofshin ato dije fetare, shpirtërore, shoqërore, shkencore, morale, ligjore apo filozofike; është udhëzues drejt të gjitha të vërtetave”²

1. Isra', 17:9.

2. “Islami”, Komuniteti Mysliman i

Nëse do të shqyrtojmë vetëm çështjet sociale që trajtohen aty, një grupim i mundshëm tregohet më **poshtë**, megjithëse ato çështje shpesh ndërthuren me njëra-tjetrën:

1. **Të drejtat e gruas dhe barazia gjinore;**
2. **Të drejtat ndaj bashkëshortëve dhe divorci;**
3. **E drejta e trashëgimisë;**
4. **Të drejtat e detyrimit ndaj jetimit;**
5. **Vlerat morale: a) ndihma ndaj prindërve, të vobektëve, udhëtarëve, borxhlinjve, b) gjykimi i drejtë dhe të qenët dëshmitar i drejtë, c) të bëhet matje apo peshim i saktë, d) pendimi, e) falja, g) Durimi, f) jo mendjemadhësia, h) jo imoralitet, i) sjellja e mirë.**
6. **Të tjera**

Këshillat, sugjerimet e urdhërimet, të lidhura me çështjet e mësipërme, janë përsëritur disa herë në disa sure. Shpesh ndodh që, në përsëritje, bëhet plotësim i asaj që është thënë më parë; ka edhe raste që brenda së njëjtës sure, përsëritet vetëm një ajet shumë herë. Të gjitha përsëritjet shpjegohen me qëllim që, ato që thuhet, t'u fiksohen mirë besimtarëve dhe të gjithë lexuesve.

Më poshtë po tregojmë numrin e sures dhe numrin e , ajetit, apo ajeteve përkatëse, ku trajtohen çështjet e mësipërme. , ajetin ose një pjesë të tij, kur ai është i gjatë dhe

Shqipërisë, 2019 faqja në internet.

trajton më shumë se atë problem, do ta shkruajmë në italic, brenda thonjëzave; ndonjëherë do të bëjmë një përmbledhje të asaj që shpreh , ajeti ose , ajetet, që i takojnë çështjes. Shpeshherë janë përdorur kllapat rrumbullake, të përdorura nga vetë përkthyesi për sqarim dhe ndonjëherë të rrallë, i kemi përdorur edhe ne, për të njëjtin qëllim.

Ky material, që po paraqesim, shpresoj se do të lehtësojë profesionistët psikologë apo sociologë, që dëshirojnë të thellohen në ndonjë nga çështjet e mësipërme të trajtuara në Kur'an, duke pasur suret dhe , ajetet përkatëse në këtë punim.

1: Të drejtat e gruas dhe barazia gjinore

Surja 16, ajeti 97: *“Cilindo, mashkull apo femer, që kryen vepra të mira, ... do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira që ka bërë”.*

Surja 24, ajetet 4-23 përmbajnë ndëshkimet që duhen marrë ndaj shpifësve për moral të keq dhe kritikohet një rast konkret shpifjeje.

Surja 24, ajeti 26: *“Gratë e pandershme janë për burrat e pandershëm dhe burrat e pandershëm janë për gratë e pandershme. Gratë e ndershme janë për burrat e ndershëm dhe burrat e ndershëm janë për gratë e ndershme...”*

Surja 24, ajeti 32: *“I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat...”*

Surja 33, ajeti 35: *“Me të vërtetë që*

për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të singertët) dhe të drejtat (të singertat), duruesit dhe durueset, të përulurit dhe të përulurat, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.”

Surja 33, ajeti 37 në të thuhet se një gruaja të ndarë nga burri, i cili kishte qenë i adoptuar, i lejohet të martohet me personin që e kishte adoptuar ish-burrin.

2: Të drejtat ndaj bashkëshortëve dhe divorci

Surja 2, ajeti 221. U jepen disa këshilla bashkëshortëve, të mos martohen me paganë, burri besimtar të mos marrë pagane dhe gruaja besimtare të mos martohet me pagan.

Surja 2, ajeti 222 Këshillohet burri të presë në kryerjen e marrëdhënieve intime, derisa gruaja të pastrohet nga të përmuajshmet.

Surja 2, ajetet 226, 227, 228, 229, 230, 231, 232, disa rregulla për burrat dhe gratë për divorcin, ribashkimin, plotësimi i kohës së pritjes...

Surja 2, ajeti 233: *“Nënat le t’u japin gjë fëmijëve të tyre dy vjet, për ata që duan ... Babai i fëmijes ka për detyrë, sipas mundësisë së tij, që t’i sigurojë si duhet*

ushqim dhe veshmbathje. Nuk ngarkohet askush përtej mundësisë që ka: nëna le të mos dëmtohet për shkak të fëmijës së saj e as babai të mos dëmtohet për shkak të tij ... Por, nëse pas këshillimit, ata vendosin me pëlqim të ndërsjellë që ta ndajnë fëmijën nga gjiri, kjo nuk është gynah për ata. Po ashtu, nuk është gynah për ju nëse doni t’i gjeni fëmijës suaj një mendeshë, ... sipas rregullave”

Surja 2, ajetet 234, 235, 236, 237, 240, 241. Në këto ajete tregohet si duhet vepruar në disa situata të tjera, për shembull kur vdes burri, gruaja duhet të presë 4 muaj e 10 ditë pas vdekjes së tij, më pas ajo mund të martohet; rasti kur burrit i afrohet vdekja, duhet t’i lërë në testament gruas mjetet e jetesës për një vit; raste të tjera ndarjeje të çiftit dhe sigurimi i caktuar i shpenzimeve të jetesës së gruas së ndarë.

Surja 4, ajetet 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25. Këtu trajtohet sjellja e burrit ndaj gruas së tij dhe ndalesa e martesës së tij me disa kategori femrash.

Surja 4 , ajetet 34, 35. Këtu tregohet si duhet ta trajtojë burri gruan e pabindur dhe nëse çifti do paqe, nga të dy, burri dhe gruaja, atëherë duhet të caktohet një ndërmjetës.

Surja 4, ajetet 127, 128, 129, 130. Në këto ajete kërkohet që burri duhet t’i japë dhuratën e martesës gruas jetime dhe më pas flitet për sjelljen e burrit ndaj grave; ai nuk duhet të anojë vetëm nga njëra. Nëse

ndahen, secili bëhet i pavarur.

Surja 33, ajeti 49: *“O besimtarë! Kur martoheni me besimtare të tjerë dhe i ndani ato para se t’i prekeni, ato nuk janë të detyruara t’ju presin në afatin kohor të caktuar, por jepuni një dhuratë të kënaqshme dhe i ndani njerëzishëm.”*

Surja 33, ajeti 58: *“Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtare, duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë, në të vërtetë, i kanë ngarkuar vetes fajin për shpifje dhe një gjynah të qartë.”*

Surja 58, ajetet 2, 3, 4: *“Ata midis jush, që i ndajnë gratë e veta, duke u thënë se iu duken si nënat e veta, duhet ta dinë se ato nuk janë nënat e tyre. Nënat e tyre janë vetëm ato që i kanë lindur ata. Fjalët që ata thanë, janë të pabijshme dhe të pavërteta. Megjithatë, Allahu është Falës dhe Shlyes i gabimeve.”*

“Ata që i ndajnë gratë e veta në këtë mënyrë e pastaj duan ta kthejnë mbrapsht atë që thanë, duhet të lirojnë një skllav (apo skllave), para se të preken përsëri. Kështu ju urdhërohet...”

“Ai që nuk gjen (ndonjë skllav për të liruar), duhet që të agjërojë dy muaj rresht, para se të preken si bashkëshortë. E, nëse nuk mund ta mbajë agjërimin, atëherë duhet të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër...”

Surja 60, ajetet 10, 11, 12: *“O besimtarë, kur ju vijnë besimtare të mërguara, provoni (besimin) tek ato. Nëse ato janë besimtare, mos i ktheni të jobesimtarët. Ato nuk janë (bashkëshorte) të ligjshme për ata dhe as ata nuk janë (bashkëshortë) të ligjshëm për ato. Kthejuni jobesimtarëve pajën, që u kishin dhënë atyre. Nuk ka pengesë që t’i merrni ato*

për bashkëshorte, pasi t’u jepni pajën e martesës. Mos qëndroni në martesë me idhujtare. Kërkonin atë që keni dhënë (si pajë), por dhe jobesimtarët le të kërkojnë atë që kanë dhënë...”

“Nëse ndonjëra prej grave tuaja kthehet të jobesimtarët e më pas ju fitoni plaçkë lufte prej tyre, atëherë jepuni atyre (besimtarëve që u kanë ikur gratë) shpenzimet e martesës...”

“O Profet, nëse vijnë tek ty besimtare të betohen se nuk do t’i shoqërojnë Allahut asgjë (në adhurim), nuk do të vjedhin, nuk do të kurvërojnë, nuk do t’i vrasin fëmijët e tyre, nuk do të sjellin ndonjë shpifje të sajuar nga ato vetë dhe se nuk do të të kundërshtojnë në çfarë është e drejtë dhe e arsyeshme, atëherë ti pranoje betimin e tyre dhe lutju Allahut t’i falë. Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”

Surja 65, ajetet 1-7 tregojnë rastet kur dikush do të ndajë gruan, e ka detyrim të mos e dëbojë atë nga shtëpia, ta lërë të presë kohën e duhur. Nëse gruaja është shtatzënë, duhet të shpenzojë për të deri sa të lindë. Pastaj të kujdeset për ushqimin e foshnjës dhe natyrisht pasaniku apo i varfëri, do të shpenzojë sipas mundësisë së vet.

3: E drejta e trashëgimisë

Surja 4, ajetet 11, 12: *“Allahu ju urdhëron për trashëgiminë tuaj...”* (tregohen disa raste).

Surja 4, ajeti 176. Këtu tregohet si duhet ndarë trashëgimia në disa raste të tjera.

Surja 4, ajeti 33: *“Gjithkujt i kemi caktuar trashëgimtarët për çdo gjë që lënë prindërit ose të afërmit, ndërsa atyre me të cilët keni bërë marrëveshje, jepuni pjesën e vet...”*

4: Të drejtat e detyrimet ndaj jetimit

Surja 2, ajeti 220: *“...T’u bëni mirë jetimëve është vepër e bukur. Nëse jetoni bashkë me ta, dini se janë vëllezërit tuaj...”*

Surja 4, ajeti 2: *“Jepuni pasurinë jetimëve, mos ua ndërroni sendet e tyre të mira me tuajat të këqija. Mos e barxhoni pasurinë e tyre duke e përzier me pasurinë tuaj. Se kjo, me të vërtetë, është gynah i madh.”*

Surja 4, ajeti 3: *“Nëse keni frikë se nuk bëni drejtësi ndaj jetimëve...”*

Surja 4, ajeti 6: *“Vërinë në provë jetimët, derisa të bëhen për martesë...”*

Surja 4, ajeti 10: *“Vërtet, ata që shpenzojnë pasurinë e jetimit pa të drejtë, vetëm mbushin barkun e tyre me zjarr dhe ata do të digjen në zjarrin flakëruës.”*

Surja 4, ajeti 127: *“...të silleni drejt me jetimët...”*

Surja 6, ajeti 152: *“...mos iu qasni pasurisë së jetimit, por vetëm për ta rregulluar derisa të arrijë pjekurinë...”*

Surja 17, ajeti 34: *“Mos iu qasni pasurisë së jetimit, veçse me qëllim të mirë, derisa të arrijë moshën e pjekurisë...”*

Surja 33, ajetet 4, 5 flasin për birësimin. Nëse dihet mbiemri i të atit, të thërritet me atë, përndryshe, i konsideroni si të mitur nën tutelën tuaj.

5: Vlerat morale

a) Ndihma ndaj prindërve, të vobektëve, udhëtarëve, borxhlinjve.

Surja 2, ajeti 177: *“...mirësia është e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, hypësit dhe për lirim të robëruarve...”*

Surja 2, ajetet 261-267: *“...Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke fyer apo duke ua kujtuar...Mos dburoni gjëra të pavlerëshme, të cilat ju nuk do t’i pranoni...”*

Surja 2, ajetet 270-274: *“...Ti jepni lëmoshat haptazi është gjë e mirë, por t’ua jepni ato fsheburazi është edhe më mirë...Ata që japin nga pasuria e tyre natën dhe ditën, fsheburazi dhe haptas, do të shpërblehen...”*

Surja 2, ajeti 280: *“Nëse e dini që borxhliu është ngushtë, shtyjani afatin derisa ta përmirësojë gjëndjen. Por është më mirë për ju sikur t’ia falnit borxhin, vec sikur ta dinit.”*

Surja 2, ajeti 282: *“O besimtarë! Shkruani huanë që ia jepni njëri-tjetrit për një afat të caktuar. Mos e lini pa e shënuar borxhin, qoftë i vogël apo i madh, duke shënuar edhe afatin e pagimit. Në qoftë se është fjala për mallin që qarkullon nga dora në dorë, atëherë mund të mos e shënoni, por thirrni dëshmitarë. Thirrni dëshmitarë edhe kur të lidhni kontrata për shitblerje dhe të mos dëmtohet as shkruesi, as dëshmitari...”*

Surja 2, ajeti 283: *“Nëse jeni në udhëtim e nuk gjeni shkrues, atëherë*

merrni peng...Mos e fsihni dëshminë...”

Surja 4, ajetet 37, 38, 39, 40:
“(Ai nuk i do) as ata që janë koprracë ... e as ata që ndajnë nga pasuria e tyre sa për sy e faqe të botës...; Allahu nuk dëmton askënd asnjë grimë, por, nëse (dikush) bën mirësi, Allahu ia shumëfishon atë dhe i jep shpërblim të madh.”

Surja 17, ajetet 26, 27, 28, 29:
“Jepuni të afërmeve, të varfërit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepruar”

“...por nëse nuk ke asgjë për të dhënë, ... atëherë thuaju atyre ndonjë fjalë të butë”

“...Mos e shtrengo dorën as mos u bëj dorëshpuar...”

Surja 30, ajeti 39. Pohohet se ata që dhurojnë me qëllim që të rrisin pasurinë e vet, nuk do të shpërblehen, ndërsa ata që japin bamirësi, për kënaqësi të Allahut, ata do të shpërblehen.

Surja 42, ajeti 38: *“...për ata që ndajnë lëmoshë prej asaj që i kemi dhënë Ne...”*

Surja 64, ajeti 16: *“...shpenzoni për bamirësi në të mirën tuaj. Ata që e ruajnë veten nga lakmia e saj, pikërisht ata janë të fituarit.”*

Surja 64, ajetet 17: *“Nëse i jepni Allahut një hua të bukur, Ai jua kthen shumëfish atë dhe ju fal...”*

Surja 70, ajetet 22-25: *“...ata që falen, që kanë caktuar pjesën e pasurisë për hypësin e nevojtarin, që frikësohen nga dënimi Zotit të tyre, ...këta do të shpërblehen e do të jenë banorë të Xhenetit.”*

Surja 76, ajetet 5-9. Këtu pohohet se besimtarë e ndershëm që

ushqejnë të varfërit, jetimët, të zënë rob, edhe pse vetë janë nevojtarë, por që nuk duan shpërblim e falënderim prej tyre, që zbatojnë premtimet dhe i frikësohen Allahut, këta do të jenë banorë të Xhenetit.

b) Të gjykosh drejt dhe të jesh dëshmitar i drejtë

Surja 4, ajeti 58: *“Allahu ju urdhëron që amanetet t’jua ktheni atyre që u përkasin dhe kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni drejt...”*

Surja 4, ajetet 92, 93 flasin për vrasjen, faljen ose pagesën e gjakut.

Surja 4, ajeti 135 bën thirrje për të dëshmuar të vërtetën edhe në qoftë se ajo i bie ndesh vetes, prindërve apo të afërmeve.

Surja 5, ajeti 8: *“...bëhuni dëshmues me drejtësi. Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë...”*

Surja 17, ajeti 26: *“...jepuni të afërmeve, të varfërit dhe udhëtarit të drejtën e tyre...”*

Surja 17, ajeti 33: *“Mos ia ndaluar ta bëni, përveçse kur e kërkon e drejta. Nëse dikush vritet padrejtësisht, i kemi dhënë pushtet trashëgimtarit të tij të kërkojë shpazim. Por edhe ai të mos e teprojë në vrasje, sepse ai është i ndihmuar (nga ligji dhe drejtësia islame).”*

Surja 30, ajeti 38: *“Jepja të drejtën e tij të afërmit, të varfërit edhe udhëtarit...”*

Surja 33, ajeti 70: *“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën.”*

Surja 42, ajeti 41, 42: “Për atë që përgjigjet kur i është bërë një padrejtësi, nuk ka kurrfarë gortimi ndaj tij.

Qortim ka vetëm kundër atyre që u bëjnë keq njerëzve dhe që pa të drejtë mbjellin ngatërresa në tokë; për ata ka dënim të dhembshëm.”

Surja 42, ajeti 43: “Kush duron dhe fal ta dijë se këto janë nga veprimet më të virtyshme.”

Surja 60, ajeti 8: “Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.”

Surja 60, ajeti 9: “Allahu ju ndalon t’i bëni miq ata që luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe ju dëbojnë nga vatrata tuaja, si dhe mbështesin të tjerët që t’ju dëbojnë. Kushdo që i bën miq ata, është punëmbrojtës.”

Surja 70, ajetet 22-35: “...ata që falen, ..., që frikësohen nga dënimi Zotit të tyre, që ruajnë nderin, që ruajnë amanetet dhe plotësojnë besëlidhjet e tyre, që dëshmojnë drejtë, këta do të shpërblehen e do të jenë banorë të Xhenetit.”

c) Të bësh matje apo peshim të saktë

Surja 6, ajeti 152: “...Kryeni drejt matjen dhe peshimin...”

Surja 7, ajeti 85: “Popullit të Medjenit Ne i dërguam vëllanë e tyre, Shuajbin, i cili u tha: ‘O populli im! Adhuroni Allahun! Ju nuk keni zot tjetër përveç tij! Me të vërtetë, ju ka ardhur provë e qartë nga Zoti juaj, prandaj matni dhe

peshoni saktë, mos u hani bakun njerëzve dhe mos bëni ngatërresa në tokë, pasi të jetë vënë rregull në të. Kjo është më mirë për ju, nëse jeni besimtarë!’”

Surja 17, ajeti 35: “Saktësoni matjen, kur matni dhe peshoni me peshore të rregullt...”

Surja 83, ajetet 1-3: “Mjerë për ata që hanë në peshë e matje, që kur masin për vete, e marrin masën të plotë, ndërsa kur u masin të tjerëve, me litër ose me kandar, ua pakësojnë.”

d) Pendimi

Surja 9 emërtohet Et-Teube (Pendimi). Në Kur’an ndeshet shumë herë “Pendimi” si një veprim i pëlqyer dhe i këshilluar për njerëzit që, me vetëdije ose jo, kanë kryer vepra që meritojnë të kritikohen ose të dënohen. Dhe nëse pas pendimit, njeriu përmirësohet e do të kryejë vepra të mira, do të falet nga Allahu. Kjo tregohet në suret dhe ajetet e mëposhtme. Kujtojmë se një nga cilësitë më kryesore të Zotit xh.sh., të përmbledhura në “99 Emrat e Allahut”, është pikërisht “Pranues i pendimit, Et-TEUAB”.

Surja 2, ajeti 54: “...O populli im, ju vetëm vetes i bë të keq, kur e adhuroat vëçin si zot. Prandaj kthehuni të penduar te Krijuesi juaj... Ai i pranon shumë pendimet dhe është Mëshirëploti.”

Surja 2, ajeti 128: “O Zoti ynë! Na bëj të përlulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlulur ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje

pendimin tonë, se, padyshim, Ti je pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!”

Surja 2, ajeti 222: “... Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.”

Surja 4, ajetet 16, 17, 18: “Dhe ata të dy prej jush që kanë bërë këtë punë të turpshme, i ndëshkoni që të dy; e nëse pendohen dhe përmirësohen, ua hiqni dënimin. Se Allahu e pranon pendimin dhe është Mëshirues.”

“Allahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga padituria dhe pendohen shpejt. Pra, këtyre Allahu ua pranon pendimin. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.”

“Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija, e kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: ‘Unë tani me të vërtetë po pendohem’. As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta, Ne kemi përgatitur dënim të dbembshëm.”

Surja 4, ajeti 27: “Allahu dëshiron që t’ju pranojë pendimet tuaja, por ata që jepen pas epsheve, dëshirojnë që të largoheni krejtësisht nga udha e drejtë.”

Surja 4, ajeti 64: “Ne i kemi nisur të dërguarit vetëm me qëllimin që njerëzit, me lejen e Allahut, t’u binden atyre. Dhe, në qoftë se ata, kurdo që ta ngarkonin veten (me gjynahet), të vinin tek ti për t’i kërkuar falje Allahut dhe i Dërguari t’i lutej Allahut për shfajësimin e tyre, do ta vërenin se Allahu, me të vërtetë, është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.”

Surja 4, ajeti 92: “Nuk bën që besimtari të vrasë besimtarin... Ai që s’mund të ejejë rob, duhet të agjërojë dy muaj rresht në shenjë pendimi para Allahut...”

Surja 4, ajeti 146: “Por ata që pendohen, përmirësohen, mbështeten fort tek Allahu dhe që besimin e tyre e kanë singërisht vetëm për Allahun, do të jenë me besimtarët e vërtetë...”

Surja 5, ajeti 31: “Allahu dërgoi një sorrë që rrëmibte në tokë, për t’i treguar sesi ta mbulonte kufomën e të vëllait. (Kabili) tha: ‘I mjeri unë, a nuk qenkam i zoti të bëhem si kjo sorrë e ta mbuloj trupin e tim vëllai?’ Dhe u bë nga të penduarit”

Surja 5, ajeti 39: “Ndërsa atij që pendohet pas të këqijave të tij dhe përmirësohet, Allahu ia pranon pendimin...”

Surja 5, ajeti 52: “...ata do të pendohen për atë që kanë fshehur në veten e tyre.”

Surja 5, ajeti 71: “Ata (bijtë e Izraelit) mendonin se nuk do t’i gjente kurrfarë dënimi, prandaj ngelën të verbër dhe të shurdhët. Pastaj Allahu ua pranoi pendimin, por përsëri...”

Surja 7, ajetet 143, 149: “... Musait i ra të fikët. Kur erdhi në vete, ai tha: ‘I lavdëruar qofsh Ti o Zot! Kthehem te Ty i penduar. Unë jam i pari i besimtarëve.’”

“Por, kur u penduan dhe e kuptuan se kishin hyrë në rrugë të gabuar, ata thanë: ‘Nëse Zoti ynë nuk na mëshiron dhe nuk na fal, me të vërtetë do të jemi të humbur.’”

Surja 9, ajeti 3: “...Nëse ju pendoheni, është më mirë për ju; por nëse largoheni (nga pendimi), ta dini se nuk do të mund t’i shpëtoni Allahut!...”

Surja 9, ajeti 5: “...Por, nëse pendohen, falin namazin dhe japin zeqatin, atëherë i lini të qetë!...”

Surja 9, ajeti 11: “Megjithatë, nëse ata pendohen, falin namazin dhe japin zeqatin, atëherë janë vëllezërit tuaj në fe!...”

Surja 9, ajeti 15: “...Allahu ia pranon pendimin kujt të dojë...”

Surja 9, ajeti 27: “Pas kësaj, Allahu e pranon pendimin për kë të dojë...”

Surja 9, ajeti 74: “...Nëse pendohen, do të jetë më mirë për ta; por nëse kthejnë shpinën, Allahu do t'i ndëshkojë me dënim të rëndë në këtë jetë dhe në tjetrën...”

Surja 9, ajeti 104: “A nuk e dinë ata se Allahu është Ai që pranon pendimin dhe bamirësinë nga robërit e Vet dhe se Ai është Prannesi i pendimeve dhe Mëshirëploti?”

Surja 9, ajeti 117: “Padyshim, Allahu e pranoi pendimin e të Dërguarit, të muhaxhirëve dhe të ensarëve, të cilët shkuan pas atij në çastin e vështirë, pasi zemrat e disave prej tyre për një fije qenë afër shmangies, pastaj Allahu pranoi pendimin e tyre. Vërtet Ai është i Butë dhe i Mëshirshëm me ta.”

Surja 9, ajeti 118: “Allahu ua pranoi pendimin edhe atyre...derisa u bindën se nuk ka strehim tjetër përveç Allahut e pastaj Allahu u dha mëshirë që të pendohen. Me të vërtetë Allahu e pranon pendimin dhe është Mëshirëplotë.”

Surja 17, ajeti 25: “Zoti juaj e di më së miri se ç’keni në shpirtat tuaj. Nëse ju jeni të drejtë, sigurisht që Ai është Falës për ata që pendohen.”

Surja 19, ajeti 60: “përveç atyre që pendohen, që besojnë dhe bëjnë punë të mirë. Këta do të hyjnë në Xhenet dhe nuk do t’u bëhet kurrfarë padrejtësie.”

Surja 20, ajeti 82: “Vërtet, Unë

jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”

Surja 20, ajeti 122: “Pastaj, Zoti i tij e zgjodhi atë (Ademin), ia pranoi pendimin, e udhëzoi dhe...”

Surja 24, ajeti 5: “Përjashtim bëjnë ata që pas kësaj, pendohen dhe përmirësoben...”

Surja 24, ajeti 10: “Sikur të mos ishin mirësia dhe mëshira e Allahut ndaj jush, si dhe fakti se Ai është Prannesi i Pendimit e i Urtë (dënimi do të shpejtonte).”

Surja 24, ajeti 31: “...Të gjithë ju o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin.”

Surja 25, ajetet 70, 71: “Përjashtim bën ai që pendohet, beson dhe punon vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira...”

“Ndërsa ai që pendohet dhe bën vepra të mira, është i kthyer krejtësisht nga Allahu.”

Surja 28 , ajeti 67: “Porse ai që pendohet, beson dhe bën vepra të mira, do të jetë i shpëtuar.”

Surja 30 , ajetet 31, 33: “Drejtojuni Atij me pendesë, Frikësojuni Atij dhe falni namazin e mos u bëni si ata, që i shoqërojnë Atij diçka tjetër (në adhurim).”

“Kur njerëzit i godet ndonjë e keqe, ata i luten Zotit të vet, duke iu kthyer me pendesë, e pastaj kur Ai u jep të shijojnë mëshirën e Tij, atëherë një pjesë e tyre i shoqërojnë Zotit të vet diçka tjetër (në adhurim).”

Surja 33, ajeti 73: “Si pasojë,

Allahu do t'i dënojë hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët dhe idhujtaret, ndërsa do t'ua pranojë pendimin besimtarëve dhe besimtareve..."

Surja 38, ajeti 24: "...Daudi e kuptoi se në të vërtetë Ne e kishim vënë në provë atë, prandaj kërkoi falje nga Zoti i vet, ra në gjunjë dhe u përul, duke u penduar."

Surja 38, ajeti 44: "...Ne e gjetëm atë të durueshëm, rob të mrekullueshëm (Ejubi). Ai kthehej vazhdimisht me pendesë te Zoti."

Surja 39, ajeti 8: "Kur njeriu n e godet një e keqe, ai i lutet Zotit të vet, duke iu drejtuar me pendesë..."

Surja 42, ajeti 10: "Për çfarëdo gjëje që ju të diskutoni, fjala e fundit i përket Allahut. Ky është Allahu, Zoti im! Unë tek Ai mbështetem dhe tek Ai kthehem i penduar."

Surja 42, ajeti 13: "Ai ka urdhëruar për ju atë Fe, të cilën ta zbuloi ty (Muhamed) dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, duke thënë: 'Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të'. Por për idhujtarët është e rëndë ajo në të cilën po i fton ti. Allahu zgjedh për këtë fe kë të dojë dhe udhëzon drejt saj këdo që kthehet tek Ai me pendim."

Surja 42, ajeti 25: "Ai e pranon pendimin e robërve të Vet, i fal grynabet dhe i di të gjitha çfarë punoni ju."

Surja 49, ajeti 12: "O ju që keni besuar! Mënjaroni shumë dyshime, se vërtet, disa dyshime janë grynab. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njeri tjetrin. ... Me të vërtetë Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë!"

Surja 110, ajeti 3: "atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërkoi falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve."

e) Falja

Ndër cilësitë e Zotit xh.xh. të dhëna në Kur'an, për cilësinë "Falës" janë të përafërt, tre të tillë: El-Gafurr (Falësi); El-Gaffar (Gjithëfalësi); El-Afwu (Falësi i mëkateve). Me cilësitë e "Falësit" janë të lidhur ngushtë edhe cilësitë "I Gjithëmëshirshmi" (ER-RAHMAN) dhe "Mëshirëploti" (ER-RAHIM). Më poshtë është trajtuar vetëm "falja", çdo herë që është gjendur në Kur'an³, si një cilësi e Zotit që do të falë njerëzit, kur ata do të pendohen për veprat e kryera, jo të mira; për gabimet e tyre të vogla, por që më pas do të kryejnë vepra të mira dhe do të besojnë Allahun. Gjithashtu, Ai do të falë edhe besimtarët, që me dashje ose pa dashje, do të bëjnë gabime të vogla. Por, "Falja" në Kur'an, konsiderohet edhe si një virtut i njerëzve të mirë. Pra, njerëzit që falin pikërisht ata persona, që u kanë bërë keq, Zoti premton se do t'i shpërblejë me të mira në këtë jetë dhe në tjetrën.

Pra, në suret më poshtë, do të shohim rastet kur Zoti premton se do

3. "Kur'ani i madhërishtëm" Mbështetur në përkthimin e Prof. Hasan I. Nabi – botim i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam, 2012.

të falë disa kategori njerëzish që kanë gabuar, por që do të përmirësohen ose janë përmirësuar; kur Zoti u premton njerëzve shpërblim, nëse ata falin të tjerët, që kanë qenë të padrejtë me ta; kur të dërguarit ose të tjerë, thërrasin për t'u larguar nga mohimi e veprat e këqija, duke i kërkuar falje Zotit e duke u penduar.

Në shumë raste, siç do ta shohim më poshtë, ajeti përfundon me shprehjen "...Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë", ose "Allahu është Falës i madh dhe i Butë", të cilat përforcojnë kuptimin e përmbytjes në ajetin përkatës. Që të mos biem në përsëritje, kemi treguar më poshtë suret dhe ajetet ku gjenden këto dy shprehje, pastaj vazhdojmë me qasjet e tjera.

Shprehja "...Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë" ndodhet te:

Surja 2, ajetet 173, 182, 192, 218, 226; Surja 3, ajetet 31, 89, 129; Surja 4, ajetet 25, 96, 100, 106, 110, 129, 152; Surja 5, ajetet 3, 34, 39, 74, 98; Surja 6, ajetet 145, 165; Surja 7, ajetet 153, 167; Surja 8, ajetet 69, 70; Surja 9, ajetet 5, 27, 91; Surja 10, ajeti 107; Surja 11, ajeti 41; Surja 12, ajetet 53, 98; Surja 14, ajeti 36; Surja 16, ajetet 18, 110, 115, 119; Surja 24, ajetet 5, 22, 33, 62; Surja 25, ajeti 70; Surja 27, ajeti 11; Surja 28, ajetet 16; Surja 33, ajetet 24, 50, 59, 73; Surja 34, ajeti 2; Surja 39, ajeti 53; Surja 41, ajeti 32; Surja 42, ajeti 5; Surja 46, ajeti 8; Surja 48, ajeti 14; Surja

49, ajetet 5, 14; Surja 57, ajeti 28; Surja 58, ajeti 12; Surja 60, ajetet 7, 12; Surja 64, ajeti 14; Surja 66, ajeti 1; Surja 73, ajeti 20;

Kurse "...Allahu është Falës i madh dhe i Butë" ndodhet te:

Surja 2, ajetet 225, 235; Surja 3, ajetet 155; Surja 5, ajetet 101; Surja 17, ajeti 44;

Surja 2, ajetet 52, 54, 58: "*Pastaj ne ju falëm, që të jeni mirënjohës.*"

"...Ai jua fali gabimin, sepse Ai i pranon shumë pendimet dhe është Mëshirëplotë."

"Kujtoni kur thamë: 'Hyni në këtë qytet ...dhe thoni: 'Falna!' që Ne t'jua falim gabimet. Atyre që bëjnë vepra të mira, Ne ua shtojmë shpërblimin."

Surja 2, ajeti 178: "*O besimtarë! Është caktuar për ju kisasi për vrasje: I liri për të lirin, skllavi për skllavin dhe femra për femrën. Ai (vrasës) që falet nga farefisi i të vrarit, dubet të sillet njerëzishëm dhe le të zbatojë dëmshpërblimin më të mirë. Kjo falje është një lehtësi dhe mëshirë nga ana e Zotit. E kushdo që pas kësaj e kapërcen kufirin, do të marrë një dënim të dhembshëm."*

Surja 2, ajeti 221: "*...Ata ju thërrasin në zjarr, kurse Allahu, me mirësinë e tij, ju thërrret në Xhenet e falje. Ai ua shpjegon njerëzve shpalljet e Veta që ata të mendojnë."*

Surja 2, ajeti 237: "*...Por që të falni, është më pranë devotshmërisë. Mos harroni që të bëheni bamirës midis jush! Vërtet, Allahu e sheh mirë se çfarë bëni."*

Surja 3, ajetet 15, 16, 17: "*... Allahu i vrojton robërit e Vet, që thonë:*

‘Zoti ynë! Ne kemi besuar vërtet, andaj na i fal gjynabet tona dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit’; ‘...që janë të durueshëm, të singertë, të devotsbëm në adhurimin e Allahut; që japin lëmoshë dhe që kërkojnë faljen e gjynabeve para agimit.’

Surja 3, ajeti 31: *‘Thuaju (o Muhamed): Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynabet!’*”

Surja 3, ajeti 133, 134, 135, 136: *‘Nxitoni drejt faljes së gjynabeve nga Zoti juaj, drejt Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e toka dhe që është përgatitur për të devotsbmit,’*

‘të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëgenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zëmërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.’

‘Për ata që kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynabet e tyre - e kush i fal gjynabet përveç Allahut?, dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë;’

‘pra për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore nga Zoti i tyre...’

Surja 3, ajeti 147: *‘Ata vetëm thonin: ‘O Zoti ynë! Na i fal gjynabet tona dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jo besimtar.’*

Surja 3, ajeti 152: *‘...Pastaj Ai, për t’ju provuar, bëri që të zmbrapseni para armikut dhe pastaj sigurisht jua falë atë gabim. Allahu ka mirësi të madhe për besimtarët.’*

Surja 3, ajeti 157: *‘Edhe nëse ju vriteni ose vdisni në udhë të Allahut, falja*

dhe mëshira e Allahut, me të vërtetë janë më të mira nga ato që kanë grumbulluar ata.’

Surja 3, ajeti 159: *‘...Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme.’*

Surja 3, ajeti 193: *‘O Zoti ynë! Ne dëguam një thirrës që na ftonë në besim: ‘Besoni Zotin tuaj’ Dhe kështu besuam. O Zoti ynë! Na i fal gjynabet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirë!’*

Surja 4, ajeti 31: *‘Në qoftë se ju u shmangeni gjynabeve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t’jua falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.’*

Surja 4, ajeti 43: *‘...dhe nuk gjeni ujë, atëherë fërkonni fytyrën dhe duart tuaja me dhe të pastër. Allahu me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynabeve.’*

Surja 4, ajeti 48 dhe 116: *‘Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Tij, por gjynabet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë...’*

Surja 4, ajeti 99: *‘mbase Allahu i fal, se Allahu, me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynabeve.’*

Surja 4, ajeti 137: *‘Ata që në fillim besojnë dhe pastaj e mendojnë besimin, më pas sërish besojnë dhe sërish e mendojnë besimin dhe thellohen në mosbesim, Allahu, me të vërtetë, nuk do t’i falë dhe nuk do t’i shpjerë në rrugë të drejtë.’*

Surja 4, ajeti 149: *‘Në qoftë se ju bëni ndonjë vepër të mirë haptazi ose fshehurazi ose falni ndonjë vepër të keqe, Allahu është Falës i madh dhe i Plotëfuqishëm.’*

Surja 4, ajeti 168: “Ata që nuk besojnë dhe bëjnë padrejtësi, Allahu nuk i fal, as nuk do t’i udhëzojë në kurrfarë rruge.”

Surja 5, ajeti 9: “Allahu u ka premtuar falje dhe shpërblim të madh atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira.”

Surja 5, ajeti 13: “...Ti përherë do ta vëshesh tradhtinë e tyre, përveç një pakice të tyre; pra, falua fajet dhe mos i qorto! Se Allahu i do bamirësit.”

Surja 5, ajeti 15: “O ihtarë të Librit! Juve ju erdhi i Dërguari i Ynë, i cili ju shpjegon gjëra nga ato që i keni fshebur ju prej librave (Teuratit dhe Ungjillit) dhe ju fal shumë. Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kur’ani).”

Surja 5, ajeti 18: “...Ai fal kë të dojë dhe dënon kë të dojë...”

Surja 5, ajeti 95: “O besimtarë! Mos gjuani duke qenë në Ihram! Kushdo që e vret gjahun me paramendim, për dënim dubet të therrë si kurban në Qabe një kafshë shtëpiake të ngjashme... Allahu e fal atë që ka kaluar (përpara ndalimit)...”

Surja 5, ajeti 118: “Nëse Ti i dënon ata, robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotëfuqishëm dhe i Urti.”

Surja 6, ajeti 54: “Kur të vijë te ti ata që besojnë në shpalljet Tona, thuaj: “Pajja qoftë me ju!” Zoti ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën. Nëse dikush nga ju bën ndonjë vepër të keqe pa e ditur, e pastaj pendohet e përmirësohet, ai do ta gjejë Allahun Falës dhe Mëshirues.”

Surja 7, ajeti 23: “Ata thanë: ‘O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na

mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.’”

Surja 7, ajetet 149: “Por kur u penduan dhe e kuptuan se kishin hyrë në rrugë të gabuar, ata thanë: “Nëse Zoti ynë nuk na mëshiron dhe nuk na fal, me të vërtetë do të jemi të humbur!”

Surja 7, ajeti 151: “Musai u lut: ‘O Zot! Më fal mua dhe vëllanë tim dhe na prano në mëshirën tënde! Ti je më i Mëshirshmi i mëshiruesve.’”

Surja 7, ajeti 155: “...Ti je Mbrotjtësi ynë, andaj falna e mëshirona! Ti je më i miri i mëshiruesve!”

Surja 7, ajeti 161: “Kur atyre iu tha: ‘Vendosuni në këtë vendbanim dhe hani çfarë të doni; kërkoni falje dhe hyni në portat e tij duke u përulur, që t’jua falim gabimet dhe t’ua shtojmë shpërblimin punëmireve.’”

Surja 7, ajeti 169: “Pas tyre erdhi një brezni, e cila e trashëgoi Librin (Teuratin), por duke marrë gjërat e pavlefshme të kësaj bote dhe duke thënë: ‘Do të na falet çdo gjë’...”

Surja 8, ajeti 38: “Thuaju atyre që nuk besojnë: nëse largohen (nga mosbesimi) do t’u falet e kaluara e nëse kthehen (në mosbesim), atëherë dënimi i popujve të mëparshëm është paralajmërim për ta.”

Surja 8, ajeti 74: “Ata që besojnë, mërgojnë e luftojnë për çështjen e Allahut dhe ata që u japin strehim atyre e i ndihmojnë, pa dyshim, janë besimtarë të vërtetë; për ta ka falje dhe shpërblim bujar.”

Surja 9, ajeti 43: “Allahu të fal ty që u lejove atyre të mungojnë, para se ta kuptojë se kush të flet të vërtetën dhe derisa t’i njihje gënjeshtarët.”

Surja 9, ajeti 66: “Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar. Nëse Ne i falim disa prej jush (për shkak se u penduan) do t’i ndëshkojmë të tjerët, ngase janë fajtorë (nuk u penduan për talljen që bënë).”

Surja 9, ajeti 80: “U lute për ta o nuk u lute (o Muhamed), Allahu nuk do t’i falë, edhe sikur ti të kërkosh falje për to shtatëdhjetë herë! Kjo sepse ata e mohuan Allahun dhe të Dërguarin e tij. Allahu nuk i udhëzon në rrugë të mbarë njerëzit e pabindur.”

Surja 9, ajeti 114: “Ndërsa lutja e Ibrahimit për faljen e babait të tij, ka qenë vetëm për shkak të një premtimi, që i kishte bërë. Por, kur iu bë e qartë se i ati ishte armik i Allahut, ai u nda prej tij. E megjithatë, Ibrahimit ishte njeri i dhembshur dhe i butë.”

Surja 11, ajeti 3: “...kërkoni falje nga Zoti i juaj e kthehuni te Ai me pendesë...”

Surja 11, ajeti 11: “vetëm ata që durojnë dhe bëjnë vepra të mira; për ata do të ketë falje dhe shpërblim të madh.”

Surja 11, ajeti 47: “(Nubu) tha: ‘O Zoti im, mbështetem tek Ti për të mos kërkuar gjëra, për të cilat nuk kam dijeni. Nëse Ti nuk më fal dhe nuk më mëshiron, do të jem nga të humburit.’”

Surja 11, ajeti 52: “O populli im! Kërkoni falje nga Zoti juaj dhe kthehuni te Ai të penduar, se ai do t’ju sjellë sbi të begatsbëm dhe do t’ju shtojë fuqi mbi fuqinë tuaj. Mos u shmangni prej Atij duke qenë keqbërës!”

Surja 11, ajeti 61: “Fisat Themud (Ne i dërguam) vëllanë e tij, Salibun. ‘O

populli im’, iu tha ai, ‘adburoni vetëm Allahun...kërkoni falje nga Ai dhe kthehuni me pendim tek Ai! Pa dyshim, Zoti im është afër dhe ju përgjigjet.’”

Surja 11, ajeti 90: “(Shuajbi u tha) ‘Kërkoni falje nga Zoti juaj e kthehuni me pendim tek Ai. Me të vërtetë Zoti im është Mëshirëplotë dhe gjithë dashuri.’”

Surja 12, ajeti 29: “Ti o Jusuf, largohu nga kjo! Kurse ti (gruaja ime) kërkoi falje për këtë gjynah, sepse në të vërtetë, ti je fajtorë.”

Surja 12, ajeti 92: “Ai u tha: ‘Sot s’ka qortim për ju; Allahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!’”

Surja 12, ajeti 97: “Ata thanë: ‘O babai ynë, kërkoi falje për ne e për gabimet tona! Paskemi qenë vërtet gjynahqarë.’”

Surja 13, ajeti 6: “...Zoti yt është Falës për njerëzit pavarësisht gjynabeve të tyre, por në të vërtetë, Zoti yt është edhe i ashpër në dënim.”

Surja 14, ajeti 10: “...Ai ju thërret juve për t’ju falur disa gjynabe tuaja dhe që t’ju lërë deri në afatin e caktuar...”

Surja 16, ajeti 84: “Ndërsa Ditën, kur do të sjellim dëshmitarë nga çdo popull, jobesimtarëve nuk do t’u jepet leje të shfajësohen e të kërkojnë falje.”

Surja 18, ajeti 55: “Çfarë i pengon njerëzit të besojnë, kur u vjen udhëzimi dhe të kërkojnë falje nga Zoti i tyre? Apo presin vetëm që të pësojnë fatin e popujve të parë ose që t’u vijë dënimi i hapët?”

Surja 18, ajeti 58: “Por Zoti yt është Falësi plot mëshirë...”

Surja 19, ajeti 47: “Ibrahimit tha: ‘Shpëtimi qoftë mbi ty! Do t’i lutem Zotit tim që të të falë...’”

Surja 20, ajetet 73: “Ne besojmë në Zotin tonë, që të na i falë gabimet dhe magjitë, për të cilat na ke detyruar ti. Allahu është më i Miri dhe i Përvetshmi!”

Surja 20, ajeti 82: “Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”

Surja 22, ajetet 50, 60: “Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ka falje dhe dhunti fisnike.”

“...Allahu është Shlyes i gjynabeve dhe Falës.”

Surja 23, ajeti 109: “Mes robërve të Mi, ishte një grup i cili thoshte: ‘O Zoti ynë, ne kemi besuar, andaj na fal dhe na mëshiro! Ti je më i miri i mëshirues!’”

Surja 23, ajeti 118: “Dhe thuaj (o Muhamed): ‘O Zoti im, fal dhe mëshiro, se Ti je më i miri i mëshirues!’”

Surja 24, ajeti 26: “...(gratë e ndershme dhe burrat e ndershëm)...janë të pastër nga shpifjet që thuben dhe do të falen e do të kenë shpërblim bujar.”

Surja 25, ajeti 6: “Thuaj: ‘Atë e ka shpallur Ai që di fshehtësinë e qiejve dhe të Tokës. Ai fal shumë dhe është Mëshirues.’”

Surja 26, ajetet 51, 82, 86: “Ne shpresojmë se Zoti ynë do të na i falë gjynabet, meqë jemi besimtarët e parë.”

“dhe i cili, shpresoj se do të m’i falë gabimet e mia në Ditën e Gjykimit!”, “Fale babanë tim, sepse ai është njëri nga të humburit.”

Surja 27, ajeti 46: “(Salibu) tha: ‘O populli im, përse ju e dëshironi të keqen para së mirës? Përse nuk kërkonin nga Allahu falje që të mund të mëshiroheni?’”

Surja 30, ajeti 57: “Atë Ditë, atyre

që kanë bërë padrejtësi, nuk do t’u bëjë dobi shfajësimi, as nuk do t’u lejohet që të kërkojnë falje.”

Surja 33, ajeti 35: “...për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.”

Surja 34, ajetet 4, 15: “...Për njerëz të tillë do të ketë falje dhe begati të mrekullueshme.”, “...Falës i madh është Zoti juaj.”

Surja 35, ajetet 7, 28, 30, 34, 41: “Për ata që nuk besojnë ka dënim të rëndë, kurse për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ka falje dhe shpërblim të madh”, “...Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës”, “...Ai është Falës dhe Falënderues.”, “...Zoti ynë është Falës dhe Falënderues.”, “...Ai është i Butë dhe Falës.”

Surja 36, ajeti 11: “...Këtij jepi lajmin e mirë për falje gjynabesh dhe shpërblim bujar!”

Surja 38, ajeti 66: “...Falësit të Madh.”

Surja 39, ajetet 5, 35: “...Ai është i Plotfuqishëm dhe Falës i Madh!”, “Allahu do t’ua falë atyre veprat më të këqija që kanë bërë dhe do t’i shpërblejë sipas veprave më të mira që kanë bërë.”

Surja 40, ajeti 3: “(Shpallja e këtij Libri është prej...), Falësit të gjynabeve...”

Surja 40, ajeti 7: “...O Zoti ynë, Ti përfsbin çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar e që ndjekin rrugën Tënde dhe ruaji ata prej Zjarrit flakëruës!”

Surja 40, ajeti 42: “...unë ju bëj thirrje të adhuroni të Plotfuqishmin, Falësin e Madh.”

Surja 40, ajeti 55: “...Lutju Zotit

për faljen e gjynabeve të tua...”

Surja 41, ajeti 6: *“...ecni në rrugën e drejtë që të çon tek Ai dhe kërkon falje prej Tij!”*

Surja 41, ajeti 24: *“...edhe nëse kërkojnë falje, lutja nuk do t’u merret parasysh.”*

Surja 41, ajeti 43: *“...Në të vërtetë, Zoti yt fal shumë, por edhe dënon ashpër.”*

Surja 42, ajeti 23: *“...Allahu, me të vërtetë, është Falës dhe Mirënjohës.”*

Surja 42, ajeti 25: *“Ai e pranon pendimin e robërve të Vet, i fal gjynahet dhe i di të gjitha çfarë punoni ju.”*

Surja 42, ajeti 30: *“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë; por Ai fal shumë.”*

Surja 42, ajeti 34: *“Ose, Ai mund t’i fundosë anijet, për shkak të gjynabeve që kanë bërë ata. Sidoqoftë, Ai fal shumë.”*

Surja 42, ajeti 37: *“për ata që ruhen prej gjynabeve të mëdha e mbrapshtive dhe që, kur i zemëron dikush, falin.”*

Surja 42, ajeti 40: *“...Por atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i Allahut...”*

Surja 42, ajeti 43: *“Kushdo që duron dhe fal, ta dijë se, në të vërtetë, këto janë nga veprimet më të virtytshme.”*

Surja 45, ajeti 14: *“Thuaju besimtarëve që t’i falin ata që nuk shpresojnë në ditët e Allahut, kështu që Ai të shpërblejë çdo popull sipas veprave të veta.”*

Surja 47, ajeti 19: *“...Kërko falje për gjynahun tënd...”*

Surja 47, ajeti 34: *“...Allahu kurrsesi nuk do t’i falë...”*

Surja 48, ajetet 2, 5, 11, 29: *“(Muhamedit) për t’i falur ty Allahu*

gabimet e mëparshme dhe të ardhshme ...”, “për t’i çuar besimtarët dhe besimtarët në kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përherë, si dhe që t’ua falë gjynahet atyre...”, *“Do të thonë ty arabët e shkerëtëtirës, të cilët ngelën pas jush: ‘Ne ishim të zënë me bagëtitë dhe familjet tona, prandaj lutju Allahut që të na falë ne.”*, *“...Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.”*

Surja 49, ajeti 3: *“Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut, janë njerëzit, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ta ka falje dhe shpërblim të madh.”*

Surja 51, ajeti 18: *“ndërsa në aqim kërkonin falje (nga Allahu)”*

Surja 53, ajeti 32: *“Për ata që ruhen prej gjynabeve të mëdha dhe veprave imorale, përveç gjynabeve të vogla, me të vërtetë, Zoti yt është i Gjjerë në falje...”*

Surja 57, ajeti 20: *“...Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.”*

Surja 58, ajetet 2, 13: *“...Allahu është Falës dhe Shlyes i gabimeve”, “...E nëse nuk jepni (lëmshë) e Allahu jua ka falur, atëherë kryeni namazin, jepni zeqatin dhe dëgjoni Allahun e të Dërguarin e tij...”*

Surja 61, ajeti 12: *“Ai do t’ju falë gabimet tuaja dhe do t’ju shpjerë në kopshte...”*

Surja 63, ajetet 5, 6: *“Kur u thuhet atyre: ‘Ejani, se i Dërguari i Allahut do të kërkojë falje për ju’, ata tundin kokat*

e tyre...”, “Njësoj është, u lute për faljen e tyre apo nuk u lute, Allahu kurrësi nuk do t’i falë...”

Surja 64, ajetet 9, 17: “*Aiij që beson në Allahun dhe bën vepra të mira, Allahu do t’ia falë gjynabet...*”, “*Nëse i jepni Allahut një hua të bukur, Ai ua kthen shumëfish atë dhe ju fal. Allahu është Mirënjohës dhe nuk nxiton në dënime.*”

Surja 66, ajeti 4: “*Nëse ju të dyja do të ktheheni të penduara te Allahu, sepse vërtet që zemrat tuaja patën devijuar, Allahu do t’ju falë...*”

Surja 67, ajetet 2, 12: “*Ai ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.*”

Surja 71, ajetet 4, 7, 10, 28: “*me qëllim që Ai të falë disa nga gjynabet tuaja dhe t’ju lërë deri në një afat të caktuar...*”, “*(Nuhu) ‘Sa herë që i thirrja për Ti falur Ti, ata shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbuloheshin me petkat e tyre, duke këmbëngulur...*”, “*e u thashë: ‘Kërkonti falje nga Zoti juaj, i cili është Falësi i madh.’*”, “*O Zoti im, falmë mua dhe prindërit e mi, si dhe çdo besimtar, që kërkon strehim në shtëpinë time! Fali të gjithë besimtarët e besimtarët, ndërsa keqbërësve shtoj vetëm shkatërrim!*”

Surja 74, ajeti 56: “*.Vetëm Ai është i Denjë për t’u pasur frikë dhe vetëm Ai është i Denjë për të falur.*”

Surja 85, ajeti 14: “*Ai është Falësi i madh, i Dhembshuri.*”

Surja 110, ajeti 3: “*atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.*”

f) Durimi

Një tjetër cilësi e Allahut, që e ka përmendur Vetë Ai në Kur’anin Famëlartë, është edhe DURUESI (ES-SABUR). Prandaj Ai e ka vlerësuar shumë personin që arrin të durojë dhe i ka premtuar shpërblim me Xhenet. Këtë fakt e shohim në disa ajete të sureve të mëposhtme:

Surja 2, ajeti 45: “*Kërkonti ndihmë (prej Allahut) me durim e me namaz! Kjo është njëmend e vështirë, përveçse për të devotshmit...*”

Surja 2, ajeti 177: “*...mirësia është...e atyre që durojnë në kohë skamje, sëmundje dhe lufte...*”

Surja 2, ajeti 249, 250: “*...Allahu është me të durueshmit.*”, “*Dhe kur u përballen me Xhalutin dhe ushtrinë e tij, thanë: ‘Zoti ynë! Na pajis me durim, na forco këmbët tona dhe na ndihmo kundër këtij populli jo besimtar!’*”

Surja 3, ajeti 17: “*që janë të durueshëm, të singertë, të devotshëm në adhurimin e Allahut, që japin lëmoshë dhe që kërkojnë faljen e gjynabeve para agimit.*”

Surja 3, ajeti 120: “*Nëse ju vjen ndonjë e mirë, ata i brengos, e nëse ju gjen ndonjë e keqe, ata gëzohen, por nëse ju duroni dhe rubeni nga gjynabet, dinakëritë e tyre nuk mund t’ju dëmtojnë aspak. Vërtet Allahu ka dijëni për çdo gjë që punojnë ata.*”

Surja 3, ajeti 125: “*Po! Por nëse ata ju sulmojnë, bëhuni të durueshëm dhe të dëgjueshëm dhe Zoti juaj menjëherë do t’ju dërgojë në ndihmë pesë mijë engjëj, me shenjë të dalluar.*”

Surja 3, ajeti 146: “*Sa e sa profetë bashkë me shumë besimtarë të vërtetë luftuan e megjithatë nuk u përkulën para goditjeve që morën në rrugën e Allahut, as nuk u dobësuan e as nuk u nënshtuan. Allahu i do të duruarit.*”

Surja 3, ajeti 200: “*O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxitni njëri tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!*”

Surja 8, ajeti 46: “*Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu me të vërtetë, është me të durueshmit.*”

Surja 11, ajeti 49: “*Këto janë nga lajmet e fshehta që Ne t’i shpallim ty. Këto nuk i ke ditur as ti, as populli yt para kësaj (shpalljes së Kur’anit). Andaj, duro! Se, vërtet, në fund, fitorja është e besimtarëve.*”

Surja 11, ajeti 115: “*Dhe duro! Se Allahu, me të vërtetë, nuk e humb shpërblimin për punëmirët.*”

Surja 12, ajeti 18: “*Dhe sollën këmishën e tij të përgjakur, me gjak të rremë. Ai tha: Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka. Por, durim! Allahut i kërkoj ndihmë kundër asaj që po tregoni ju.*”

Surja 12, ajeti 90: “*Ata thanë: Vallë vërtet ti je Jusufi? Ai u përgjigj: Po, unë jam Jusufi e ky është vëllai im. Allahu na mëshiroi. Atë që ruhet dhe bëhet i durueshëm, Allahu e shpërblen, se Ai kurrë nuk ia humb shpërblimin punëmirëve.*”

Surja 13, ajetet 22, 24: “*dhe ata që durojnë për të fituar dashurinë e Zotit të tyre, që falin namazin, që ndajnë fsheburazi dhe haptazi nga ajo që ua kemi dhënë Ne, dhe që të keqen, e kethejnë me të mirë. Këtyre u takon shpërblimi në Shtëpinë e fundit.*”, “*(dhe engjëjt do t’u thonë) Shpëtimi qoftë mbi ju, për durimin që keni treguar! Sa vendbanim i bukur që është ky!*”

Surja 14, ajeti 5: “*Ne e dërguam Musain me shenjat Tona (dhe i thamë): Nxirre popullin tënd nga errësira në dritë dhe përkujtoju atyre ditët e Allahut! Vërtet, në këtë ka shenja për çdo njeri që është i durueshëm dhe falënderues.*”

Surja 16, ajetet 126, 127: “*Nëse ndëshkoni, ndëshkoni aq sa jeni ndëshkuar, por nëse duroni, kjo është më e mira për të durueshmit.*”, “*Prandaj duro! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Dhe mos u pikëllo për ta e mos u ngushto për shkak të dredhive të tyre!*”

Surja 18, ajetet 67, 68, 69: “*Ai (Hidri) u përgjigj: Ti nuk mund të durosh dot me mua!*”, “*E si mund të durosh (pa pyetur) para diçkaje për të cilën nuk di asgjë?*”, “*(Musai) tha: Do të më gjeshtë të durueshëm, në dashtë Allahu e nuk do të kundërshtoj për asgjë.*”

Surja 18, ajetet 72 dhe 75: “*(Hidri) tha: A nuk të thashë se ti nuk mund të durosh me mua?*”

Surja 18, ajeti 78: “*(Hidri) tha: Kjo është ndarja ndërmjet meje dhe teje. Unë do t’i shpjegoj ty ato gjëra për të cilat nuk munde të durosh.*”

Surja 20, ajeti 130: “*Prandaj duroje (o Mubamed) atë që thonë ata dhe*

lavdëroje me falënderim Zotin tënd para lindjes së Diellit dhe para përdimit të tij! Lavdëroje Atë edhe në orët e natës, edhe në skajet e ditës, që të mund të kënaqesh.”

Surja 23, ajeti 111: *“Unë i kam shpërblyer ata sot për durimin e tyre e ata me të vërtetë janë të shpëtuar.”*

Surja 25, ajeti 75: *“Njerëz të tillë do të shpërblehen me Xhenet të lartë për durimin e tyre dhe do të mirëpritën e do të gjejnë paqe.”*

Surja 28, ajeti 54: *“Atyre do t’u jepet shpërblim i dyfishtë, për shkak të durimit që kanë treguar. Ata e zmbrapsin të keqen me të mirë, ndajnë lëmshë nga ajo që u kemi dhënë Ne.”*

Surja 28, ajeti 80: *“Ndërsa njerëzit e dijsbëm thoshin: ‘Të mjerët ju! Shpërblimi i Allahut është më i mirë për atë që beson dhe bën vepra të mira. Ai do t’u jepet vetëm të duruarve.’”*

Surja 29, ajetet 58, 59: *“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t’i vendosim në pallatet e Xhenetit... Sa i bukur është shpërblimi i atyre që punojnë mirë e të cilët kanë duruar dhe janë mbështetur te Zoti i tyre.”*

Surja 31, ajeti 17: *“O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!”*

Surja 32, ajeti 24 *“Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm dhe besonin bindshëm.”*

Surja 34, ajeti 19: *“...në këtë ka shenja si mësim për çdo të durueshëm dhe falënderues.”*

Surja 37, ajeti 102: *“Kur fëmija u rrit aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahim i tha: ‘O djali im, kam parë në ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti?’ I biri i tha: ‘O ati im, vepra ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!’”*

Surja 38, ajeti 17: *“Ti duroje atë që thonë ata dhe kujtoje robin Tonë të fuqishëm, Daudin, që përberë i drejtohej Zotit.”*

Surja 38, ajeti 44: *“(për Ejubin)... Ne e gjetëm atë të durueshëm, rob të mrekullueshëm...”*

Surja 39, ajeti 10: *“Thuaj: ‘O robër besimtarë, frikësojuni Zotit tuaj! Ata që bëjnë mirë në këtë jetë, do të kenë të mira. Toka e Allahut është e gjerë. Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë.”*

Surja 40, ajetet 55, 77: *“Andaj bëhu i durueshëm ti (o Muhamed) sepse pa dyshim, premtimi i Allahut është i vërtetë...”, “Andaj, bëhu i durueshëm, se premtimi i Allahut, me siguri që do të përmbushet. E nëse të tregojmë ty diçka nga dënimi që u kemi premtuar atyre apo nëse të lëmë të vdesësh para kësaj, ata te Ne do të kthehen gjithsesi.”*

Surja 41, ajeti 35: *“Ky virtyt u dhurohet vetëm atyre që durojnë dhe vetëm atyre që kanë një fat të madh.”*

Surja 42, ajeti 33: *“Nëse Ai do, e qetëson erën dhe ato mbesin të palëvizshme në sipërfaqen e detit. Këtu ka shenja për çdo kënd që është i durueshëm dhe mirënjohës.”*

Surja 42, ajeti 43: *“Kushdo që duron dhe fal, ta dijë se në të vërtetë, këto janë nga veprimet më të virtytshme.”*

Surja 46, ajeti 35: “Prandaj, ti bëhu i durueshëm (o Muhamed), ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të dërguarit e vendosur dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ata...”

Surja 68, ajeti 48: “Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd dhe mos u bëj si Njeriu i Peshkut (Junusi a.s.), kur iu lut Zotit të vet i dëshpëruar (në barkun e balenës).”

Surja 73, ajeti 10: “Duroji lllomotitjet e atyre dhe largobu nga ata në mënyrë të hijshme.”

Surja 74, ajetet 7: “dhe për hir të Zotit tënd, duro”

Surja 76, ajeti 12: “dhe për durimin e tyre, Ai do t’i shpërblejë me Xhenet dhe petka të mëndafshta.”

Surja 103, ajeti 3: “përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”

g) Kundër mendjemadhësisë

Surja 7, ajeti 36: “Kurse ata që i mobojnë shpalljet e mija dhe sillen me mendjemadhësi ndaj tyre, do të jenë banorë të zjarrit”

Surja 7, ajeti 48: “Pastaj, njerëzit e Murit (Araf) do t’u thërrasin disa njerëz që i njohin nga pamja, duke u thënë: Nuk ju ndihmoi as grumbullimi i pasurisë, as kryelartësia e juaj (ndaj të Vërtetës).”

Surja 7, ajeti 166: “Kur ata ngulmuan me mendjemadhësi të bënin atë që u ishte ndaluar, Ne u thamë: Bëhuni majmunë të përbuzur.”

Surja 8, ajeti 47: “Mos u bëni si ata (jobesimtarët e Mekës) që dolën nga shtëpitë e tyre me mendjemadhësi e për sy e faqe të botës, duke dashur t’i pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut. Allahu e di mirë çfarë punojnë ata.”

Surja 10, ajeti 75: “Pastaj, Faraonit dhe parisë së tij, pas tyre u dërguam Musain dhe Harunin me mrekullitë tona, por ata u sollën me mendjemadhësi, sepse ishin popull keqbërës.”

Surja 14, ajeti 21: “...ata që kanë genë të përlurur, do t’u thonë atyre që kanë genë kryelartë...?”

Surja 16, ajetet 22, 23, 29: “Zoti i juaj është një Zot i vetëm. Ata që nuk besojnë në jetën tjetër, i kanë zemrat mohuese të së vërtetës dhe janë mendjemëdhenj.”, “S’ka dyshim se Allahu di gjithçka që ata fshehin dhe që shfaqin haptazi. Me të drejtë, Ai nuk i do mendjemëdhenjtë.”, “Hyni në portat e Xhehenemit, ku do të mbeteni përgjithmonë! Eh sa vend i shëmtuar është ai për mendjemëdhenjtë.”

Surja 16, ajeti 49: “Allabut i përkulet në sexhde çdo gjallesë, në qiej dhe në tokë, edhe engjëjt, të cilët nuk janë kryelartë.”

Surja 17, ajetet 4: “Ne u shpallëm solemnisht në Libër bijve të Izraelit: ‘Ju do të bëni dy herë ngatërresa në tokë dhe do të tregoni mendjemadhësi të tepërt.’”

Surja 17, ajeti 37: “Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve.”

Surja 28, ajetet 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82 tregojnë se mendjemadhësia ndëshkohet. Këtu jepet rasti i

Karunit nga populli i Musait, i cili ngazëllehej me pasurinë dhe diturinë e tij, por që e gëlltiti toka bashkë me shtëpinë e pasurinë e tij.

Surja 28, ajeti 83: “*Sa për shtëpinë e botës tjetër, Ne do ta caktojmë atë për ata që nuk kërkojnë as madhështi e as ngatërresa në tokë. Përfundimi është për ata që ruhen nga të këqijat.*”

Surja 29, ajeti 39: “*Kështu ndodhi edhe me Karunin, Faraonin dhe Hamanin. Atyre u vajti Musai me prova të qarta, por ata treguan mendjemadhësi në Tokë dhe nuk i shpëtuan dënimit.*”

Surja 31, ajeti 18, 19: “*Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemadhësitë dhe mburracakët!*”, “*Ec me kujdes e i përmbytur dhe fol me zë të ulët, se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!*”

Surja 34, ajetet 31, 32, 33 Këtu tregohen akuzat që do të zhvillohen DitëneKiametitndërmjetdëdobëtëve dhe atyre që madhështoheshin. Të dobëtit do t’u thonë “Sikur të mos ishit ju, ne do të ishim besimtarë. Ju na keni urdhëruar që ta mohonim Allahun...” Por përgjigja do të jetë : “Nuk ju penguam ne nga udhëzimi i Allahut. Ju jeni keqbërës.”

Surja 35, ajeti 43: “*Ata u sollën me mendjemadhësi në Tokë dhe me dredhi të shëmtuara, të cilat godasin vetëm atë që i bën...*”

Surja 37, ajeti 35: “*...kur u thubej atyre: Nuk ka zot tjetër (të denjë për adhurim), veç Allahut!, ata tregoheshin mendjemadhësitë.*”

Surja 38, ajetet 2: “*...por jobesimtarët janë mendjemadhësitë dhe kundërshtues.*”

Surja 38, ajetet 74, 75: “*përveç Iblisit, ai u bë mendjemadh e një nga mobuesit. Zoti tha: ‘O Iblis, ç’të pengoi ty që të mos përuleshe në sexhde para atij që kam krijuar Vetë me duart e Mia? A mos u bëre mendjemadh apo mendon se je nga të lartët?’*”

Surja 39, ajetet 59, 60: “*Me të vërtetë juve ju erdhi shpallja Ime, por nuk besuat dhe u bëtë mendjemadhësitë e jobesimtarë.*”, “*Në ditën e Kiametit do t’i shihni ata që kanë trilluar gënjeshtër për Allahun, me fytyra të nxira. Vallë a nuk është Xhebenemi vend për ata që janë mendjemadhësitë?*”

Surja 39, ajeti 72: “*Atyre u thubet: ‘Hyni në portat e Xhebenemit, ku do të qëndroni gjithmonë!’ Sa vend i shëmtuar që është ai për mendjemadhësitë.*”

Surja 40, ajeti 27: “*Musai tha: ‘Unë i lutem Zotit Tim dhe Zotit tuaj për të më mbrojtur prej çdo mendjemadhi, që nuk beson në Ditën e Llogarisë!’*”

Surja 40, ajeti 35: “*...Kështu Allahu ia vulos zemrën çdo mendjemadhi e dhunuesi.*”

Surja 40, ajeti 56: “*Ata që polemizojnë për shpalljet e Allahut, pa pasur kurrfarë prove, kanë në zemrat e tyre vetëm mendjemadhësi...*”

Surja 40, ajeti 60: “*Zoti juaj ka thënë: Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemadhësitë e nuk duan të Më adbuojnë, do të hyjnë në Xhebenem të poshtëruar!*”

Surja 40, ajeti 76: “*Hyni në dyert e Xhebenemit për të qëndruar përherë në të! Sa i shëmtuar që është vendbanimi i mendjemëdhenjve!*”

Surja 45, ajeti 8: “*Ai i dëgjon shpalljet e Allahut që i lexohen e përsëri ngulmon në mendjemadhësi, sikur nuk i ka dëgjuar ato; jepi lajmin për dënim të dhembshëm!*”

Surja 45, ajeti 31: “*Ndërsa mobuesve do t’u thubet: ‘Vallë, a nuk ju kanë lexuar shpalljet e Mia? Por ju shfaqët mendjemadhësi dhe u bëtë njerëz të këqij.’*” **Surja 51, ajeti 44:** “*Ata u treguan mendjemëdhenj ndaj urdhrave të Allahut, pastaj i goditi rrufeja...*”

Surja 54, ajetet 25, 26: “*Vallë, vetëm atij mes nesh t’i dërgohet Shpallja? Jo, ai është gënjeshtar e mendjemadh!*”

“(Të dërguarit iu tha) *Nesër do ta marrin vesh ata se kush është gënjeshtari mendjemadh!*”

Surja 57, ajeti 23: “*...Allahu nuk i do kryelartët mburraveçë!*”

Surja 63, ajeti 5: “*Kur u thubet atyre: ‘Ejani, se i Dërguari i Allahut do të kërkojë falje për ju’, ata tundin kokat e tyre dhe i sheh ata të kthehen me mendjemadhësi.*”

Surja 67, ajeti 21: “*Kush janë ata, që do t’ju japin mjete jetese, në qoftë se Ai jua ndalon ato? Por ata janë zhytur në kryeneçësi e mendjemadhësi.*”

Surja 71, ajeti 7: “*Sa herë, që i thirrja për t’i falur Ti, ata shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbulobeshin me petkat e tyre, duke këmbëngulur me mendjemadhësi (në mosbesim).*”

h) Jo imoralitetit

Surja 4, ajetet 15, 16. Këtu flitet kundër imoralitetit dhe ndëshkimit të dyve, por nëse pendohen dhe përmirësohen, këshillohet t’u hiqet dënimi.

Surja 5, ajeti 5: “*...Të lejuara për ju janë femrat e ndershme besimtare dhe femrat e ndershme të atyre që u është dhënë Libri para jush, nëse u jepni pajën e kurorëzimit, duke u martuar me ato e jo duke bërë kurvëri, as duke i marrë për dashnore...*”

Surja 7, ajetet 80, 81, 82, 83: “*Kujtoni fjalët e Lutit, i cili i tha popullit të vet: ‘Përse bëni paturpësi të tilla që askush nuk i ka bërë në botë?’*”, “*Ju u qaseni meshkujve me eps në vend të femrave. Me të vërtetë, ju jeni popull që e teproni me të këqija.*”, “*Përgjigja e popullit të tij ishte: ‘Dëbojini ata nga vendbanimi juaj! Ata janë njerëz që duan të mbahen të delirë.’*”, “*Kështu, Ne e shpëtuam atë me gjithë familje, përveç gruas së tij. Ajo ishte nga ata që mbetën pas (dhe u ndëshkuan).*”

Surja 17, ajeti 32: “*Dhe mos iu qasni kurvërisë, se ajo është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar!*”

Surja 24, ajetet 2, 3: “*Laviren dhe lavirin - t’i rribni çdo njërin prej tyre me nga njëqind goditje. Të mos ju pengojë kurrfarë mëshire për të kryer detyrën e fesë së Allahut, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Fundit. Le ta shikojnë dënimin e tyre një grup besimtarësh!*”, “*Laviri mund të martohet vetëm me laviren apo idhujtaren, kurse laviren mund ta marrë vetëm laviri ose idhujtari. Këto janë të ndaluara për besimtarët.*”

Surja 24, ajeti 26: “Gratë e pandershme janë për burrat e pandershëm dhe burrat e pandershëm janë për gratë e pandershme. Gratë e ndershme janë për burrat e ndershëm dhe burrat e ndershëm janë për gratë e ndershme. Ata janë të pastër nga shpifjet që thuben (kundër tyre) dhe do të falen e do të kenë shpërblim bujar.”

Surja 24, ajeti 30: “Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme). Kjo është më mirë për to...”

Surja 24, ajeti 31: “Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre...”

Surja 24, ajeti 33: “...Mos i detyroni skllavet tuaja të bëjnë kurvëri, që të arrini ju dobi të përkohshme, nëse ato dëshirojnë të jenë të ndershme...”

Po e plotësojmë çështjen 5 “Vlerat morale”, me pikën “sjellja e mirë”, por të gjitha pikat e çështjes më sipër, mund të shihen si pjesë përbërëse të saj. Te suret dhe, ajetet që do të paraqesim, mbizotron më shumë këshillimi për vepra të mira si dhe premtimi për shpërblim i atij, që kryen vepra të mira. Disa herë është treguar edhe kur keqbërësi do të ndëshkohet.

i) Sjellja e mirë

Surja 2, ajeti 25: “Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, gëzoji me kopshte të Xhenetit...”

Surja 2, ajeti 42: “Mos e përzieri të vërtetën me të pavërtetën dhe të vërtetën mos e fshehni me vetëdije.”

Surja 2, ajeti 62: “...dhe bën vepra të mira, do të shpërblehet nga Zoti i tyre...”

Surja 2, ajeti 79: “Mjerë ata që me duart e tyre shkruajnë Librin e pastaj thonë: ‘Kjo është prej Allahut’ që për këtë të kenë ndonjë dobi të vogël (materiale)...”

Surja 2, ajeti 80: “Ata thonë: ‘Zjarri do të na prekë vetëm ca ditë të numëruara’...a po shpifni kundër Allahut gjëra që nuk i dini?”

Surja 2, ajeti 81: “...Ata që bëjnë vepra të këqija dhe mbulohen nga fajet e veta, do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”

Surja 2, ajeti 82: “Kurse ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”

Surja 2, ajeti 83: “Kujtoni kur Ne morëm besën tuaj, o bijtë e Izraelit, se do të adhuroni vetëm Allahun, do të silleni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët dhe të varfrit, do t’u thoni fjalë të mira njerëzve, do të falni namazin e do të jepni zëqatën...”

Surja 2, ajeti 84: “dhe kujtoni kur nga ju morëm besën që të mos derdhni gjakun e njëri-tjetrit dhe të mos e dëboni njëri –tjetrin nga banesat tuaja. Ju e pranuat këtë dhe dolët dëshmitarë.”

Surja 2, ajeti 85: “Mirëpo, ja tek jeni, duke vrarë farefisin tuaj, duke i dëbuar disa syresh nga shtëpitë e veta dhe duke ndihmuar njëri-tjetrin kundër tyre, fajësisht dhe armiqësisht. Dhe kur ju vijni të robëruar, ju i shpëtoni nga robëria me të

holla, ndërkohë që me marrëveshje e keni të ndaluar t'i dëboni...Cilido që vepron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër..."

Surja 2, ajeti 87: *"...Sa herë që ndonjë i dërguar ju sillte atë që nuk ju pëlqente, ju kapardiseshit, prandaj disa i quajtët gënjeshtarë e disa i vratë."*

Surja 2, ajeti 112: *"Vërtet, ata që i përgulen Allahut dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre..."*

Surja 2, ajeti 148: *"...Bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira..."*

Surja 2, ajeti 177: *"...mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun..."*

Surja 2, ajeti 215: *"...Çfarëdo bamirësie që bëni, ajo le t'u takojë prindërve, farefisit, jetimëve, të varfërve dhe udhëtarëve..."*

Surja 2, ajetet 190, 193: *"Luftoni... ndaj atyre që luftojnë kundër jush, por mos e kaloni kufirin...", "...Nëse ata heqin dorë nga lufta kundër jush, atëherë s'ka armiqësi, përveçse kundër keqbërësve."*

Surja 2, ajeti 219: *"...Vera dhe kumari sjellin dëme të mëdha, por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, dëmi i tyre është më i madh se dobia... Të pyesin se çfarë dubet të japin si lëmoshë? Thuaju: 'Tepricën!...'"*

Surja 2, ajeti 224: *"Mos e bëni pengesë betimin ne Allahun për kryerjen e veprave të mira, largimin prej të ligave dhe pajtimitin e njerëzve!..."*

Surja 2, ajeti 225: *"Allahu nuk ju dënon nëse betoheni pa qëllim..."*

Surja 2, ajeti 275. Këtu dënohet marrja e fajdes, kamata.

Surja 2, ajeti 276: *"Allahu ia heq çdo përfitim kamatës, ndërsa e rrit përfitimin e bamirësisë..."*

Surja 3, ajeti 104: *"Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në bamirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit."*

Surja 3, ajeti 110: *"Ju jeni populli më i mire i dalë për njerëzimin, (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun..."*

Surja 3, ajeti 114: *"Ata besojnë Allahun dhe Ditën e Kiametit, e urdhërojnë të mirën, e ndalojnë të keqen dhe nxitojnë për të bërë punë të mira. Këta janë ndër të drejtët."*

Surja 3, ajeti 130: *"O besimtarë! Mos pranoni kamatë të shumëfishtë mbi kamatë! Kijeni frike Allahun që të shpëtoni."*

Surja 3, ajetet 133, 134, 135, 136. Në këto ajete tregohet se do të ketë shpërblim madhështor për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë, edhe kur janë në mirëqenie edhe kur janë në vështirësi, që mposhtin zemërimin dhe iu falin fajet njerëzve, si edhe për ata që kërkojnë falje për gynahet e tyre.

Surja 4, ajeti 1: *"...ruani lidhjet farefisnore..."*

Surja 4, ajetet 29, 30: *"...Mos e përvetësoni pasurinë e njëri tjetrit në mënyrë të palejueshme, përveç rastit kur ajo është tregti me pëlqim të dyanshëm dhe mos e vritni veten...", "Këdo prej jush që e bën këtë përdhunisht dhe padrejtësisht, Ne pa dyshim, do ta hedhim në zjarr. Kjo është shumë e lehtë për Allahun."*

Surja 4, ajeti 36: *“...silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin (që ka mbetur ngushtë) dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj...”*

Surja 4, ajeti 112: *“Kush bën ndonjë gjynah ose të keqe, pastaj ia vesh atë një të pafajshmi, atëherë ai e ka ngarkuar veten me fajin e shpifjes dhe me një gjynah të qartë.”*

Surja 4, ajeti 149. Këtu njerëzit ftohen për vepra të mira, të kryera haptazi ose fshehtas.

Surja 5, ajeti 6. Këtu, besimtarëve u kërkohet pastërti, sidomos gjatë kryerjes së namazit. Tregohet si duhet ta kryej pastrimin (abdesin) i shëndoshi dhe i sëmuri, me ujë ose kur uji mungon.

Surja 5, ajeti 9: *“Allahu u ka premtuar (falje të gjynahëve) dhe shpërblim të madh atyre që besojnë e bëjnë vepra të mira.”*

Surja 5, ajeti 32: *“...kush vret ndokënd, që s’ka vrarë njeri e që nuk ka bërë çrregullime në tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve...”*

Surja 5, ajetet 33, 34, 35, 38, 39. Në këto ajete, tregohet ndëshkimi për ata që bëjnë shkatërrime në tokë dhe falja për ata që pendohen dhe bëjnë më pas vepra të mira.

Surja 5, ajeti 45. Këtu tregohet shpagimi në Teurat.

Surja 5, ajeti 89: *“Allahu nuk ju ndëshkon për betimin që e bëni pa qëllim,*

por ju ndëshkon për betimin e bërë me qëllim. Shlyerja...”

Surja 5, ajetet 90, 91: *“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyra...”*

Surja 6, ajeti 151: *“...të silleni mirë me prindërit, mos vrisni fëmijët për shkak të varfërisë..., mos iu afroni veprave të turpshme..., të mos ia merrni jetën tjetrit, veçse kur e kërkon drejtësia (ligji)...”*

Surja 6, ajeti 152: *“Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të arrijë pjekurinë. Kryeni drejt matjen dhe peshimin; Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësisë së tij. Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj...Këto ju porosit Ai që të mos harroni.”*

Surja 10, ajeti 26: *“Ata që bëjnë vepra të mira do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër. Fytyrat e tyre nuk do t’i mbulojë as errësira, as poshtërimi. Ata do të jenë banorë të Xhenetit, në të cilin do të banojnë përherë.”*

Surja 11, ajeti 23. Edhe këtu, si më sipër, tregohet se do të shpërblehen ata që kryejnë vepra të mira.

Surja 13, ajeti 29. Edhe këtu, shpërblimi i veprave të mira.

Surja 14, ajetet 23, 24, 25, 26. Edhe këtu, shpërblimi i veprave të mira dhe i fjalës së mirë. Ndërsa fjala e keqe krahasohet me pemën e keqe.

Surja 16, ajetet 30, 97. Edhe këtu shpërblimi i veprave të mira.

Surja 16, ajetet 58, 59. Tregojnë për ata që kur u lindte

vajzë, mbusheshin me mjerim dhe mendonin për ta varrosur të gjallë në dhë.

Surja 16, ajeti 90: “Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon që t’ia vini veshin.”

Surja 16, ajeti 94: “Mos i përdorni betimet tuaja për të mashtruar njëri-tjetrin...”

Surja 16, ajeti 96: “...Ne do t’i shpërblejmë ata që kanë duruar sipas veprave më të mira që kanë bërë...”

Surja 17, ajeti 9. Përsëri, premtohet shpërblimi për veprat e mira.

Surja 17, ajetet 23, 24: “...të silleni mire me prindërit. Nëse njeri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as ‘uh’, mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti.” “...e thuaj: ‘O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël.’”

Surja 17, ajeti 25: “...Nëse ju jeni të drejtë, Ai është falës për ata që pendohen.”

Surja 17, ajeti 31: “Mos i vrisni fëmijët nga frika e varfërisë! Ne u sigurojmë ushqim atyre dhe juve. Vërtet, vrasja e tyre është gjynah i madh.”

Surja 24, ajetet 27, 28: “O besimtarë! Mos hyni në shtëpitë e huaja pa marrë leje e pa i përshëndetur banorët e tyre...” “Nëse atje nuk gjeni askënd, mos hyni derisa t’iu lejohet...”

Surja 24, ajetet 58, 59, 60, 61, 62, 63: “O besimtarë! Sklleverit dhe fëmijët tuaj që s’kanë arritur pubertetin,

le t’ju kërkojnë leje (për të hyrë) ... Nuk ka gjynah as për ju e as për ata që, pas këtyre rasteve, të vizitoni njëri-tjetrin (pa kërkuar leje për të hyrë)...”, “Kur fëmijët tuaj të arrijnë moshën e pubertetit, le të kërkojnë leje, ashtu siç kanë kërkuar leje ata para këtyre...”, “Kur të hyni në shtëpi, të përshëndetni njëri-tjetrin me përshëndetje të mirë e të bukur...”, “...Kur të kërkojnë leje prej teje për ndonjë punë të tyre, jepi leje kujt të duash...”, “Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit...”

Surja 28, ajeti 84: “Kush bën një të mirë, do të ketë shpërblim më të mirë se ajo. Ndërsa, ai që bën një të keqe, do të dënohet vetëm aq sa e meriton vepra e tij.”

Surja 29, ajeti 8: “Ne e kemi urdhëruar njeriun që të sillet mirë me prindërit...”

Surja 29, ajeti 9: “Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri do t’i radhisim në mesin e më të mirëve.”

Surja 31, ajeti 14: “Ne e kemi urdhëruar njeriun që të nderojë prindërit e vet...Ne i thamë atij: ‘Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu!’”

Surja 31, ajetet 13, 16, 17, 18, 19. Vetë surja 31 emërtohet “Lukmani” dhe vetëm në, ajetin 12 ky emër përmendet kështu: “Ne i dhamë Lukmanit urtësinë (duke i thënë): ‘Falënderoje Allahun! Kush është falënderues, e bën për të mirën e vet dhe kush mohon, ta dijë se vërtet Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i denjë për lavdërim.’” Më pas, në ajetet e shënuara më sipër, tregohen porositë e bukura të tij (Lukmanit) për djalin e vet:

Urdhëroje të mirën, pengoje të keqen, bëhu i durueshëm, mos i trajto njerëzit me nënçmim, mos ec në tokë me mendjemadhësi, fol me zë të ulët, ec me kujdes e i përmbajtur...

Surja 31, ajeti 22. Pohohet se punëmiri do të shpërblehet.

Surja 33, ajeti 29. Edhe këtu pohohet shpërblimi për gratë e profetit Muhamed, nëse kryejnë vepra të mira.

Surja 46, ajetet 15, 16: *“Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellsbëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gjë për tridhjetë muaj dhe kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë: ‘O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ti kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!’.”* *“Këta janë ata njerëz, të cilëve do t’ua pranojmë veprat e tyre më të mira e nuk do t’ua vëmë re veprat e tyre të këqija...”*

Surja 46, ajetet 17, 18, 19. Njerëzit e tjerë, që u thonë prindërve të vet: “Uf, ju” dhe i kundërshtojnë ata në këshillat që u bëjnë lidhur me besimin në Allah, këta njerëz do të jenë përherë të humburit.

Surja 49, ajeti 6: *“...Nëse ndonjë njeri i pandersbëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.”*

Surja 49, ajeti 9, 10: *“Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdbrat e Allahut. E nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe paanësi, sepse Allahu i do ata, që veprojnë me drejtësi.”*, *“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre...”*

Surja 49, ajeti 11: *“O ju që keni besuar! Asnjë burrë prej jush të mos tallet me burra të tjerë, se këta mund të jenë më të mirë se ai. Gjithashtu, asnjë grua të mos tallet me gra të tjera, se këto mund të jenë më të mira se ajo. Mos e nënçmoni dhe mos e qesëndisni njëri-tjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq pas (pranimit të) besimit! Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës.”*

Surja 49, ajeti 12: *“O ju që keni besuar! Mënjaroni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë grynab. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin...”*

Surja 65, ajeti 11. Përsëri pohohet se ata që bëjnë vepra të mira, do të shpërblehen.

6: Të tjera

Le të sqarojmë më poshtë kuptimin e fjalisë: **“Allahu ju dënoi me dëshpërim pas dëshpërimit...”**, e cila ndodhet te:

Surja 3, ajeti 153: *“Kur ju morët malin dhe nuk i vinit veshin askujt, të Dërguarin e kishit prapa e ju thërriste, Allahu ju dënoi me dëshpërim pas dëshpërimit, që të mos pikëlloheni as për*

*atë që ju doli duarsh, as për atë që ju goditi.
Allahu di gjithëka që punoni ju.”*

Te [2, f. 186], shkruhet se psikologët thonë se, nëse një njeriu i bie një fatkeqësi dhe kalon në trishtim, pastaj i bie një fatkeqësi edhe më e madhe se e para, ai e harron trishtimin për fatkeqësinë e parë, duke pasur edhe më të fortë trishtimin për të dytën. Por kur merr vesh se fatkeqësia e dytë nuk ishte e vërtetë, nuk ka ndodhur, ai qetësohet dhe pothuajse e harron edhe të parën. Kështu p.sh. nëse dikujt i kanë vjedhur një sasi të hollash, ai dëshpërohet, por nëse merr vesh se fëmija i tij është aksidentuar rëndë dhe ka rrezik jete, ai i harron paratë e vjedhura dhe përqendrohet tek i biri. Kur mëson se i biri ka shpëtuar, ai qetësohet shpirtërisht dhe gati i harron paratë e humbura.

Më poshtë po tregojmë disa këshilla e thënie të dobishme, si:

Surja 7, ajetet 31, 32, 33: “*...hani e pini por, mos e teproni...”, “...Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet...”, “Zoti im ka ndaluar vetëm punët e pabijshme, qofshin të hapta ose të fshehta dhe gjynahet, dhunimin pa të drejtë...dhe të thoni për Allahun atë që nuk e dini.”*

Surja 17, ajeti 36: “*Mos shko pas diçkaje që nuk ke dijeni...”*

Surja 57, ajetet 23, 24: “*... Allahu nuk i do kryelartët mburraveçë*

e as ata që, përveçse janë vetë koprracë, i nxisin edhe të tjerët në koprraci...”

Surja 58, ajeti 9: “*O besimtarë! Kur të bisedoni fshehtas mes jush, mos flisni për gjynabë, armiqtësi dhe mosbindje ndaj të Dërguarit; por bisedoni për mirësi dhe drejtësi...”*

Surja 70, ajetet 10-21, flasin për personin fajtor, që ka grumbulluar pasuri dhe e ka fshehur, që është i paqëndrueshëm; kur i bie një e keqe, ligështohet, por kur i bie një e mirë, bëhet koprrac. Ai nuk do të pyesë as për fëmijët, as për gruan, as për vëllain e as për shokun e do t’i sakrifikonte të gjithë ata për të shpëtuar nga zjarri flakërues.

Surja 89, ajetet 16-23. Ka njerëz që kur sprovohen me ngushtim jetese, thonë “Zoti më ka poshtëruar” Por nuk është kështu, ata nuk sillen mirë me jetimët, nuk ushqejnë të varfrit, trashëgiminë e zhvatin me lakmi dhe e duan pasurinë me një dëshirë të pakufishme. Këta do të jenë prej të ndëshkuarve.

Surja 90, ajetet 4-18. Njeriu është krijuar për të luftuar në vështirësi...Dhe rruga e vështirë është të lirosh një skllav, të ushqesh në ditë zie jetimin e afërm ose të varfrin e mjerë. Njeriu duhet të besojë, të këshillojë për durim dhe për mëshirë.

Surja 104, ajetet 1-4: “*Mjerë për çdo shpëfës-përqeshës, që grumbullon pasuri dhe e ruan, duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pandekshëm! Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese...”*

Surja 107, ajetet 1-7. Këtu pohohet se ai që mohon Ditën e Llogarisë, është ai që dëbon ashpër jetimet, nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit, fal namaz sa për t'u dukur dhe nuk u jep ndihmë nevojtarëve.

Studimet e sotme kanë treguar se ngjyra e gjelbër sjell qetësim, gëzim dhe gjallëri në mendime. Ngjyra e gjelbër përmendet në disa sure e ajete, si ngjyrë e Xhenetit, konkretisht:

Surja 18, ajeti 31: "...do të vishen me rroba të gjelbra..."

Surja 55, ajeti 76: "...ata rrinë në mbështetëse të gjelbra..."

Surja 76, ajeti 21: "...kanë veshur petka prej mëndafshi të hollë e të gjelbër..."

Në suren e mëposhtme tregohet urdhëresa e Zotit për mbulesën e femrës:

Surja 33, ajeti 59: "O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët..."


Duke ditur se racizmi edhe sot përbën një problem shumë të mprehtë kudo në botë, vërejmë se ajetet e mëposhtëm, tregojnë se Islami priret drejt barazisë, pa pasur asnjë diskriminim mbi baza gjinie, race, ngjyre, pozite social-ekonomike, kulture apo kombësie. Të gjithë njerëzit janë pasardhës të Ademit dhe Havasë.

Surja 30, ajeti 22: "Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjubëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë."

Surja 49, ajeti 13: "O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri tjetrin..."

Në përfundim disa paraqitje grafike rreth punimit:

a) Për këtë punim, nga numri i përgjithshëm i sureve në Kur'an, 114, del se janë përfshirë 71 sure, ndërsa nga 6185 ajete gjithsej, janë përdorur vetëm 652 të tillë. Fig. 1



b) Duke ditur se gjatësia e sureve në Kur'an, e lidhur me numrin e ajeteve që përmbajnë, shkon nga 3 deri në 286 ajete, del se

janë përdorur në punim për suret e ndryshme, nga 0 ajete deri në 72 ajete. Shpërndarja e numrit të ajeteve sipas sureve të përdorura në punim, tregohet grafikisht në Fig. 2

c) Për çështjet e ndryshme, shpërndarja e numrit të sureve dhe të ajeteve të përdorura për to në punim, paraqitet në grafikun më poshtë, Fig. 3:




Fig. 2




Fig. 3

Literatura

“Kur’ani i madhërisëm” *Mbështetur në përkthimin e Prof. Hasan I. Nabi* – botim i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam, 2012

“Thesare në Kur’an” Përshtatur nga Orjeta Deda (Bulku) dhe Saimir Bulku, “Progres”, Tiranë 2002.

“Islami”, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2019 faqja në internet.

Roli i gruas në edukimin e brezave, bazuar në revistat kulturore islame

Dr. Ilirjana Kaceli
Departamenti i Drejtësisë
Universiteti Bedër

Abstrakt

Në të gjitha periudhat historike, si dhe në të gjitha shoqëritë, roli i gruas në familje dhe shoqëri mbetet i pazëvendësueshëm. Ato janë shquar jo vetëm në detyrën e tyre si nënë, grua, motër, bijë, por edhe si dijetare, prijëse dhe udhëheqëse të shtetit. Ato janë përpjekur dhe kanë arritur të edukojnë breza, që me veprat e tyre lanë shenjë dhe gjurmë në histori. Ato i rritën fëmijët e tyre me dashurinë dhe sakrificën për atdheun, i pajisën me kulturën e dubur dhe edukatën për të qenë bij të denjë dhe besimtarë të devotshëm. Ato luajnë rolin kryesor në familje, e cila është baza e shoqërisë dhe si e tillë mund të themi që shoqëria dhe shteti lulëzojnë e përparojnë vetëm prej disiplinës, rregullit, bashkimit dhe paqes, si dhe nga individë të edukuar dhe mirëarsimuar. Figura e gruas dhe roli i saj në edukimin e brezave ka zënë një vend të rëndësishëm në revistat kulturore islame si: Zani i Naltë, Kultura Islame, Njeriu, Dituria Islame, Drita Islame të botuara në viset shqiptare. Këto revista pasqyrojnë gjerësisht veprimtarinë e gjerë, misionin human, përkushtimin, besimin, devotshmërinë dhe cilësitë e rralla të shumë nënave, motrave dhe grave myslimane.

Hyrje

Gruaja është njëri prej dy elementëve kryesorë nga të cilat formohet familja dhe shoqëria. Roli i saj në shoqërinë njerëzore mbetet i pazëvendësueshëm në lindjen, edukimin dhe transmetimin e cilësive të njeriut me virtyte të larta në shekuj, brez pas brezi. Gratë përbëjnë gjysmën e shoqërisë dhe ato janë përgjegjëse për të edukuar, drejtuar brezat që do të vijnë. Ato u përpoqën dhe arritën t'i rrisin fëmijët e tyre me dashurinë dhe sakrificën për atdheun, i pajisën me kulturën e duhur dhe edukatën për të qenë bij të denjë dhe besimtarë të devotshëm. Roli i gruas si bijë, motër, nënë dhe bashkëshorte është me të vërtetë i fuqishëm, sepse pikërisht tek ato qëndron forca tek e cila mund të mbështetemi, të gjejmë forcë dhe besim, dhe nga ku presim të përfitojë jo vetëm familja e ngushtë, por edhe komuniteti dhe gjithë shoqëria. Pra mund të themi se *“Gruaja është ura lidhëse e të gjitha shoqërive dhe çelësi i sekretit të mbarëvajtjes së tyre.”*¹

Të flasësh për rolin dhe pozitën e gruas në botë, si asaj të fesë myslimane, por edhe të feve të tjera, patjetër duhet t'i referohesh historisë. Pozita e saj në shoqëritë e vjetra do të dallonte sipas institucioneve shtetërore, por edhe

sipas ligjeve dhe shoqërive. Në disa vende ajo kishte arritur të ngrihej në shkallët më të larta, madje arrinte të drejtonte dhe udhëhiqte shtetin në pozitën e mbretëreshës Kleopatra në Egjipt, apo në Iliri mbretëresha Teutë. Ndërsa në disa vende të tjera të botës së lashtë femra mbyllej në shtëpi, varrosej për së gjalli, apo trashëgohej si plaçkë, siç ndodhte në shoqëritë e vjetra indiane, romake, etj. Si të gjitha gratë e botës, edhe gruaja shqiptare, dhe historia nëpër të cilën ka kaluar ka qenë e gjatë dhe e mundimshme².

Që nga lashtësia e deri më sot duhet të theksojmë se gruaja ka marrë pjesë aktive në jetën e vendit. Krahas burrit, gratë kanë luftuar dhe kanë treguar heroizëm të rrallë në beteja dhe luftëra të ndryshme për mbrojtjen e atdheut. Veprimtaria e tyre është aq e madhe dhe e fuqishme, saqë mendimtari dhe ideologu i shquar i Rilindjes Kombëtare shqiptare, Sami Frashëri, iu kushtoi atyre një vepër të plotë me emrin *“Gratë”* (Kadinlar).

Samiu ishte luftëtar i të drejtave njerëzore, një paralajmëtar i një bote të re pa despotizëm dhe pa shtypjen e dinjitetit të njeriut. Dëshmia më kuptimplotë ndoshta është qëndrimi i Samiut ndaj gruas. Problemit të gruas, të vendit të saj në shoqëri, të rrugëve të emancipimit të saj, të

1. <http://www.dritaislame.al/nga-Valmira-Demaj>.

2. Dr. Sabile Kecmezi-Basha, *Roli i femrës në ruajtjen e identitetit kombëtar*, botuar në: *Dituria Islame*, nr. 44, f. 30.

cilat ai do t'i shprehte në librin e tij. Shkrimet e Samiut, e gjithë vepra e tij në shqip dhe në turqisht është e mbushur më një besim të madh tek e ardhmja e vendit. Prandaj gruas do i njihnte një rol të rëndësishëm në shoqëri, atë të edukimit të brezit të ri dhe, nëpërmjet tij, të konsolidimit të vetë shoqërisë. “*Një shtet i qytetëruar, - shkruante Samiu, - mbështetet në edukatën e gruas.*”³

Me të drejtë, ai në librin “Gratë” do të vlerësonte figurën e gruas si shtyllë e familjes dhe e shoqërisë. Botëkuptimi i tij mbi gruan dhe rolin e saj është tejet interesant dhe tepër përparimtar, pavarësisht rrethanave historike dhe kohës në të cilën u shkrua vepra. Ai shkruante se: “*Përparimi i shoqërisë njerëzore varet nga edukata e grave. Atëherë pra lipset që mësimi i parë i qytetërimit e i përparimit të jetë edukimi i grave.*”⁴

Në libër ai rrëfente të drejtat që ka gruaja për shkollim dhe punësim, duke na dhënë edhe qëndrimin e Islamit ndaj gruas dhe të drejtat dhe detyrat që ai ia parashtron asaj⁵. Ai e shpjegon edukimin e grave nëpërmjet dy argumenteve:

3. *Historia e Popullit Shqiptar, (Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek.XIX-1912)*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë - Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 342.

4. Sami Frashëri, *Gratë (vepra 15)*, Shtëpia Botuese, Logos-A, Prishtinë 2004, f. 19.

5. Mr. Abdullah Hamiti, *Sami Frashëri për rolin e gruas në familje e në shoqëri*, botuar në, Dituria Islame, nr. 72, f. 26-27.

I pari, meqë gjysma e popullsisë së globit tokësor përbëhet nga gratë, duke edukuar ato, nëpërmjet tyre edukohet gjysma e racës njerëzore. *I dyti*, nëpërmjet edukatës familjare, dhënë nga gratë, nënat, trashëgohet kultura dhe edukata në të ardhmen e racës njerëzore⁶.

Samiu më tej shtonte se materia e kësaj vepre është shumë e gjerë dhe shumë e rëndësishme, meqë gratë përbëjnë gjysmën e njerëzimit. Ai thekson se është i vetëdijshëm se në një broshurë të tillë nuk mund të shpjegojë gjerësisht pozitën e saj (gruas), por se dëshiron të thotë disa fjalë mbi gjendjen dhe rolin e gruas në përgjithësi, dhe në veçanti për gratë myslimane, aq më tepër kur në gjuhët tona, nuk është shkruar asgjë për këtë çështje të rëndësishme, e cila, në të vërtetë, do të ishte shpëtim për shoqërinë. Samiu e përshkruan gjerësisht gjendjen e gruas në të kaluarën dhe rolin e rëndësishëm të saj në përgjithësi duke nënvizuar se “*Esenca dhe rëndësia e grave është kuptuar shumë vonë*”. Pasi përmend disa dallime natyrore midis burrit dhe gruas ai shton se gratë nuk duhen privuar nga të drejtat dhe detyrat që i kanë fituar burrat dhe shton se “*Gruaja është baza e shoqërisë njerëzore, shtylla e moralit publik, një e një lidhjeje të shenjtë, familjes, e cila e nxjerr njeriun nga errësira dhe e qytetëron. Ajo është lulësimi e njerëzimit*”. Samiu gjithashtu vlerëson

6. Sami Frashëri, *Gratë (vepra 15)*, Shtëpia Botuese, Logos-A, Prishtinë 2004, f. 20.

arsimimin dhe edukimin e gruas për të ardhmen e shoqërisë njerëzore duke theksuar se “...qytetërimi mund të arrihet me lehtësi e shpejtësinë më të madhe vetëm nëpërmjet edukimit të gruas”.

Dihet se edukata e mirë është begatia e njeriut, prandaj nëpërmjet teorive dhe mendimeve pedagogjike shpjegohet se fëmija, në fëmijëri, është i lidhur më ngushtë me nënën dhe se hapat e para të shkollimit dhe të edukimit i merr nga vetë ajo. Prandaj Samiu shprehet se “Edukimi i fëmijëve varet nga gratë, sa më e edukuar të jetë gruaja në përgjithësi po aq e edukuar është edhe shoqëria njerëzore.” dhe më tej ai e shtjellon mendimin e tij në veprën “Gratë” kur thotë se “Krijuesi i Madhëruar, grave u ka dhënë butësinë të rrisin dhe të edukojnë fëmijë... pas dasburisë së nënës, përkëdheljeve të saj, kur shkon në shkollë, edhe më e dobishme është që mësuesi i tij i mektepit (shkollës fillore) të jetë femër, ngase edukimi lehtësobet dhe shpejtobet”, duke bërë krahasimin me vendet e përparuara perëndimore. Sipas tij, sa më e ngritur të jetë gruaja në familje aq më e shëndoshë është familja, aq më e fortë shoqëria dhe aq më i dashur do të jetë atdheu. Idetë e Samiut mbi të drejtën e gruas në Islam do të pasqyroheshin edhe në revistat kulturore islame që e filluan botimin e tyre në vitet 20-30 të shekullit kaluar në Shqipëri, në momentin kur elita politike shqiptare e asaj kohe po përpiquej që të vendoste institucionet shtetërore mbi krizat politike të kohës.

Figura e gruas dhe roli i saj i rëndësishëm në edukimin e brezave u shtrua në artikuj të ndryshëm dhe nga pena të fuqishme të kohës në të gjitha revistat kulturore islame si: “Zani i Naltë”, “Kultura Islame”, “Njeriu”, “Dituria Islame”, të botuara në viset shqiptare. Këto revista pasqyruan gjerësisht veprimtarinë e gjerë, misionin human, përkushtimin, besimin, devotshmërinë dhe cilësitë

7. Revistat kulturore islame “Zani i Naltë”, organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, u themelua në tetor të vitit 1923, menjëherë pas Kongresit të parë të Komunitetit Mysliman Shqiptar. Botimi i kësaj reviste zgjati deri në vitin 1939. Pas ndërpreprjes së saj në Shqipëri fillon të botohet revista “Kultura Islame”, që zgjati nga 1 shtatori 1939 e deri në janar-shkurt të vitit 1946. Krahas tyre, në Shqipëri, u botuan edhe revista “Njeriu”, organ i organizëts “Drita Hyjnore”. Kjo revistë filloi të botohej nga muaji korrik i vitit 1942 deri në shtator 1944 nën drejtimin islam të Sherif Putrës. Por fatkeqësisht, me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri, nga regjimi komunist, u ndaluan të gjitha veprimtaritë fetare dhe publicistika islame në gjuhën shqipe u shua. Në Kosovë revista “Dituria Islame” e pa dritën e botimit në vitin 1986, si periodik tremujor kulturor-informativ. Edhe pse revistë e sapo lindur është një ndër revistat në të cilën shpалosen ngjarjet që bënë kthesat e mëdha për historinë më të re të popullit shqiptar, sidomos atij jashtë kufijve të Shqipërisë. Pas rënies së sundimit komunist në Shqipëri filluan të botohen “Drita Islame” në vitin 1992 dhe “Zani i Naltë” në 2012, si vazhdimësi e revistave kulturore të mëparshme dhe si tribunë ku do të shpалosen njohuritë e personaliteteve akademike nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia.

e rralla të shumë nënave, motrave dhe grave myslimane.

Në revistat shkencore kulturore që merren me shkencat islame janë botuar një numër i madh artikujsh me tematikë mjaft të gjerë dhe në shumë fusha e lëmi si filozofi, moral, letërsi, sociologji, histori islame, shoqëri, ekonomi, familje, për figurën e gruas, edukimin dhe literaturë kombëtare. Në këto revista botuan personalitete, dijetarë dhe intelektualë të shquar të fesë islame, si Haki Sharofi, Salih Vuçiterni, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ali Kraja, etj. Por krahas tyre botuan shkrime edhe bashkëpunëtorë të fushave të ndryshme, intelektualë të elitës politike dhe asaj shoqërore të kohës, si Ferit Vokopola, Mehdi Frashëri, Lumo Skëndo, Shefqet Muka, etj.

Që nga viti 1923, kur nisi botimin e saj, revista shkencore-kulturore “Zani i Naltë”, në numrat e ndryshëm të saj, i ka prirë edukimit të shoqërisë shqiptare jo vetëm në aspektin shpirtëror, por edhe në atë juridik, kulturor e social. Në ato vite kur shoqëria shqiptare kishte nevojë për një ringritje në të gjitha fushat, revista “Zani i Naltë” mori përsipër trajtimin e një sërë çështjesh, duke shërbyer jo thjesht vetëm si një revistë, por edhe si një shkollë edukimi për brezat e rinj.

Në numrin e parë të saj, revista “Zani i Naltë”, mbi kapak kishte të shkruar shënimin: “*Revistë fetare, merret edhe me filozofi, moral, literaturë*

kombëtare, sociologji”. Pra ajo do të kishte fushë të gjerë studimi dhe do të trajtonte problematika të ndryshme.

Në revistën “Zani i Naltë”, krahas tematikave të larmishme të përmendura më sipër, mes tyre gjejmë edhe një rubrikë të veçantë për gruan, problemet e saj shpirtërore dhe sociale në përgjithësi: Në rubrikën e gruas, u botuan artikuj si: “*Gruaja në myslimanizëm me disa pjesë, Ne demokrasit detyra sociale e gruas, Rëndësia e martesës, Gruaja duhet ta respektojë Kuranin më tepër se mashkulli, Vlera e diturisë, pozita e gruas në fenë islame, Edukata shoqërore e gruas në islam, Edukata morale, rregullat e mirësjelljes dhe të nxanët, Gratë e famshme myslimane në dituni, Pak fjalë më Prindërit (Haxhi Kalaja), Rregullat e mirësjelljes*”, etj.

Numra të ndryshëm të revistës “Zani i Naltë” kanë sjellë objekte diskutimi për dukuri të ndryshme nëpërmjet parashtrimit, analizave, diskutimit, debatit dhe detyrave. Janë trajtuar problemet e marrëdhënieve shoqërore dhe familjare, emancipimi i gruas myslimane, kuptimi i drejtë i civilizimit dhe progresit, lufta kundër veseve shoqërore, në përputhje me vlerat, normat dhe etikën islame si dhe atë kombëtare.⁸

Qëllimi kryesor i revistës “Zani i Naltë” ishte vendosja e një ekulibri,

8. “90 vjet Revista “Zani i Naltë”, <http://www.dritaislame.al/90-vjet-revista-zani-i-nalte/>-nga Fatma Karaj

një mesoreje të artë, që i vlerëson vajzat dhe gratë në përputhje me pikëpamjet e Islamit dhe dispozitat e familjes në Sheriat dhe, njëkohësisht, iu njeh atyre të drejtën e aktivizimit në të gjitha fushat.

Në një nga shkrimet e posaçme të botuar në njërin nga numrat e revistës, të titulluar “Modeli islam në emancipimin e gruas”, thuhet se “*Kjo qasje e mesme ndaj emancipimit të gruas dhe ruajtjes së feminitetit të saj, bazohet gjithashtu te praktikatat profetike që rridhnin nga logjika e Kur’anit. Këto praktika të cilat e emancipuan gruan muslimane dhe e çliruan atë nga varrosja për së gjalli, e shndërruan atë në një forcë aktive në ndërtimin e familjes, shtetit dhe civilizimit islam, e bënë atë pjesëmarrëse në të gjitha fushat e jetës dhe të fesë. Diçka të tillë e gjejmë që ditët e para të lindjes së diellit Islam.*”⁹

Vëmendjen e revistës “Zani i Naltë” ndaj figurës së gruas e dëshmon edhe studiuesi Viron Koka në studimin e tij “*Kultura islame shqiptare në vitet ’20-’30*”, ku midis të tjerave vlerëson çështjet që kanë të bëjnë me pozitën e saj në familje dhe shoqëri, të cilat zinin një vend të rëndësishëm në këtë revistë dhe rreth tyre diskutohej shpesh. Një problem tjetër social dhe kulturor me rëndësi, sipas tij, ishte edhe qëndrimi ndaj gruas dhe familjes. Për këtë çështje,

9. Dr. AMARE, Muhamed, *Modeli islam në emancipimin e gruas*, Zani i Naltë, <http://zaninalte.al/2015/06/modeli-islam-ne-emancipimin-e-gruas/>

ishte diskutuar mjaft në këto vite dhe ishte kërkuar emancipimi i gruas.¹⁰

Në Islam, familja është unioni i ndërtimit të shoqërisë, mbi forcën dhe bashkimin e saj është i ndërtuar sigurimi dhe mirëqenia e shoqërisë. Familja në Islam synon plotësimin e qëllimeve të saj, duke shkëmbyer qetësinë, mëshirën dhe dashurinë mes pjesëtarëve të saj.

Nëpërmjet mendimeve të shprehura në faqet e saj, kjo revistë, përveç dhënies së shpresës dhe besimit, solli edhe siguri për brezat e ardhshëm, kur pohonte: “*Mos të kujtojë brezi i ri se për përparimin e njerëzisë, për mbarëvajtjen e jetës sociale brenda në kufij të moralit, nuk jemi përkrabësit e zhvillimit të gjithmbarshëm*”. “*Neve e dimë më shumë se të tjerët se me përdredhjen e kohës, ndryshohen edhe urdhërat, por këto urdhëra lëndorë duhet të përputhen kurdoherë me nevojat zhvillimtare tue mbrojtun shtyllën e moralit*”.

Në këtë kuadër, në Shqipërinë e viteve 30-të, u projektuan një varg zhvillimesh¹¹ të rëndësishme, ku shquhen prirjet progresiste të “lëvizjes feministe”, që u shfaq si një shqetësim i shoqërisë së kohës për një rol dhe vlerësim më njerëzor të femrës shqiptare. Revista “Zani i Naltë”, në

10. Viron Koka, *Kultura islame shqiptare në vitet ’20-’30 të shekullit XX*, botuar në revistën “Studime Historike”, viti 1992, nr.1-4, f. 59.

11. A. Bala, “Zani i Naltë - Revistë e orientimit drejt reformave dhe progresit shoqëror”, botuar në: “Zani i Naltë”, vëll. X (artikuj të zgjedhur), (2014), f. 231.

numrin 3, të vitit 1926, do t'i thurte himn figurës dhe personalitetit të gruas: *“Gruaja asht krijuem me një fuqi madhështore të cilën mund ta përdorim edhe në një mënyrë të dobishme për të gjithë, kaq sa vlefsta e një kombi bazohet me atë të grave.”*, – shkruhej atje.

Më tej në revistën “Zani i Naltë” u trajtua edhe e drejta e pamohueshme e femrës shqiptare për arsimim: *“... të hapim shkolla vorfnore mashkullore e femnore, - shkruan Salih Vuçiterni, - që të mësohen e të edukohen e mbasi të kenë krem shkollën të jenë të zot secili prej tyre m'u marrë me lloj mjeshtrije qi asht si gjymtyrë të dobishme të baben të dejun m'u përzi me shoqinë njerzore”*. Revista “Zani i Naltë” e ka ngritur zërin, që gruas shqiptare t'i sigurohet e drejta e punës, si realitet i rolit parësor të saj në shoqëri, si nënë dhe grua. *“Asht për t'u përmend, - shkruhej aty, - se nuk ka ndalim për gratë e reja me mësue dituni e mjeshtri... si dhe me shkue me ushtrve mjeshtrinë ndër vendet e punimev”*.

Padyshim, një ndër problemet më të rëndësishme, që është trajtuar në këtë revistë, ka qenë edhe pasqyrimi i përpjekjeve kolosale, që kanë bërë forcat përparimtare në luftën për emancipimin e femrës myslimane shqiptare.

Autori Ferit Vokopola, në nr. 3, të revistës “Zani i Naltë” të vitit 1937, shkruante: *“Le të shpresojmë se me marrjen pjesë të gruas në lamën e aktivitetit njerëzues, atdheu i jonë do të përparojë me hapa gjigande drejt sferave të lumnisë landore e shpirtnore”*.

Në shumë artikuj të revistës është ngritur si problem për zgjidhje parimi islam i barazisë së plotë të gruas me burrin, atë që sot ne e quajmë “karta e të drejtave të njeriut”, deri në të drejtën e gruas për të marrë pjesë në drejtim. *“Nuk ka dallim për një grua, m'u bamë njeri i shtetit, - shkruante “Zani i Naltë”, - dhe tue u interesue në punë politike, me dhanë mendimin e vet për modifikimet që duhen me u bamë në formulim të ligjeve”*.

Një vend me shumë rëndësi në revistë kishte edhe problemi i familjes dhe i rolit të saj edukativ, i detyrave dhe i përgjegjësive të saj në çdo fushë. Familja në Islam synon plotësimin e qëllimeve të saj, duke shkëmbyer qetësinë, mëshirën dhe dashurinë mes pjesëtarëve të saj. Kësaj i kushtohen shumë artikuj, të botuara veçanërisht në rubrikat “Ç'dubet të bajmë”, “Edukatë morale”, “Këshillat e filozofëve”, etj. Në këto rubrika e artikuj, zberthehen mësimet kur'anore për familjen, baza ekonomike, shoqërore e shpirtërore e krijimit të saj, kushtet e jetesës e të harmonisë bashkëshortore dhe marrëdhëniet e ndërsjella prindër fëmijë. *“Lumturia e një shteti, – shkruan revista, – bazohet në lumturinë e familjeve dhe lumturia e familjes mbështetet në harmoninë e pjesëtarëve të saj”*.

Gjerësisht do të trajtohet roli i nënës si edukatore e fëmijës, duke theksuar se edukimi i fëmijës fillon që në barkun e nënës, se ai është pasqyra e saj, se nëna është ajo, që do

të vendosi gurin e parë të edukatës së fëmijës, e pastaj do t'ia dorëzojë shkollës dhe shoqërisë për të ngritur ndërtesën edukative. Nga nëna kërkohet që t'i japë fëmijës bazat e para të formimit të një trupi të shëndoshë, të një mendjeje të hollë dhe të një karakteri të fortë. “Nana, – shkruan revista, – *dubet me i dhanë e me siguruar atdheut e mbretit ushtarë besnikë, të fortë, të shëndoshë e të fuqishëm*”. Artikujt që trajtojnë problemet e edukatës familjare dallohen për qartësi e kompetencë pedagogjike, për njohje të saktë të nivelit të familjes shqiptare, të mangësive, të dobësive, si dhe të nevojave të saj, për përcaktimin e drejtë të detyrave të prindërve, e sidomos të nënës në edukimin e fëmijëve dhe të marrëdhënieve reciproke.

Krahas revistës “Zani i Naltë” do të botohej edhe “Kultura Islame”, si revistë mujore fetare, letrare, diturore e artistike. Kjo revistë na ofroi mjaft studiues të rinj myslimanë shqiptarë të kohës, të cilët ndikuan në rritjen e efikasitetit të saj formues e edukativ, filozofik e moral të lexuesit shqiptar nëpërmjet artikujve si: *Detyra e gruas botuar në nr.1* nga Sashi, ku do të theksohej se *çdo pjesëtar i shoqërisë ka një detyrë për të përmbushë, kështu edhe grueja*. Detyra e saj është më delikate, sepse, sipas tij, *gratë e bajnë dhe e ruajnë shtëpinë*¹². Krahas këtij artikulli janë botuar artikuj me titull si; *Hadixheja*,

12. Sashi, *Detyra e gruas*, botuar në: “Kultura Islame”, nr. 1. 1939-1940, f. 30.

Familja, islamizmi dhe gruaja, Mbi punën, Vajza Shkodrane shkruar nga një vajzë me pseudonimin Postribësja dhe botuar në (nr. 23/1940-1941), *Gruaja në islamizëm, Gruaja myslimane nga pikëpamja kombëtare*, ku shkruhet se përparimi i vërtetë i njerëzimit kërkon “*division du travail*”, pra ndarjen e detyrave dhe obligimeve që kanë, duke mos lënë pas dore detyrat e saj në familje, si edukuese e brezave, si rregullatore e familjes, si dhe interesimin e saj në të gjitha çështjet kombëtare, marrjen pjesë në luftë, përgatitjen e sendeve dhe veshjeve siç kishte bërë Zejnepi, njëra prej grave të Profetit (a.s.), të cilat më pas i dhuronte ato për bamirësi, etj.

Ndërsa në revistën “Njeriu”, kishte një rubrikë vetëm për problemet femërore ku u botuan artikujt: *Detyrat e njeriut, Familja, Shembulli i Femrave, Gruaja në jetën Shqiptare, A asht femna faktor kryesor i mbarëvajtjes së shoqërisë?, Të drejtat e burrit dhe të gruas, Zakone që na dëmtojnë, Martesat*, etj. E rëndësishme është se në të dyja revistat e fundit, për herë të parë, botuan edhe autore femra me pseudonime si Madaline apo Lulja-Blertë, duke thyer tabutë e kohës, që treguan se edhe në Shqipëri kishte filluar arsimimi dhe emancipimi i gruas.

Revista “Drita Islame”, në çdo numër të saj, ka pasur hapësirë për gruan. Kjo do të thotë se ajo e ka parë shumë të domosdoshme që çështjet

e gruas të trajtohen denjësisht dhe shoqëria mbarë të ndërgjegjësohet. Jo vetëm kaq, por në revistën “Drita Islame” është shkruar për vajzat dhe gratë, duke u kujdesur që të nxjerrë në pah vlerat më të bukura të tyre, të mbrojë të drejtat dhe të nxisë emancipimin. Pra, revista “Drita Islame”, me rubrikën e gruas, ka dashur të ndriçojë dhe të zgjojë vetëdijen e lartë për lidhjet e shumëfishta të misionit hyjnor të gruas dhe të rolit të saj në përparimin e shoqërisë¹³.

Krahas revistave të botuara në Shqipëri vend të rëndësishëm zë edhe revista “Dituria Islame”, e cila botohet në Kosovë. Dituria Islame, në faqet e saj, i ka dhënë rëndësi të madhe shkrimeve rreth familjes dhe gruas, kjo vihet re që në fillimet e saj, në numrat e parë të vitit 1986. Aty jepen zgjedhja dhe mënyrat e duhura drejtuar fëmijëve për Zotin, duke u mbështetur në fjalët profetike të Muhamedit (a.s.) si bashkëshort, duke e vënë theksin në formimin e familjes mbi baza të shëndosha, duke vazhduar më tej me tema të përshtatshme për gruan dhe familjen në përgjithësi, si: *Pozita e femrës në sistemet e ndryshme shoqërore dhe në sistemin islam, Femra-obligimi detyrat dhe problemet e saj, Sami Frashëri për të*

13. Fatma Karaj, *Roli i “Dritës Islame” Në Ndërgjegjësimin E Gruas Myslimane*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore mbi 25 vjetorin e revistës Drita Islame, Tiranë, 28 shkurt, 2017.

*drejtat e gruas në Islam*¹⁴, *Pozitën e femrës në Islam dhe në krishterizëm, Prindërit dhe fëmijët, Familja e shëndoshtë, shoqëria e shëndoshtë; Barazja gjinore sipas besimit Islam dhe barazja gjinore në Ballkan, Roli i gruas myslimane në familje dhe shoqëri*, etj. Gratë myslimane kanë luajtur gjithmonë një rol të rëndësishëm në përhapjen e dijes fetare. Gruaja e Muhamedit (a.s.), Aishja r.a, ishte një burim i rëndësishëm i hadithit, ishte një lule e mençurisë dhe dijeve të jurisprudencës islame. Në fakt thuhet se profeti me fjalën e tij ju tha sahabëve se ata do të marrin gjysmën e fesë së tyre prej saj¹⁵. Dhe në të vërtetë ajo njihet si një nga transmetueset më të mëdha të fjalës dhe veprës së profetit a.s.

Gruaja (nëna) pavarësisht nga vështirësitë e shumta që mban mbi supe, në vazhdimësi përkujdeset për fëmijët, burrin, shtëpinë. Rëndësinë e saj e shohim në çdo aspekt të jetës, ajo është shkaku pse jemi këtu ku jemi, është me ne dhe pranë nesh që nga momenti kur jemi në brendësinë e saj (mitrën), në çastin e lindjes, gjatë kohës së fëmijërisë, kur ajo me net të tëra mbetet pa gjumë. Pra gruaja është struktura më e fortë brenda familjes, për të cilën Pejgamberi a.s

14. Sami Frashëri botoi librin “Gratë (Kadinlar)” në Stamboll në vitin 1879.

15. Muzaqete Kosumi-Prishtina, *Gruaja dhe familja në revistën ‘Dituria Islame’*, botuar në Revistë ‘Dituria Islame’ Tri Dekada Jetë, Punë, Sfida dhe Sukses (Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor Prishtinë 18-20 nëntor 2016), Prishtinë, 2018, f. 119.

ka thënë: “*Xheneti është nën këmbët e nënës*”¹⁶. Gruaja është nga faktorët më të rëndësishëm brenda familjes, ndërsa familja është institucioni i parë dhe më me rëndësi në shoqërinë njerëzore; aty merren fillet e para të edukimit të njeriut...¹⁷

Disa nga temat e trajtuara gjerësisht në revistën “Dituria Islame” janë ato rreth rolit, kontributit, rëndësisë, barazisë dhe të drejtës së gruas në familje dhe në shoqëri si: “*Roli i mbulesës në parandalimin e çrregullimit social dhe krimit; Martesa dhe pengesa në rrugë të saj; Roli i gruas myslimane në familje dhe shoqëri; Kontributi i grave të gjeneratës së parë në Islam; Barazia gjinore sipas besimit Islam dhe barazia gjinore në Ballkan*, etj. Autorët që kanë shkruar më së shumti rreth rolit të saj dhe rëndësisë së gruas myslimane në familje dhe shoqëri janë: Dr. Naim Tërnavë, Prof. Dr. Fahrush Rexhepi, Mr. Qemajl Morina, Mr. Sadat Rustemi, Emine Vezaj, Amire Prebeza Sopjani, Hatixhe Ahmeti, Arta Tahiri, Esmë Morina, etj.

Vend të rëndësishëm në këtë revistë ka edhe rubrika: *Roli i gruas në edukimin e fëmijëve*. Ky rol është i rëndësishëm dhe që fëmijët të jenë të suksesshëm në jetë duhet të jenë

përgjegjësi e lartë e prindërve. Familja është vatra e parë e dijes dhe shkolla e jetës për edukimin e fëmijëve dhe se fëmija ka nevojë të domosdoshme për dashurinë e saj, ngase ajo e rrit, e frymëzon, i nxit dëshirën dhe i rrit vullnetin për të ecur përpara dhe për të qenë i devotshëm për shoqërinë. Kjo vihet re në rastet kur familjet janë të shëndosha dhe kur prindërit, e veçanërisht nënat, kanë ndikuar në formimin e personalitetit të tij, ndjenjat e dashurisë, respektit, bashkëpunimit, kanë ndërtuar vullnetin e mirë për të tjerët, punën për të mirën e përgjithshme, si dhe sakrificën për hir të parimeve të larta. Është e domosdoshme të arsimohet më tepër femra, sepse si nënë asaj i duhet të jetë pedagoge, edukatore dhe psikologe shumë e mirë. Në duart e saj formohet dhe edukohet njeriu. Edukimi është një akt jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i ndërlikuar, prandaj shkruhen artikuj tematikë si; *Fëmija janë dhuratë e jo të keqpërdoren apo të abuzohen; Si të rrisim fëmijë të shëndetshëm; Si ta largojmë frikën nga fëmijët tanë; Fëmijët tanë dhe Kurani; dita ndërkombëtare e fëmijëve; edukimi i fëmijëve me namaz; Adoptimi i fëmijëve*, etj. Autorët që janë përpjekur dhe kanë shkruar rreth edukimit të fëmijëve janë; Rexhep Suma, Driton Artifi, Arta Tahiri, Vlora Podvorica-Shala, Nermine Kopriva-Jonuzi, Fatos Gërvalla, etj.

Krahas edukimit të fëmijëve i jepet një vend i veçantë i jepet *Rubrikës*

16. Mr. Naim Tërnavë, *Gruaja është elementi - struktura më e fortë brenda familjes*, Dituria, Islame, nr. 275, f. 7.

17. Amire Preza Sopjani, *Roli i gruas myslimane në familje dhe shoqëri*, Dituria Islame, nr. 204/205, f. 36.

së edukimit të grave. Revista “Drita Islame”, lidhur me këtë tematikë, përcakton disa arsye kryesore në lidhje me nevojën e edukimit të gruas: *E para*, gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së botës, prandaj, duke u edukuar ato, është edukuar gjysma e globit tokësor dhe e racës njerëzore. *Së dyti*, kalimi i një jete të lumtur të çiftit bashkëshortor është tejet e rëndësishme, sepse edukata familjare, që buron nga nëna, trashëgohet në të gjithë familjen, nga brezi në brez, dhe transmetohet në të ardhmen e racës njerëzore. Nga një nënë e arsimuar dhe e edukuar kalohet në një shoqëri të emancipuar. Krahas saj, familja dhe pozita e gruas në familje zë një vend të rëndësishëm në faqet e kësaj reviste. Sistemi i familjes islame vendos të drejtat e burrit, gruas, fëmijëve dhe të afërmeve në një ekuilibër të përsosur dhe këto marrëdhënie nga aspekti juridik dhe moral janë të shpjeguara deri në detajet më të imta. Ai ushqen tek individit bujarinë, dashurinë dhe modestinë në kuadrin e një familjeje të organizuar mirë. Familja në kontekstin islam është një strukturë e veçantë, parimet e së cilës janë lidhur me njëri-tjetrin përmes lidhjeve të gjakut dhe marrëdhënieve bashkëshortore, lidhshmëria e të cilave është e një natyre të atillë sa të kërkojë “kërkesa të ndërsjella” që janë caktuar nga feja, të përforcuara nga ligji dhe të ndërtuara nga individit. Struktura familjare në fenë

islame është e ndërtuar mbi baza të shëndosha, me qëllim të suksesit dhe vazhdimësisë së saj¹⁸. Revista “Drita Islame” vlerëson lart cilësitë e gruas për edukimin e fëmijëve në familje e shoqëri dhe na tregon respektin që duhet të kemi për të si nënë, bashkëshorte dhe na urdhëron pajisjen e saj me kulturë. Edukimi i grave dhe vajzave është baza e shëndetit, paqes, zhvillimit të vendit dhe demokracisë¹⁹.

Përfundime

Kontributi i publicistikës islame, revistave me karakter shkencor dhe kulturor, në shtypin shqiptar, ka qenë i dukshëm dhe i dobishëm. Në këto revista me karakter fetar në shkencat islame, por edhe kulturor, u pasqyruan materiale origjinale, jo vetëm të përkthyer, por edhe të shkruara e hartuara nga të rinj dhe intelektualë shqiptarë me tematikë të gjerë dhe shumë dimensionale. Shtypi islam në Shqipëri dhe Kosovë, paraqet vlera të edukimit fetar e atij patriotik kombëtar të bazuara mbi filozofinë islame. Artikuj të shumtë kanë shërbyer për të rritur më tej vlerën që ka kultura islame në trojet shqiptare, qëndrimin dhe

18. Aida Kurti, *Familja themeli bazë i shoqërisë*, Drita Islame, 6 prill 2018.

19. GADC, Aleanca Gjimore për Zhvillim, *Perspektiva gjimore në tekstet shkollore. Udhëzues për shtëpitë botuese të teksteve shkollore*, Pegi, Tiranë, 2008.

përkrahjen që Islami i bën historisë, shoqërisë, e në veçanti gruas si qenie, dhe rolit të saj si përçuese e vlerave më të mira shoqërore në edukimin e familjes dhe rritjen e brezit të ri. Edukimi duhet të kalojë nëpërmjet vajzave dhe djemve për të

arritur drejtpërdrejt te familja. Ajo është baza e çdo shoqërie dhe luan rolin e edukimit të brezave përkrah shkollës, ndaj edukimi i familjes me konceptet e barazisë gjinore ndihmon në forcimin dhe zhvillimin e saj.

Bibliografi

“90 vjet Revista “Zani i Naltë”, <http://www.dritaislame.al/90-vjet-revista-zani-i-nalte/>-nga Fatma Karaj

Bala, A., *Zani i Naltë - Revistë e orientimit drejt reformave dhe progresit shoqëror*, botuar në: “Zani i Naltë”, vëll. X (artikuj të zgjedhur), (2014).

Basha, Sabile Keçmezi, *Roli i femrës në ruajtjen e identitetit kombëtar*, botuar në: *Dituria Islame*, nr. 44.

Frashëri, Sami, *Gratë (vepra 15)*, Shtëpia Botuese, Logos-A, Prishtinë 2004.

GADC, Aleanca Gjimore për Zhvillim, *Perspektiva Gjimore në Tekstet Shkollore. Udhëzues për shtëpitë botuese të teksteve shkollore*, Pegi, Tiranë, 2008.

Hamiti, Abdullah, *Sami Frashëri për rolin e gruas në familje e në shoqëri*, botuar në *Dituria Islame*, nr. 72.

Historia e Popullit Shqiptar (Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek. XIX-1912), Akademia e Shkencave të Shqipërisë - Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002.
<http://www.dritaislame.al/nga-Valmira-Demaj/>

Karaj, Fatma, *Roli i “Dritës Islame” Në Ndërgjegjësimin E Gruas Myslimane*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore mbi 25 vjetorin e revistës Drita Islame, Tiranë, 28 shkurt , 2017.

Koka, Viron, *Kultura islame shqiptare në vitet '20-'30 të shekullit XX*, botuar në revistën “Studime Historike”, viti 1992, nr. 1-4.

Kurti, Aida, *Familja themeli bazë i shoqërisë*, “Drita Islame”, Tiranë, 6 prill 2018.

Muhamed, Amare. *Modeli islam në emancipimin e gruas*, Zani i Naltë, <http://zaninalte.al/2015/06/modeli-islam-ne-emancipimin-e-gruas/>

Prishtina, Muzaqete Kosumi, *Gruaja dhe familja në revistën “Dituria Islame”*, botuar në *Revista “Dituria Islame” Tri Dekada Jetë, Punë, Sfida dhe Sukses* (Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor Prishtinë 18-20 nëntor 2016), Prishtinë, 2018.

Sashi, *Detyra e gruas*, botuar në: “Kultura Islame”, nr. 1. 1939-1940.

Sopjani, Amire Preza, *Roli i gruas myslimane në familje dhe shoqëri*, “Dituria Islame”, nr. 204/205, f. 36.

Tërnavë, Naim, *Gruaja është elementi - struktura më e fortë brenda familjes*, “Dituria Islame”, nr. 275.

Kur'ani dhe sufizmi

Prof. William C. Chittick

Fjala arabe *sufi*, nga e cila nxirret termi ‘sufizëm’ në anglishte, fillimisht përdorej për të dëftuar një lloj të caktuar fetarie në shekullin II/VIII. Kuptimi burimor i saj duket se ishte “veshës leshi”, ndonëse janë sugjeruar edhe derivate të tjera. Me të hyrë në përdorim kjo fjalë, dijetarët muslimanë nuk arritën kurrë njëzëshmëri se ç’nënkuptonte ajo tamam. Deri në shekullin VII/XIII, ajo përdorej përgjithësisht për të karakterizuar figura të caktuara të lartë shpirtërisht dhe mësimet e tyre,

dhe që prej asokohe vlente edhe për tarikate (“udhë”), në të cilat mësues udhëzonin nxënës në kërkimin e Zotit. Në botën islame lulëzojnë akoma një mori tarikatesh të tilla, çdonjëri nga të cilët e gjurmon prejardhjen e vet deri te një ose më tepër evlija themelues dhe në fund te Profeti. Për shekuj me radhë, tarikatat luajtën rol mbizotërues në jetën fetare të bashkësisë muslimane, por së fundmi format e politizuara të Islamit të njohura si “fundamentalizëm” ua kanë errësuar në shkallë të dukshme praninë, të paktën për mediat.

Dijetarët e periudhës moderne e marrin rëndom fjalën ‘sufizëm’ si sinonim të mistikës, shpirtshmërisë, ose ezoterikës, çdonjëra nga të cilat sugjeron diçka nga ajo çfarë ka dëftuar kjo fjalë. Për synimet e kësaj sprove, sufizmi mund të kuptohet më mirë në raport me strukturën e traditës islame. Burimet binjake të Islamit – Kur’ani e Sunneti – sigurojnë përrudhje në tri nivele: të vepruarit, të kuptuarit, të shndërruarit. Tek nxirrnin rrjedhimet e Përrudhjes së Zotit në nivelin e praktikës dhe të vepruarit, muslimanët dalëngadalë nxorrën në pah lëmin e jurisprudencës (*fikh*) dhe shkollat (*medhabib*) e Ligjit të Shpallur (*Sher’ah*). Tek përsiatëshin mbi rrjedhimet e Udhëzimit Hyjnor për një të kuptuar të vërtetë të Zotit, kozmosit (“tjetër-veç-Zotit”) dhe trupëzimit njerëzor, ata u dhanë shkas shkollave të mendimit si *kelam*-i (teologjia) dhe filozofia. Ndërkaq, shumë muslimanë – shpesh të njëjtat figura të përfshira në dy lëmejtë e parë – mëtonin se synimi i të vepruarit të duhur dhe i të kuptuarit të vërtetë ishte shndërrimi i vetes, pra arritja e përputhjes së brendshme me *el-Hakk*, “Realin”, të Vërtetën Eprane dhe Realitetin Absolut, që është Vetë Zoti. Pikërisht këta muslimanë quheshin shpesh “sufi” nga bashkëkohësit ose brezat e mëvonshëm.

Veçoria dalluese e qasjes sufiste ndaj traditës islame ka qenë të

fokusuarit te asimilimi i vetes në Fjalën Hyjnore, gjithmonë në bazë të modelit të vendosur nga Profeti. Duke iu drejtuar atij, Kur’ani thotë: “Vërtet, ti je me virtyte madhore (*’adhim*)” (68:4), dhe askujt nuk i shpëtoi që Kur’ani përdor të njëjtin mbiemër për t’i referuar vetes – “Kur’ani i Madhnueshëm (*’adhim*)” (15:87). Madhnueshmëria e virtyteve të Profetit buron pikërisht nga fakti se ai e kishte përvetësuar Kur’anin në qenien e tij. Ja si e kanë kuptuar sufitë thënien e bashkëshortes së Profetit, ‘Aishes, kur ajo u pyet për moralin e tij pasi ai kishte ndërruar jetë. Ajo u përgjigj: “A nuk e ke lexuar Kur’anin? Morali i tij ishte Kur’ani.”¹

Roli i Kur’anit në shndërrimin e vetes brendashkruhet në rrëfimet për ngjytjen (*mi’raxh*) e Profetit te Zoti, “Udhëtimin Natën”, të cilit i referohet ajeti “Lartësuar qoftë Ai që e barti robin e Tij natën” (17:1). *Lejletu’l-isra’* (“Nata e Udhëtimit”) ose *el-mi’raxh* (“Ngjytja”) u kuptua si përmbushja e *lejletu’l-kadr* (“Natës së Fuqisë”, 97:1–3). Pasi e kishte zbritur Fjalën Hyjnore te Profeti Natën e Fuqisë, Xhibra’ili (Gabrieli) e mori lart për të takuar Zotin, Natën e Udhëtimit. Ai mund ta takonte Zotin pikërisht sepse “Moralin e tij ishte

1. Ahmed 10 (nr. 25240); Sulejman ibn Ahmed et-Taberani, *el-Mu’xhem el-enset*, ed. Ebu Mu’adh Tarik ibn ‘Awadullah ibn Muhammed & Ebu’l-Fadl el-Huseini, 10 vëll. (Kajro: Daru’l-Haramejn, 1994), f. 30 (nr. 72).

Kur'ani", i cili ishte zbritur në veten (*nefs*) e tij dhe e kishte shndërruar në "kandil ndriçues" (33:46), në përgjigje të lutjes së tij "Bëmë një dritë".² Tekembramja, vetë Kur'ani është drita (64:8), e shpallur nga Drita e qiejve dhe e tokës (24:35) për ta "nxjerrë njerëzimin nga terri në dritë" (14:1).

Udhë e shndërrimit

Mësuesit sufi flisnin shpesh për synimin e traditës islame si "realizimi" (*tehkik*), një fjalë e nxjerrë nga e njëjta rrënjë si Emri Hyjnor *el-Hakk*, Reali, i Njëmendti, i Vërteti, i Duhuri. Gramatikisht, realizim do të thotë me përmbushje të vërtetën (*hakk*) dhe realitetin (*bakikah*), dhe në sufizëm ai erdh' e shënoi rezultatin përfundimtar të ndjekjes së udhës së Zotit. Arritja e realizimit nënkupton arritjen e Realit, shikimin dhe rrokjen e të gjitha gjërave në dritën e Realit, dhe veprimin drejt e tamam në të gjitha situatat. Kjo kërkon shndërrimin e vetë qenies së kërkuesit, dhe roli i shkrimeve sufiste është pikërisht shpjegimi i natyrës së këtij shndërrimi, përshkrimi i udhës që mund të shpjerë në të dhe ofrimi i

2. Kjo fjali është pjesë e lutjes së Pejgamberit: "O Zot, vendosmë në zemër një dritë, në të dëgjuarit tim një dritë, në të pamurit tim një dritë, në dorën e djathtë një dritë, në dorën e majtë një dritë, përpara një dritë, mbrapa një dritë, mbi mua një dritë, nën mua një dritë, dhe caktomë një dritë" ose "bëmë një dritë" (Muslim 7.26, nr. 1830).

udhëzimeve dhe mjeteve praktike se si mund të përshkohet udha.

Nocioni i "udhës" është qendror për të vetëkuptuarit musliman. Në çdo cikël (*rek'ah*) namazi muslimanët këndojnë Fatihanë (Suren 1). Pasi lavdëron Zotin dhe pohon nevojshmërinë njerëzore, sureja shpreh zemrën e kërkimit fetar: "Udhëzoni rrugën e drejtë" (1:6). Pikërisht kjo rrugë (*sirat*) trupëzohet si ura (*sirat*) mbi Ferr, të cilën duhet të përpiqet ta kalojë gjithkush në Ditën e Ringjalljes. Ata që ndjekin Udhëzimin Hyjnor në këtë jetë do të kalojnë të sigurt, ndërsa ata që e shpërfillin do të bien në Skëterrë. Kur'ani e bën "përudhjen" (*buda*) atributin e përgjithshëm të profetëve dhe ia njeht "çoroditjen" (*idlal*) Shejtanit. Duke iu drejtuar Profetit, ai thotë: "Vërtet, ti përudh në rrugë të drejtë" (42:52). Por, ai na kujton gjithashtu se Pejgamberi përudh vetëm mbi bazën e Përudhjes së Zotit, dhe se vetëm Zoti është Përudhësi i Mbramë: "Vërtet, ti (Muhammed) nuk përudh kë do ti, por Zoti përudh kë dëshiron Ai" (28:56).

Fjalët e përdorura në Kur'an për "udhën" ose "rrugën" luajnë rol spikatës në konceptualizimin e traditës. *Sebil* tregon rrugën e përgjithshme të drejtudhëzimit, sidomos në frazën "rruga e Zotit". *Sheri'ah* ("rruga") vjen e shënon shtegun specifik të praktikës së duhur të kodifikuar në Ligjin dhe

jurisprudencën islame, si dhe udhëzimin profetik përgjithësisht (sidomos në shumës, *shera'i'*, “rrugët”, pra “fetë”). *Tarikah* vjen e nënkupton udhën e disiplinës shpirtërore, rrugëtimin e brendshëm drejt të kuptuarit të duhur dhe puqjes së duhur me Realin, që jepet mësim nga mjeshtrat sufi (shehlerët, pirët); së këndejmi edhe përdorimi i saj për të dëftuar rendet sufiste.

Duke përmbledhur natyrën e rrugës drejt Zotit, mësuesit flisnin shpesh për “pastrimin e vetes” (*tezkiyetu'n-nefs*), shprehje kjo e nxjerrë nga 91:7–9. Pastrimi kërkon eliminimin e tipareve të qortueshme të moralit (*akhlak dhemimeh*) dhe fitimin e tipareve të lëvdueshme të karakterit (*akhlak hamideh*). *Akhlak* (“tiparet e moralit”) është shumësi i *khuluk* (“moral”) dhe përdoret për të dëftuar shkencën e etikës (*'ilmu'l-akhlak*). Ndër të gjithë shërbëtorët e Zotit, “virtytin më madhor” e kishte Muhammedi, fjalë për fjalë “I Lavdëruari”, i quajtur edhe Ahmed, “Më i Lavdërueshmi” (61:6). Kur’ani flet për Zotin si “I Lavdërueshmi” (*el-Hamid*), me rrjedhimin se askush tjetër nuk është tamam i denjë për lavdërim. Nëse Kur’ani e quan Pejgamberin hem “Muhammed”, hem “Ahmed”, kjo vjen nga përputhja e moralit të tij me “moralin” e Zotit, çka do të thotë se “moralin e tij ishte Kur’ani”, të Folurit dhe Vetë-Shprehurit e Zotit.

Shkurt, të gjithë ata që duan të dëlirin vetet e tyre, duhet të ndjekin rrugën e drejtë, udhën e Zotit. Kjo kërkon imitimin e Profetit në dy nivele bazë: i) të vepruarit e duhur, duke ndjekur Sheriatin; ii) të kuptuarit dhe të realizuarit e duhur, duke ndjekur Tarikatin. Të imituarit e Profetit mund të shpjerë në përtëritjen e natyrës së kryehershme (*fitreh*) të vetes, të krijuar sipas shëmbëlltyrës apo “formës” (*sureh*) së Zotit. Kësodore, sufitë flisnin rëndom për synimin si “të karakterizuarit nga tiparet morale të Zotit” (*ettekhal'uk bi-akhlak Allah*), dhe kuptonin se “virtyte madhore” i Profetit buronte pikërisht nga të karakterizuarit e tij me gamën e plotë të Emrave dhe Atributeve Hyjnore, nga realizimi i plotë i Realitetit të Realit prej tij. Ebu Hamid el-Ghazzali (vd. 505/1111) i kushton një kre të komentimit të tij mbi Emrat Hyjnorë këtij procesi dhe, duke ndjekur terminologjinë e përdorur ngaherë hem nga sufi, hem nga filozofë, i referohet synimit si realizimi i *te'al'lub*-ut (“të qenurit si Allahu”), pra “deiformitetit” apo “teomorfizmit” vetjak.³

Fakti se sufitë e kanë fokusuar

3. Ebu Hamid el-Ghazzali, *el-Mekşedu'l-esna* (“Synimi më i lartë”), red. Fadlou A. Shehadi (Beirut: Dar El-Machreq, 1971). Pj. I, kreu 4 titullohet “Të shpjeguarit se përsosuria dhe lumturia e shërbëtorit qëndron te të bërit i karakterizuar nga tiparet morale të Zotit.” Ai e përmend *te'al'lub*-un në f. 65.

vëmendjen tek arritja e shndërrimit shpirtëror, ndihmon të shpjegohet përkushtimi i tyre ndaj asaj që një studiues e ka quajtur “Kur’anizimi i kujtesës”.⁴ Kjo nënkuptonte jo vetëm që ata, si muslimanë të tjerë, i kushtonin mund të madh mbamendjes e këndimit të Kur’anit dhe thërritjes së Emrave Hyjnore të përmbajtur në Kur’an, po edhe se i shprehnin mësimet e tyre me terminologji kur’anore dhe mbanin parasysht se qëllimi i të gjitha përpjekjeve të tyre ishte përvetësimi i Fjalës Hyjnore. Synimi ishte gjithmonë që vetja të shndërrohej në Dritën Hyjnore, realitetin gjallues të Vetë-Shprehjes së Zotit. Ky përkushtim i posaçëm ndaj Kur’anit mund të vërehet qartë mes mësuesve sufi të brezave të hershëm, të cilët kujtohen kryesisht përmes aforizmash që kthjelltësojnë domethënien shpirtërore për fjalë e fraza kyç të Kur’anit. Kur, sufi të mëvonshëm nisën të shkruanin shkoqitje të hollësishme të gjendjes njerëzore karshi Zotit dhe kozmosit, ata i mbushën veprat e tyre me koment mbi ajete kur’anore. Ndër shembujt më të mirë këtu është Ibn ‘Arabiu (vd. 638/1240), të cilin sufitë e quajnë “Mjeshtri më i madh” për shkak të hollësisë dhe thellësisë së pakapërcyer me të cilën e shpjegoi ai natyrën e rrugës drejt Zotit. Vepra e

4. Paul Nwyia, *Ibn ‘Ata Allah et la naissance de la confrérie šadilite* (Beirut: Beirut: Dar El-Machreq, 1971), f. 46.

tij monumentale *el-Futubatu’l-mekkiyye* (“Hapjet mekase”) nuk është tjetër, veçse varg përsiatjesh mbi Kur’anin dhe kuptimin e tij të brendshëm.

Në leximin sufi të traditës islame, çdo njeri thërritet të ndërmarrë udhën e shndërrimit shpirtëror. Të gjithë njerëzit e kanë trashëguar dijen e emrave që Zoti “i mësoi Ademit” (2:31) dhe janë të aftë ta përtërijnë këtë dije të kryehershme, adamike duke përvetësuar Kur’anin. Në dy ajete, Profeti porositet me thënë: “Unë jam veçse vdekatar si ju” (18:110, 41:6). Si ne, ai e kishte trashëguar dijen e emrave nga Ademi, por ndrysh’ prej nesh, vazhdojnë e thonë ajetet, Zoti i zbriti shpalljen e Unitetit të Tij. Pikërisht, kjo ngjarje i lejoi atij ta ndiqte Përudhjen Hyjnore deri në burimin e saj dhe ta përtërinte natyrën e kryehershme njerëzore, *fitreb*. Duke qenë vdekatarë si ai, ne mund të ndjekim gjurmët e tij.

Shenjat e Zotit

Mund të thuhej se synimi i mësimave teorike të sufizmit është ofrimi i një antropologjie kozmike të kombinuar me kozmologjinë, pra i një shkoqitjeje të natyrës njerëzore në raport me qëllimin e Zotit në krijimin e gjithësisë. Të kuptuarit e drejtë të natyrës njerëzore duhet të nisë te fillimi, që është Zoti, pohimi i Unitetit të të cilit, teuhidi, është kryeparimi i besimit islam. Teuhidi shprehet më thuktazi nga pjesa e parë e shehadetit,

“Nuk ka zot tjetër përveç Allahut”, një formulë që siguron bërthamën e mendimit islam. Dy gjysmat e saj – të quajtura tipikisht mohimi (*nafi*) e pohimi (*ithbat*) – i mohojnë Cilësi Hyjnore tjetër-veç-Zotit dhe ia njohin tërë Realitetin dhe të gjitha Cilësitë vetëm Atij.

Dialektika e vendosur nga ky mohim dhe pohim kumbon përgjatë shkrimeve të sufive dhe siguron vendqëndrimin kryesor për të kuptuar mesazhin e Kur’anit, që ngërthehet nga “Emrat më të Bukur të Zotit” (*el-esma’ ul-husna*). Kështu, për shembull, nëse Zoti është Krijuesi (*el-Khalik*), kjo do të thotë se nuk ka krijues tjetër përveçse Zotit. Me fjalë të tjera, ky Emër ua mohon krijuesinë ontologjike krijesave dhe pohon se ajo i përket veç Zotit. Kur’ani e shpreh retorikisht: “A ka krijues tjetër përveçse Zoti?” (35:3). Në qoftë se Zoti është i Forti (*el-Kami*), atëherë “nuk ka forcë përveçse në Zotin” (18:39). Nëse Ai është i Pasuri (*el-Ghani*), atëherë “O njerëz! Ju jeni nevojtarë të Zotit; dhe Ai është i Vetë-Mjaftueshmi, i Lavdëruari” (35:15). Në qoftë se Ai është Sovrani (*el-Malik*), atëherë “Zotit i përket sovraniteti mbi qiejt dhe tokën” (3:189) dhe “Ai nuk ka ortak në sovranitet” (17:111).

Përsiatja mbi Emrat kur’anorë të Zotit shpie në të kuptuarit se gjithçka në univers vjen nga Zoti, i kthehet Zotit dhe mbahet e furnizohet nga Zoti në çdo çast. Në

realitet, gjithësia është panoramë e pamatë “shenjash” (*ajat*) të Zotit, fjalë të cilën Kur’ani e përdor për të treguar dukuritë e lëmit natyror, ndijimin dhe vetëdijen e vetes, veprimtaritë dhe mrekullitë e profetëve, dhe vetë vargjet e tij. Ai u bën thirrje njerëzve të përsiaten e të meditojnë mbi shenjat, çdonjëra nga të cilat shpalos nishane dhe gjurmë të Emrave Më të Bukur të Zotit. Mënyra e gjerë, në të cilën Kur’ani flet për shenja/vargje, shpie te diskutimi i tre librave – kozmosit, vetes njerëzore (*nefs*), dhe vetë Kur’anit, i cili është çelësi për interpretimin e dy të parëve. Siç na thotë Ibn ‘Arabi, i tërë kozmosi janë “gërmat, fjalët, suret dhe ajetet, pra është Kur’ani i Madh.”⁵ Nxënësi i tij Sadr ed-Din el-Kunawi (vd. 673/1274) e shtjellon shpesh këtë figuracion. Në një fragment, ai shpjegon përse vetja njerëzore, të cilës i janë mësuar të gjithë emrat nga Zoti, është libri i shpallur i Zotit:

A nuk i ke dëgjuar Fjalët e Zotit? “Lexo Librin tënd! Këtë Ditë, vetja jote mjafton si njehës kundër teje” [17:14]. Kushdo që e lexon këtë Libër ka arritur të dijë se çfarë ka qenë, çfarë është dhe çfarë do të jetë. Nëse nuk e lexon dot tërë Librin tënd, atëherë lexo prej tij ç’të mundesh. A nuk e ke

5. Ibn ‘Arabi, *el-Futuhatul-mekkiyye* (Kajro, p.b., 1911; risht. Beirut: Dar Şadir, 1968), 4:167, rr. 22.

parë se si thotë Ai: “Dhe në vetet e juaja. Nuk vëreni vallë?” [51:21] Dhe a nuk e ke parë se si thotë Ai: “Ne do t’ua dëftojmë shenjat Tona ndër horizonte dhe në vetet e tyre gjersa t’u bëhet e qartë se është e vërteta. A nuk mjafton që Zoti yt është Dëshmues mbi çdo gjë?” [41:53]... Ky, pra biri im, është Libri dhe dija e Librit. Dhe libri je *ti*, siç thamë. Dija jote për veten tënde është dija jote për Librin. Dhe nuk ka “gjë të lagësht”, që është bota e dukshme, “apo të thatë”, që është bota shpirtërore dhe gjithçka matanë, “që të mos jetë në një Libër të qartë” [6:59], dhe ky je ti.⁶

Gjithçka në univers, nefsi dhe Kur’an është shenjë/varg. Të gjitha shenjat duhen deshifruar hem me mohim, “jo zot”, hem me pohim, “përveçse Zoti”. Te mohimi, shenjat nuk kanë realitet në krahasim me Realitetin e pafundmë të Zotit; kurse te pohimi, çdo shenjë tregon kah Reali, sepse të gjitha cilësitë e nxjerrin furnizimin nga Cilësitë e Tij. Përderisa të gjitha gjërat dëftojnë Emrat dhe Cilësitë e Zotit, çdo gjë në mbarë gjithësinë është *texhal’li*, “teofani”, “Vetë-Shpalosje” (*texhal’li*) Hyjnore. Kjo fjalë merret nga një ajet, në

6. *Mir’at ul-’arifin fi multanas Zejnu’l-’Abidin* (“Pasqyra e gnostikëve: Me kërkesë të Zejnu’l-’Abidinit”) në dorëshkrim. Një tekst i mangët me përkthim është botuar nga S. H. Askari në *Reflection of the Awakened* (London: Zahra Trust, 1983).

të cilin Musai (Moisiu) i kërkon Zotit të shfaqet. Zoti përgjigjet se Musai nuk do të jetë në gjendje ta shikojë. “Dhe kur Zoti i tij iu shpërfaq (*texhal’la*) malit, Ai e bëri të shkërmoqej në pluhur dhe Musai u shemb i alivanosur” (7:143). Drita verbuese e teofanisë mohon malin dhe shikuesin e saj, ashtu sikurse çdo shenjë, e parë me syrin e dallimbërjes, mohon jorealen dhe pohon se nuk ka asgjë reale përveçse Reali.

Çdonjëra nga shenjat/vargjet kozmike është gjë, ngjarje, fjalë, ose fjali specifike, por secila tregon gjithashtu kah diçka tjetër përtej vetvetes. Edhe shenjat/vargjet që përbëjnë Kur’anin janë tregues; porse Kur’ani është “Libri i qartë” (12:1) dhe “Kur’an i qartë” (15:1), i cili siguron qartësinë dhe tejevshtrimin, me të cilët të interpretohen shenjat në kozmos dhe në vete. Mirëpo, për ta kuptuar këtë Përudhje Hyjnore, njerëzit duhet t’i përkushtohen asaj që u kërkon Libri, sidomos ndjekjes së rrugës së Zotit dhe studimit të kujdesshëm të Fjalës së Tij. Pa i kuptuar shenjat e shkruara të Kur’anit, ata nuk do të jenë kurrë në gjendje t’i deshifrojnë shenjat kozmike dhe të brendshme. Atëherë do të jenë treguar të pavëmendshëm (gafilë) ndaj rolit të tyre në krijim dhe të paaftë të veprojnë me botën dhe veten si duhet dhe drejt (*bi’l-hakë*), pra në përputhje me Realitetin e Realit.

Fytyra e Zotit

Kur’ani flet nganjëherë për Vetë-Shpalosjen e Zotit si “Fytyra” (*waxhb*) e Tij, sikurse në 2:115 “Ngado që të ktheheni është Fytyra e Zotit”. Me fjalë të tjera, Zoti vetëshpaloset në çdo gjë; pra, secila është shenjë që pohon Realitetin e Zotit dhe mohon realitetin e pavarur të saj. Megjithatë, në të njëjtën kohë, çdo gjë është thjesht vetvetja, pra vel që fsheh Fytyrën Hyjnore të shpalosur në të. Një varg i dytë sugjeron diçka për natyrën e dyanshme të Vetë-Shpalosjes Hyjnore, me dykuptimësinë e saj gramatikore: “Të gjitha gjërat shkatërrohen, përveç Fytyrës së Tij” (28:88), një fjali që mund të lexohet njëlloj “Çdo gjë shkatërrohet, përveç fytyrës së saj”. Nëse përemrin e marrim të nëkuptojë “Tij”, atëherë vargu pohon përhershmerinë e Zotit dhe mohon përhershmerinë e të gjitha gjërave. Nëse e marrim se nënkupton “saj”, atëherë fytyra e diçkaje, pra aspekti i saj i raportit me Zotin, është e përhershme, por jo edhe pjesa tjetër e gjësë. Ibn ‘Arabiu shpjegon se kjo fytyrë e përhershme e diçkaje është realiteti i saj më i brendësishëm, i cili kundron prore Zotin dhe përfundimisht nuk është tjetër përveçse Fytyra e Tij që e kundron atë. Ai e quan këtë realitet më të brendësishëm “Fytyra e Posaçme” (*waxhb kebass*) e Zotit, duke nënkuptuar se Zoti në Dijen

e Tij të pafundme ka një pafundësi Fytyrash, çdonjëra nga të cilat kthehet kah diçka specifike për ta sjellë në ekzistencë dhe furnizuar.

Kur’ani na thotë se kërkuesit e Zotit “dëshirojnë Fytyrën (Kënaqësinë) e Zotit” (30:38) dhe i lavdëron ata që i kthejnë fytyrat nga Ai: “Kushdo që ia dorëzon (*islam*) fytyrën Zotit e është i virtytshëm (*muhsin*) është kapur vërtet për dorezën më të patundshme” (31:22). Duke ia dorëzuar fytyrat Zotit, kërkuesit gjejnë fytyrat e tyre të vërteta, të cilat janë të njëjta si Fytyrat e Posaçme që Zoti ka kthyer drejt tyre. Të dyja fytyrat janë përfundimisht një, sepse “nuk ka fytyrë përveçse Fytyra e Zotit”. Ata që kërkojnë Fytyrën e Zotit, pra përpiqen të njohin Fytyrën e Zotit, që është vetja e tyre e vërtetë.

Ky kërkim për ta njohur Fytyrën e Zotit ndihmon me shpjegue një prej kuptimeve të hadithit “Kush njih vetveten njih Zotin e tij.”⁷ Ky hadith i cituar pareshtur në tekste sufiste përkthehet zakonisht në anglishte si “Kush di vetveten, di Zotin e tij.” Mirëpo, folja ‘arefe’ tregon njohje e jo thjesht ditje (të cilën e tregon ‘alime). Përdorimi i

7. Ai nuk gjendet në përmbledhjet standarde dhe nuk pranohet nga shumica e ekspertëve të Hadithit, disa nga të cilët ia njohin kushëritit të Pejgamberit, ‘Ali ibn Ebi Talibit. Të shihet Muhammed ibn el-Munawwer, *Asrar et-tenbid fi mekamat esh-Shejkh Ebi Sa’id*, ed. M. R. Shafi’i Kadkani (Tehran: Agah, 1366/1987), ff. 774–5.

kësaj fjale specifike sugjeron se dija e arritur nga njohja e vetes është në të vërtetë dije e përtërirë e asaj, të cilën njeriu e njeh paraprakisht në qenien e tij më të brendësishme. Në të vërtetë, aq i rëndësishëm është ky nocion i “njohjes” saqë sufizmi quhet shpesh *ma’rifeh* ose *’irfan*, çdonjëri nga të cilët është emër veprimi nga folja *’arefe*. Nëse studiuesit i përkthejnë shpesh këto dy fjalë si “gnosë”, kjo ndodh sepse ajo nënkupton njohje të menjëhershme të së vërtetës së përsipirtshme, çka sugjeron diçka me natyrë si vetënjohja që është njëherësh njohje e Zotit.

Vlen të kujtohet këtu se termi kur’anor *dhiker* shënon hem “kujtimin” e ardhur nga Zoti, hem “përkujtimin” që është përgjigjja njerëzore ndaj tij. Në të njëjtën kohë, kjo fjalë do të thotë edhe “me përmendë” ose “thërritë”, dhe Kur’ani e inkurajon dendur përmendjen ose thërritjen e Emrit të Zotit si mjet i përkujtimit të Tij, për shembull (Përmende Zotin tënd në mëngjes e mbrëmje) (76:25). Ky mësim kur’anor është baza e ushtrimit universal të përkujtimit (*dhiker*) të Emrit të Zotit (ose “përmendjes”) të gjendur në të gjitha tarikatet. Përdorimi kur’anor i kësaj fjale dhe i të buruarave prej saj tregon se, në vështrimin kur’anor të gjërave, ne e zotërojmë paraprakisht dijen që po na kujtohet, porse duhet ta përtërijmë atë. Shkurt, njohja e vërtetë e vetes kërkon që vetja të shihet si Fytyrë të

Zotit dhe të kuptohet se “gjithçka po shkatërrohet, përveç Fytyrës së Tij”, që nuk është tjetër veçse fytyra e vërtetë e dikujt. Njëjtësia e mbrame e Fytyrës së Zotit me fytyrën njerëzore na kujton se përkujtimi i Zotit prej nesh është njëherësh përkujtimi ynë prej Zotit: (Kujtomëni e do t’ju kujtoj) (2:152).

Një tjetër varg që përmend Fytyrën e Zotit është burimi i një prej çifteve konceptuale më të famshme në fjalorin sufi, *fena’*, shuarje ose asgjësim, dhe *beka’*, mbetje ose mbiqëndrim. “Gjithçka në të (tokë) shuhet. Dhe mbetet Fytyra (Qenia) e Zotit tënd, plot Madhështi e Begati” (55:26–27). Të gjitha shenjat zhduken, por Fytyra Hyjnore që vetëshpaloset te shenjat mbetet. Sufitë e marrin këtë jo vetëm si pohim për natyrën kalimtare të botës, po edhe thirrje për veprim. Kërkuesit duhet ta dallojnë natyrën kalimtare të vetëve të tyre përveç “fytyrave” të tyre dhe ta gjejnë Fytyrën e përhershme të Realit; ata duhet t’i mohojnë velet dhe të pohojnë Fytyrën e Zotit, pra të asgjësojnë vetvetet e tyre të paditura dhe të kufizuara, në mënyrë që të vërejnë “Fytyrën Hyjnore”.

Njerëzit, të krijuar nga Zoti për të qenë mëkëmbës (*kbala’if*; nj. *kbalifeh*) të Tij mbi tokë (2:30), mund t’i luajnë rolet e duhura të tyre vetëm po njohën se kush janë dhe kush është Zoti i tyre. Ademiti iu mësuar tërë emrat, por ai “harroi” (20:115)

e “u mosbind” (20:121). Zoti e fali Ademin dhe e caktoi profet e mëkëmbës, por shumica e fëmijëve të tij mbizotërohen nga harresa e mosbindja. Zoti dërgon udhëzim pikërisht për t’ua kujtuar rolin e tyre në krijim. Kur kujtohen, ata kuptojnë se duhet të përpiqen me i përmbushë tiparet e karakterit që rrinë latente në natyrën e tyre të kryehershme. Duhet ngritur velet që të shfaqet Fytyra e Zotit. Tiparet e qortueshme të karakterit duhen asgjësuar, ndërsa tiparet e lëvdueshme – të rrënjësura në *fitreb* – duhen shpërfaqur për të mbiqëndruar. Të udhëhequr nga mohimi i velit dhe pohimi i Fytyrës Hyjnore, kërkuesit e Zotit synojnë ta ndjekin Profetin në shkallën e ngjites dhe ta përtërijnë formën e tyre të kryehershme në Prandinë Hyjnore, fytyrat e tyre burimore para se të lindeshin prej prindërve të tyre. Kur e tërë injoranca dhe tiparet e qortueshme të jenë asgjësuar, mbetet veç Fytyra e Zotit – morali i mrekullueshëm i Realit.

Dashuria

Historianët kanë vërejtur se sufizmi ka pasur aftësi të jashtëzakonshme për të tërhequr masat dhe përshkuar kulturën popullore. Leximi sufi i Kur’anit përcillej nëpërmjet rrezatimit personal të mësuesve të përsipirt dhe një letërsie të pamatë, shumë prej të cilës u paraqit në formën e

poezisë dhe këngës. Teologët dhe juristët parapëlqenin stërhollime të thata në arabishte, gjuhën universale të dijetarisë muslimane, ndonëse shpesh shkruanin vepra më popullore në persishte, turqishte, gjuhë të tjera, madje edhe në arabishte. Poetët i këndonin këngët e tyre në gjuhët e tyre dhe poezia u bë bartës i bukur e i qasshëm i mësimëve sufiste. Monumentali *Mesnevi* i Xhelal ed-Din Rumiut (vd. 672/1273) për shembull, është quajtur Kur’ani në gjuhën perse. Kjo, jo sepse ai ka ndonjë ngjashmëri të jashtme me Fjalën Hyjnore, por sepse Rumi arriti të rrokte në gjuhë joteknike, të përditshme, të kuptueshme për çdo persisht-folës, atë çka ai vetë e quan “rrënjët e rrënjëve të rrënjëve të fesë”⁸ – një përshkrim me vend ky i vetë Kur’anit, themelit të gjithçkaje islame.

Tema bazë e shumicës së poezisë popullore, sidomos asaj sufiste, është dashuria, me të gjitha ngritjet dhe uljet, gëzimet dhe pikëllimet e saj. Konturet e sufizmit si antropologji kozmike dhe shpirtërore ndofta mund të shihen më mirë duke vështruar disa ajete për dashurinë

8. Rumi e nis hyrjen në arabishte të kësaj vepre të madhe me fjalët: “Ky është libri i *Mesnevi*-ut dhe përbën rrënjët e rrënjëve të rrënjëve të fesë, që shpалos fshehtësitë e mbërritjes [te Zotit] dhe të sigurisë; të kuptuarit e thellë më i madh i Zotit (*fikh Allah el-ekber*), Rruga më e shndritshme e Zotit (*sber' Allah el-ezher*), dhe prova më e shpërfaqur e Zotit (*burban Allah el-edhber*).”

dhe mënyrën në të cilën kuptoheshin ato. I cituari më shpesh është pa dyshim ajeti 5:54, “Zoti do të sjellë njerëz, të cilët Ai i do dhe të cilët e dojnë Atë”, zakonisht në formën e shkurtuar (Ai i do ata dhe ata dojnë Atë). Teologu Ahmed es-Sam‘ani (vd. 534/1140) shpjegon se Zoti i përmend Emrat e Tij më të Bukur në Kur’an për t’ua sqaruar shërbëtorëve të Tij se duhet t’ia mohojnë Atributet Hyjnore vetvetes dhe t’ia pohojnë vetëm Zotit. Zoti flet për Lartësimin e Tij dhe uljen e tyre, Dijen e Tij dhe injorancën e tyre, Shenjtërinë e Tij dhe njollosjen e tyre, Jetën e Tij dhe vdekjen e tyre, Unitetin e Tij dhe shumësinë e tyre. Por “kur Ai dha habere dashurie, ashtu siç pohoi dashjen për Vetën, Ai pohoi edhe dashjen për ne – *Ai dashuron ata, dhe ata dashurojnë Atë.*”⁹

Vëreni se ky ajet flet hem për Zotin, hem për njerëzit, si dashurues e i dashur. Teuhidi na paralajmëron për faktin se nuk mund të ketë dashurues dhe të dashur të vërtetë përveçse Zoti. Në çfarë kuptimi, atëherë mund të quhen njerëzit dashurues të Zotit dhe përse u dashka që të jenë objektet e dashurisë së Zotit? Mund të nisim duke kujtuar se Pejgamberi ka thënë: “Zoti është

i bukur dhe e don të bukurën.”¹⁰ Në raport me teuhidin, kjo do të thotë se asgjë nuk është tamam e bukur përveç Zotit, dhe askush nuk e dashuron tamam Zotin përveç Zotit. Megjithatë, Zoti i krijoi njerëzit në formë të bukur: “Ai ju formësoi dhe jua bëri të bukura format” (40:64). Format tona janë të bukura, sepse Zoti na krijoi sipas “formës” së vetë Atij, çka do të thotë se na ka sendërtuar me Emrat e Tij më të Bukur. Zoti e dashuron bukurinë; pra Ai dashuron bukurinë e formave njerëzore, domethënë shpërfaqjen e Emrave më të Bukur të vetë Atij në krijim.

Përse, pra e krijoi Zoti gjithësinë në radhë të parë? Në Kur’an, Ai thotë: “Nuk i krijova xhindët dhe njerëzit, përveçse që të Më adhurojnë” (51:56), ku fraza e fundit mund të nënkuptojë edhe “të Më shërbejnë”. Përmbushja e rolit të duhur njerëzor si mëkëmbës i Zotit kërkon që t’i shërbehet Zotit, dhe nuk ka shërbim më të madh se mohimi i vetes dhe pohimi i Zotit, asgjësimi i tipareve të qortueshme të karakterit dhe lejimi i tipareve Hyjnore të karakterit që të mbiqëndrojnë. Po ç’lidhje ka shërbimi/adhurimi me dashurinë? Këtu, tekstet sufiste pëlqejnë të citojnë hadithin kudsí: “Isha Thesar i Fshehur dhe dashurova të njëhem; ndaj i krijova krijesat që të njëhem.”¹¹ Me fjalë të tjera, Zoti e

9. Cituar në William C. Chittick, *Sufism: A Short Introduction* (Oxford: Oneworld, 2000), f. 120. [Të shihet përkthimi nga Sokrat Amataj, *Në kërkim të zemrës së humbur* (Tiranë: Fondacioni Rumi, 2007), f. 140].

10. Muslim 2.41 (nr. 275).

11. Kjo thënie citohet shumë në tekstet e

krijoi gjithësinë, sepse, siç e shpreh ajeti i dashurisë së ndërsjellë, “Ai i dashuron ata”, pra njerëzit, kështu që u ka dhënë kapacitetin për ta njohur e dashuruar edhe ata. Duke përtërirë fitren e tyre, ata e njohin veten si shërbëtorë të Zotit dhe e njohin Krijuesin e tyre si mbajtësin e Emrave më të Bukur, që janë edhe Emrat më të Dashurueshëm, sepse bukuria tërheq dashuri. Njohja, pra e kthen dashurinë e tyre kah Zoti, dhe dashuria kërkon shërbim të përkushtuar.

Kështu, nuk ka dashurues përveçse Zoti, dhe “Ai dashuron ata”, pra njerëzit e krijuar sipas “formës” së Tij, sepse ata janë Vetë-Shpalosje të Emrave më të Bukur të Tij. Dhe nuk ka të dashur përveçse Zoti, çka do të thotë se njerëzit dashurojnë Zotin dhe vetëm Zotin, qoftë nëse e dinë apo jo. Kjo, sepse askush nuk është i bukur përveçse Zoti, kështu që çdo dashuri tërhiqet nga Bukuria e Tij. Autorëve sufi ua ka ënda veçanërisht që ta shpjegojnë këtë të vërtetë, sepse ajo i bie ndesh logjikës së zakonshme, e cila na thotë se ne dashurojmë këtë person apo atë gjë. Ç’është e vërteta, Kur’ani vëren: “Njeriut i janë bërë t’i duken të këndshme dashuria e pasioneve, mes tyre gratë, fëmijët, grumbuj të stivuar ari e argjendi, kuaj me nishan, gjedhë e kullosa” (3:14). Po pse këto

mëvonshme, prej aty nga shekulli VII/XII e këndej, por shumica e dijetarëve të Hadithit nuk e konsiderojnë autentike.

gjëra “duken të këndshme”? Arsyeja është sepse ata dashurojnë Atë dhe e shohin Bukurinë e Fytyrës së Tij në shenjat e Tij, pa qenë të vetëdijshëm për të. Siç e thotë Rumi, objektet e dashurisë janë të veshura në flori nga Atributet e Zotit. Njerëzit duhet të përpiqen të kuptojnë se ata nuk dashurojnë këto objekte në vetvete, po Zotin. Ibn ‘Arabi e shpjegon këtë pikë në këtë mënyrë, duke iu referuar fillimisht një vargu grash të bukura me nam në poezinë arabe:

Askush nuk dashuron kënd veç Krijuesit të vet, porse prej Tij e velon dashuria për Zejnebin, Su’adën, Hindin e Lejlën, dynjanë, paranë, pozitën dhe gjithçka të dashuruar në botë. Poetët i shterojnë fjalët për tërë këta ekzistues, por nuk dinë gjë. Gnostikët nuk dëgjojnë kurrë varg, gjëgjëzë, elegji a poezi dashurie që të mos jetë për Zotin, fshehur matanë velit të formave.¹²

Domethënia e ajetit të dashurisë së ndërsjellë bëhet paksa më e qartë me t’u përsiatur rreth asaj që dëshirojnë dashuruesit. Në qoftë se “Ai dashuron ata dhe ata dashurojnë Atë”, edhe Zoti edhe njerëzit dëshirojnë të njëjtën gjë: të jenë bashkë. E thënë me gjuhën teknike të sufizmit, ata dëshirojnë bashkim (*visal*), jo ndarje (*firak*), sepse dashuria nuk konsumohet dot kurrë në largësi. Mirëpo, është po aq e vërtetë se dashuruesit nuk mund

12. Cituar në Chittick, *Sufism*, f. 67. [Faqe 76–7 e botimit shqip].

të bashkohen pa qenë më parë të ndarë. Pikërisht dëshira për bashkim e nxiti Realitetin Një, që të sjellë dysi e ndarje pikësëpari. “Urdhri i Tij, kur dëshiron diçka” - thotë Kur’ani, “është vetëm t’i thotë “Bëhu!” e ajo bëhet” (36:82). Kjo dëshirë për të krijuar gjëra nuk është tjetër veçse dashuria e Thesarit të Fshehur për t’u njohur, sepse pa krijim të ndarë nuk do të kishte kush ta njihte dhe dashuronte Atë.¹³

Pra, qëllimi i veprimtarisë krijuese të Zotit nuk është, siç mund të pandehin disa, që thjesht të ketë një botë aty pari, por që Zoti dhe të dashurit e Tij të bëhen tok, siç ishin para krijimit. Rumi e shpjegon këtë lojë dashurie kur thotë se të gjithë neve ishim peshq që notonin në oqeanin e Unitetit Hyjnor, të pavetëdijshëm për dallimin tonë nga uji. Atëherë Zoti na nxori në tokë të thatë, sferën e ndarjes, mallit, dhimbjes dhe vuajtjes. Vetëm duke shijuar ndarjen mund të na kujtohet gazmendi i ujit dhe dëshira për t’u kthyer atij. Me t’u kthyer, do të notojmë sërish në Oqeanin e Unitetit me vetëdije të plotë për gëzimin e dashurisë së përmbushur.

Referimi më i hapët ndaj bashkimit me Zotin në burimet më të hershme islame është me siguri

13. Në versione të tjera, hadithi i Thesarit të Fshehur thotë “dëshirova” (*aradtu*) në vend të dashurova (*abbabtu*). Teologët zakonisht e klasifikojnë “dashurinë” si formë specifike “dëshire”.

hadithi kudsî i saktë, në të cilin Zoti flet për shërbëtorin që kërkon afrinë me Atë përmes veprave të mira. Kur shërbëtori përparon në udhë, atëherë – thotë Zoti, “Unë e dashuroj, dhe kur e dashuroj, Unë jam të dëgjuarit me të cilin dëgjon, të pamurit me të cilin shikon, dora me të cilën rrok e këmba me të cilën ecën.”¹⁴ Ky hadith ka qenë lëndë shkoqitjesh pa fund në tekste sufiste, sepse përshkruan me terma konkrete frytin e “Ai dashuron ata”. Por, edhe “ata dashurojnë Atë” luan rol bazë: dashuria e shërbëtorëve për Zotin i nxit ata me ndjekë rrugën e udhëzimit. Sikur dashuria e tyre të ishte e çoroditur, ata do të tërhiqeshin pas veshjes me ar, në vend të Zotit; kështu që nuk do të përparonin në udhë. Për të përparuar, ata duhet të veprojnë bukur e virtytshëm (*ihsan*) dhe të arrijnë të karakterizohen nga tipare të bukura karakteri. E vetmja mënyrë për ta realizuar këtë është me ecë gjurmëve të Profetit (a.s.). Profeti porositet: “Thuaj, ‘Nëse doni Zotin, ndiqmëni mua dhe Zoti do t’ju dojë’” (3:31). Kur na don, Zoti është të dëgjuarit me të cilin dëgjojmë, sytë me të cilët shikojmë dhe zemra me të cilën dashurojmë.

“Zoti është i bukur dhe e dashuron bukurinë”. Qartas, Profeti (a.s.), i fundit i profetëve dhe “më i lavdërueshmi” i krijesave të Zotit, është trupëzimi i virtytit dhe bukurisë njerëzore. Siç e shpreh hadithi kudsî, “Të mos ishe ti [O

14. el-Bukhari 81.38 (nr. 6581).

Muhammed], nuk do t'i kisha krijuar sferat [qjellore].”¹⁵ Zoti e krijoi gjithësinë nga Dashuria e Tij për t'u njohur, dhe Profeti e përmbushi këtë rol në mënyrën më të përsosur, çka e bëri më të dashurin e Zotit dhe modelin që duhet të ndjekin të gjithë dashuruesit. Duke ndjekur Profetin, ata mund t'i aktualizojnë Emrat më të Bukur në karakterin e tyre, dhe pikërisht bukurinë e pasqyrimin të këtyre Emrave të qeniet njerëzore dashuron Zoti. Është sigurisht e vërtetë po ashtu, se Zoti i dashuron të gjithë njerëzit dhe ç'është e vërteta mbarë krijesat. Ai “bëri të bukur gjithë çka krijoi” (32:7) dhe e dashuron të bukurën. Kësodore, edhe fryti i “që dashuria e Tij të njihej” ishte krijimi i mbarë krijesave, jo thjesht i njerëzve.

Megjithatë, Kur'ani nuk përmend haptas krijesë tjetër, veç njerëzve, si objekte të Dashurisë së Zotit. Specifikisht, ai thotë se Zoti dashuron bukurbërësit (ata që kanë *ihسان*, në pesë ajete), ata që i ruhen (tre ajete), të drejtit (dy), pastruesit e vetes (dy), pendestarët, durimtarët dhe ata që i mbështeten Atij. Ai thotë po ashtu se ka njerëz që Zoti nuk i dashuron: jobesimtarët, zullumqarët, ngatërresëtarët,

15. Kjo thënie citohet rëndom në tekste sufiste, por nuk dëshmohet në burimet e sakta. Disa vepra Hadithi e kanë në formën “Të mos ishe ti, nuk do t'i kisha krijuar Kopshtin dhe Skëterrën.” Bedi' uz-Zaman Furuzanfar, *Ahadith-i Methnani* (Tehran: Amir Kabir, 1347/1969), f. 172.

shkelësit, të shkujdesurit, krenarët dhe mburravecët. Me fjalë të tjera, Kur'ani na thotë se Zoti ka dashuri të veçantë për ata që zgjedhin të ndjekin sifitet e Tij, dhe kjo dashuri nuk është tamam njëlloj si dashuria që solli në ekzistencë gjithësinë. Sifitet e Zotit të ndjekura nga ata që Ai i dashuron ngërthehen të “shembulli i bukur” (35:21) dhe morali i madhnueshëm i Profetit.

Shkoqitja e rrugës së stolisjes me tiparet e bukura të karakterit u siguron bazën shumë librave nga mjeshtra sufi. Më i famshmi i këtyre në Perëndim është *Mantiku't-tajr* (“Gjuha e zogjve”) nga Farid ed-Din 'Attar (vd. 618/1221), një poemë e përkthyer disa herë në anglishte. Titulli i referohet një ajeti kur'anor, në të cilin thuhet se Solomoni dinte (gjuhën e zogjve) (27:16). Në leximin që i bën 'Attari, ajeti aludon për njohjen profetike - nga Solomoni - të veteve njerëzore, të vetmeve ndër të gjitha krijesat me potencialin për të fluturuar te Prania e Zotit. Çdonjëri nga zogjtë në rrëfim përfaqëson një tip njerëzor me fuqitë dhe dobësitë e tij. Pas goxha diskutimi e debati, tridhjetë zogj pajtohen të nisen në kërkim të Simurgh-ut, mbretit përrallor të zogjve që rron diku larg. Me shumë mundim, ata fluturojnë mbi shtatë male, çdonjëri më i lartë se paraprirësi dhe përfaqësues i një etape në rrugën drejt Zotit, tipar karakteri që duhet bërë cilësi e përhershme e vetes. Shtatë etapet – kërkimi, dashuria, njohja, pavarësia, uniteti, shushatja dhe

varfëria – bazohen në terminologji kur'anore dhe pasqyrojnë shekuj mësimi e ushtrimi sufi, që synojnë përtëritjen e fitës dhe arritjen e “deiformitetit”. Kur mbërrijnë fundin e rrugës, zogjtë zbulojnë se të gjitha tiparet e tyre të karakterit janë asgjësuar dhe vetëm tiparet e karakterit të Simurgh-ut mbiqëndrojnë. “Tridhjetë zogjtë” (*si murgh*) vijnë e kuptojnë se, qysh në fillim, ata kishin qenë Vetë-Shpalosja e Simurgh-ut.

Mësuesit sufi i numërojnë etapat në rrugën drejt Zotit në shumë mënyra të ndryshme, por tejevështrimi i tyre i përbashkët është se Kur'ani e Sunneti ofrojnë udhëzuesit për realizimin e “Formës Hyjnore”, që rri latente në çdo vete. Çdo njeri thërritet që ta njohë Thesarin e Fshehur, t'i rikujtojë emrat që iu mësuuan Ademit, të dashurojë të Dashurin e vërtetë, dhe

me u rrokë nga Dashuruesi i vërtetë. Të qenurit plotësisht njerëzor, kërkon përmbushjen dhe realizimin e kuptimit të teuhidit në thellësitë e zemrës. Rumi u përmbledh udhën kur'anore të sufizmit:

Dashuria është ajo flakë që, kur ndizet,

shkrumbon gjithçka veç Të Dashurit Mbiqëndruës.

Ajo ngul shpatën e “jo zot” për të mbytur tjetër-veç-Zotit.

Pa shiko – pas “jo zot” çfarë mbetet? Mbetet “përveçse Zoti”, tjetra është zhdukur.

Të lumtë, O e madhja Dashuri idhull-djegëse.¹⁶

Shqipëroi: Edin Q. Lohja

16. Burimi i artikullit: “The Quran and Sufism”, The Study Quran. Edited by Seyyed Hossein Nasr et al. New York: HarperCollins, 2015, pp. 1737-49.

**Recensë librit “Hoxhë Kadri Prishtina
Mendimtar Islam”
me autor z. Qemajl Morina**

**Refik Gerbeshi
Kosovë**

Biografi e autorit

Mr. Qemajl Morina lindi në vitin 1951 në fshatin Hodonovc të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në “Medresenë Alaudin” në Prishtinë. Studimet i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin “Umduruman” në Sudan (1976), ndërkaq studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Kajros (1979).

Gjatë viteve 1980 – 1989) ka punuar në Bengazi në detyrën e sekretarit dhe përkthyesit në Ministrinë

e Shëndetësisë së Libisë. Më 1990 u zgjodh kryeredaktor i revistës “Dituria Islame”, post në të cilin qëndroi deri në vitin 1996. Pastaj, nga viti 2001 deri më 2016, ishte kryeredaktor i revistës “Edukata Islame”. Ka Ligjruar gjuhën arabe në Katedrën e Orientalistikës në Fakultetin e Filologjisë (1990-1992), si dhe Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë (1992 -2016); përveç kësaj ishte edhe prodekan në FSI (1992-2011). Mirëpo ajo që e dallon profesor Qemajlin është publicistika, shkrimet e tij bënë bujë. Me shkrime merret që nga viti 1970-të, ka bashkëpunuar me një numër të konsiderueshëm të revistave shkencore, brenda dhe

jashtë vendit, si “Edukata Islame”, “Takvim-Kalendar”, “Rilindja”, “Jeta e Re”, “Përparimi”, “Hëna e Re”, “Dituria Islame”, “El-Muxhtema”, “Et-Talib”, “Err-Rrisaletu” (Sudan), “Al-Arab” (Bejrut), “Gllasnik”, “Preporod” (Sarajevë), “Drita islame” (Tiranë), Zëri, etj. Ka të botuara këto libra: Lidhja shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian (1878-1881), (2007), Glosari i nocioneve fetare (islame, ortodokse, katolike dhe çifute)(2010), etj. Profesori Qemajl Morina është mjeshtri i penës islame shqiptare në publicistikën bashkëkohore. Vdiq në vitin 2019.

Kush ishte Hoxhë Kadri Prishtina

Lindi në vitin 1878 në Prishtinë. Ishte një nga nëntë fëmijët e Lutfullah Halimit. Mësimet fillore i kreu në Prishtinë, ndërsa ato të mesme në Shkup, në shkollën e njohur “Dar ul-Mualimin”. Studimet i vazhdoi në Stamboll, në shkollën e Lartë Pedagogjike. Më pas kreu Medresenë e famshme “Fatih”. Gjatë kohës që vazhdonte studimet në Turqi, ai u fut në klubet patriotike, që qenë krijuar atje, dhe formoi lidhje të ngushta me atdhetarët shqiptarë.¹

Në vitin 1904, në moshën 26 vjeçare, ka fituar titullin Myderriz (Dijetar-Profesor), por ende vijonte studimet në shkollën e lartë të së

1. Eqber Skëndi, *Hoxhë Kadriu (Kadri Prishtina)* Prishtinë 1992, f. 10-13.



drejtës fetare. Në këtë vit u arrestua për arsye se nuk pranoi të tregonte autorin e dorëshkrimit “Fitret ul-Islâm” - dorëshkrim i Syrja bej Vlorës - një dorëshkrim në lëmë të fesë Islame dhe të drejtës fetare. Sa ishte në burg në Jedikule, ku vuanin dënimin edhe të burgosur të tjerë politikë, Hoxha Kadriu u sëmur dhe iu desh të bënte prerjen e këmbës mbi gju. Kthehet në atdhe dhe në vitin 1915 në Shkodër ku themeloi një komitet me emrin “Komiteti i Fshehtë”, ndërsa pas tri vitesh, me një grup atdhetarësh e intelektualësh, kryesisht nga Kosova, themeloi organizatën politike që do të organizonte popullin shqiptar në luftë për çlirim e bashkim kombëtar.

Më 1 maj 1918, u themelua Komiteti “Mbroytja Kombëtare e

Kosovës”. Në përbërje të tij kishte Këshillin Qendror, ku bënë pjesë shtatë anëtarë, të cilët kryetar zgjodhën Hoxhën Kadri Prishtinën.²

Komiteti kishte organin e vet, gazetën “Populli”, e cila botohej në Shkodër. Hoxhë Kadriu, përgatiti Programin e përgjithshëm të kryengritjes së Kosovës me këtë përmbajtje:

I. Asnjë kryengritës nuk guxon t’i dëmtojë shkiët (serbët) e vendit veç atyre që qëndrojnë me armë në dorë kundër qëllimit shqiptar.

II. Asnjë kryengritës nuk guxon të djegë shtëpia, të rrënojë kisha e gjëra të tjera.

III. Plaçka është jasak (e ndaluar) e kryengritjes.

Ndër pikat e këtij programi kishte edhe citatin: Kot e pa nevojë, as gjaku i popullit tonë as gjaku i popullit të armikut, s’ka pse të derdhet. Dhe pikën ku thuhej: “Të vrarët shqiptarë s’kanë për t’u shti në dhe derisa të vijë një komision i huaj. Mizoritë e bëra prej armikut kanë për t’u shënuar dhe për t’iu dëftuar Evropës e Amerikës.”

Më 24 prill 1919, filluan të shpërndahen thirrjet për kryengritje. Dita e fillimit të kryengritjes u caktua më 6 maj 1919. Kjo njihet si Kryengritja e Llapushës, ku luftuan Azem dhe Shotë Galica. Edhe në qendrat e tjera të Kosovës kishte filluar kryengritja në të njëjtën kohë. Numri i kryengritësve arriti në rreth

2. E. Skëndi, *Hoxhë Kadriu*, cit., f. 37.

10.000 veta. Ai është zgjedhur disa herë përfaqësues i popullit (deputet) në parlamentin shqiptar në Tiranë dhe më 1921 zgjidhet nënkryetar i Parlamentit të parë Shqiptar.³

Hoxhë Kadriu është shquar si imam, dijetar, atdhetar, politikan, diplomat, publicist dhe jurist. Urrente diplomacinë evropiane, e cila me hipokrizinë e saj merrte nëpër këmbë të drejtat e popujve të vegjël.⁴ Hoxhë Kadriu ishte anëtar i qeverisë së Sylejman Delvinës formuar në Kongresin e Lushnjës më 1 janar 1920⁵. Ndërroi jetë më 20 janar 1925, në moshën 47 vjeçare.

Historia u ka borxh plejadës së hoxhallarëve

Nuk ka dyshim se rolin kyç për ruajtjen e traditës islame e kishin prijësit fetarë islamë, hoxhallarët, të cilët gëzonin autoritetin në popull dhe kishin njohuri të mjaftueshme për zgjerimin e mësimëve të Zotit. Në dritën e shkencës të shihet edhe roli i Islamit si faktor integruës i njësisë etno-kulturore dhe gjeopolitike të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar deri në fillet e rilindjes.⁶ Autoriteti i tyre ishte i madh në popull dhe kjo ndikonte

3. Po aty, f. 218.

4. Q. Morina, *Hoxhë Kadri Prishtina Mendimtar Islam*, Prishtinë 2000, f. 15.

5. Grup Autorësh, A. Sh. Sh., *Historia e Popullit Shqiptarë vol III*, Tiranë 2007, f. 147.

6. Dr. Muhamet Pirraku, në *Feja, kultura dhe tradita islame ndër Shqiptarët*, Prishtinë 1995, f. 43.



që edhe ndikimi i tyre të jetë i gjerë te masa. Patriotizmi e besimi që i vuri ata (hoxhallarët) në krye të ngjarjeve të mëdha të kombit, me të cilat jo vetëm që hynë në histori, por edhe e bënë historinë.⁷ Sistemi komunist, në luftën e ashpër kundër fesë, përdori metoda e forma të ndryshme. Nga ana tjetër historiografia komuniste dhe ajo postkomuniste, nën trysnitë e propagandave ateiste sllave, ngurroi të paraqiste kontributin real të imamëve. Në këto periudha vërehet tendenca për fshehjen e titullit fetar islam të kontribuuesve për shkollat e para shqipe, pra edukim, arsim pajtimet e gjaqeve dhe aktivitetin e luftën për liri. Ndërkohë që populli përpiquej për liri, hoxhallarët ishin figura të rëndësishme në këto përpjekje. Në fund të vitit 1918 në Shkodër ishte formuar Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, kryetar i të cilit u zgjodh Hoxhë Kadri Prishtina.⁸ Pak përmendet në histori si figurë kyçe e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e

Kosovës 1918”. Komiteti kryesohej nga Hoxhë Kadri Prishtina. Komiteti i Kosovës shtroi si detyrë të përpiquej për lirim kombëtar të vendit, për rimëkëmbjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe për bashkimin e Kosovës me shtetin shqiptar.⁹

Nuk ka dyshim se historia kombëtare, ajo komuniste si edhe post komuniste, u ka borxh figurave të tilla, ngase i anashkalon apo i përmend sipërfaqësisht. Për shkak të ndikimit të ideologjisë moniste në veprimtarinë shkencore dhe kulturore, kjo figurë aq e respektuar dhe e merituar, është zhveshur tërësisht nga ndjenjat e tij islame. Këto ndjenja ai më së miri i kishte shprehur revistën mujore me titullin; ”Udha e s’Vërtetës”, në vitin 1923.¹⁰ Qëllimi i kësaj reviste, siç e cekë vetë Hoxha, ishte demaskimi i propagandave anti islame, që bëhej në qarqet shqiptare, ku thekson: “Dami ma i madh i këtyne pseudo intelektualëve asht të bamit e tyre mjet e vegël me përhapë e me predikua mendimet kundra besimit mysliman, mendime qi janë t’adoptueme nga Evropianët e nga armiqt e myslimanve.”

Për veprimtarinë atdhetare të tij janë shkruar shumë artikuj, punime, studime, janë organizuar sesione shkencore. Ky erudit dhe kjo figurë kombëtare është përmendur në

7. Naim ef. Tërnavë, *Ligjërime për Fe e Atdhe* - 2, Prishtinë 2015, f. 148.


8. Selatin Novosella, *Kosova '64, Renesanca*, Prishtinë 1994, f. 20.

9. Grup Autorësh, A. Sh. Sh, *Historia e Popullit Shqiptar vol III*, Tiranë 2007, f. 125.

10. Qemajl Morina, *Hoxha Kadri Prishtina, Mendimtar Islam*, cit., f. 6.

Historinë e Shqipërisë, në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar. Gjithashtu për të është botuar edhe një monografi nga Eqber Skëndi me titull: “Hoxhë Kadriu (Kadri Prishtina)”, 1992.

Në asnjërën prej këtyre shkrimeve nuk është shkruar për veprimtarinë e tij fetare, përveç nga mjeshtri i pendës islame shqiptare Mr. Qemajl Morina, i cili, që në vitin 1997, në revistën “Dituria Islame”, ka shkruar studimin me titull: “*Idetë Islame të Hoxhë Kadriut në revistën ‘Udha e s’Vërtetës’*”, si dhe libri për të cilin po shkruajmë këtu.



Shkurtimisht rreth librit

Libri monografi: *Hoxhë Kadri Prishtina - mendimtar islam*, Prishtinë (2000), është një qasje shkencore hulumtuese e argumentuese që paraqet figurën e Hoxhë Kadri Prishtinës, figurë kjo jo e ndriçuar sa duhet në qarqet shkencore tek ne. Duke filluar me një biografi të shkurtër përgatitjen shkollore, profesionalizmin në Stamboll dhe studimet për jurisprudencë-drejtësi më 1904, duke marrë gradën shkencore profesor,¹¹ libri është i mjaftueshëm për të ditur gjërat elementare të këtij eruditi.

Ngritjen e vetëdijes patriotike e bëri kur takonte figurat e mëdha shqiptare me kthimin në Shqipëri. Kishte oferta që ia bënin austriakët por ky nuk lëkundej nga identiteti i tij dhe ideja për shqiptari.

Autori Qemajl Morina kishte hulumtuar gjerë e gjatë për të sjellë te lexuesi një libër modest por me shumë vlerë. Këtu i qaset elementit islam të Hoxhë Kadriut, gjë për të cilën historia u ka hak shumë prej figurave islame shqiptare, sepse atyre iu fsheh titulli islam hoxhë, imam, etj., duke vënë në pah që në fillim se kjo figurë ishte e zhveshur tërësisht nga ndjenjat e tij islame. Me argumentin e kontributit të tij në revistën “Udha e së vërtetës”, të cilën e botonte në Shkodër në vitin 1923, ai demantonon demaskone sulmon tentimet e atyre

11 Po aty. f. 9

që duan të fshehin elementin islam te hoxha. Gjatë hulumtimit të revistës në fjalë, argumentet e interesit që hoxhë Kadriu kishte për Islamin ishin të shumta siç ishte prapambetja dhe përçarja e myslimanëve, mashtrimi i një pjese intelektualësh myslimanë pas civilizimit evropian dhe mbështjellja e fesë me zakonet, ku ndër të tjera shprehet “si populli ashtu edhe hoxhallarët kanë humbur hapin e kohës”.¹²

Nën hijen e titullit “Nevoja e fesë” profesor Qemajli bën një analizë të thukët rreth interpretimit që hoxhë Kadriu i bën lindjes, zhvillimit dhe rëndësisë së fesë për ngritjen individit dhe shoqërisë; siç ishte imitimi i verbër që autori e quan sëmundje. Ngaqë nevoja për fenë, e cila është prehje e vetme shpirtërore për njeriun, është e vërtetë e përhershme dhe mjeti më i mirë për ruajtjen nga e keqja, më tutje sqaron se njeriu pa fe nuk mund të jetë i sinqertë dhe arsyeja e ngecjes mbrapa është pikërisht lënia anash e mësimave fetare pra braktisja e fesë. Pastaj sjell edhe tematikën për femrën ruajtjen e nderit e moralit dhe martesën me kurorë dhe ngre hipotezat çfarë dëmi shkaktojnë ata që nuk martohen, apo si përfundojnë ata. Çka nënkuptojmë me emancipimin e femrës dhe si duhet të lidhet kurora. Titulli “Burimi i mendimit të besimit në njerëzi” është i shoqëruar me

12. Po aty. f. 22.

mendimet e filozofëve e dijetarëve evropianë, të cilat i sjell përmes nëntitujve “Historia nuk njeh popull pa fe”, “Besimi është instinkt i lindur me njeriun”. Kurse te titulli “Profesioni më i keq” sjell analogjinë e kthjellët filozofike se si njeriu ul vetveten duke urryer e luftuar mes vete, duke u shthurur moralisht dhe duke spiunuar njëri-tjetrin në shërbim të armiqtve dhe në dëm të shoqërisë.¹³

Me debatin që bën me revistën “Lajmëtari”, e cila u bën thirrje shqiptarëve për t’u kthyer në fenë e krishterë, propagandë kjo shekullore ndër trojet tona, e cila elhamdulillah nuk ka pasur as nuk do të ketë efekt, as në përçarje. Siç e ilustron profesor Qemajli: “Pluralizmi fetar është realitet i shqiptarëve.” Në Përmbyllje fokusohet te qëllimi i këtij libri, duke besuar se i ka bërë një shërbim të mirë hoxhë Kadriut si mendimtar i kalibrit të El-Afganit, Abduhus, etj.¹⁴

Gjithashtu profesor Qemajli bën thirrje për hulumtime e studime të mëtejme, duke ndriçuar te bëmat e kalibrit të Hoxhë Kadriut, që janë të shumta, duke përfunduar me dua, andaj edhe unë po e përfundoj me dua për Hoxhë Kadriun hoxhallarët e tjerë që na ruajtën identitetin islam, si edhe për Profesor Qemajl Morinën Allahu e shpërbleftë me xhenetet e larta.

13. Po aty. f. 62.

14. Q. Morina, *Hoxhë Kadri Prishtina, Mendimtar Islam*, Prishtinë 2000, f. 98.

H. Hafiz Dr. Hasan Kaduku (1948-1865)

*Nj hafiz Kur'ani, mjeku i par
stomatolog shqiptar*

Dr. Genti Kruja

Departamenti i Shkencave Islame
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë
Universiteti Bedër



Hasan Kaduku lindi në Shkodër dhe ishte djali i madh nga pesë djemtë e Ismail (Mala) Kadukut, një tregtar i njohur në pazarin e qytetit në punimin e lëkurave, burrë i ndershëm, dijedashës dhe atdhetar. Hasani ishte vëllai i madh i Haxhi Ibrahim Kadukut, i cili kreu detyra të rëndësishme në shërbim të Islamit dhe vendit të tij¹, vëllai

1. Haxhi Ibrahim Kaduku (1869-1949) është cilësuar si dijetari i tre kontinenteve, për arsye se shërbeu si pedagog në universitetet dhe medresetë e Stambollit, Edirnesë, Kajros,

i Riza Kadukut, funksionar në Komunitetin Mysliman në sektorin e financës, Sulejmanit (i cili posedonte kartolerinë më moderne), si dhe Hafiz Jusuf Kadukut, një prijës fetar i shkolluar si vëllezërit e tij Hasan e Ibrahim në Universitetin e Stambollit, ku njihej për komentimin e Kur'anit gjatë qëndrimit atje.²

Hasan efendiu që në moshë të re shkon në Stamboll për të vazhduar shkollën, ku vendoset pranë dajës së tij Fetah Lini, ku fillon dhe punë. Atje njihet me dijetarë të kohës, nga të cilët merrte edhe mësimë mistike, si dhe filloi mësimin përmendësh të Kur'anit. Sipas kronikanit Hamdi Bushati, mësuesit e tij kishin vënë re se kishte disa probleme me dhëmbët e parë të cilët i kishin rënë dhe bënë, që të mos i shqiptonte qartë shkronjat arabe me “texhvid”, të cilët duan një vokalitë shumë të pastër. Nga dashuria që kishte për Kur'anin, ai vendos fillimisht që paralel me mësimin e Kur'anit, të rregullojë edhe dhëmbët, ku u njoh edhe me profesionin e dentistit, të

etj., si dhe kur u kthye në Shqipëri përfundimisht më 1925, ku u emërua drejtori i parë i Medresesë së re në lagjen Pazar, Shkodër. Më pas kreu edhe detyrën e zv/kryetarit të Komunitetit Mysliman dhe për 20 vjet deri sa ndërroi jetë më 1949 ishte myfti i rrethit Kavajë (1929-1949).

2. Artikull i botuar në librin “100 personalitete shqiptare të kulturës Islame”, botimet KMSH, Tiranë, 2012, fq. 65-69.

cilin e dashuroi menjëherë. Kështu ai i lutet dentistit të tij, që ta merrte në punë, por dentisti i thotë se nuk ka nevojë. Hafiz Hasani i thotë se, “ti nuk ke nevojë për mua, por unë kam nevojë për ty dhe jam gati të të paguaj rrogë, vetëm të rri pranë teje dhe të mësoj profesionin”, e kështu ndodhi. Më vonë fillon praktikën edhe pranë dentistit të famshëm Halid Shenazi Bej dhe më pas dhe te profesor Dionizi me kombësi armene. Pasi siguron lejen e ushtrimit të profesionit, ai kthehet në vendlindjen e tij, në Shkodër.

Kështu ai për një kohë të shkurtër rreth tre vjeçare bëhet Hafiz Kur'ani dhe dentist.

Hafiz Hasani me t'u kthyer nga Stambolli në Shkodër, fillon ushtrimin e këtij zanati, duke hapur një klinikë portative, duke shkuar në shtëpitë e atyre që kishin nevojë, siç shkonin edhe mjekët e tjerë. Por nga dëshira e madhe për profesionalizëm të plotë me t'u hapur Fakulteti i Stomatologjisë në Universitetin e Stambollit (1907), pasi punoi disa vjet si dentist diletant, në një moshë kur tashmë ishte familjar dhe me fëmijë, shkon përsëri në Stamboll, ku nga tre vjet studimi, që kishte fakulteti, ai i kryen studimet për dy vjet, favor ky që iu bëhej atyre që kishin njohuri praktike disa vjeçare. Hafiz Hasani arrin të bëhet një nga studentët më të përparuar të fakultetit, pavarësisht moshës së tij gati 40 vjeçare. Madje familjarët e tij tregojnë se edhe letrat

që i vinin nga familja nuk i hapte deri në fundjavë, për të mos u shkëputur nga mësimet.³ Ai diplomohet më 1908 dhe kthehet në vendlindje si i pari mjek stomatolog, apo siç njihej ndryshe “mjek dhëmbësh” me diplomë universiteti, jo vetëm në Shkodër, por edhe në të gjithë Shqipërinë. Hafiz Hasani njihte gjithashtu shumë mirë arabishten, osmanishten dhe frëngjishten.

Doktor Kaduku mbahet si njeriu që vuri bazat e shërbimit stomatologjik modern në qytetin e tij të lindjes, në Shkodër.

Kronikani Hamdi Bushati tregon se Hafiz Hasan Kaduku e ushtroi profesionin si dentist në disa qytete të Shqipërisë, por edhe në Mal të Zi. Kronikat e asaj kohe tregojnë që Hasan Kaduku, me zotësinë e një dentisti të talentuar, tërhoqi vëmendjen e të gjithë bashkëqytetarëve të tij, duke krijuar një klientelë të gjerë edhe jashtë kufijve të vendit, si p.sh. në Mal të Zi. Të gjithë konsujt e huajt, që ishin të akredituar në Shkodër, si dhe personalitete të viseve të tjera të vendit, kishin si dentist (apo siç quhej atëherë *mjek dhëmbësh*) të tyre Hafiz Hasan Kadukun. Shkodra në fillim të shekullit XX, duke qenë një prej pikave më perëndimore të Perandorisë Osmane, kishte pesë konsullata të huaja, personeli i të cilëve bëheshin shpeshherë pacientë të Hafiz Hasanit.

3. Kaduku, Hasan (nip i Hafiz Hasanit), dorëshkrim, 2012.

Hafiz Dr. Hasan Kaduku ua la trashëgim profesionin e tij pinjollëve të tjerë të familjes, e cila në atë kohë ishte një ndër më të njohurat në Shkodër. Haki Kaduku⁴, djali i dentistit të parë shqiptar, pasi kreu gjimnazin në Austri dhe fakultetin e stomatologjisë në Stamboll, u kthye në Shkodër. Ai vijoi profesionin e të atit, duke punuar kështu bashkë me të. Derisa doli në pension, Haku, djali i Hafiz Hasan Kadukut, punoi si dentist në poliklinikën e qytetit të Shkodrës. Ai ishte një mjek i cili i kushtonte një rëndësi të madhe edukimit të rinisë për përkujdesjen shëndetësore. Haki Kaduku mbante biseda për përkujdesjen ndaj dhëmbëve në shkollat e shtetit të të gjitha niveleve.

Tradita e familjes Kaduku vazhdon me të tjerë emra. Qamurani djali i Hakiut dhe nipi i Hafiz Hasanit, është brezi i tretë i dhëmbëtarëve të kësaj familjeje. Ndërsa Hasan Haki Kaduku, nipi i Hafiz Hasanit ka ushtruar profesionin e profesorit të matematikës në shkollat e qytetit. Ndërsa Mesereti, njëra nga vajzat e Haki Kadukut, ashtu si vëllai i vet arsimitare në matematikë, do të vinte bazat e matematikës për shumë vite në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia” në Shkodër.

Studiuesi Osman Hoxha e përshkruan kështu figurën e Hasan Kadukut: “Njeri madhështor, shtatlartë e shpatullgjerë, syshqiponjë

4. Haki Kaduku (1900-1978).

e hundëshkabë, me mjekër të bardhë dhe shumë i pashëm, fisnik dhe zemërgjerë, i respektuar dhe mendjemprehtë, energjik dhe i papërkulur, i dashur e bujar, ishte gjithmonë mes njerëzve, që e donin dhe i donte aq shumë. Ishte i punës por dhe i pushkës. Në kohën e rrethimit të Shkodrës nga malazezët në vitet 1912-1913, Hafiz Hasan Kadukun e gjejmë të rreshtuar në llogore përkrah vullnetarëve të tjerë, duke kryer detyrën ndaj atdheut.

Në vitin 1932 kreu edhe ritualin e Haxhit. E tashmë njerëzit e njihnin si Dr. Haxhi Hafiz Hasan efendi Kaduku.

Shprehja “po shkoj te Kaduku”, më shumë se prej një shekulli në Shkodër nënkupton “po shkoj te dentisti”.

Klinika e famshme dentare “Kaduku”, në vitin 1948 do të sekuestrohej e gjitha nga shteti (regjimi komunist), duke bërë kështu që shumë klinika shtetërore për stomatologji në Shkodër dhe Tiranë, të hapeshin me veglat e shtetëzuara të Dr. Kadukut.

Klinika e Hafiz Hasanit ndodhej në pikëtakimin e lagjeve të vjetra myslimane dhe katolike, e cila shërbeu kështu edhe si një busull afrimi mes dy besimeve, sepse klientët ishin nga të dyja lagjet.

Shenjë e tolerancës ndërfitare është edhe një fakt interesant ku revista katolike e kohës “Elçija (lajmëtari) e Zembrës s’Krishtit”, e

vitit 1906 (vjeta XVI, Dhetuer, 1906, nr. 12), boton një reklamë interesante të Hafiz Hasan Kadukut, i cili i fton klientët që të mbushin apo të venë proteza dhëmbësh në klinikën e tij dhe paratë mund t’i paguajnë më vonë, pasi ata të jenë mësuar me protezat apo mbushjet dhe të jenë të kënaqur prej tyre.



“N’saje t’Dautetit (shtetit), pasi kam zan (studinar) n’Stamboll edhe e kam Diplomën, tesh (prej) gjashtë vitesh n’Shkodër edhe ndër vende tjera kam punu zanatin e dhambëve si me t’hjekun (heqje) pa t’vështirë (vështirësi), si me godituna (rregullime) e myshteritë (klientat) kanë kenë të konnen (të kënaqur).

Për me fitue një t’zanun besë ndaj të

Kur mosha bëri të veten, Hafiz Hasani vetë kaloi në laborator dhe i biri, Hakiu në klinikë. Ai ishte i pari që mbajti korrespondencë me një firmë londineze (A.S.H. & Sons), nga ku kishte porositur edhe klinikën e tij, të cilën e ka pasur me qira në shtëpi të ndryshme shkodrane, njëra prej të cilave është fotografuar edhe nga Marubi.

Studiuesi i njohur, i ndjeri Prof. Gëzim Uruçi, në dosjen e tij “Personalitete të shquara në memorien e malësorëve tanë”⁶, (*Haxhi Dr. efendi Kaduku dhe kroni i Kadukut në fshatin Theth të Dukagjinit*), na njeh me shumë histori, episode dhe toponime që hapin një faqe të re shumë interesante për figurën e Hasan Kadukut. Lidhur me këtë ka shkruar edhe dr. Musa Bizaku, duke bërë një monografi për brezninë Kaduku.

Hafiz Hasani ishte ndër të parët pushues dhe i pari mysliman, që veroi në fshatin turistik të Thethit që nga viti 1936, i ftuar fillimisht nga bajraktari i zonës i cili ishte edhe klient i tij.

Dr. Hasani i mahnitur nga bukuritë dhe ujërat e Thethit, mendon t’i bëjë një shërbim humanitar Thethit, një nxitje për emancipim, duke bërë një

6. Uruçi, Gëzim, “Personalitete të shquara në memorien e malësorëve tanë”, (*Haxhi Dr. efendi Kaduku dhe kroni i Kadukut në fshatin Theth të Dukagjinit*), Shkodër, 1985:127.

marrëveshje të firmosur nga vetë ai dhe lënë shenjat e gishtërinjve nga bajraktari i Shoshit. Ai ndërtoi depozitën e parë të ujit, duke hapur kanale në drejtim të tre kullave kryesore aty pranë. Për këtë arsye, të futjes së ujit në disa shtëpi për herë të parë, që nga ajo ditë ai krua quhet “Kroni i Kadukut”. Kështu krahas kësaj hynë edhe toponime të reja “Livadhi i Kadukut”, “Bajrakja e Kadukut”, etj. Ai i ftoi gjithashtu thethianët, që të vinin dhe t’i kuronin dhëmbët falas në klinikën e tij në Shkodër. Gjatë qëndrimit në bjeshkët e Thethit ai mblidhte dhe përpunonte shumë bimë mjekësore, duke njohur vlerat e tyre për kurimin e shumë sëmundjeve evidente në këtë zonë.

Dr. Hasani, sipas dëshmisë së Lulash Markut, fshatar i zonës, ishte bërë shumë i vizituar nga malësorët e zonës, madje ai u lexonte me kënaqësi edhe letrat, që u vinin atyre.

Hafiz Dr. Hasan Kaduku kuroi e mjekoi gjatë jetës së tij konsuj, priftërinj, hoxxhallarë, diplomatë e njerëz të thjeshtë. Në karrigen e tij u ulën gjithashtu njerëz të shumë kombësive e personalitete të ndryshme.

Dr. Frederik Shiroka do ta quante Haxhi Hafiz Dr. Hasan efendi Kadukun “Legjendë e stomatologjisë shqiptare”.⁷

7. Bizaku, po aty, fq. 8.

Pse duhet te jemi fetar

Abstrakt

Kur-ani është një vepër e denjë për ç'do respekt. Kur-ani i ka njoftue njerëzsis tagrin e Zotit; ja shkoqitë qartaz njeriut marëdhaniet që ka me Perëndin dhe ç'duhet të pres prej Tij. Kur-ani mbështet krejt bazat morale e filozofike. Virtuti e vesi, e mira dhe e keqja, e vërteta dhe ngjyra e vërtetë e ç'do sendi është spjegue në Kur-an...

Kur-ani është ai që disa thërmija grindavecësh të bastardhuëm e të degjeneruëm i lidhi ngusht dhe i bashkoj në një tansi Kombëtare që kishte të bëjë me fatin e botës. Themelet e urtës e të filosofis, drejtsija e barasija, janë spjegue në Kur-an.

Kur-ani këshillon e porosit kursim dhe shpenxime me masë; Aj nxjerr në dritë njerin që ka humbë rrugën. Aj shpëton moralin. Kur-ani të mëtat dhe gabimet e njeriut i ndryshon dhe i këmben në vërtete të larta e të përsoruna.

Kanë qenë të marrë ata që Islamiçmës i kanë thanë fë barbare. Këta njerëz i kanë mbyllë sytë përpara Kur-anit, dhe s'kan dasht të kuptojnë se si ky libër i naltë qysh prej shumë shekujsh po shkël e po resitë nga zemrat e njerzvet veset e liga.

Po të shfletojmë historinë botnore, kemi me konstatuer se asnjë popull a komb nuk ka jetue mbi syperfaqe të tokës pas pasur besim ndaj një Hyjnië. Ndjenjat shpirtnore dhe rrethanat dhe rrethanat e kohës i shyjshin dhe, bile, i detyrojshin popujt e ndryshëm me besue në diçka.

Pra, popujt primitivë tue u përpjekë nër errsina të shekujve, u shtërnguën të shpikin besime të kota. Këto besime, ose së paku një pjesë e tyre ekzistojnë edhe sot e bile, kanë për ndjeksa jo një numur të pakët; P. sh. Paganizma.

Me pak fjalë, që njeriu duhet të jetë fetar dhe që duhet të besojë ndaj një Hyjnië është një nga principet më

kryesore që pohon fare qartë shpirti i tij: “Tuj shëtitë botën, mundeni me gjetë popuj pa kështjellë, pa shpija, pa ligjë, pa qarkullim parje... por një popull pa Zot, pa uratë, pa ceremoni fetare, kurkush s’e pau kund” ka thanë Plutarku.

Për me’e spjegue subjektin e sipërmë, due të flas pakë se si është rregullue dërgimi i Profetëve ndër njerz dhe do të tjera, të cilat, ju, të dashtun lexues, besoj se s’keni m’u merzitet për me këndue.

Si është rregullue dërgimi i Profetëve

Si kur dihet, njerzija kur u krijua më parë ish ignorante dhe primitive. Mësuesit, më parë, i mësojnë foshnjës së vogël, si mbas metodave moderne të Pedagogjis, Abetaren, dhe kufizohen vetëm me aq për vjetin e parë. Po kjo ngjet edhe në krijesën e parë: Zoti – krijuesi i gjatshkafjes – kur krijoi njerin e parë, domodo ky (njeriu) ish ignorant; dhe kështu Perëndija, pra, si mësues i plotditshëm që është, i mësoj këtij elementa më të para dhe më të nevojshme, të cilat i duheshin atij dhe që mund t’i vente në përdorim, apo më mirë me thanë në veprim.

Mirë po njerzija vinte dita ditës tuj u shtue, dhe, pra, njerin e parë e mësoj vetë Zoti (xh. xh.); por të tjerët duhej të mësoheshin, natyrisht, prej një njeriu...

Për këtë qëllim, u dërguë me mission profetik Ademi, krijesa më e parë njerzore, që i mësoj bashkëshekullarve të tij, ç’ka u duheshin dhe u nevojiteshin atyne.

Rrjedh prej vedit se, njeriu, dita ditës, me kalim kohe, vjen e zhvillohet, dhe mendja e tij don të mësojë edhe një gjë të re, ç’ka s’e ka dijtë ditën e kalueme. Ay nuk mund të rrijë gjithmonë është si është. Foshnja del nga barku i nanës tue qenë e vogël nga trupi dhe ignorant; d. m. th. e vogël nga trupi, dhe krejt e vogël kah mendja. Por, me kalim kohe, trupi i saj rritet, dhe mendja e saj o shkon paralel me trupin, që kjo është mënyra më e preferueshme, o shkon më para, ose, disa herë, rrin më mbrapa, a shumë më mbrapa; koha, pra rritë trupin, dhe këshillet e pësimet rrisin mendjen. Shi po kështu edhe njeriu primitiv; këtij me pësimet që i ngjajshin mendja i zhvillohej më tepër. Prandaj, për këtë qëllim, mbas profetit, mësuesit të parë u dërguë një i dytë me program pak më të naltë. Mbas këtij të dytit një i tretë me program pak më të gjanë; dhe mbas këtyre të tjerë, me programin e lypun prej kohës.

Krishti dhe Muham-medi

Jahudit nuk duen t’a pranojnë si të vërtetë profetsin e Krishtit, të cilin e munduen aqë tepër; po kështu edhe Kristjant nuk duen m’e besue se Muhamedi ka kenë Profet.

Mirë po, po t'a vështrojmë punën me pa-ansí kemi me konstatue se do e mos mbas Krishtit duhej të vinte një profet edhe arsytet janë këto:

I.- Se e gjithë bota kish humbë udhën e drejtë ose kish ra mbas superstitioneve dhe idolatrís;

II.- Se Krishti ish dërgue me mission profetik vetëm mbi Israelitët (Beni Israilt), dhe detyra e tij kje me tërëhjekë kët popull në udhë të drejtë; dhe

III.- Se libri i tij, Ungjilli nuk përmbante të tana konditat dhe n'j'ato gjâna qi lypsen njëj personi si kolektivisht dhe individualisht në këtë botë. Ay predikon vetëm mëshirë dhe jetën tjetër... Due me thanë se Perëndija jo vetëm nuk e dërgoi Atë profet të përgjithshëm, por edhe atij populli që j'a dërgoj nuk j'a përmbushi të tana konditat që i duheshin në këtë botë për kohën e ardhëshme.

Pra ish e arësyeshme dhe e domosdoshme ardhja e një profeti mbas Jesu-it, dhe ky profet kje Muham-medi.

Qe paralajmue ardhja e Muhammedit ndër libra të shënjtja?

Kështu na paraqitet një pyetje, të cilës po të dinte gjithë kush me i dhanë përgjegje, do të mjaftojshin vetëm me një "po". Mirë po, për fat të keq, shumica a nuk e dinë të vërtetën, a nuk donë m'e dijtë, apo

e dinë dhe rrinë indiferent kështu që detyrohemi m'u spjegue pak më gjanë. Po të hapim librat e shënjtja, dhe t'i vështrojmë me kujdes, kemi me hasë, aty këtu në versete që flasin drejt për së drejti ose në formë alegorike për ardhjen e një profeti mbas Krishtit; P.sh: -- që të mos zgjatemi më tutje n'Ungjill të "Joanit" – gjejmë shumë kësi versetesh: "Në më doni, ruani porosit' e mija" (faqe 56 krej 14 verseti 15) dhe më tutje, në faqen 57 k. 14 v. 16-17 thotë: "Edhe unë do t'i lutem Atit, dhe do t'u japë juve një tjetër ngushullimtar, që të mbetet bashkë me ju për gjithë jetën." Verseti 15 tregon që t'i binden urdhënit të Krishtit tue veprue si mbas urdhnave të tij; dhe dy të fundit shpjegojnë ardhjen e një profeti mbas Tij. Prap në faqen 57 k. 14 e verseti 24, 26 thotë: "Ay që s'më do fjalët e mija nuk i ruan, edhe fjala që dëgjoni nuk është e imja, po e Atit që më dërgoj". "Po ngushëllimtar, Frymë e shënjtëruarë, të cilën Ati do t'a dërgonjë mb'emërit t'im, ay do t'u mësonjë juve të gjitha edhe do t'u bierë juve ndër mënt gjithë sa u kam thënë juve." Edhe në këta dy versete Krishti ka thanë më parë, për të treguar se duhet të besojnë doemos në profetin e mbas Tij ardhun (e ardhun mbas Tij): "Ay që s'më do, fjalët e mija nuk i ruan..."

Më poshtë në kryen 15 faqe 60 verset 22, 23, për të tregue se mbassi ay i u tregoj të drejtën atyne dhe ata duhet që t'a besojnë pse në mos e

besofshin bëjnë faj; thotë: “Të mos kishnjam ardhur e të mos u kishnjam folur atyre, nuk do të kishin faj; po ndashti nuk kanë ç’të thonë për fajin e tyre.” Prap po n’at faqe e krye verseti 26 e 27 tuj tregue ardhjen e një profeti thotë tekstualisht kështu: “Po kur të vinjë Ngushullimtari, të cilinë do t’u a dërgoj unë juve prej Atit, Fryma e së vërtetës, që del nga Ata, ay do të dëshmonjë për mua. Po edhe ju dëshmoni, sepse që në krye jeni bashkë me mua. “Gjithashtu në kryen 16 faqe 61 verseti 12 e 13 thotë: “Edhe shumë u kam për të thënë juve, po ndashti nuk mund t’i mbani; po kur të vinjë ay Frym’ e së vërtetësë, do t’u heqnjë juve udhën mbë gjithë të vërtetënë; sepse nuk do të flasë prej vetiu...”

Të gjitha këto versete që përshkruam nalt na apin të kuptojmë fare qartë se ardhja e një profeti mbas Krishtit ish e lajmueme edhe e ditun; e gjithë bota ishte ka priste lindjen e Tij. Dhe ky profet nuk vonoj me

ardhë. Më 12 të Rebiul-evvelit, në një natë të bukur e të kthjellët, kur hana hudhte dritën e saj ledhatare mbi syprinë të tokës, dhe yjtë e bukur xixillojshin me gëzim në qiell, lindi Muhammedi, Profeti i ardhshëm dhe i përgjithshëm. Ç’do gjâ t’epete me kuptue se një mrekulli po ndodhte. Dhe me të vërtetë; a nuk qe një çudi ardhja e Muhammedit në këtë botë, dhe kur akoma ish fmí i lutej Zotit vetëm e vetëm për pshtimin e popullit mbarë?...

Karakteristikat që zotnonte Muhammedi, dhe lajmi i dhanun prej Ungjillit për ardhjen e një Profeti mbas Krishtit, banë që Ay të njihej prej Behira-it...

Të mo zgjatemi që ardhja e Muhammedit ka kjenë e paralajmueme flet çiltas “Testamenti i ri”; dhe jo vetëm ky, po por edhe “Testamenti i vjetër”.¹

1. Marrë nga revista “Zani i Naltë”, nr. 8-9, viti 11, gusht-shtator 1936, f. 240-251.

Abstracts in English

Islamic Studies

1. Sociological Aspects in the Qur'an, Juz XXV

Msc. Ada Qama, Madrasa of Tirana "H. Mahmud Dashi"

Sociology, as one of the most important human sciences, has in the focus of its studies man as a social being, as well as the society in which he belongs. Thus, it analyzes man in all episodes of his social interaction and necessarily thus forms a close connection with all other human sciences, such as social psychology, anthropology, philosophy, folklore, history, theology, etc.

One of the subtypes of sociology is the sociology of religion, which examines the interrelationships that exist between social structures and different religions, identifying their religious aspects, practices and forms of organizing religious beliefs through sociological methods and disciplines.

The divine books are an inexhaustible source of pictures of human society throughout different historical periods, therefore, seen from this point of view, they are among the key points that attract the interest of scholars of the sociology of religion.

In this paper, in an abbreviated and concise form, we will present some of the sociological aspects contained in the twenty-fifth juz of the holy book of the Islamic religion, the Qur'an.

Key words: *sociology of religion, sociological aspect, individ.*

2. The role of women in Islam and today's challenges

Msc. Valdrin Mera, Department of Islamic Sciences, Bedër University

As the first sociological community, the family is the smallest building unit and fundamental element of society, and as such, has managed to survive any danger despite the changes it has undergone throughout history. The main protective role in the regard of "family", have religion and traditions as institutions that organize social life

According to historical and anthropological data, women have always been at the center of the "family institution". From the perspective of Islamic religion, the woman has a family-forming position and is the main carrier of the current social structure. Most of the

chapters written about women, in classical Islamic works, focus on the crucial importance of the family in Islam and the central role of women in maintaining the family unit. Based on the various functions that society obliges, the woman appears as “mother”, as “daughter”, as “sister” and so on.

Numerous cultural developments and the changing role of women in the 21st century has made a mandatory a more global approach the issue of women in the Islamic universe of reference. This article, beyond the repetition of norms, duties, and rights, literally looks at finding a way to face contemporary challenges in coherence with the divine message while staying faithful to fundamental principles and goals.

Key words: Religion, Family, Tradition, Institution, Woman in Islam.

Studies

3. Modern Biology as a Cultural Expression

Fatos A. Kopliku, Ann Arbor, Michigan, USA

This essay traces the genesis of the mechanistic and scientific premises, which became the root of a new worldview in the West where the role of the Divine gradually diluted to the point that the only “real” things became random material forces. These premises gave rise to a new culture, expressed in a variety of forms, especially in the evolutionary theory of Darwin. The latter was a result, a precipitation of a long process of saturation of philosophical materialism that occurred because of a gradual loss of metaphysical transparency in the West.

Key words: History of science, history of ideas, biology, evolution, cultural expression

4. Reflections from demographic data of the world Muslim population

Ilir Akshija, University Hospital Center, “Mother Teresa”, Statistics Department

Demographic data are essential to Islamic societies. The origins of a census are to be found in the first year of Islamic calendar ordered by the Prophet (pbuh). The actual number of people populating earth is comparable to the supposed number of Muslims who ever lived on earth is at least interesting. Leaving the spiritual interpretation to the competent ones we could give, based in ‘semi-scientific data’, an approximate of this number. Calculations show that from 107 billion people ever lived on earth while 7,269,215,000 (6.8%) were born Muslims. Further elaboration of data represented graphically show the ever living Muslim population as proportion to the living at that point on time of other humans’ population which indicates some interesting breaking points. All data have to be taken in consideration carefully because of precarious sources of information.

5. Madrasas in Kosovo during the Ottoman period

Dr. Sadik Mehmeti, University of Prishtina, Faculty of Philology

With penetration of the Ottomans in Kosovo and with the establishment of their administration (XIV - XV centuries), and after the acceptance of Islam by most of its population, they, as is well known, have brought to these parts the same principles of which they had appropriated from the Arabs and Persians. Among these are the Muslim religious schools - mektepes and madrasas -, which, behind the mosques, we encounter very early in Kosovo.

In fact, the first beginnings of the Islamic educational activity in our lands date back to the earliest period of the creation of the first nuclei of the Islamized Albanian community. This activity in its beginnings took place in the mosque, or near the mosque. Precisely for this reason, the history of the activity of Islamic education is related to the history of the establishment of the first mosques in these lands, which began in the first years of the establishment of Ottoman rule.

6. LPA (Labour Party of Albania) Policy against Religious Beliefs: Measures with Legal Character and Propaganda Campaign in 1967

Msc. Xhorxhina Seferi, Department of Islamic Sciences, Bedër University

Immediately after liberation from the fascist conqueror, the communist regime was established in Albania, which was based on the dictatorship of the proletariat and the class struggle. The government led by Enver Hoxha in the first years after the liberation was presented as a visionary government, which had drafted projects for the country's educational, cultural, economic and social development. In its beginnings the communist state was not affirmed in public as an atheist state, but as a secular state. However, this would not prevent the state from starting the struggle for the eradication of religion as an opposing ideology. Developed in a closed society with a low cultural level, communist propaganda managed to denigrate the clergy and violate the integrity of religious services. In 1967 was developed intensively an open and programmed propaganda against religious beliefs, which showed the need of the regime for political and social uniformity. In this study of LPA (Labour Party of Albania) policies against religious beliefs, we stopped at the establishment of the communist regime in Albania, its relationship with religious communities, the first measures against religious beliefs, the methods used in the fight against religion, propaganda campaigns and the main propaganda tools, the clergy attitude to the ban on religious activity in the country.

Key words: Religious beliefs, LPA, Propaganda, Legal Measures, The ban on religion, Atheism, Communism, Regime, Religious Communities, Albania.

Islamic Pedagogy

7. The most important theses in the issue of the education of our children, Prof. Ahmed Muadh el Hatib

Human education is really weird. There are different forms and ways of human education. Each individual, in itself, is a world. The more laws that follow it, the greater the intimacy and wealth of its interior is felt. The upbringing of children, in particular, is a fruitful and acceptable environment, and the more the educator strives, the more human art is shown in it, and it becomes a beacon of guidance, rebirth, and wisdom.

For this reason, it is very difficult to describe in some sheets that incomprehensible, multidimensional and self-renewing world, but this is a small supplement, the purpose of which is to uncover a curtain and illuminate this subject due to obligation, counseling and mutual remembrance.

Sociology of Islam

8. Social issues found in the verses of the Noble Qur'an Prof. Dr. Sadije Bushati

Muslim scholars often value the Glorious Qur'an, for the basic principles by which human life is regulated, because it regulates the whole of society, even at all times.

The Glorious Qur'an consists of 114 suras, which have a certain number of verses. The number of the latter ones varies from 3 to 286 verses. It deals not only with social issues, but also legal, scientific ones, in a word, it is the regulator of all the problems of a society, of course if its rules are known and applied and with full conviction. "It is true that this Qur'an guides to the path that is most right..."

Communication Sciences

9. The role of women in the education of generations, based on Islamic cultural magazines

Dr. Ilirjana Kaceli, Universiteti Bedër

In all historical periods, as well as in all societies, the role of women in the family and society remains irreplaceable. They are distinguished not only in their duty as mothers, wives, sisters, daughters, but also as scholars, leaders and leaders of the state. They have tried and succeeded in educating generations, who with their works left a mark and trace in history. They raised their children with love and sacrifice for the homeland, endowed them with the right culture and education to be worthy sons and devout believers. They

play the main role in the family, which is the basis of society and as such we can say that society and the state thrive and prosper only from discipline, order, unity and peace, as well as from educated and well-educated individuals. The figure of the woman and her role in the education of generations has occupied an important place in Islamic cultural magazines such as: Zani i Naltë, Kultura Islame, Njeriu, Dituria Islame, Drita Islame published in Albanian areas. These magazines extensively covered the broad activity, human mission, dedication, faith, devotion, and rare qualities of many Muslim mothers, sisters, and women.

10. The Quran and Sufism

William C. Chittick

Modern-day scholars commonly take the word “Sufism” as a synonym for mysticism, spirituality, or esotericism. The twin foundations of Islam—the Quran and the Sunnah—provide guidance on three levels: activity, understanding, and transformation; or practice, thought, and spirituality. Those Muslims who held that the goal of both right activity and correct understanding was transformation of the soul, that is, achieving inner conformity with al-Haqq, “the Real”, the Supreme Truth and Absolute Reality that is God Himself, were often called “Sufis”. The Sufis focus on assimilating the soul to the Divine Word on the basis of the model established by the Prophet. For them, the goal of the Islamic tradition is “realization” (taḥqīq). To achieve realization means to reach the Real, to see and understand all things in light of the Real, and to act rightly and appropriately in all situations. This demands the transformation of the very being of the seeker, and Sufi writings explain the nature of this transformation, describe the path that can lead to it, and offer practical instructions and means on how one can travel on the path. This article expounds on the Qur’anic roots of such a path, with a stress on love.

11. Review of the book “Hodja Kadri Prishtina Islamic Thinker” by

Mr. Qemajl Morina

Refik Gerbeshi, Kosovë

Personalities

12. H. Dr. Hasan Kaduku (1865-1948), a Hafiz of Qur’an, the first Albanian dentist

Dr. Genti Kruja, Department of Islamic Sciences, Faculty of Humanities and Law, Bedër University

Retrospective

13. Why we should be religious

The Qur'an is a deed worthy of all respect. The Qur'an has informed man of the attribute of God; make clear to man the relationship he has with God and what to expect from Him. The Qur'an encompasses all moral and philosophical foundations. Virtue and vice, good and evil, truth and true color of everything is explained in the Qur'an...

The Qur'an is the one who tied some pieces of bastardized and degenerate quarrelsome people together and united them in a National unity that had to do with the fate of the world. The foundations of wisdom and philosophy, justice and equality, are explained in the Qur'an.

The Qur'an advises and envisions mass savings and expenses; It brings to light the man who has lost his way. It saves morale. The Qur'an changes man's faults and mistakes and exchanges them for high and perfect virtues.

It was foolish to call Islam a barbaric religion. These people have closed their eyes to the Qur'an, and they did not want to understand how this lofty book has been eradicating evil vices from the hearts of people for many centuries.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikulli duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.

REVISTË SHKENCORE DHE KULTURORE

Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti X (XXIV) - Nr. 33 (186)

Shkenca Islame

Msc. Ada Qama, Medreseja e Tiranës “H. Mahmud Dashi”

Msc. Valdrin Mera, Departamenti i Shkencave Islame, Universiteti Bedër

Studime

Fatos A. Kopliku, Ann Arbor, Michigan, SHBA

Msc. Ilir Akshija, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, Shërbimi i Statistikës

Histori

Dr. Sadik Mehmeti, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë

Msc. Xhorxhina Seferi, Departamenti i Shkencave Islame, Universiteti Bedër

Pedagogji Islame

Prof. Ahmed Muadh el Hatib

Sociologji Islame

Prof. Dr. Sadije Bushati

Shkenca Komunikimi

Dr. Ilirjana Kaceli, Departamenti i Drejtësisë, Universiteti Bedër

Përkthime

William C. Chittick

Reçencë

Refik Gerbeshi, Prishtinë

Personalitete

Dr. Genti Kruja, Departamenti i Shkencave Islame, Universiteti Bedër

Retrospektivë



Çmimi 300 lekë / 3 €